

Prof. Dr. Mimoza Gjokutaj (Çano)

Prof. Dr. Islam Krasniqi

Prof. Dr. Shezai Rrokaj

Saranda Kumnova (Pozhegu)

# Libër për mësuesin Abetare

(ABETARE E PËRBASHKËT SHQIPËRI-KOSOVË)

*duk<sup>2</sup>gjini*

BOTIME



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © Pegi & Dukagjini, 2012  
Të gjitha të drejtat lidhur me këtë botim janë ekskluzivisht të zotëruara nga Botime "Pegi", Shqipëri dhe "Dukagjini", Kosovë. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar pjesërisht ose tërësisht pa miratimin paraprak nga botuesi.

## BOTIME



**dukagjini**

---

**Shtëpia botuese:** Tel: 042 374 947; Cel: 069 40 075 02  
**E-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al  
**Spektori i shpërndarjes:** Tel/Fax: 048 810 177; Cel: 069 20 267 73  
**Shtypshkronja:** Tel: 048 810 179; Cel: 069 40 075 01  
**E-mail:** shtypshkronjapegi@yahoo.com

---

---

**Adresa:** "Ismail Qemali" Nr. 2 - 30 000 - Pejë  
**E-mail:** info@dukagjinigroup.com; web: www.dukagjinigroup.com  
**Tel/Fax:** +381 39 431-601; 432-025; 432-341; 433-093; 434-281

---

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

## **PJESA I: Programi, metodologjia dhe struktura**

I.1. Hyrje

I.2. Programi i gjuhës shqipe (Abetare), klasa I, miratuar nga MASH, Shqipëri

I.3. Programi analitik i Abetares, i zbërthyer sipas programit të miratuar nga MASH/MASHT, Shqipëri-Kosovë

I.4. Struktura e kurrikulës së Gjuhës shqipe – Abetare

I.5. Parimet udhëheqëse të kurrikulës së Gjuhës shqipe – Abetare

I.6. Metodologjia e mësimit të Gjuhës shqipe – Abetare

## **PJESA II: Udhëzime shkencore, didaktike, metoda dhe strategji mësimdhënieje**

A) Udhëzime të përgjithshme

- Udhëzime për Paraabetaren

- Udhëzime për Abetaren

- Udhëzime për Pasabetaren

- Udhëzime për Librin e Punës

B) Metoda, teknika e strategji mësimdhënieje

- Metoda ndërvepruese të nxëni

- Metoda të punës në grup

- Metoda të zhvillimit të mendimit kritik

C) Modele mësimi

- Modele mësimi për Parabetaren

- Modele mësimi për Abetaren

- Modele mësimi për Pasabetaren

## **PJESA III:**

## **Vlerësimi**

- Probleme të përgjithshme të vlerësimit

- Vlerësimi me fjalë dhe me shprehje

- Vlerësimet motivuese

- Përgatitja e listave të vlerësimit

- Përgatitja e dosjes personale

- Modele testesh

## **PJESA IV: Mjetet didaktike**

- Probleme të përgjithshme për përdorimin e mjeteve

- Mjetet kolektive

- Mjetet individuale

- Mjetet autentike

## **PJESA V: Fjalori**

## PJESA I:

- Programi
- Metodologjia
- Struktura

## I.1. Hyrje

### Si ta kuptojmë dhe si ta përdorim librin e Abetares

Libri i Abetares u mëson nxënësve të lexojnë dhe të shkruajnë të gjithë tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe.

Libri i Abetares u mëson nxënësve të lexojnë me kuptim tregime e tekste të ndryshme me karakter letrar dhe joletrar, të shkruajnë tekste të shkurtra, fjali, fjalë dhe ushtrime të ndryshme me karakter analitik, sintetik dhe krijues.

Ai u mëson nxënësve që, në mënyrë intuitive, të zbulojnë disa dukuri gjuhësore, si: shenja pikësimi, rregulla drejtshkrimore të thjeshta, të cilat bëjnë të mundur mësimin e gjuhës shqipe saktë, bukur e pa gabime.

Ky libër është i mbështetur në metodat më bashkëkohore të tekstologjisë moderne për përvetësimin e lexim-shkrimit fillestar, nëpërmjet një gërshetimi të harmonizuar të metodave alfabetike, globale e analitike-sintetike. Ai mbështetet gjithashtu në traditën e abetaresve të gjuhës shqipe dhe në natyrën e veçantë të gjuhës shqipe, në dallim nga gjuhët e tjera.

Libri i Abetares është i strukturuar në tri pjesë:

- **Paraabetarja**, e cila mbështetet në metodën fonetike-alfabetike-globale;
- **Abetarja**, e cila mbështetet në metodën analitike-sintetike;
- **Pasabetarja**, që është vazhdim i përfundimit të leximit të kuptimshëm.

Libri i Abetares realizon një integrim ndërmjet lëndëve shkollore: lexim, shkrim, matematikë, art, dramë, shkenca etj. Ai mban parasysh botën e fëmijës, si: lojërat, kafshët, ëndrrat, edukimin me dashurinë për prindërit, për mësuesin, për vendin. Jep njohje të mjaftueshme për vendlindjen, natyrën e saj, historinë dhe shoqërinë shqiptare ku flitet shqip. Ky tekst mban parasysh të gjithë larminë e intelektit të fëmijëve.

Libri i Abetares shoqërohet me Abetaren e Punës, përmes së cilës nxënësit do të kryejnë shumë ushtrime gjuhësore për të zbrëthyer e përvetësuar librin bazë.

Libri i Abetares është i shoqëruar me librin e mësuesit, ku mësuesit do të gjejnë shumë parime, zbrëthime didaktike dhe modele mësimi, të cilat pasurojnë përvojat vetjake të mësuesve. Përmes tij jepen edhe shumë këshilla për prindërit.

Ky libër rekomandon për përdorim dhe shumë mjeteve didaktike audio-vizuale të ndryshme, të cilat mund të përdoren në kushtet e klasave të shkollave shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri.

Ai garanton cilësi të lartë të të nxënësve të procesit të lexim-shkrimit dhe një përgatitje tërësore të fëmijëve në përputhje me standardet e kërkuara në këtë program.

## I.2. PROGRAMI I GJUHËS SHQIPE

### ABETARE

#### Klasa e parë

Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Shqipëri dhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Kosovë

#### Hyrje

Mësimi i gjuhës shqipe është një nga objektivat parësorë në të gjithë arsimin e detyruar të shkollës shqipe.

Gjuha shqipe fillon të mësohet në familje, vazhdon më pas në arsimin parashkollor përmes ushtrimeve të të folurit dhe aftësisë të fëmijëve për të lexuar dhe për të shkruar në mënyrë globale. Vijon të pasurohet më tej në arsimin fillor me përvetësimin e aftësive të plota të të lexuarit dhe shkruarit.

Në klasën e parë të shkollës fillore, gjuha shqipe fillon të mësohet në mënyrë sistematike përmes të ushtruarit për lexim-shkrimin fillestar. Në këtë kuptim, gjatë gjithë vitit, në klasën e parë, nxënësit ushtrohen të lexojnë dhe të shkruajnë gjuhën shqipe përmes nyjetimit (shqiptimit) dhe bashkimit të tingujve dhe shkronjave të saj në fjalë dhe fjali të thjeshta por të kuptimshme, përmes leximit të historive (rrëfimeve, copëzave, tregimeve) dhe materialeve të tjera të shkruara, të rekomanduara për nxënësit në librat shkollorë, por edhe jashtëshkollorë.

Në këtë mënyrë, mësimi i gjuhës shqipe në arsimin fillor shoqërohet me ndryshime të mëdha, të cilat lidhen me pasurimin e shprehive komunikative të gjuhës së folur, të gjuhës së shkruar dhe të të lexuarit. Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e parë shoqërohet me përdorimin e disa metodave të të mësuarit të lexim-shkrimit, të cilat lehtësojnë procesin e përvetësimit të shprehive të nxënësve për të lexuar dhe për të shkruar.

Në klasën e parë fillon të shfaqet modeli i gjuhës së shkruar dhe drejtshkrimi i saj, mësohen në mënyrë intuitive koncepte gjuhësore, si: fjala, fjalia, zanoret, bashkëtingëlloret, shenjat e pikësimit, përdorimi i shkro-njëse të madhe etj. Nxënësit fillojnë të dallojnë tekstin, titujt, paragrafët etj.

Mësimi i lexim-shkrimit fillestar ndjek një ecuri didaktike, e cila lidhet me respektimin e tri fazave:

**Faza e parë** lidhet me periudhën përgatitore për lexim-shkrim;

**Faza e dytë** lidhet me mësimin e shprehive themelore të teknikës së lexim-shkrimit;

**Faza e tretë** lidhet me përfundimin e teknikës së lexim-shkrimit

(të thëna ndryshe, Paraabetare, Abetare, Pasabetare).

#### Synimet

Mësimi i gjuhës shqipe (abetares) në klasën e parë të

arsimit të detyruar 9-vjeçar synon të aftësojë dhe të krijojë shprehitë fillestare të nxënësve për zhvillimin e të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën shqipe. Nëpërmjet programit, i cili, tradicionalisht, është përcjellë në shkollën tonë me Abetaren, si libri i parë shkollor, synohet që të formohen nxënësit të aftë si folës, si lexues dhe si shkruar të gjuhës shqipe në nivelin e përshtatshëm për moshën e tyre.

Qëllimi i mësimin të gjuhës shqipe në klasën e parë është:

- përvetësimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme komunikuese;
- krijimi i aftësive individuale për formimin gjuhësor e kulturor;
- përvetësimi i disa normave e gjuhës standarde shqipe;
- përgatitja e nxënësve për ta përdorur gjuhën në formën e saj standarde: të folur, të lexuar dhe të shkruar;
- përgatitja e nxënësve për ta njohur jetën në aspektet të ndryshme të saj;
- përgatitja e nxënësve për të njohur dhe për të marrë pjesë me interes dhe gatishmëri për tema të ndryshme me karakter edukativ dhe shoqëror;
- edukimi dhe motivimi i nxënësve me ndjenjën dhe edukatën e punës, për të mësuar dhe për të nxënë në mënyra dhe forma të ndryshme.

Në këtë mënyrë, përmes gjuhës shqipe dhe lëndëve që rrjedhin prej saj: Abetare, Gjuhë e Lexim, aftësohen nxënësit për ta përdorur gjuhën shqipe (gjuhën amtare) në nivelin që e kërkon shoqëria shqiptare sot.

Nëpërmjet arteve të gjuhës (të thëna ndryshe edhe fusha studimi apo linja e nënlinja), në shkollën shqipe, në klasën e parë, lënda **Gjuhë shqipe** (Abetarja) synon t'i aftësojë nxënësit:

- a- për zhvillimin e dëgjimit të vëmendshëm;
- b- për zhvillimin dhe pasurimin e fjalorit dhe të folurit me përpikëri;
- c- për zhvillimin e të lexuarit dhe të kuptuarit e tij;
- d- për zhvillimin e të shkruarit të gjuhës standarde shqipe.

Duke e diferencuar mësimin e gjuhës shqipe nga

njëra klasë në tjetrën, le të njihemi në mënyrë të përmblendhur me synimin e të mësuarit të kësaj lënde në klasën e parë:

**“Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e parë synon të aftësojë dhe të krijojë shprehitë fillestare të nxënësve me qëllim që ata ta flasin, ta lexojnë dhe ta shkruajnë bukur gjuhën shqipe”.**

## Fushat e studimit të programit

1. **Zhvillimi i shprehive komunikative: të folurit e të dëgjuarit**
2. **Shprehitë komunikative të lexim-shkrimit**
  - të lexuarit
  - të shkruarit
3. **Njohuri gjuhësore**

### OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Synimet e programit për mësimin e gjuhës shqipe (Abetare) në klasën e parë, të zbërthyer në objektiva sipas fushave të mësipërme, kanë si objektivi t’i aftësojnë nxënësit në fushat e mëposhtme:

#### **Zhvillimi i aftësive dëgjuese dhe folëse**

#### **A**

- Të flasin qartë e bukur në gjuhën shqipe.
- Të pasurojnë në vazhdimësi fjalorin dhe të folurin bazë në përkatësi me moshën.
- Të nyjëtojnë qartë tingujt e shqipes.
- Të dëgjojnë në grupe të vogla dhe të mëdha.
- Të dëgjojnë me vëmendje dhe t’u përgjigjen bashkëfolësve në kontekstin për të cilin flitet.
- Të tregojnë me vëmendje bisedat që lidhen me jetën dhe veprimtarinë e tyre.
- Të aftësohen për të hyrë në bashkëbisedim me bashkëfolës të tjerë, bashkëmohatarë dhe të rritur.

#### **B**

- Të shqiptojnë drejt fjalët e gjuhës shqipe.
- Të bashkëbisedojnë lirshëm me njëri-tjetrin.
- Të japin sqarime dhe udhëzime të thjeshta, kur u duhen dhe kur u kërkohen.
- Të dëgjojnë me vëmendje bashkëbiseduesin.
- Të mbajnë qëndrimin e duhur të trupit dhe gjestive.

- Të bëjnë pyetje kur është e nevojshme.
- Të kërkojnë sqarime kur kanë nevojë për to.
- Të kryejnë biseda të thjeshta telefonike.
- Të ritregojnë përmbajtje të thjeshta tregimesh apo historish që kanë lexuar a dëgjuar nga të tjerët.
- Të emërtojnë objekte, zhurma e zëra që i rrethojnë dhe shohin.
- Të tregojnë histori dhe përralla të thjeshta, të dëgjuara a të lexuara më parë nga të rriturit ose nga ata vetë.

#### **Zhvillimi i aftësive për të lexuar dhe për të shkruar**

- Të fitojnë shprehinë e teknikës së të lexuarit dhe të shkruarit.
- Të lexojnë fjalë në mënyrë globale.
- Të lidhin tingullin me shkronjën përkatëse.
- Të lexojnë globalisht fjalë të tilla, si: *libër, faqe, titull, shkronjë*.
- Të dallojnë tekstin nga fjalia dhe fjala.
- Ta ndajnë tekstin në fjali dhe në fjalë.
- Të bëjnë analizë dhe sintezë të fjalëve.
- Të dallojnë tingujt dhe shkronjat e ngjashme.
- Të dallojnë bashkëtingëlloret dhe zanoret.
- Të njohin dhe të thonë përmendsh shkronjat e alfabetit.
- Të lexojnë saktë shkronjat dyshe të alfabetit.
- Të lexojnë në mënyrë të kuptimshme.
- Të ritregojnë thjesht përmbajtjen e pjesëve që lexojnë.
- Të dallojnë terma letrarë, të tillë, si: *varg, vjershë, tregim, përrallë, libër, kapak e titull*.
- Të njohin revista për fëmijë, gazeta, fletushka, emisione për fëmijë, *kaseta, CD etj*.
- Të luajnë në role pjesë të dramatuara.
- Të zhvillojnë imagjinatën, duke u udhëhequr nga figura apo tregime me figura.

- Të fillojnë të lexojnë edhe në tipa tekstesh joletrare (përmes lojërave elektronike).
- Të shfaqin dëshirë për të lexuar tekste të tipit: *gjëegjëzë, përrallë, fjalë të urta*.
- Të shfaqin dëshirë për të lexuar tekste të tipit historik (*prozë, vjersha, skeç*).
- Të respektojnë gjatë leximit shenjat e pikësimit, si: *pikën, presjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen*.
- Të lexojnë me intonacionin e duhur fjalitë dëftore dhe pyetëse.
- Të japin shpjegime të thjeshta mbi tekstet që lexojnë.
- Të dallojnë në një histori: *personazhet, vendin dhe kohën* kur zhvillohen ngjarjet.

#### Zhvillimi i aftësive shkruese

- Të shkruajnë fjalë dhe shprehje globale.
- Të shkruajnë shkronjat e dorës të gjuhës shqipe.
- Të shkruajnë shkronjat e mëdha të dorës.
- Të shkruajnë fjali të thjeshta.
- Të ndajnë fjalët në rrokje.
- Të shkruajnë me të diktuar fjali dhe paragrafë të thjeshtë.
- Të plotësojnë fjalët në vendet ku mungojnë.
- Të emërtojnë objekte, dukuri për të cilat dëgjojnë, flasin apo lexojnë, të tilla si: *fluturim, re, shi, këngë, sport etj.*
- Të shkruajnë letra e kartolina të thjeshta, duke parë dhe duke kopjuar modele.
- Të përshkruajnë përvoja vetjake.
- Të shprehin mendime e ndjenja vetjake.
- Të shkruajnë drejt dhe pa gabime drejtshkrimore.
- T'u përgjigjen me shkrim pyetjeve që u bëhen.
- Të shkruajnë tregime të thjeshta, duke pasur si udhërrëfyes figura apo filma multiplikativë.
- Të përdorin shenjat e pikësimit, si: *pikën, pikëpresjen etj.*

#### Njohuri nga gjuha

- Të dallojnë tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe.
- Të dallojnë sipas intonacionit fjalinë pohore dhe pyetëse.
- Të dallojnë sipas intonacionit fjalinë pohore nga mohore.
- Të dallojnë emrat e njerëzve dhe të sendeve.
- Të dallojnë emrat kur janë njëjës dhe shumës.
- Të dallojnë emrat kur janë femërorë dhe mashkulorë.
- Të dallojnë emrat e njerëzve.
- Të gjejnë dhe shkruajnë fjalët që tregojnë se si janë njerëzit, sendet, kafshët.
- Të dallojnë nën drejtimin e mësuesit fjalët që tregojnë veprime (folje).
- Të dallojnë fjalë që tregojnë veprime që janë bërë më parë, bëhen tani dhe do të bëhen më pas.
- Të përdorin shkronjën e madhe tek emrat e njerëzve.
- Të përdorin shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe tek emrat e njerëzve.

### Fushat e studimit të programit

Nr.	Fushat e studimit	Koha
1	Zhvillimi i aftësive folëse të nxënësve, pasurimi i fjalorit	30%
2	Zhvillimi shprehive fillestare të të lexuarit	30%
3	Zhvillimi i shprehive fillestare të të shkruarit	30%
4	Njohuri mbi gjuhën	10%



## Përshkrimi i nivelit të nxënësit në përfundim të klasës së parë

Fusha 1. Zhvillim të foluri	Fusha 2. Shprehitë fillestare të të lexuarit	Fusha 3. Shprehitë fillestare të të shkruarit	Fusha 4. Njohuri mbi gjuhën
1. <b>Merr pjesë</b> në situata të thjeshta dhe të larmishme të foluri.  Ka fjalor të pasur me fjalë dhe shprehje që i përkasin fushës për të cilën flitet.	1. <b>Njeh</b> shkronjat dhe i shqipton drejt ato sipas metodës nyjetimore: <i>Tingull-shkronjë/Shkronjë-tingull.</i>	1. <b>Shkruan</b> drejt shkronjat e gjuhës shqipe.	1. <b>Emërton</b> sende dhe frymorë, i diferencon mbi bazën e figurave apo të dëgjimit të emërtimeve të tyre.
2. <b>Flet</b> për tema që i interesojnë, të cilat lidhen me emisionet e TV apo filmat e parë, si dhe për tema që i rekomadohen e diktohen.	2. <b>Lexon</b> fjalë e grupe fjalësh në mënyrë globale.  (Lexon 30-40 fjalë e grupe fjalësh)	2. <b>Modelon</b> dhe shkruan fjalë globale.	2. <b>Shkruan</b> me shkronjë të madhe në fillim të fjalive.
3. <b>Pasuron</b> fjalorin me fjalë dhe shprehje të fushave tematike që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme.	3. <b>Njeh dhe lexon</b> shkronjat e gjuhës shqipe, të bashkuara në rrokje të thjeshta, të hapura apo të mbyllura.	3. <b>Dallon</b> dhe i përdor në vendin e duhur shkronjat e gjuhës shqipe.	3. <b>Shkruan</b> me shkronjë të madhe emrat e njerëzve.
4. <b>Përdor</b> saktë gjuhën shqipe, duke përmirësuar strukturën sintaksore.	4. <b>Shqipton qartë</b> tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe.	4. <b>Shkruan</b> të gjitha shkronjat, zanoret dhe bashkëtingëlloret.	4. <b>Shkruan</b> në mënyrë intuitive drejt fjalët sipas modelit (njëjës-shumës).
5. <b>Shpreh</b> mendimet qartë, saktë, bukur, duke treguar vëmendje gjatë bashkëbisedimeve.	5. <b>Dallon</b> tekstin, fjalinë, fjalën.	5. <b>Modelon</b> shkronjat e shqipes.	5. <b>Shkruan</b> duke imituar modelin dhe me intuitë fjalët që tregojnë veprime të kryera në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen.
6. <b>Përmirëson</b> aftësitë gjuhësore folëse.	6. <b>Ndan</b> fjalinë në fjalë dhe fjalën në rrokje.	6. <b>Shkruan</b> fjalë të thjeshta me dytri rrokje.	6. <b>Përdor</b> shenjat e pikësimit, si: pikën (.) e pikëpyetjen (?).
7. <b>Flet</b> në mjedise klase <i>me</i> dhe <i>për</i> njëri-tjetrin.	7. <b>Bën analizën</b> e fjalëve në rrokje dhe tinguj.	7. <b>Shkruan</b> dhe lidh kuptueshëm fjalët në struktura fjalish.	7. <b>Shkruan</b> fjalët që tregojnë cilësi.
8. <b>Shkëmben</b> mendime për çështje që u interesojnë.	8. <b>Lexon</b> me logjikë, qartë, saktë dhe kuptueshëm.	8. <b>Shkruan</b> me të diktuar.	8. <b>Vendos</b> në formën e duhur fjalët në vendet që mungojnë.
9. <b>Tregon</b> histori dhe tregime të thjeshta.	9. <b>Riprodhon</b> përmbajtjen e pjesëve të lexuara.	9. <b>Shkruan</b> me të kopjuar.	9. <b>Ushtrohet</b> për të shkruar drejt dhe pa gabime.
10. <b>Tregon</b> me dëshirë përralla të dëguara përmes magnetofonit, radios, TV ose librave të lexuar.	10. <b>Lexon</b> në mënyrë të kuptimshme.	10. <b>Shkruan</b> duke plotësuar pjesë të fjalës ose të fjalisë që mungojnë.	10. <b>Ushtrohet</b> për të shkruar drejt fjalët e gjata të gjuhës shqipe.

11. Mëson përmendsh dhe reciton vjersha.	11. Ka shpejtësinë normale të të lexuarit (45-100 fjalë në minutë).	11. Shkruan duke iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme.	11. Përdor saktë shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe tek emrat e njerëzve.
12. Luan në role pjesë të thjeshta.	12. Lexon libra të natyrave të ndryshme, në përshtatje me moshën.	12. Kopjon pjesë që kanë dialog deri në 3-4 fjali.	12. Vendos shenjat e pikësimit në dialog: vizën (-), pikëpyetjen (?) dhe pikën (.) nën kujdesin e mësuesit.
13. Ritregon përmbajtjen e librave që lexon.	13. Lexon libra të natyrave të ndryshme.	13. Shkruan tregime të thjeshta nga figurat që i ofrohen.	13. Respekton shkronjën e madhe në fillim fjalisë dhe në titujt e pjesëve.

## Zbërthimi i programit

35 javë x 8 orë = 280 orë

LINJAT <sup>1*</sup>	NR	FAZAT	ORËT
	1.	<b>Periodha përgatitore (Parabetare )</b>	<b>4 javë x 8 orë = 32 orë</b>
D & F	1.1.	Shqiptimi i tingujve të shqipes. Shkrimi i shkronjave.	
D & F	1.2.	Zhvillimi i të folurit. Pasurimi i fjalorit.	
L	1.3.	Lexim global dhe shkrimi i fjalëve dhe fjalive.	
Sh	1.4.	Shkrimi i elementeve të shkronjave dhe i fjalëve e i fjalive të thjeshta në mënyrë globale.	
	2.	<b>Periodha e Abetares</b>	<b>26 javë x 8 orë = 208 orë</b>
D, F, L & Sh	2.1.	Punimi i 6 shkronjave të para. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	6 x 5 orë = 30 orë
D, F, L & Sh	2.2.	Rimarrje e 6 shkronjave të para.	4 orë
D, F, L & Sh	2.3.	Punimi i 6 shkronjave të dyta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	6 x 5 orë = 30 orë
D, F, L & Sh	2.4.	Rimarrje e 6 shkronjave të dyta.	4 orë
D, F, L & Sh	2.5.	Punimi 6 shkronjave të treta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	6 x 5 orë = 30 orë
D, F, L & Sh	2.6.	Rimarrje e 6 shkronjave të treta.	4 orë
D, F, L & Sh	2.7.	Punimi 6 shkronjave të katërta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	6 x 5 orë = 30 orë
D, F, L & Sh	2.8.	Rimarrje e 6 shkronjave të katërta.	4 orë
D, F, L & Sh	2.9.	Punimi 6 shkronjave të pesta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	6 x 5 orë = 30 orë
D, F, L & Sh	2.10.	Rimarrje e 6 shkronjave të pesta.	2 orë
D, F, L & Sh	2.11.	Punimi i 6 shkronjave të pesta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	6 x 5 orë = 30 orë

D, F, L & Sh	2.12.	Rimarrje e 6 shkronjave të fundit.	4 orë
		Në dispozicion të mësuesit	4 orë
	3.	Pasabetare	5 javë x 8 orë = 40 orë
L	3.1.	Lexime.	18 orë
D, F, L & Sh	3.2.	Ushtrime gjuhësore.	18 orë
		Në dispozicion të mësuesit	4 orë
		GJITHSEJ	280 orë

## Metodologjia e zbatimit të programit

### 1. Metodatat e mësimit të Abetares

Metodat më të përdorshme për mësimin e lexim-shkrimit fillestar janë:

1. **metoda fonike-alfabetike;**
2. **metoda globale “Shiko dhe lexo”;**
3. **metoda analitike-sintetike.**

**Metoda dëgjimore dhe pamore (fonike-alfabetike)** lidhet me aftësimin e nxënësve për të shqiptuar dhe për të lexuar drejt tingujt e gjuhës shqipe, duke i lidhur me shkronjën përkatëse. Ushtrime të kësaj njohjeje dhe lidhjeje me fëmijët duhen bërë që në moshat e hershme, me qëllim njohjen e tyre para se të hyjnë në arsimin e detyruar. Zakonisht, kjo metodë nxit njohjen e veçuar të tingujve dhe shkronjave.

Kjo metodë është shumë e rëndësishme në hapat e parë të ushtrimit të nxënësve për lexim-shkrim. Ajo fillon në kopsht dhe mund të shtrihet në fazën përgatitore të mësimit të lexim-shkrimit.

**Metoda “Shiko dhe lexo” (globale)** lidhet me elemente të metodës globale, në të cilën, nxënësit, në mënyrë të pavarur, por edhe të orientuar, mund të lexojnë fjalë apo shprehje në mënyrë globale, të cilat diktohen nga përvojat e tyre, si: *njohja dhe leximi i titujve të librave, i emisioneve, i reklamave, i etiketave dhe shumë materialeve të tjera autentike.*

Ushtrimi i kësaj metode gjatë mësimit të Abetares është karakteristikë për fazën përgatitore, por mund të përdoret edhe në hapat e parë të mësimit të Abetares.

Është e rëndësishme që gjatë ushtrimit të saj, mësuesi t’i ushtrojë nxënësit për të lexuar e shkruar në mënyrë globale fjalë të fjalorit të nevojshëm dhe

të domosdoshëm, i cili do t’u duhet nxënësve për të lehtësuar më tej procesin e të lexuarit dhe të shkruarit.

Në këtë kuptim, mësuesi mund ta ndërtojë vetë këtë fjalor. Ai mund të përbëhet nga disa fjalë të thjeshta dhe pak folje të nevojshme për faqet e para të Abetares, ku nuk mund të lexohen në mënyrë sintetike.

**Metoda analitike-sintetike** është metoda bazë, ku mbështetet mësimi i lexim-shkrimit. Koncepti mbi këtë metodë lidhet me analizën dhe sintezën e tekstit, fjalisë, fjalës, rrokjes. Në të njëjtën mënyrë siç zbërthen dhe mbërthen një makinë-lodër, fëmija duhet të punojë edhe me gjuhën (tekstin, fjalinë, fjalën, rrokjen).

Kjo metodë e ndërthurur edhe me metodat e tjera mundëson arritjen e objektivave të mësipërm dhe një cilësi të mirë të nxënësve në lexim-shkrimin fillestar.

## 2. STRUKTURA E PROGRAMIT

Programi i Abetares është një program shumë i rëndësishëm për përfshirjen e nxënësit në veprimtari të nxëni, që lidhen me fitimin e shprehive fillestare për lexim-shkrimin e gjuhës amtare.

Për këtë qëllim, që në hapat e parë të tij,

mësuesi duhet të përqendrohet në një komunikim të ngrohtë me nxënësit dhe në gjithëpërfshirjen e tyre në përvetësimin e këtij programi.

Programi i Abetares përbëhet nga tri periudha:

### 1) Periudha e parë

**Periudha përgatitore**, që zakonisht shoqërohet me Abetaren e Punës dhe materiale të tjera didaktike me efekte të dallueshme për lexim-shkrimin, me veprimtari që i shërbejnë mësimit të lexim-shkrimit fillestar në gjuhën shqipe.

### 2) Periudha e dytë

Periudha e dytë lidhet me përvetësimin e teknikës së lexim-shkrimit. Ajo zakonisht shoqërohet nga *libri i Abetares* dhe nga fletore pune të përshtatshme për këtë libër. Njëkohësisht shoqërohet edhe me mjete didaktike që e lehtësojnë mësimin e lexim-shkrimit.

### 3) Periudha e tretë

Përforcon shprehinë e nxënësve për lexim-shkrimin fillestar, duke i pajisur nxënësit edhe me disa njohuri të thjeshta gjuhësore. Shoqërohet me pjesë leximi të shkurtra, interesante dhe me ushtrime gjuhësore.

Metodologjia e zbatimit të këtij programi duhet të lidhet me veprimtaritë që duhet të udhëheqë mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit për ta realizuar dhe për ta përvetësuar atë plotësisht.

## 3. VEPRIMTARI DIDAKTIKE TË REKOMANDUARA

Programi i Abetares këshillon që mësime të bëhen e saj të mbështetet në parimin:

### “Mësimdhënie me në qendër nxënësin”

Për të arritur këtë objektiv metodologjik këshillohet që gjatë punës mësimore për realizimin e objektivave për lëndën “Gjuha shqipe 1” të zbatohen veprimtari të larmishme mësimore, të cilat realizojnë objektiva të caktuar.

Në këtë mënyrë, përmbledhtazi, këshillohen:

#### 1. Lojëra didaktike që lidhen me lexim-shkrimin:

- Dëgjon, vëren, krahason, manipulon.
- Emërton, shqipton tinguj.
- Lidh tingujt me shkronjat përkatëse.
- Formon fjalë me shkronja dhe rrokje lëvizore.
- Formon fjalë dhe fjali me etiketa fjalësh të prera nga revistat dhe gazetatat.
- Ndërton tregime të thjeshta, duke u udhëhequr nga fotot përkatëse.
- Zgjidh enigma, gjëgjëza e fjalëkryqe, në përshtatje me moshën.
- Pret, ngjit, modelon, zbukuron dhe plotëson pjesë që kërkojnë vizatime dhe fjalë.

#### 2. Riprodhim pjesësh

- Ritregon kuptimin e pjesëve të dëgjua.
- Ritregon kuptimin e pjesëve të lexuara.

#### 3. Lojëra me lëndën gjuhësore në tekst

- Vendos titull tjetër.
- Krijon një fillim dhe/ose një fund të ri.
- Shton ndonjë episod.

#### 4. Dramatizim

- Realizon role të thjeshta.
- Realizon lojëra me lëvizje e pantomima, duke imituar personazhe kafshë apo njerëz, të shfaqur në tregimet e lexuara.

#### 5. Recitim

- Reciton poezi të shkurtra dhe të lehta, të përshtatshme për moshën.

#### 6. Lojëra me kukulla

- Realizon në grup lojëra me lodrat, miqtë etj., si: *kukulla, qen, mace, makinë, kafshë parahistorike, robot, ufo etj.*
- Realizon me lodrat personale krijime sipas imagjinatës a pjesëve të lexuara.
- I shoqëron lojërat me zë dhe me ndryshime të tij, sipas roleve që përfaqësojnë.

#### 7. Tregime të imagjinuara

Mësuesi mund të kërkojë që nxënësit të krijojnë apo të realizojnë tregime të ndryshme. Ai mund t'i ndihmojë, duke iu dhënë fjalë kyç të fushave të caktuara tematike p.sh., për lojërat (top, ra, thye, mori, vrau dorën etj.).

## 8. Pasurim fjalori

Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë fjalë me kuptim të njëjtë ose me kuptim të kundërt, të dialekteve të ndryshme të shqipes (çikë-vajzë, bardhë-zi, bar-bar, pjek-pjek etj.). Sipas trevave ku ndodhen mësuesit, tregojnë kujdes me ushtrime të tipit **thuhet ... shkruhet**. Qëllimi i këtij ushtrimi është që nxënësit të mësojnë standardin, nëpërmjet rritjes së vetëdijes për të folmen e zonës ku banojnë.

## 9. Lojëra të zëshme

Imitojnë zërat dhe zhurmat e kafshëve, të njerëzve, lojëra me zë, enigma.

Përdorimi i magnetofonit, i videos dhe i TV-së e pasuron shumë mësimin e gjuhës në veprimtari të tilla.

## 10. Modelim grafik i tekstit

Përpiqen të paraqesin tekste të shkurtra në mure ose të bashkuara me idenë e një gazete të thjeshtë muri ose revista klase, të ndihmuar nga mësuesit dhe nga më të rriturit.

## 11. Lojëra shoqërimi

U përgjigjet shoqërimeve të thjeshta në bazë të fjalëve apo të figurave që u paraqiten.

Mësuesi imiton zhurma të natyrës, p.sh., zhurmën e lumit. Nxënësi shkruan fjalën lumi. Mësuesi imiton mjaullimën e maces dhe nxënësi shkruan fjalën macja. Mësuesi imiton lehtën e qenit, nxënësi shkruan fjalën qeni, e kështu me radhë: shi, erë, makinë, bubullimë, gurgullimë.

Dhe e kundërta, mësuesi nxjerr figurat, nxënësit shkruajnë emrat e tyre dhe imitojnë zhurmat dhe zërat që dalin prej tyre.

Në këtë ushtrim, nxënësit mund të këshillohen të shkruajnë fjali, të udhëhequr edhe nga pyetjet që bën mësuesi ose të shkruajnë pyetje, lidhur me figurat apo zhurmat që ofron mësuesi. Mund të përdoren magnetofoni, videoja etj.

## 12. Organizim dhe përdorim informacionesh

Nxënësit mund të mbajnë shënime të thjeshta telefonike.

Të bëjnë lista të librave të lexuar.

Të riorganizojnë tekste.

Të mbledhin kartolina, të bëjnë koleksione të thjeshta me etiketa, lodra apo stema, kausha e mbajtëse plastike akulloresh, me ambalazhe

ëmbëlsirash, mbështjellëset e çokollatave apo krokanteve, që vetë ata përdorim etj.

## 13. Lojëra me ndërrim vendesh dhe interpretim rolesh

Interpretojnë role nga tregimet e lexuara, role të rriturish: mësuesin, prindin, mjekun, shitësin etj.

## 14. Lojëra me imitime zëri

Imitojnë zërat dhe zhurmat e kafshëve, njerëzve, lojëra me zë, me enigma etj.

## 4. METODAT E MËSIMDHËNIES

Programi “Gjuha shqipe 1” (Abetare) është një program, i cili kërkon njohjen dhe përdorimin e metodave ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat kanë në qendër të mësimdhënies dhe të mësimnxënies nxënësin.

Që ky program të fitojë këto karakteristika, lipset që mësuesit t’i njohin metodat ndërvepruese. Në këtë mënyrë, rekomandohen të përdoren metodat e zhvillimit të mendimit kritik, metodat e programit “Hap pas hapi”, “Të modelit të Rexhio Emilias” etj.

**Puna në grupe** këshillohet si një veprimtari mësimore, e cila jep shumë rezultat në mësimin e lexim-shkrimit fillestar.

**Punët me shkrim** të ofruara për nxënësit përmes fletoreve të punës apo të mjeteve të tjera didaktike janë shumë frytdhënëse.

Rekomandohet **përdorimi i materialeve autentike** për mësimdhënie. Përveç librave bazë, mësuesi dhe prindërit të krijojnë bibliotekën personale të fëmijëve me libra për moshën e tyre.

## 5. MJEDISI I TË NXËNIT

Klasa e parë, ku nxënësi për herë të parë përballet me një mjedis të nxëni, ka shumë rëndësi që të ketë një paraqitje tërheqëse dhe funksionale.

Mjedisi i klasës së parë duhet të jetë i përgatitur në kontekstin e lexim-shkrimit, me mjete figurative, vizatime, figura, shkronja, libra, revista, kaseta me këngë, videokaseta etj.

Për këtë qëllim, klasat e para duhet të jenë të organizuara në mënyrë të tillë, që nëpërmjet organizimit dhe pasurimit të mjedisit, të “godasin” dhe të tërheqin vëmendjen e nxënësve në drejtim të

të lexuarit dhe të shkruarit.

Muret e klasës duhet të jenë të mbushura me sa më shumë materiale të nxëni: *shkronja, fjalë, fjali, libra, mjete të shkruari, lapsa, penela, fletë të bardha ose me ngjyra të madhësive të ndryshme, tabela të mëdha për të manipuluar me fjali, fjalë, rrokje.*

Në klasë ka rëndësi të bien në sy këndi i leximit, këndi i shkrimit, i dramatizimit etj.

Është mirë që mësuesi të këtë edhe kuti të vogla për çdo nxënës, ku të vendosë libra që nxënësi mund t'i lexojë në kohë të ndryshme dhe duke i qarkulluar nga një kuti në një tjetër.

Krijimi i bibliotekës është një objektivi më vete që lidhet me plotësimin e mjedisit të klasës.

Materialet e vendosura nëpër mure duhet të jenë fleksible me qëllim që të mos vjetërohen dhe nxënësit të mos tregojnë më interes për to.

Muret duhet të mbushen me punimet e nxënësve sido që të jenë ato. Ato janë pronë e tyre. Duke u vënë në mure i motivojnë nxënësit për të lexuar dhe shkruar më tepër.

## 6. NDËRTHURJA NDËRLËNDORE (INTEGRIMI)

Mësimi i lexim-shkrimit në klasën e parë lidhet me shumë fusha të veprimtarisë së të nxënësve të nxënësve.

Gjuha është një veprimtari komunikuese e domosdoshme për të gjitha lëndët shkollore. Por, ndërkohë, gjuha nuk mund të mësohet veçmas, pa një marrëdhënie me fushat e tjera të dijeve, siç janë: artet, kultura, edukata qytetare etj.

Në kontekstin e sotëm botëror, tema të tilla, si: *liria, edukata shëndetësore, mjedisi, të drejtat e fëmijëve* etj., nuk mund të anashkalohen në një kurrikulë të re. Këto tema lidhen ngushtë me edukimin global të brezit të ri dhe në këtë mënyrë, përmes synimeve dhe shtrirjeve të kurrikulës, ato duhet të zënë vendin që u takon, për të krijuar ekuilibër dhe koherencë në kurrikulë. Pa respektimin e tyre, një kurrikulë do të ndihet e vjetëruar.

Pavarësisht moshës që kanë fëmijët temat e mësipërme duhet të jenë pjesë përbërëse e përmbajtjes shkollore.

Duhet pranuar se, sa më shumë në marrëdhënie të integruara të jetë fëmija midis inteligjencës së tij pamore, lëvizore, matematikore, shkruese, aq më i

suksesshëm do të shfaqet në të nxënësve të tij.

Në këtë mënyrë, gërshetimi i mësimdhënies së lexim-shkrimit me veprimtari vizatimi, kënge etj., u jep më shumë vullnet dhe dëshirë nxënësve për të punuar dhe për të shkruar më tej.

Bashkëveprimi midis aftësive komunikuese folëse, shkruese dhe lexuese është i pranishëm në çdo orë mësimi të Abetares, por ky gërshetim i parë edhe në ndërthurje të tjera, përmes inteligjencës së shumëfishtë dhe njohurive apo aftësive të lëndëve të tjera, krijon hapësira pafund integrimi mësimor.

## 7. MJETET MËSIMORE

Lënda e gjuhës shqipe për klasën e parë dallon për përdorimin e mjeteve të shumta mësimore, në veçanti, mësimi i Abetares kërkon përdorimin e mjeteve të ndryshme mësimore. Në këtë mënyrë dallojmë: **mjetet kolektive dhe mjetet individuale.**

**Mjetet për përdorim kolektiv** mund të jenë:

- tabelat e mëdha, shkronjat e alfabetit, etiketa fjalish dhe fjalësh me përmasa të caktuara etj.;
- mjete të ndryshme të shkruari, si: *shkumësa, shënues (lapustila), materiale vizatimi* etj.;
- këndi i librit (biblioteka), këndi i dramës, ekspozitat e murit etj.

Krahas mjeteve kolektive, nxënësit kanë edhe **mjete individuale**, ku përveç librit dhe fletoreve të punës mund të përfshihen tabela plastike që ndihmojnë për shkrimin simultan të nxënësve, rrokje lëvizore, xhepore etj.

Mësuesit mund të bëhen krijues të mjeteve kolektive dhe individuale të nxënësve.

Lodrat e fëmijëve, ku ka përmbajtje që lidhet me lexim-shkrimin, janë një burim tjetër për pasurimin e mjeteve mësimore në klasën e parë.

## 8. VLERËSIMI

**Vlerësimi** është një përbërës i rëndësishëm i punës me Abetaren. Për moshat e ulëta shkollore, shkolla shqiptare e ka të konsoliduar tashmë **vlerësimin me fjalë dhe shprehje** dhe pa mbetje në klasën e parë dhe të dytë.

**Përdorimi i simboleve dhe shenjave nxitëse**, si: *flamur, lule, arush, yje e shenja të tjera që i zgjedh mësuesi së bashku me nxënësit*, janë mjete të

rëndësishme për të motivuar nxënësit për një cilësi më të mirë në lexim-shkrim.

**Testi** është një praktikë që jep rezultate të mira. Nxënësit e klasës së parë mund të bëjnë 2-3 teste gjatë vitit.

**Diktimet e kontrollit** janë një formë tjetër për vlerësimin e shkrimit të nxënësve.

Mund të përdoren forma më të buta si fletore pune dhe materiale të tjera didaktike, të cilat e ndihmojnë nxënësin hap pas hapi për të arritur rezultate.

**Fletoret e punës dhe fletët e punës** e kryejnë më së miri punën e tekstit. Për çdo fushë studimi është mirë që nxënësi të ketë vlerësime periodike.

Në praktikatat e sotme shkollore për një vlerësim më real të nxënësve në lexim-shkrim kanë nisur të

përdoren **listat e kontrollit** në të cilat shkruhen disa nga shprehjet bazë që duhet të pasqyrojnë nxënësi në periudha të ndryshme të vitit shkollor: **në dëgjim, në të folur, në të shkruar, në të lexuar**. Listat e mësipërme do të ndihmojnë edhe për vlerësime që lidhen me pasqyrimin e tyre në regjistër.

Këto lista vendosen në dosje personale për çdo nxënës dhe, në periudha të caktuara të vitit shkollor, bëhen vlerësime dhe krahasime nga njëra periudhë në tjetrën. Herë pas here prindërit njihen me progresin e fëmijëve të tyre përmes listave të kontrollit.

Listat dhe testet e kontrollit mund të hartohen nga mësuesit në bashkëpunim me inspektorët.

Orët në dispozicion, mësuesi i shpërndan sipas nevojave specifike të klasës.

## I.3. Programi analitik i Abetares shpërndarja e orëve

**Shqipëri, 35 javë x 8 orë = 280 orë**

**Kosovë, 37 javë x 7 orë = 259 orë**

VENDI	PARABETARE	ABETARE	PASABETARE	TOTALI
SHQIPËRI	32 ORË	208 ORË	40 ORË	280 ORË
KOSOVË	28 ORË	196 ORË	35 ORË	259 ORË

	NR	TEMAT MËSIMORE	ORËT
Temat për zhvillim të folurit	I	Periudha përgatitore - PARABETARE	Shqipëri 4 javë x 8 orë = 32 orë Kosovë 4 javë x 28 orë

<p>sh D, F, L &amp; Sh</p> <p>Prezantimi</p> <p>Drejt shkollës</p> <p>Në shtëpi</p>		<p>1- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>A</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p> <p>2- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>I</b>, vizatim dhe elemente shkrimi</p> <p>3- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>M</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p> <p>4- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>N</b>, vizatim dhe elemente shkrimi</p> <p>5- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>E , Ē</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p> <p>6- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>B</b>, vizatim dhe elemente shkrimi</p> <p>7- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>F</b>, vizatim dhe elemente shkrimi</p> <p>8- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>C, C</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p>	<p>8 orë</p>
<p>sh D, F, L &amp; Sh</p> <p>Në mëngjes</p> <p>Dita ime</p> <p>Kalendari i ditëlindjeve</p>	<p>1.2.</p>	<p>9- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>H</b>, vizatim dhe elemente shkrimi</p> <p>10- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>U</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p> <p>11- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>D</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p> <p>12- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>DH</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p> <p>13- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>K</b>, vizatim dhe ele-mente shkrimi</p> <p>14- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>J</b>, vizatim dhe elemente shkrimi</p> <p>15- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën <b>G, GJ</b>, vizatim dhe elemente shkrimi</p> <p><b>16. Rimarrje /përsëritje/kontroll</b></p>	<p>8 orë</p>



Sh D, F, L & Sh	1.3.	17- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën L, LL, vizatim dhe ele-mente shkrimi  18- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën P, vizatim dhe elemente shkrimi  19- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën NJ, vizatim dhe ele-mente shkrimi  20- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën O, vizatim dhe elemente shkrimi  21- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën Q, vizatim dhe elemente shkrimi  22- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën R, RR, vizatim dhe ele-mente shkrimi  23- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën S, SH, vizatim dhe ele-mente shkrimi  24- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën T, vizatim dhe elemente shkrimi	8 orë
Në fshat			
Luajmë			
D, F, L & Sh	1.4.		8 orë
Në rrugë		25- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën TH, vizatim dhe ele-mente shkrimi  26- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën X, vizatim dhe elemente shkrimi  27- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën XH, vizatim dhe ele-mente shkrimi  28- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën V, vizatim dhe elemente shkrimi  29- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën Y, vizatim dhe elemente shkrimi  30- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën Z, vizatim dhe elemente shkrimi  31- Njohja, shqiptimi dhe shkrimi me tingullin dhe shkronjën ZH, vizatim dhe ele-mente shkrimi  32- Përsëritje, rimarrje/kontroll	
Dhia dhe kecat			

## ABETARE

LINJAT <sup>2*</sup>	NR	FAZAT	ORËT
	2.	Periodha e ABETARES	<b>Shqipëri = 208 orë</b>  Kosovë  196 orë



D, F, L & Sh	2.4.	<b>Rimarrje e 6 shkronjave të dyta</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	Shqipëri - Kosovë 4 orë
D, F, L & Sh	2.5.	<b>III. <u>Punimi i 6 shkronjave të treta</u></b>  <b>1. Punimi i shkronjës B</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <b>2. Punimi i shkronjës H</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <b>3. Punim i shkronjës T</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <b>4. Punim i shkronjës S</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	6 x 5 orë =30 orë  5 orë  5 orë  5 orë  5 orë
		<b>5. Punim i shkronjës Sh</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <b>6. Punim i shkronjës F</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	5 orë  5 orë
D, F, L & Sh	2.6.	<b>Rimarrje e 6 shkronjave të treta</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqet përkatëse të Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	Shqipëri- Kosovë 4 orë

D, F, L & Sh	2.7.	<p>IV. <u>Punimi i 6 shkronjave të katërta</u></p> <p><b>1. Punimi i shkronjës Rr</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>2. Punimi i shkronjës J</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>3. Punim i shkronjës V</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>4. Punim i shkronjës Q</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>5. Punim i shkronjës D</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>6. Punim i shkronjës Dh</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	<p>6 x 5 orë = 30 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p>
D, F, L & Sh	2.8.	<p>Rimarrje e 6 shkronjave të katërta</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqet përkatëse të Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	<p>Shqipëri- Kosovë</p> <p>4 orë</p>

D, F, L & Sh	2.9.	<p>V. <b><u>Punimi i 6 shkronjave të pesta</u></b></p> <p><b>1. Punimi i shkronjës Ll</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>2. Punimi i shkronjës G</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>3. Punim i shkronjës Gj</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>4. Punim i shkronjës Th</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>5. Punim i shkronjës C</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>6. Punim i shkronjës Ç</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	<p>6 x 5 orë =30 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p>
D, F, L & Sh	2.10.	<p>Rimarrje e 6 shkronjave të pesta</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqet përkatëse të Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	<p>Shqipëri- Kosovë 4 orë</p>
D, F, L & Sh	2.11.	<p>VI. <b><u>Punimi i 6 shkronjave të gjashta</u></b></p> <p><b>1. Punimi i shkronjës Nj - 6 orë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqet përkatëse të Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>2. Punimi i shkronjës Y</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	<p>6 x 5 orë =30 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p>

		<p><b>3. Punim i shkronjës Z</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>4. Punim i shkronjës X</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>5. Punim i shkronjës Xh</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul> <p><b>6. Punim i shkronjës Zh</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqja përkatëse e Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	<p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p> <p>5 orë</p>
D, F, L & Sh	2.12.	<p><b>Rimarrje e 6 shkronjave të gjashta</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Faqet përkatëse të Abetares</li> <li>▪ Abetarja e Punës: ushtrime aplikative dhe pjesë e modeluar për shkrim dore.</li> </ul>	2 orë
D, F, L & Sh		<p>Orë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përsëritje</li> <li>▪ Veprimtari shkrimi</li> <li>▪ Teste</li> <li>▪ Përgatitje për festën e Abetares</li> </ul>	<p><b>Shqipëri</b></p> <p>10 orë</p>

LINJAT <sup>3</sup> KATEGORITË	NR.	FAZAT	ORËT
	3.	LEXIME PERIUDHA PASABETARE	Shqipëri 5 javë x 8 orë = 40 orë
L, D, F & Sh 1	1	Gjuha shqipe	
Lexim 2	1.1	Fjalë-njerëz-kafshë-sende (emra)	
Ushtrime gjuhe 3	2	Për një shkronjë	
4	2.1	Emra njerëzish, sendesh	
5	3	Alfabeti i gjyshe Rozës	
6	3.1	Emra kafshësh	
7	4	Para televizorit	
8	4.1	Besa, Bledari (Emra femërorë-emra mashkullorë)	
9	5	Edukata	
10	5.1	Djalë-djali (emra njerëzish-kafshësh-sendesh )	
11	6	Në zyrën e babit	
12	6.2	Si quhet...?	
13	7	Mendime të ngjyrosura	
14	7.1	Një mollë-shumë mollë	
15	8	Biçikleta	
16	8.1	Cilësi – i bukur - i lehtë	
17	9	Dy duar, tre fëmijë	
18	9.1	Cilësi – Si janë?	
19	10	Hunda e Pinokut	
20	10.1	Cilësi – Si është shoku/shoqja ime?	
21	11	Dielli dhe reja	
22	11.1	Cilësi-fjalë me kuptim të kundërt	
23	12	Miqtë e pyllit	
24	12.1	Veprime – Çfarë mund të bëjmë me ...?	
25	13	Zemërimi i luleve	
25	13.1	Veprime - Çfarë bëjnë fëmijët?	
27	14	Legjenda e lulediellit	
28	14.4	Unë ti ai/ajo-ne ju ata ato (kam/nuk kam)	
29	15	Piktura e Edlirës	
30	15.1	Veprimet dhe koha	
31	16	Një gjuhë për të gjithë	
32	16.1	Festa e ditëlindjes: përshkrim me zëvendësim fjalësh, fjalish	
33	17	Librat rrinë radhë-radhë	
34	17.1	Në piknik: përshkrim me zëvendësim fjalësh, fjalish	
35	18	Kur nuk kishte telefon	
36	18.1	Ditë me shi	
37	19	Miq nga hapësira	
L, D, F & Sh 38	19.1	<b>Kush? Çfarë? Ku? Si? Me kë?</b>	
39	20	<b>Filmat vizatimorë</b>	
40	20.1	<b>Unë jam, ti je, ai... (është/nuk është)</b>	
		Në dispozicion të mësuesit	4 orë
<b>GJITHSEJ</b>			<b>280 orë</b>

Shënim 1. Temat e Pasabetares 19, 19, 1, 20, 20.1 janë planifikuar më tepër me qëllim që mësuesi t'i përdorë sipas nevojave të tij dhe ato të nxënësve, brenda orëve të planifikuara në program.

## I. 4. PARIMET UDHËHEQËSE TË KURRIKULËS SË ABETARES

- Në praktikat e mëparshme dhe ato bashkëkohore thuhet se mësimi i Abetares është mbështetur në **metodat alfabetike globale (për pjesën e Paraabetares) analitike, sintetike dhe mikse (për pjesën e punimit të Abetares)**. Ato janë gjithashtu edhe të ndërthurura me njëra-tjetrën për realizimin e qëllimeve të caktuara, të cilat lidhen me fitimin e aftësive për të lexuar dhe për të shkruar.
- Ky është parimi themelor që na ka drejtuar në hartimin e Abetares.
- **Parimi i mësimi të lexim-shkrimit, i mbështetur në situata konkrete kontekstuale**, vlerësohet sot si një parim i parapëlqyer, i cili ofron për nxënësit mundësi për të realizuar shkrirjen dhe ndërthurjen e metodave të tjera të të mësuarit kontekstual, nxit dhe zhvillon të folurit e nxënësve, pasuron fjalorin e tyre dhe u jep fëmijëve njohuri të sistemuara rreth botës dhe jetës.
- **Parimi udhëheqës i fotografimit të figurave-fjalë dhe të fjalëve-figurë, si dhe i fjalëve kyç** është një kriter që respektohet në këtë Abetare dhe që ndihmon në mënyrë të ndjeshme në kapërcimin e vështirësive të para tek nxënësit, të tilla si ato të përdorimit të fjalëve kyç dhe lidhëse, apo siç janë foljet e para që duhen përdorur, si: *ka, kam, jam, luan* fjalëzat *me, në* etj. Njohja pamore e strukturës së këtyre fjalëve jep dorë për lidhjen logjike të fjalëve në struktura fjalish, fillimisht të thjeshta dhe më pas edhe më të zgjeruara. Ato e bëjnë gjuhën më të kuptueshme.
- **Metoda globale** përgjithësisht kapet në **Abetaren e punës** (Parabetare). Kjo zgjidhje lehtëson mësimin e shumë aftësive gjuhësore të nxënësve. Për shembull, përmes pasurimit të fjalorit ata njihen edhe me struktura fjalësh të thjeshta, mësojnë t'i lexojnë dhe t'i shkruajnë ato me shkronja shtypi. Më pas, strukturat e mësuara në tërësinë e tyre i nënshtrohen procesit të analizës dhe të sintezës. Ato i nënshtrohen ndërthurjes së metodave në fjalë, të përdorura gjatë gjithë materialit gjuhësor e figurativ në Abetare.
- Synohet që gjatë periudhës përgatitore nxënësit të kenë arritur të shkruajnë në mënyrë globale deri në 30 fjalë. Shkrimi global i tyre i ndihmon më pas gjatë leximit dhe shkrimit. Për të sqaruar *ngurrimet* e disave që mendojnë se si mund të "mësohet globalisht" na lejoni ta ilustrojmë idenë tonë me një shembull. Një nxënës, kur sheh një makinë-lodër, e emërton menjëherë atë, pra e lexon emrin e saj nga figura, por në rast se në do t'i japim një makinë të zberthyer atij do t'i duhet shumë kohë ta emërtojë apo ta mbërthejë dhe ta bëjë përsëri makinë. Kështu ndodh edhe me fjalën. Kjo gjë është provuar në 5 nxënës gjatë kohës së punës me Abetaren, por është vërtetuar edhe më parë nga përvojat e fëmijëve. Kjo është një arsye më tepër për të besuar se funksionon me shumë sukses. Rezultatet e tyre kanë qenë premtuese: nxënësit kanë mësuar më shpejt të lexojnë më mirë.
- Metoda globale nuk do të jetë mbizotëruese në këtë Abetare, pasi për nga mënyra si punohet në periudhën përgatitore ajo shuhet gjatë periudhës së mësimi të Abetares sepse, edhe në rastet kur në një faqe apo tekst shfaqen një ose dy fjalë në trup të të cilave ka 1-2 shkronja të papunuara ende, vjen në ndihmë pjesa e Parabetares, e cila përmes metodës alfabetike dhe globale ka bërë të mundur që nxënësit të jenë njohur me këto shkronja. Në këtë çast ata i rikujtojnë. Pra, periudha e Parabetares ka kryer një funksion shumë të rëndësishëm. **Ajo ka ezauruar elementet e metodës globale gjatë punës me pjesën e Abetares, elemente që shpesh janë të pashmangshme.**
- **Një parim tjetër**, që është mbajtur parasysh në këtë libër, është edhe ai i bashkëshoqërimit të gjuhës së shkruar me figurat. Ky parim gjen shtrirje si në Abetare, ashtu edhe në Abetaren e Punës, në të cilën në tema të caktuara, figurat lidhen edhe me fjalët emërtuese të tyre dhe shërbejnë si një mini-fjalor shpjegues.

**Libri është i mbushur me ilustrime që nxisin nxënësit për të shprehur imagjinatën e tyre dhe lidhjet me botën reale dhe veprimin e tyre konkret në të. Figura dhe teksti krijojnë një tërësi të tillë që fëmija të ndihet i përfshirë, pothuaj si një personazh brenda faqes. Kjo mënyrë konceptimi e zbatuar, që përdoret në tekstologjinë e abetareve bashkëkohore, krijon një hapësirë bashkëjetese midis tekstit dhe figurës nga njëra anë, dhe vetë nxënësit, i cili "udhëton" si një personazh brenda faqes.**



Çdo shkonjë e pjesës së Abetares shoqërohet nga një strukturë e tillë mësimore: prezantim me shkronjën, prezantim me një temë bazë për zhvillim të foluri, e cila në vetvete përmban një fabul, të cilën do ta zbulojnë nxënësit me mësuesit përmes bashkëbisedimit dhe që synon kërkimin e fjalëve që përmbajnë tingullin dhe shkronjën, e cila punohet përmes veçimit të tyre në struktura të lidhura dhe me kuptim (në këtë rast gjatë bashkëbisedimit). Punohet me fjalorin e fjalëve përfaqësuese për çdo shkronjë, punohet me fjalinë bazë, e cila zërthehet në fjalë, rrokje, shkronja, vazhdohet me ushtrime manipuluese për analizë dhe sintezë. Faqja e dytë e pjesës së Abetares nis për çdo shkronjë me një tekst, i cili lexohet dhe përmes tij synohet të aftësohen nxënësit të lexojnë me intonacionin e duhur, të kuptojnë atë që lexojnë, të gjejnë fjalët që lidhen me shkronjën që lexohet, të ndajnë në rrokje, të ushtrohen përmes ushtrimeve manipuluese për përvetësimin e disa dukurive gjuhësore, që lidhen me leximin, si: intonacioni, kuptimi i fjalisë, shenjat e pikësimit, ritregimi etj.

Çdo faqe e Abetares synon të krijojë një **mjedis fonologjik të përshtatshëm** për tingullin që punohet dhe për ta kaluar nxënësin me lehtësi nga ana tingullore e fjalës drejt shkronjës, e cila përfaqëson një tingull të caktuar.

**Fabulat shoqërojnë faqet e Abetares dhe punimit të çdo shkronje, të përmbledhura në tekste të shkurtra** e të përshtatura për shkronjën apo për fjalët, që është parë e nevojshme të aktivizohen, por pa cenuar mesazhet që ato përcjellin për botën e fëmijëve.

**Shumë njohuri mbi botën** janë dhënë përmes pjesëve të tjera të përzgjedhura dhe të përshtatura për qëllimet tona.

Për t'u ndier si një tekst koherent, në Abetare janë përfshirë edhe **tema të reja**, të cilat janë pjesë e botës dhe e imagjinatës së fëmijëve, siç janë ato që lidhen me **robotin, kompjuterin, ufot** e personazhe të tjera imagjinare për fëmijët deri te personazhet e filmave vizatimorë që ata ndjekin.

- **Parimi i rimarrjes** zë vend të dukshën në Abetare. Ai nis me rimarrjen e shkronjave në çdo faqe të librit dhe më pas vijon me rimarrjen për analizë të fjalëve të vështira, si dhe të fjalëve me probleme drejtshkrimore, kryesisht ato me grupe shkronjash tri-katër rrokëshe, si dhe me rrokje të vështira (të mbyllura) për t'u përvetësuar nga nxënësit që në çastin e parë të paraqitjes së tyre.

Rimarrja zë një vend të rëndësishëm edhe gjatë punës me shkronjat, në çdo 6 shkronja bëhet një rimarrje: në këto çaste, nxënësit ushtrohen për të lexuar tekste të ndryshme dhe për të bërë ushtrime sinteze e analize të fjalëve e fjalive të veçanta, të rimarra nga mësimet e mëparshme, pa përjashtuar ato të rejat.

Rimarrja në këtë model abetareje zë vend në kohën e nevojshme, që i lihet veprimtarisë së fëmijëve për lexim-shkrim në periudha të caktuara pas grupeve të caktuara shkronjash. Në rimarrjet e mësipërme është e nevojshme të vlerësohen arritjet e nxënësve përmes fletëve të punës të parashikuara në Abetaren e Punës, si dhe përmes testeve të thjeshta modele, që do të jepen në këtë libër.

- Për të mundësuar një përvetësim sa më të mirë dhe në një kohë më të përshtatshme për fëmijët, **libri paraqet një organizim dhe një strukturë tepër të përdorshme** për mësuesit, por veçanërisht për nxënësit, të cilët do të punojnë me të.
- Përmes **shenjave konvencionale**, dhe jo përmes kërkesave, ashtu siç është në tekstologjinë paraardhëse, fëmija kupton se çfarë veprimi do të kryejë. Kërkesat për nxënësin i lexon mësuesi në fund të faqes me shkronja të vogla, si dhe i zërthen me rrugë metodike në tekstin e mësuesit.
- **Ilustrimet lidhen kryesisht me kafshët, miqtë më të dashur** të fëmijëve. Ato zënë një vend tepër të dukshëm në Abetare dhe janë personazhet kryesore. Brenda tyre qëndrojnë fjalët, të cilat fëmijët i fiksojnë nëpërmjet figurës dhe më pas shkronjë pas shkronje fillojnë t'i lexojnë.
- **Tekstet e zgjedhura janë të shkurtra**, tregime të thjeshta, përralla, gjëgjëza, vjersha etj.

- Në çdo faqe, në skajet e **Abetares shkruhen shkronjat e mësuara**, me qëllim përsëritjen e tyre. Shkronja e re tërheq vëmendjen me ngjyrën ndryshe nga të tjerat.
- Në çdo faqe abetareje do të **përdoren tri lloje shkrimesh** me shkronja të mëdha, me shkronja shtypi të vogla dhe me shkronja dore.
- Pjesa më e madhe e figurave janë vjelë nga botimet e sotme për fabulat e njohura, me qëllim që fëmija të hyjë menjëherë në marrëdhënie me to, sepse i ka të njohura. Për disa të tjera kemi shfrytëzuar figura nga letërsia për fëmijë, të cilat kanë qenë tepër cilësore.
- Teksti i Abetares nuk do të jetë i vetmi tekst që do të përdorin nxënësit në klasën e parë. Kjo Abetare kërkon që fëmijët të lexojnë edhe tekste të tjera për moshën e tyre, të cilat mund të sigurohen në bibliotekën e klasës ose në familje.
- Këshillohet që çdo muaj, fëmija i klasës së parë të ketë lexuar një libër të moshës apo histori, nga ai vetë ose me ndihmën e më të mëdhenjve. Kjo këshillë nuk duhet kuptuar si një mundësi, por si një objektiv, për të cilin nxënësit i duhet kërkuar të fillojë të mbajë shënimet për të, në fillim të shkruajë titullin, emrat e pjesëmarrësve në fabul apo tregim e kështu me radhë.
- **Teksti është i organizuar në rubrika**, të cilat kanë synime të tilla, si:
  - Leximi i shkronjave fillimisht për njohje dhe për krahasim me njëra-tjetrën e, më pas, për rimarrje dhe përsëritje.
  - Bisedë për zhvillim dhe pasurim të foluri, e cila realizohet përmes temës së zgjedhur (fabulës), figurës kryesore të Abetares dhe figurave në anë të librit, të cilat luajnë rolin e fjalorit, ku fjalët janë të shoqëruara me figurat përkatëse.
  - Paraqitja e shkronjës së re, grafika pamore e shkronjës së madhe dhe të vogël të shtypit dhe ajo e dorës jepen menjëherë me qëllim që nxënësi të kuptojë se bëhet fjalë për të njëjtën shkronjë dhe jo për shkronja të ndryshme. Rubrikat që shoqërojnë tekstin janë të larmishme.
  - Leximi i strukturës kryesore të fjalisë shoqëron çdo faqe të parë të shkronjës së re dhe më poshtë bëhet zbërthimi i strukturës së fjalisë në fjalët përbërëse.

Strukturat kryesore janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbajnë fjalë që e kanë shkronjën e re në pozicione të ndryshme: është treguar kujdes që të jenë fjalë që lexohen nga nxënësit, por në ndonjë rast mund të ketë edhe 1-2 shkronja që nuk i njohin (për të cilat na vjen në ndihmë figura dhe puna e bërë gjatë Paraabetares në të cilën janë njohur me të gjitha shkronjat dhe kanë mësuar të shkruajnë shkronjat kapitale për çdo tingull).

Deri në 6 shkronjat e para, strukturat gjuhësore, fjalë, fjali janë të kufizuara, por duke qenë se nxënësit janë njohur në mënyrë grafike me shkronjat që në faqet e fletores së punës, në të cilën ata i kanë nyjtuar, i kanë përdorur dhe shkruar, duke respektuar kriterin alfabetik (pa i vendosur në trup të fjalëve, por thjesht si grafikë), ato ndihmojnë në gjetjen e tyre gjatë leximit në struktura fjalësh të ndryshme.

Zbërthimi analitik dhe më pas sinteza e strukturës së fjalisë do të kryhet me laps mbi Abetare dhe jo me etiketa që priten. Të lexuarit dhe të shkruarit e humbin kuptimin kur fëmija fillon të presë apo të ngjisë. Kjo Abetare pranon lexim dhe shkrim me laps në dorë. Fëmijët do të punojnë me laps në fillim për të plotësuar struktura fjalësh, rrokjesh, shkronjat, duke pasur parasysh modelin bazë.

Në rast se në hapin e parë fëmija kopjon/riprodhon në mënyrë mekanike, kjo gjë nuk duhet vlerësuar si një veprim jo i zgjedhur, pasi ka shumë mënyra rimarrjeje, me anë të të cilave, nxënësi fiton shprehinë e kërkuar. Le të kujtojmë se Abetarja e Punës luan pikërisht këtë rol. Por nuk duhet tepruar me veprimtari të kopjuari. Ato duhet të integrohen me veprimtari diktimi, riprodhimi ose plotësimi.

- Fabulat e shkurtra që shoqërojnë librin në faqen e dytë të çdo shkronje, nxisin aftësitë e nxënësve për të realizuar një të lexuar kontekstual dhe me kuptim.
- Për të mënjeluar paraqitjen globale të shumë fjalëve, ato i kemi zëvendësuar me figurat përkatëse: herë ua kemi shkruar emrin poshtë, herë është zbatuar parimi i përdorimit të figurave në strukturat

e fjalive, i cili është shumë i përdorshëm sot për fëmijët e moshave të vogla. Ai i intrigon dhe i nxit fëmijët për leximin e mëtejshëm.

- Rubrikat që pasojnë faqen e dytë të shkronjave lidhen me ushtrime rreth përmbajtjes së tekstit-fabul.
- Shpesh nxënësve u kërkohet të bëjnë edhe vizatime, të cilat i përforcojnë aftësitë e tyre rreth formës së shkronjave apo për të riprodhuar mendime dhe imagjinatë. Kjo veprimtari është çlodhëse dhe nuk duhet vlerësuar si larg synimeve të leximit dhe shkrimit. Vizatimi është prodhim dhe riprodhim idesh. Edhe një “shkarravinë” e fëmijëve duhet kuptuar si një mesazh që ai ka dashur të thotë me gjuhën e tij të “shkarravinës”.
- Në faqe të ndryshme të Abetares gjenden edhe informacione të shkurtra të tilla, si: një faqe kalendari që tregon një datë të caktuar, një grafik apo diagram që tregon stinët, histori të pambaruara, në të cilat u kërkohet nxënësve t’i përfundojnë. Këto kërkesa janë karakteristike për faqet e fundit të Abetares.
- Parimi bazë, i cili duhet të funksionojë përmes kësaj Abetareje në mësimin e lexim-shkrimit duhet të jetë: “Asnjë hap para, pa mësuar mirë pjesën e mëparshme”.
- Kjo Abetare nuk mundëson një mësim global e të njëjtë për të gjithë. Mësuesi duhet të diferencojë dhe ta plotësojë me veprimtari për lexim dhe shkrim për nxënësit e tij, sipas nevojave të tyre. Prandaj rekomandohet që mësuesi t’u rekomandojë nxënësve të përparuar veprimtari suplementare për të lexuarin, në ndihmë të të cilave mund të vijnë librat jashtëshkollorë.

Ushtrimet në Abetaren e Punës përfaqësojnë nivele të ndryshme të nxëni. Kjo do të thotë se jo të gjitha ushtrimet mund të kryhen nga të gjithë nxënësit. Kjo gjë do t’i japë mësuesit informacion për nivelet e nxënësve dhe për punën e diferencuar që duhet të kryejë me nxënës të caktuar, të cilët kanë nevojë për më tepër ndihmë.

- **Detyrat e shtëpisë duhet të jenë të diferencuara**, jo të njëjta dhe me të njëjtin vëllim për të gjithë. Një nxënës që nuk ka nevojë ta shkruajë *a*-në shumë herë nuk duhet t’ia japë patjetër detyrë. Mund t’i jepet detyrë të shfrytëzojë detyra të tjera, edhe pse nuk i njeh të gjitha shkronjat, ai do të kërkojë dhe do të gjejë shkronja të tjera, edhe pse nuk i ka mësuar ende.
- Me ta do të punohet në mënyrë të tillë që fëmija të mos mbingarkohet me detyra të tepërta. Detyrat që do të jepen duhet të jenë të thjeshta, jovolunozë. Në këtë kuptim, në tre muajt e parë, mësuesi duhet të synojë që nxënësit të realizojnë në klasë gjithë veprimtarinë e parashikuar nga Abetarja dhe nga Abetarja e Punës. Mund të jepen detyra të diferencuara për të gjithë nxënësit.
- Në aspektin gjuhësor është treguar kujdes që strukturat të jenë të thjeshta dhe me një fjalor tepër të përdorshëm nga ana e tyre. Në shkronjat e para punohet më tepër me shprehje në të cilat foljet nuk jepen për arsye të pamundësisë për t’u lexuar. Ato nënkuptohen ose lexohen me mend.

Për çdo shkronjë është treguar kujdes që të zgjidhen fjalët bazë përfaqësuese të saj, të cilat përbëjnë fjalorin e faqes, kryesisht ato që e kanë shkronjën në pozicion nistor, pastaj edhe ata që mund ta kenë në pozicion mesor dhe fundor.

Fjalori i bashkëngjitet tekstit të mësuesit. Falë tij kemi punuar për gjetjen e fjalëve për çdo shkronjë dhe në të tria pozicionet. Ky fjalor i bashkëngjitet tekstit me synimin që mësuesi mund ta përdorë për të bërë gjetje të tjera për fletë të tjera pune, që mund ta përgatisë për punë të diferencuar, për përsëritje dhe për shumë qëllime të tjera gjuhësore.

Fjalësi i fjalorit, i nxjerrë nga “Fjalori i Gjuhës Shqipe”, është i përshtatshëm për moshën e fëmijëve 6-8-vjeçarë.

- Shenjat e pikësimit fillojnë të bëhen të njohura në mënyrë graduale.

Ndryshe nga abetaret e mëparshme, tregohet kujdes që në hapat e tyre të parë, nxënësit të shkruajnë me shkronja të mëdha shtypi dhe hap pas hapi kalohet në ato të dorës.

E rëndësishme në këtë abetare është kërkesa për të riprodhuar shkrimin e lexuar dhe të mbështetur në të menduar dhe imagjinatë.

**Nxitja e riprodhimit të leximit dhe shkrimit të kuptimshëm** është një parim themelor i kësaj Abetareje.

- Në mënyrë të vazhdueshme kemi kërkuar e gjetur forma e tipa ushtrimesh, të cilat i largohen riprodhimit mekanik të të lexuarit dhe të shkruarit të nxënësve.

Këshillohet që të lexuarit e nxënësve duhet të fillojë prej tyre dhe jo i riprodhuar nga mësuesi, pasi kjo mënyrë nxit të mësuarit mekanik të këtij procesi.

Mësuesi duhet të lexojë pak. Të gjithë nxënësit duhet të kenë kohën e tyre për të lexuar.

- Abetarja e Punës bashkëshoqëruese e Abetares do të jetë e organizuar në tri pjesë.
- Në pjesën e parë, paraqitet puna që do të bëhet në periudhën e Paraabetares: ngritja e mjedisit fonologjik, lidhja e tingullit me shkronjën, vizatim i elementeve të shkronjave të dorës, bashkëbisedim për një temë të caktuar, shkrim global e zëvendësim i shkronjës që mungon. Shumë lojëra dhe veprimtari argëtuese duhet ta shoqërojnë këtë hapësirë kohe.
- Në pjesën e dytë janë ushtrimet për thellim në të lexuar logjik, si dhe për analizën dhe sintezën e strukturave të fjalive dhe të fjalëve. Kjo Abetare Pune do të jetë e mbushur me ushtrime manipuluese, ku trajtohen gjithashtu edhe probleme të tjera që i takojnë aspektit gjuhësor, të tilla si: disa probleme të vështira drejtshkrimore që kanë të bëjnë me vendosjen pranë njëri-tjetrit të disa tingujve bashkëtingëllore, të strukturave të gjata të fjalëve, të shkrimit të shkronjave të mëdha, të shkronjave dyshe etj.

Pjesa e tretë synon modelimin e shkrimit me shkronja dore. Në këtë fletore nuk do të jetë thjesht një modelim mekanik i shkronjave. Ajo do të shoqërohet me një rubrikë të quajtur Pyetje, ku do t'u kërkohe t'i përgjigjen një pyetjeje me shkrim ose të bëjnë një pyetje me shkrim, duke u nisur nga shkronja që modelohet.

Në fletoren e punës do të zënë vend edhe shumë ushtrime krijuese, të cilat kanë të bëjnë me riprodhimin e gjuhës së shkruar prej nxënësve.

Përmes pyetjeve apo situatave të papërfunduara prej tyre kërkohet krijim dhe plotësim ushtrimesh të larmishme.

Fletët e punës së Pasabetares e mbyllin serinë e paketës së kësaj Abetareje. Përmes saj, nxënësit ushtrohen dhe përsosen në përdorimin e gjuhës dhe në njohjen me disa dukurive. Çdo ushtrim i kësaj natyre realizohet duke u mbështetur në intuitën e nxënësve.

Kjo Abetare përmban edhe një risi tjetër, e cila lidhet me përdorimin standard të gjuhës. Për të njohur mirë gjuhën dhe dialektet e saj, sidomos dallimin midis tyre, në këtë Abetare gjendet dhe rubrika **Thuhet ... Shkruhet**. Përmes saj kemi synuar t'u themi fëmijëve se kur flasim ne mund të përdorim shumë trajta të një fjale, por kur shkruajmë duhet të përdorim vetëm atë të standardit.

Në librin e mësuesit do të gjejmë një material të gjerë për të punuar me këtë rubrikë, të cilën e shohin të nevojshme për t'u punuar edhe për një arsye tjetër: për afrimin e dialekteve të shqipes me njëri-tjetrin, si dhe për situatën e re të shoqërisë shqiptare, si dhe për nxitjen e një komunikimi sa më të gjerë të shqiptarëve në të gjitha trevat ku ata ndodhen. Kjo rubrikë le të pasurohet më tej nga mësuesit, kryesisht me shembuj tipikë të zonës ku ndodhen, pasi përbën një element për pasurimin e gjuhës standarde me fjalë nga vetë brumi i saj.

## 1.5. RRETH METODAVE TË MËSIMIT TË LEXIM-SHKRIMIT

Për problemin e të mësuarit të lexim-shkrimit në moshat më të vogla, mendime të ndryshme dhe mbarëkombëtare ngulin këmbë me të drejtë që, për mësimin e tij të përdoren metoda jo të improvizuara, por metoda që të kenë vlerë të sigurt shkencore, të jenë eksperimentuar gjerësisht dhe që të mund të japin garanci për suksesin dhe që kanë të bëjnë me arritjen e përvetësimin e disa aftësive e mjeteve që lidhen me teknikën e leximit dhe të shkrimit.

Në këtë aspekt kaq të rëndësishëm të aftësimin të fëmijëve, formimi profesional i mësuesve të shkollës fillore merr një rëndësi të veçantë. Mësuesit duhet të gjejnë e të zgjedhin metodën më prodhimtare, ta njohin në thelb atë e ta bëjnë të suksesshme.

Po cilat janë tipat e metodave që janë përdorur historikisht dhe të atyre që kanë të bëjnë me kërkimet që janë bërë dhe po bëhen aktualisht. Më shumë se për metoda të veçanta, këtu mund të flitet për prirje metodologjike, d.m.th. për një grup metodash, të cilat me gjithë ndryshimet që kanë midis tyre, kanë të përbashkët një skemë, një substrat, një procedim e një mbështetje shkencore. Të tilla grupime metodologjike janë në një numër të kufizuar, por brenda tyre mund të dallojmë një numër të madh metodash specifike, me variante të përbashkëta, mbi një skemë referimi, që bën të mundur futjen e tyre në një grup më të gjerë. Në literaturën metodike të shkrim-leximit fillestar, për shumë kohë është vlerësuar si më i arsyeshëm klasifikimi i pedagogut dhe psikologut të njohur amerikan (William S. Gray), i cili i ndante në dy grupe bazë metodat e mësimin të lexim-shkrimit fillestar:

1. **Metodat relativisht të vjetra dhe,**
2. **metodat moderne, më pak a më shumë eklektike.**

Në metodologjinë e kohës më të re, të mësimdhënies së lexim-shkrimit fillestar këtij klasifikimi i janë bërë vërejtje të shumta dhe, për mendimin tonë, shkencërisht të arsyeshme. Thuhet se është shumë i përgjithësuar dhe nuk mbështetet në kriterë të qëndrueshëm. Këtë klasifikim, Grej (Gray) e bën në bazë të "përcaktuesit kohor" dhe jo në ndonjë nga ligjësitë njohëse, mendore ose psikologjike..." që janë shumë më të rëndësishme dhe shkencërisht më të qëndrueshme. Kjo ka nxitur metodicientët të provojnë klasifikimin e metodave të mësimin të lexim-shkrimit fillestar mbi baza të kriterëve shkencërisht më të pranueshëm.

Në lidhje me këtë, Konferenca e 12-të Ndërkombëtare e UNESCO-s (Gjenevë) dhe Zyra Ndërkombëtare e Edukimit, më 1949, përkrah mendimin që për kriter bazë të klasifikimit të metodave të lexim-shkrimit fillestar të merret rrjedha e ndodhjes së leximit dhe shkrimit si procese psiko-fiziologjike. Hulumtimet në fushën e psikologjisë së edukimit kanë provuar se leximi dhe shkrimi, si procese psiko-fiziologjike kanë rrjedhë të kundërt, njëri është analitik (leximi) dhe tjetri sintetik (shkrimi). Bazuar në këtë kriter, në Konferencën e 12-të Ndërkombëtare për Mësimin Publik të UNESCO-s e të Byrosë Ndërkombëtare për Edukim, u miratua klasifikimi i metodave të mësimin të lexim-shkrimit fillestar në këto tri grupe bazë:

1. **Metodat sintetike (këtu përfshihen edhe ato fonetike, globale)**
2. **Metodat analitike**
3. **Metodat analitike-sintetike**
4. **Metoda mikste**

Brenda këtyre tri grupeve bazë përfshihen më shumë metoda të veçanta, disa prej tyre tashmë janë tepër të vjetëruara e të papërdorshme dhe disa të tjera me mundësi të kufizuara përdorimi. Për këtë arsye, edhe pse për këto tri grupime ka një mendim të përbashkët për thelbin dhe specifikat e tyre, ka edhe kundërshtime të caktuara. Kjo, për faktin se në praktikën e mësimin të leximit e të shkrimit fillestar vështirë se mund të zbatohet ndonjë metodë "e pastër" analitike ose sintetike.

**Metodat sintetike.** Nën këtë emërtim grupohet një gamë e gjerë e metodave, që kanë karakterizuar dhe karakterizojnë mësimin e lexim-shkrimit që nga shkollat e antikitetit grek dhe romak e deri në ditët e sotme. Ky është një grupim brenda të cilit mund të dallojmë metoda të vjetra alfabetike: metoda fonetike apo foniko-sintetike. Metoda e këndimit shkronjë për shkronjë (metoda alfabetike), metoda e këndimit tingull për tingull (metoda zanore), metoda e këndimit rrokje për rrokje (metoda silabike), metoda e tingujve natyralë (metoda e tingujve normalë), metoda fonografike, metoda fonetike dhe metoda fonomimike (metoda interjektive) etj.

Struktura e përbashkët e këtyre metodave qëndron në procedurat e përvetësimit, duke sintetizuar elementet e gjuhës së folur (tingujt) dhe të shkruar (shkronjat) të njohura më parë. Fillimisht merren me tinguj e shkronja të veçanta, që, në mënyrë të përshkallëzuar, vijnë e bashkohen, duke formuar rrokje, fjalë e fjali.

Në periudhën e lashtë greke, në atë helenistike dhe romake, fëmijët e fillonin jetën e tyre shkollore në moshën 7 vjeç dhe e ndiqnin shkollën fillore për 5 vjet, periudhë gjatë së cilës duhej, para së gjithash, të lexonin, të shkruanin dhe të bënin llogari. Në këtë shkollë, metoda e përgjithshme për të mësuar leximin dhe shkrimin kishte të bënte me përvetësimin paraprak të elementeve të alfabetit, duke i shqiptuar ato jo sipas vlerës fonetike si tinguj të veçantë, siç shqiptohen brenda fjalëve, por ashtu siç shqiptohen normalisht kur duam të shqiptojmë shkronja të alfabetit, duke marrë në këtë mënyrë pjesë të shkronjave të alfabetit. Mësuesi shkruante në stil shkronjat e alfabetit, si model për t'i kopjuar. Kështu, ai i ndihmonte nxënësit në ushtrimin e tyre, duke udhëhequr dorën e tyre për shkronja të veçanta.

Një element të ri gjejmë në shkollën romake, ku, mbi tryeza druri, të cilat kishin shkronja me vëllim, nxënësit ushtroheshin me stilin e tyre për të kuptuar dhe për të përvetësuar në mënyrë të pavarur modelin e shkronjave. Megjithatë, jo të gjithë ishin dakord me përdorimin e këtij mjeti.

Shembullin e përdorimit të kësaj metode sintetike të tipit alfabetik e kemi gjatë gjithë “Medio Evo”(periudha e mesjetës). Është i njohur fakti që një prifti anglez me emrin Sanson, shumë inteligjent, që kish mësuar në një ditë të gjitha shkronjat e alfabetit, por, më pas i ishte dashur një javë e tërë për t'i bashkuar e për t'i lexuar ato në fjalë.

Vetëm rreth shekullit XVI vijnë të dhëna të rëndësishme se metodat sintetike të tipit alfabetik filluan të pësojnë ndryshime fonike. Siç kuptohet, inkonsekuencat metodologjike e bëjnë mësimin e shqiptimit, në njëfarë mënyre, shqiptim me një vlerë të ndryshme fonetike për të lexuar fjalën aty ku ndodhet tingulli.

Siç shihet, metoda e parë e tipit fonetik-sintetik, për të cilën ka të dhëna, vjen pikërisht nga gjermani Valentino Iskelsauer-Ikelzamer (1527-1534), mësues gjerman dhe bashkëkohës i reformatorit Martin Luter. Ai, në një artikull të botuar më 1534 me titull: “Për rrugën e drejtë, sipas së cilës mund të mësohet leximi” paraqet pikëpamjet e tij mbi procedimin, sipas tij, më të efektshëm të përvetësimit të tingujve dhe shkronjave e të leximit dhe shkrimit fillestar. Sipas tij, tingulli duhej të ishte pikënisje e mësimin të gjuhës dhe leximit e shkrimit. Ai këshillon të mësuarit e leximit, duke bërë njohjen dhe shqiptimin e shkronjave të veçanta, nga ana tjetër, duke përdorur tingullin si përbërës të fjalës, bashkon një shkronjë me figurën e një objekti, emri i të cilit fillon me këtë shkronjë.

Përpjekje të tjera janë bërë nga njerëz të ndryshëm në shek. XVII në Spanjë. Dallon në këtë kohë vepra e Ramirez de Carrionit dhe e Joan Pablo Bonetit, në Holandë me nismën e Petrus Montaniusit e në Gjermani këshilltari pedagogjik Hajnrih Stefani (1764-1850) dhe bashkëmendimtarit të tij Krug (1771-1813) etj. Që të dy, por Krug në mënyrë të veçantë, u përpoqën ta thjeshtësonin e lehtësonin procedimin metodik të mësimin të tingujve e të leximit e shkrimit fillestar, siç e rekomandonte metoda e këndimit shkronjë për shkronjë. Kërkonte që tingujve bashkëtingëllorë, varësisht prej karakteristikave formësuese e të shqiptimit të tyre, t'u jepeshin edhe emërtime të caktuara si: “tinguj fryrës”, “shushuritës”, “zukatës”, “shpërthyes” etj.

Mbi të gjitha, përpjekjet më të mëdha për metodën alfabetike, të cilat janë zëvendësuar me atë fonetiko-sintetike, që duket se kanë pasur shumë sukses, janë ato të punës së Komenio e de Portorealistit.

Komenio, në librin e tij shkollor “Rreth kuptimit të pikturës” vë në dukje, ndër të tjera, që për të pasur një lexim të tipit fonetiko-sintetik, rekomandohet përdorimi i një lloj alfabeti me të cilin vlerësohet përfaqësimi i një tingulli nga një shkronjë.

Ndërsa Portorealisti propagandon një metodë të tipit foniko-sintetik, e cila e bën më të lehtë përvetësimin e leximit e të shkrimit nga fëmijët.

Që nga periudha e mesjetës “Medio Evo” dhe deri në fund të shekullit XVIII, mësimi i shkrimit ishte ai i shkronjave. Edhe në shekullin XVIII mësuesit privatë pretendonin për vlerën e madhe që ka mësimi i të shkruarit veç nga ai i të lexuarit. Vetëm pas çeljes dhe masivizimit të shkollave publike nisi të vlerësohej rëndësia e të dy llojeve të të mësuarit: e leximit dhe e shkrimit.

Nuk duhet të harrojmë që metoda e tipit sintetik e mbështetur nga M. Montesori është ende e freskët. Ajo përkrahet nga një specialiste franceze, Susanne Maissony, e cila ka përpunuar një pjesë të metodës së tipit sintetik për ato subjekte (nxënës) që kanë natyrë të vështirë.

Këto metoda, të emërtuara si metoda thelbësore, ndikojnë për një përvetësim të përmbledhur të lexim-shkrimit.

Janë disa metoda sintetike, të cilat po u zbatuan me masë dhe vend të duhur, japin rezultate të mira edhe në praktikën e sotme të mësimit të tingujve e shkronjave dhe leximit e shkrimit fillestar. Të tilla janë: metoda e leximit rrokje për rrokje (metoda silabike), metoda e tingujve natyralë, themelues e mbështetës më i dalluar i së cilës konsiderohet metodisti gjerman Alvin Ajhler, metoda fonografike, metoda fonetike dhe metoda fonomimike, themelues e përkrahës më i dalluar i së cilës konsiderohet mësuesi freng Ogisten Groslen. Ai propozonte që nocioni për tingullin dhe mësimi për rrugën e formësimit e mënyrën e shqiptimit drejt tingujve të bëhet duke vënë në lidhje imitimimin e tingujve natyralë me mimikë, me gjestikulacione e lëvizje përkatëse të fytyrës e të organeve të tjera të trupit. Është e përshtatshme, sidomos, për fëmijët me dëmtime në të dëgjuar. Mund të parapëlqehet në situatat e mësimit inkluziv e me klasa të bashkëngjitura, por edhe me fëmijët me zhvillim normal.

Në përmbyllje dhe në një mënyrë të përmbledhur do të thoshim se metodat sintetike, të cilat zbatohen pjesërisht edhe në praktikën e sotme të mësimit të lexim-shkrimit fillestar, mund të ndihmojnë në përvetësimin gradual dhe pa shumë vështirësi të tingujve e shkronjave dhe kuptimin e mirë të strukturës fonetike dhe grafike të gjuhëve në të cilat u zbatuan. Ato janë më të efektshme dhe ndihmojnë përvetësimin cilësor të procesit të leximit.

Dobësia më e madhe e tyre qëndron në faktin se të gjithë punën për përvetësimin e leximit dhe të shkrimit fillestar e mbështesin vetëm dhe vetëm në komponentin sintetik. Kjo e bën të vështirë shkriren e tingujve dhe të shkronjave në fjalë e fjali si njësi më të plota gjuhësore. Ngadalëson procesin e leximit. E bën leximin punë mekanike dhe pengon kuptimin e drejtë të përmbajtjeve që lexohen. Leximi i mësuar vetëm mbi baza të metodave sintetike tingëllon shumë artificial, jo i natyrshëm dhe “shkollaresk”, çfarë ndodh ta ndeshim edhe sot në shkolla dhe te mësuesit me arsim të vjetëruar metodik.

**Metodat analitike.** Në këtë grup metodash vendosen ato metoda, të cilat marrin si fillim fjalën dhe fjalinë. Në mënyrë të suksesshme, ajo bën analizën e tyre në fjalë, në rrokje e në tinguj, duke e aftësuar nxënësin, që, nëpërmjet strukturës së fjalës, të përvetësojë fjalën e lexuar dhe të shkruar. *Përpunuesit teorikë dhe mbështetësit e metodave analitike mendonin se tingulli vetë nuk ka domethënie jashtë tekstit, prandaj dhe në procesin e mësimit të leximit është më mirë të nisemi prej fjalës si bartëse e kuptimit.*

*Këtij grupi i përkasin metodat globale, të cilat kanë përparësi historike. Në veprën e tij, që më 1768, abati i Radonvilliers-it (Paris) këshillon mësimin e leximit, duke u nisur nga njohja e fjalës në tërësi, dhe më pas në zbërthimin e saj në rrokje dhe tinguj.*

Edhe profesori frëng Zhan Zhoséf Zhakoto (Jean Josepf Jacotot, 1770-1840) konsiderohet si njëri prej mbështetësve të dalluar të metodave analitike. Për këtë arsye, njëra prej metodave analitike më të hershme njihet me emrin e tij - “metoda e Zhakotos”. Bashkëmendimtarët dhe përkrahësit e mëvonshëm të Zhakotos, me qëllim përparimin e procedimit analitik të metodës së tij, propozuan metoda të reja analitike. Ndërkohë u nisën e u afirmuan më shumë metoda analitike, midis të cilave bëjnë pjesë: metoda e teksteve normale, metoda e fjalive normale, metoda e fjalëve normale, metoda e rrokjeve normale dhe metoda globale.

Duke dashur të shmangë dobësi të ndryshme të varianteve më të hershme të metodave analitike, metodisti Grafunder propozoi që për analizë të mos merreshin tekstet, as fragmentet letrare nga librat, por fjali të shkurtra. Këto, sipas tij, do të duhej të ishin fjali të shkurtra, të thjeshta, të kuptueshme dhe me porosi të shëndosha edukative. Të njohura e të afërta dhe me strukturë grafike dhe fonetike të përshtatshme për

fëmijët e kësaj moshe shkollore. Për shkak të veçorive psiko-lingvistike që duhet të kenë, këto u quajtën dhe njihen edhe sot me emrin fjalë normale, prandaj edhe metoda e mësimit të tingujve e të shkronjave dhe e lexim-shkrimit fillestar, edhe sot njihet si metodë e fjalëve normale. Metoda e fjalëve normale e lehtësoi shumë mësimin e shkronjave dhe të lexim-shkrimit fillestar. Për këtë arsye, metoda e fjalëve normale konsiderohet edhe sot si metodë shoqëruese e metodës analitiko-sintetike.

*Metoda e fjalëve normale* është një metodë tjetër analitike, e cila e shoqëron metodën analitiko-sintetike të tingullit në praktikën e sotme të mësimit të shkronjave dhe lexim-shkrimit fillestar në shkollat tona. Gjurmë të metodës së fjalëve normale i ndeshim në veprën metodike të Komenskit “Bota ndijore në fotografi” (*Orbis sensualium pictus*). Mësuesit gjermanë, Maksimilian Oto Kramer dhe Karlo Fogel (mesi i shek. XIX) e përpunuan teorikisht dhe e ngritën në nivel të metodës.

Një metodë e tillë u sistemua më pas në një formë, e cila bëhet më e freskët dhe aktuale nga Nikolas Adam (Paris, 1887), i cili, duke iu referuar në fillim të shekullit XIX qytetarit, Oualio Dekroli, mbështet metodën e tipit global, si premisë për mësimin e leximit dhe të shkrimit.

Këto konsiderata janë bazë e vazhdimësisë së kësaj metodologjie (analitike-globale), e përfaqësuar nga R. Dottreus, i cili përpiket të nxjerrë në pah fjalën, e cila shpreh përvojën konkrete dhe si moment themelor të përvetësimit të leximit dhe të shkrimit, ofron motive që nxisin veprimtarinë spontane të fëmijëve.

Këto metoda nuk na largojnë nga ajo e Dekrolit (1904-1907) e N. Adamit (1787), kur ata vënë në plan të dytë momentin e analizës dhe të sintezës në procesin e përvetësimit të lexim-shkrimit, duke synuar që fëmija spontanisht dhe në kohën e volitshme të zbulojë shkronjat që janë në përbërje të fjalës dhe me të cilat, më vonë, nëpërmjet sintezës arrin t’i lexojë e t’i shkruajë.

Përgjithësisht mund të thuhet se teoria u begatua me metodat analitike dhe bëri hap përpara edhe praktika e mësimit të shkronjave dhe të lexim-shkrimit fillestar. Ato ndihmuan kuptimin e drejtë dhe më të plotë të përmbajtjeve. Ndihmuan edhe ndërlidhjen më të mirë të mësimit të shkronjave dhe të lexim-shkrimit fillestar, me përmbajtjet programore të lëndëve të tjera mësimore të klasës së parë fillore. Me ecurinë metodike që përdornin, ndihmuan veçanërisht në zotërimin më të mirë të shkathtësisë së leximit.

Edhe metodat analitike kanë dobësitë e tyre. Për këtë arsye, ato sot duhet të kuptohen vetëm si metoda shoqëruese të metodës analitiko-sintetike dhe të formës së mësimit të tingujve e shkronjave dhe leximit e shkrimit fillestar.

**Metodat analitike-sintetike.** Me kalimin e kohës, këto metoda u përsosën më tej. Kështu, metoda analitike (globale) nisën nga struktura të bashkuara të gjuhës së shkruar (fjalë, fjali), pas së cilës procedohej në zëvendësimin e saj me atë analitike-sintetike. Afritë midis këtyre metodave, asaj analitike (globale) dhe asaj sintetike-analitike janë vetëm në pamjen e jashtme. Në thelb ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra si nga ana shkencore, ashtu edhe nga ana didaktike. Bazat teorike të këtyre metodave i ka mbështur dhe i ka vërtetuar procesi mësimor. Këtu del në pah J. Piazhe, i cili për momentin e parë të përvetësimit dhe të nxënies të lexim-shkrimit i jep përparësi metodës analitike (globale).

Në psikologjinë e fillimit të këtij shekulli theksohen dhe vlerësohen vështirësitë e shumta në momentin e analizës dhe të sintezës.

Me fjalë të tjera, nëse metoda globale praktikohet në momentin e parë të përvetësimit të lexim-shkrimit, metoda analitike-sintetike praktikohet në momentin e analizës dhe të sintezës, e pikërisht pas momentit të njohjes globale.

Në praktikën mësimore të shkollave, në vende të ndryshme të Evropës u zbatuan variante të ndryshme të metodës analitiko-sintetike. Varianti më i përhapur i kësaj metode dhe më i zbatueshmi edhe në mësimin e shkrim-leximit fillestar në shkollat tona është metoda analitiko-sintetike e tingullit. I përshtatet mirë natyrës së gjuhës shqipe, prandaj shumë nga abetarët tona u hartuan me këtë metodë bazë.

Zbatimi me mjeshtëri i metodës analitiko-sintetike të tingullit bën të mundur që “...në orën e mësimit të shkrim-këndimit të zbatohen forma pune të tilla që zhvillojnë mendjen e fëmijës dhe që nuk mbështeten në



të mësuarit e shkronjave dhe rrokjeve përmendsh, por me vetëdije”.<sup>1</sup>

Ecuria metodike e punës me këtë metodë nis me analizën e fjalisë e të fjalës normale. Parapëlqehet që fjala normale e veçuar për analizë të fillojë me tingullin a shkronjën e re. Analiza e fjalës, si rregull bëhet përmes rrokjes deri te tingulli dhe shkronja e re që mësohet brenda orës përkatëse. Fjalët me strukturë fonetike e grafike më të thjeshtë, të afërta dhe joshëse për fëmijët, mund të analizohen drejtpërdrejt, nga fjala në tingullin dhe shkronjën me të cilën fillon.

Pasi të jetë veçuar tingulli i ri, mësuesi demonstroi shqiptimin model të tij. Këtu mësuesi duhet t'i kushtojë kujdes shqiptimit model të tingujve, me shmangie karakteristike nga norma shqiptimore.

Tregohet shkronja e re si shenjë grafike për tingullin përkatës. Edhe këtu teknika e të shkruarit të shkronjës duhet të përdoret në Abetare. Me këtë rast, mësuesi duhet të heqë dorë nga lakoret dhe elementet e tjera të shkrimit të qëndisur ose ornamentistik.

Deri këtu, metoda analitiko-sintetike e tingullit ecën sipas procedimit analitik. Prej këtu, kërkohet që nxënësit të formojnë, të lexojnë dhe të shkruajnë fjalë e fjali me shkronjën e re dhe ato të mësuara më përpara. Pastaj kalohet në leximin e tekstit të Abetares ose të hartuar posaçërisht nga mësuesi.

Për përmbyllje do të thoshim se metoda analitiko-sintetike e zbatuar me mjeshtëri, siguron këto efekte pozitive në mësimin e shkronjave dhe lexim-shkrimit fillestar:

- ndihmon njohjen më të mirë të nxënësve me strukturën fonetike të teksteve, të fjalive e të fjalëve,
- lehtëson kuptimin më të mirë të përmbajtjeve që lexohen,
- kontribuon edhe për zotërimin më të lehtë të shkathtësisë së shkrimit, duke i njohur nxënësit me strukturën grafike të fjalive e të fjalëve,
- siguron edhe shumë efekte pozitive në edukimin e nxënësve nismëtarë të shkollës fillore.

Metoda mikste është kombinim i të gjitha metodave të parashtruara më lart.

### Nga sa parashtruar më lart, orientimi metodologjik në këtë Abetare është drejt metodës **ANALITIKE-SINETIKE**

Duke u nisur nga kjo pikëpamje, metodat analitike-sintetike me variantet e ndryshme që janë shfaqur, prezantohen si metoda që mbartin arritjet shkencore më aktuale gjatë procesit të përvetësimit dhe të nxënësve të lexim-shkrimit.

Mbi bazën e këtyre të dhënave, sot shkencat didaktike kanë arritur në këto vlerësime:

- Momenti i parë i të nxënësve të leximit është ai analitik global. Është shumë më e lehtë t'i jepen fëmijës mundësitë e para për këtë veprimtari.
- Është i domosdoshëm momenti i analizës së fjalës, d.m.th., i njohjes së elementeve a germave me të cilat është e përbërë fjala, me qëllim që më pas fëmija të ketë mundësi të kuptojë si është formuar ajo, për të mundur më vonë të lexojë fjalë të reja, si sintezë e shkronjave të njohura.

Dimë, nga ana tjetër, se momentet e analizës dhe të sintezës janë më të vështira, sepse fëmija 6-7-vjeçar është në hapat e parë të zhvillimit intelektual dhe ndesh vështirësi për leximin dhe shkrimin e saktë të fjalës e fjalisë.

Burimet e mësipërme, të cilat u shfrytëzuan në këtë parashtrim, qofshin ato me karakter historik, qofshin edhe aktuale, janë një ndihmesë e mirë për rritjen e kulturës profesionale të mësuesve dhe hartuesve të teksteve të abetaresve, prandaj edhe i parashtruar në këtë Abetare Pune për mësuesit.

<sup>1</sup> Grup autorësh, Metodika e gjuhës amtare për shkollën Normale dhe për mësuesit e shkollës fillore, ETMM i Kosovës, Prishtinë, 1971, f. 11.

## PJESA II: Udhëzime shkencore, didaktike, metoda dhe strategji mësimdhënieje

### Udhëzime të përgjithshme

#### II.2. Udhëzime për periudhën përgatitore

##### Paraabeta

##### Synimet

Periudha përgatitore synon të aftësojë nxënësit për të fituar disa shprehje të thjeshta për lexim-shkrimin.

Përmes kësaj periudhe synohet të fitohen disa shprehje komunikimi të domosdoshme për fëmijët e kësaj moshe, të tilla si:

- Zhvillimi i të folurit
- Pasurimi i fjalorit
- Përmirësimi dhe saktësimi i strukturave gjuhësore folëse të shqipes
- Zhvillimi i disa aftësive motorike të domosdoshme për procesin e lexim-shkrimit
- Leximi global i disa fjalëve dhe shprehjeve të shkurtra (elemente të metodës globale)
- Njohja me shkronjat dhe tingujt në mënyrë të shpejtë (elemente të metodës alfabetike)

**Struktura: Shqipëri 4 javë x 8 orë = 32 orë; Kosovë 4 javë x 7 orë = 28 orë**

Periudha e Paraabetares synon:

- Zhvillim të foluri
- Krijimi i mjedisit fonologjik të tingullit/shkronjës
- Njohja me elemente të shkrimit të dorës

Gjatë periudhës përgatitore do të synohet që me nxënësit të kryhen veprimtari të ndryshme mësimore, lojëra didaktike mësimore në shërbim të lexim-shkrimit, të tilla si:

- Vizatime e punime me dorë,

- Imitime të zhurmave të natyrës dhe tingujve të ndryshëm (ciu-ciu, mjau-mjau, tik-tak etj.),
- Lojë në role,
- Dramatizime përrallash dhe tregimesh të ndryshme,
- Lojëra me pazëlla, me letra dhe me lojëra të tjera me shkronja të ndryshme,
- Këngë të ndryshme për të fituar lartësinë mesatare të zërit,
- Biseda për tema të ndryshme që lidhen me botën dhe aktivitetin e tyre jetësor, duke pasuruar fja-lorin me fjalë dhe shprehje që i përkasin kësaj teme,
- tregime përralla gjëgjëza, vjersha, pyetje rrufe etj.

Aktivitetet e kësaj periudhe do të kryen në mënyrë të integruar përmes bashkëveprimit të shprehive të të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit nga njëra anë dhe përmes veprimtarive tematike, të cilat do të bashkëshoqërohen me veprimtari argëtuese për fëmijët: lojë në role, dramatizime, vizatime, punime me dore, aplikime etj.

- Forma shkronjash ku nxënësit mund t'i ngjitin sipas modelit për të formuar fjalë, ushtrime fizike, prova etj.
- Rekomandohet që temat që do të shoqërojnë këtë periudhë të lidhen me paraqitjen: lojërat, kafshët, profesionet, ushqimet, shkollën, shokët, dëshirat etj.
- Do të mësojnë të shkruajnë shkronjat e shtypit, kryesisht shkronjën e madhe.

#### Struktura e një faqeje libri

- Materiale që duhet të përdoren:
- Abetarja
- Abetarja e Punës

### Struktura e faqes së Paraabetares

Tema për zhvillim të foluri dhe pasurim fjalori.

Tingulli / shkronja

Përmbajtja (fabula)



Elemente shkrimi (vijat vertikale, horizontale e të lakuara)

### Struktura e faqes së Abetares

Tingulli / shkronja.

Shiko / dëgjo / fol.

Lexo.

Shkronja e dorës

Plotëso fjalët

Lidh me shigjetë

Analizë/ sintezë/ fjalish/fjalësh/ rrokjesh

Qarko

**AKULLORJA**

**KUSH E HËNGRI AKULLOREN?**

Na ish në park 1 ëmbëltore, kishte shurup dhe akullore me manaferra e flokë bore... Oh, sa të mirat! Të tërë që vinin, gishtat lëpinin.

1 ditë, kur doli dielli, që lart nga qielli, na shkon arushi në ëmbëltore e na kërkon 2 akullore.

Akulloren e parë, miku arush e për lau bashkë me kaush. Akulloren tjetër, mbushur plot me bore, për mamin e ka blerë, shpejt vrapon t'ia shpjerë...

**Pyetje**

Embëltorja ishte:  në mal?  në park?  
 Akulloren e bleu:  pëllumbi?  arushi?  
 Akulloren e shkriu:  dielli?  llamba?

**Formo fjalë me fjalët.**

Pëllumbi mori kullon Dielli është në qiell. Drini solli pikë-pikë akullore. në qiell. letrën.

**Shkruaj.**

UNË I HASHUMË AKULLORET.

Unë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_


Lidh me shigjetë Shkruaj me shkrim dore

Gjej

Vizato

### Struktura e faqes së pasabetares.

**MIQTË E PYLLIT**



**DITË LEXOJ DHE SHKRUAJ**

● Lexo pjesën. Nënviçto emrat e personazheve.

● Personazhet e tregimit janë shoqe?  Po  Jo

● A ndienin të ngrohtë nën kërpudhe?  Po  Jo

● A e harruan shoqet kërpudhën?  Po  Jo

● Shkruaj si janë:

kërpudha	shoqe	ngrohtë	harruan	shoqet	
mollëkuqja					✓
milingona					
larva					

● Luajmë në role. Luani në role pjesën.

<input type="checkbox"/> kshenj	<input checked="" type="checkbox"/> gështenje	gështenje
<input type="checkbox"/> mronte	<input type="checkbox"/> mbronte	
<input type="checkbox"/> ban si ban	<input type="checkbox"/> bënë si bënë	

Në këmbët e një gështenje jetonte një kërpudhë e madhe, me kësulë të kuqe me pika të bardha. Nën kërpudhë jetonin të lumtura tri shoqe: mollëkuqja, milingona dhe larva. Erdhi dimri. Kërpudha nuk i mbronte dot nga të ftohtët. Shoqet vendosën të shkonin te trugu i gështenjes. Po si t'i thoshin kërpudhës se po largoheshin? Ajo do të mërzitej. Bënë si bënë dhe një ditë ia thanë. Morën rrobat dhe u larguan. Por shoqet nuk e harruan kërpudhën. Ato shkonin çdo ditë dhe e përshëndetnin. Kështu, kërpudha nuk u ndje e vetmuar.

**ZEMËRIMI I LULEVE**

Një ditë, trëndafili i tha fluturës:  
- Lajmëro të gjitha lulet se sonte do të mbldhemi nën pishën e madhe.  
Në mbrëmje, ishin ulur pranë e pranë tulipani, karafili, trëndafili, lulëkuqja, manushaqja etj.

I pari e mori fjalën trëndafili:  
- Njeriu ka krijuar lule artificiale më të bukura se ne.  
- Ky është turp i madh! - shpërtheu gjithë inat tulipani.  
Të gjitha lulet përsëritën të njëjtat fjalë:  
- T'i fshehim lulet artificiale! T'i fshehim! T'i fshehim!  
Në fund e mori fjalën manushaqja:  
- Ne nuk duhet të zemërohemi me lulet artificiale. Ato mund të jenë të bukura, por nuk mund të jenë kurrë të gjalla. Ato nuk prodhojnë lule e fara.  
- Nuk mund të krahasohen me ne! - thirrën lulet njëzëri.  
Ne duhet të kthehemi në kopshtet e vazot tona, të shtohemi e të zbukurojmë parqet dhe oborret. Të qetësuara, lulet u kthyen në kopshtet dhe vazot e tyre.

**DITË LEXOJ DHE KRAHASOJ**

● Lexo pjesën dhe nënvizto emrat e luleve.

● Pyetje  
Cili është shqetësimi që kanë lulet?  
Çfare bënë ato?  
Si u qetësuara lulet?

● Luani në role bisedën e luleve.

● Formo fjali me emrat e luleve.

ngjashmëritë

lule natyrale	ngjashmëritë	lule artificiale
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

● Plotëso dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet luleve natyrale dhe luleve artificiale.

● Vizato një lulet që marrin pjesë në tregim dhe shkruaj emrat e tyre.

### Struktura e librit të Abetares së Punës














Alfabeti

Paraqitja e tingullit  
Paraqitja e shkronjës

Lexim dhe shkrim  
i fjalës globale

Shkronjë e madhe  
e shtypit

Elemente shkrimi  
Elemente vizatimi  
dhe ngjyrosjeje

A B C C D D h E E F G G j H I J K L L i M N										N j O P Q R R r S Sh T Th U V X X h Y Z Zh														
 <p>PINOKU <input type="checkbox"/> INOKU</p>																				 <p>ORA TIRA</p>				
 <p>PULA <input type="checkbox"/> ULA</p>															 <p>ROBOTI RIBITI</p>									
 <p>NJESH <input type="checkbox"/> ESHI</p>															 <p>QENGJI <input type="checkbox"/> ENGJI</p>									
 <p>NJERIU <input type="checkbox"/> ERIU</p>															 <p>QYTETI <input type="checkbox"/> YTETI</p>									

Shkronjat dhe rrokjet

Plotëso shkronjat që mungojnë

Ushtrime analize dhe sinteze

Struktura e fjalisë

Shkrimi i dorës

**L l**

LI				
LA	LI	LE	LË	LU
la				

lumë limon lule

miu ariu lule iriq lumi ura leu era

limoni leu lau luan Iliri maji imel ilam uej

Lira me luan lule mali  
Iliri e u në luani e lanë lumë

*Me shkrim dorë*

l l l  
l l lule lule me ere  
L L L  
Alma u la në lumë

Diktim 30

**K k**

Kk				
KA	KI	KE	KË	KU
ka				

kali lekë makinë

miu iriq kali ura lumi era kam ura

Unë kam Ai Ne kam ke ka kemi keni kamerë kalë makinë lekë pako kuti

*Me shkrim dorë*

k k k  
k k kali im  
K K  
K Keli iku me makinë

Diktim 31

Ushtrime për fjalët, cilësitë, veprimet, fjalitë, përshkrimi, pyetjet

**Veprime**

Shkruaj çfarë bëjnë fëmijët.

Beni  
 Ana  
 Miri  
 Tani

Beni \_\_\_\_\_  
Ana \_\_\_\_\_  
Miri \_\_\_\_\_  
Tani \_\_\_\_\_

Lidh fjalët dhe shkruaj fjalë me to.

Zogu Mushkonja Lulja Karroca Barka	ka	thumb. gjethe. vela. sqep. rota.	Shtëpia Fëmija Qershia Peshku Gjeli	ka	lodra. hala. lafshë. bërthamë. derë.
--	----	--	---	----	--

Zogu ka sqep. Shtëpia ka ...  
Mushkonja ...

Shkruaj çfarë bëjnë fëmijët.

\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

74

**Unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato**

Plotëso.

Unë po bëj mësimet. Unë nuk po bëj mësimet.

Ti \_\_\_\_\_  
Ai \_\_\_\_\_  
Ne \_\_\_\_\_  
Ju \_\_\_\_\_  
Ata \_\_\_\_\_

Shkruaj fjalë me emrat e atyre që bëjnë këto veprime.

shpjegon, udhëzon, \_\_\_\_\_  
vrapon, leh \_\_\_\_\_  
ha bukë, fruta, \_\_\_\_\_  
punon, shpenzon, \_\_\_\_\_  
studion \_\_\_\_\_

Plotëso fjalitë.

Dikur Tani

Dikur ndriçohet \_\_\_\_\_  
Dikur lëvizet Tani \_\_\_\_\_

Lidh me shigjetë. Shkruaj emrat e figurave.

presim \_\_\_\_\_  
qepim \_\_\_\_\_  
fshijmë \_\_\_\_\_  
lyejmë \_\_\_\_\_  
sharrojmë \_\_\_\_\_  
mbërthejmë \_\_\_\_\_

Shkruaj sipas modelit:  
Me gërshtë presim letër, \_\_\_\_\_

75

Për periudhën përgatitore janë planifikuar rreth 32 orë mësimore, për shkollat ku nuk është frekuentuar arsimi parashkollor ose kur duam të sistemojmë aftësitë e nevojshme të nxënësve për të ecur në mënyrë progresive në fazat të mëpasshme.

Në orët e planifikuara mendohet që nxënësit të njihen me tingujt, shkronjat, fjalë globale, siç u përmend edhe më lart.

Në çdo orë mësimi, mësuesi duhet:

- të njohë nxënësit me një tingull përkatës dhe me grafikun e tij,
- të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje, të cilat e përmbajnë tingullin përkatës,
- të aftësojë nxënësit për të folur për një temë përkatëse sipas planifikimit, në mënyrë që nxënësit të përdorin fjalë e fjalor që përmbajnë tingullin përkatës,
- të ushtrohen për të shkruar e për të modeluar forma shkronjash,
- të lexojnë e shkruajnë në mënyrë globale 2-3 fjalë për çdo shkronjë, të cilat mund ta kenë tingullin përkatës në fillim, në mes dhe në fund të fjalëve përkatëse,
- të tregojnë tregime, përralla, përvoja të thjeshta, që lidhen me tema të caktuara,
- të diskutojnë me njëri-tjetrin.

## II.3. Udhëzime për Abetaren

### Materialet:

- Abetarja
- Abetarja e Punës (pjesa e dytë)

**6 shkronjat e para do të zhvillohen në 4 orë secila.**

**30 shkronjat e tjera do të zhvillohen në 5 orë secila.**

**6 temat e rimarrjes do të zhvillohen në 4 orë secila.**

**3 orë - Punë me faqen e Abetares:** bisedë, prezantim shkronje e tingulli të ri, lexim, analizë e sintezë strukturash fjalish dhe fjalësh, leximi i pjesëve të leximit, ushtrime përforcimi.

1 orë - Ushtrime analize e sinteze në Abetaren e Punës: analizë e sintezë strukturash fjalësh, fjalish etj.

1 orë – **shkrim i dorës** – Pjesa e tretë e Abetares së Punës.

Në çdo 6 shkronja do të bëhet **një rimarrje** 4-orëshe: lexim, ushtrime manipuluese leximi dhe shkrimi.

Në dispozicionin të mësuesit mbeten **10 orë**, të cilat mund t'i shfrytëzojë sipas nevojave të nxënësve.

### Ndarja në 6 grupe shkronjash

- |    |           |                            |
|----|-----------|----------------------------|
| a. | Shkronjat | a, i, m, n, e, ë           |
| b. | Shkronjat | r, u, l, k, o, p           |
| c. | Shkronjat | <b>b, h, t, s, sh, f</b>   |
| d. | Shkronjat | rr, j, v, q, d, dh         |
| e. | Shkronjat | <b>ll, g, gj, th, c, ç</b> |
| f. | Shkronjat | <b>nj, y, z, x, xh, zh</b> |

## Standarde që duhet të arrihen

Në përfundim të Abetares, nxënësi i klasës së parë duhet:

- Të përdorë librin si mjet të nevojshëm për të përmbushur interesa vetjake për të lexuar.
- Të njohë dhe të shpjegojë shenjat orientuese në librat që u lexon titullin, autorin, paragrafin.
- Të lexojë me intonacionin e duhur.
- Të respektojë shenjat e pikësimit të tilla, si: pika, presja, dy pikat, viza, pikëpyetja, pikëçuditja.
- Të lexojë me kuptim.
- Të bëjë pyetje rreth teksteve që lexon.
- T'u përgjigjet pyetjeve nga tekstet e lexuara.
- Të lexojë me shpejtësi mesatare jo më pak se 50 fjalë në minutë.
- T'u përgjigjet me shkrim pyetjeve të ndryshme.
- Të shkruajë me të diktuar.
- Të formojë fjali të thjeshta.
- Të plotësojë në fjali fjalët që mungojnë.
- Të përdorë shkronjën e madhe në fillim të fjalive.
- Të përdorë shenjat e pikësimit në fjali si: (.) (,) (!) (?)
- Të njohë dhe të përdorë terma, të tillë si: fjalë, fjali, rrokje, shkronjë, shkronjë e madhe, tingull, titull, shenja pikësimi etj.

## II.4 Udhëzime për Pasabetaren

	Shqipëri	Kosovë
I.	Veprimtari leximi – 18 orë	18
II.	Veprimtari shkrimi – 18 orë	17
III.	Dispozicion 2	

### Standarde që duhet të arrihen

Në përfundim të periudhës së tretë së Pasabetares, nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Për të lexuarin**
  - Të realizojë aktin e të lexuarit në mënyrë të natyrshme.
  - Të lexojë në mënyrë të kuptimshme.
  - Të përdorë intonacionin e duhur në të lexuar.
  - Të lexojë me shpejtësi mesatare deri në 50-60 fjalë në minutë. Por kjo varet edhe nga mjedisi i klavave (mësuesi këtu duhet të njohë dhe të vendosë edhe një standard të vetin për ta pasur si instrument për kontrollin dhe ecurinë e mëtejshme për sigurimin e një cilësie të mirë për të lexuarin e nxënësve).

- Të lexojë në mënyrë të pavarur.
  - Të shprehë dëshirë për të lexuar.
  - Të lexojë në stile të ndryshme letrare, artistike, poezi, prozë, fabul, përrallë.
  - Të shpjegojë kuptimin e fjalëve, të tilla si: tregim, përrallë, vjershë e gjëegjëzë.
- **Për të shkruarin**
    - Të shkruajë bukur dhe pa gabime.
    - Të shkruajë me kuptim fjalë dhe fjali.
    - Të ndajë fjalë në rrokje.
    - Të shkruajë në përgjigje të kërkesave të ushtrimeve.
    - Të shkruajë duke iu përgjigjur shkurt pyetjeve të ndryshme.
    - Të shkruajë me të diktuar.
    - Të shkruajë me të kopjuar.
    - Të shkruajë mendime origjinale duke përshkruar thjesht sende, situata.

## II. 5. Udhëzime për Abetaren e Punës

Abetarja e Punës e shoqëron Abetaren në të tria pjesët e saj.

Ajo **synon** të aftësojë nxënësit:

- Të lidhin shkronjat në fjalë dhe fjalët në fjali.
- Të kryejnë nxënësit ushtrime gjuhësore manipuluese për të përvetësuar strukturat e fjalëve.
- Të ushtrohen të bëjnë analizën dhe sintezën e fjalëve.
- Të krijohet te nxënësit vetëdija gjuhësore e konceptit të fjalës, fjalisë, tekstit.
- Të ushtrohen për të shkruar mendimin.
- Të lidhin gjuhën e folur dhe të lexuarin me gjuhën e shkruar.

### Procedura didaktike

Në pjesën e parë të saj, Abetarja e Punës synon krijimin e një mjedisi fonologjik për tinguj dhe shkronja, zhvillim të folurit dhe shkrim të elementeve të shkrimit të dorës dhe atij global.

Kjo pjesë e kësaj Abetareje Pune shoqëron periudhën e Paraabetares dhe synon që nxënësit të artikulojnë dhe të shkruajnë me shkronja kapitale të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, si dhe elemente të ndryshme shkrimi, me qëllim përgatitjen për veprimtari të rëndësishme shkrimi dhe leximi, me të cilat do të ndeshen në pjesën e dytë të Abetares.

**Pjesa e dytë** e Abetares së Punës nis me ushtrimet, të cilat duhet të kryhen sipas radhës së paraqitur në të. Kjo pjesë shoqëron pjesën e dytë të Abetares në të gjitha faqet e saj, përmes ushtrimeve përforcuese që i bëhet punës me Abetaren.



Faqja e pjesës së dytë të Abetares së Punës është e strukturuar në dy pjesë: pjesa e ushtrimeve përforcuese dhe pjesa për shkrimin me shkronja dore.

- Ushtrimet në këtë pjesë të Abetares së Punës respektojnë shkallën e vështirësive.
- Jo të gjitha ushtrimet mund të kryhen brenda një ore mësimore.
- Jo të gjitha ushtrimet mund të kryhen nga të gjithë nxënësit.
- Mësuesi duhet t'i ketë në vëmendje nxënësit që kanë vështirësi në realizimin e ushtrimeve të Abetares së Punës.
- Për nxënësit me vështirësi, që mund të mos i plotësojnë në të njëjtën kohë me të tjerët ushtrimet e Abetares së Punës, në kohë të ndryshme, mësuesi mundëson dhe ndihmon këta nxënës për të plotësuar mangësitë.
- Ushtrime të caktuara mund t'u lihen edhe si detyrë shtëpie, në rastet kur mendohet se mund t'i kryejnë me ndihmën e prindërve.
- Për rastet kur ushtrime të Abetares së Punës, të paplotësuara në kohën e parashikuar, është mirë të kërkohet që nxënësit t'i plotësojnë në një kohë tjetër.
- Në përfundim të Abetares së Punës, nxënësit duhet të kenë plotësuar të gjitha fletët e tij.
- Faqet e përsëritjeve, të planifikuara në fletoret e punës, mund të shërbejnë si faqe përmes të cilave mund të kontrollohen dhe të vlerësohen nxënësit. Ato janë modele të përafërta testesh që ndihmojnë mësuesin për të formuar modele të tjera të përafërta me to.
- Në varësi të nivelit të nxënësve, mund të ndodhë që gjatë një ore mësimi të mos përfundojnë të gjitha ushtrimet e parashikuara në Abetaren e Punës.
- Në faqet e fundit, kur mësuesi mendon se nxënës të caktuar nuk kanë nevojë për të bërë ushtrimet e para të këtyre faqeve, pasi ato mund të jenë të thjeshta për ta, u jep atyre të punojnë me ushtrime të një niveli më të përparuar, të cilat zakonisht përfshijnë ushtrimet pas 2 ose 3.
- Mësuesi duhet të bëjë vlerësime të vazhdueshme në pjesën e modeluar të Abetares së Punës, por vlerësimet më të rëndësishme formuese për të, mësuesi zakonisht duhet t'i bëjë në faqet e orës së rimarrjes.

**Pjesa e tretë e Abetares së Punës synon:**

- Të ushtrojë nxënësit përmes ushtrimeve gjuhësore të përvetësojnë më mirë trajtat e sakta drejtshkrimore të fjalëve në gjuhën shqipe.
- Të ushtrojë nxënësit që përmes ushtrimeve gjuhësore të fitojnë aftësi për ta shkruar gjuhën shqipe për qëllime të caktuara, për t'u përgjigjur, për të përshkruar thjesht një send ose një objekt.
- Të shkruajnë për interesa vetjakë.
- Të zhvillojnë intuitën gjuhësore përmes të shkruarit për dukuri të tilla, si: emrat e njerëzve, shkronja e madhe, fjalët që tregojnë cilësi.
- Fjalët që tregojnë veprime.
- Fjalët që tregojnë njerëz, kafshë e sende.
- Të plotësojnë në tekste të ndryshme fjalët që mungojnë.
- Të shkruajnë duke respektuar shenja të thjeshta pikësimi, si: pika, pikëpyetja etj.
- Të ndajnë fjalët në rrokje dhe në fund të rreshtit.

## II. 5. Udhëzime për pjesën e punës së modeluar/shkrimin e dorës

Pjesa e punës për shkrimin e modeluar të dorës në këtë Abetare Pune është përfshirë brenda faqes së ushtrimeve të analizës dhe sintezës, me synimin që, pasi të kenë përfunduar ushtrimet për shkronja të caktuara, të hidhen në shkrimin e dorës. Në këtë mënyrë kemi synuar t'i mbajmë sa më pranë shkrimin e shtypit me atë të dorës.

Pjesa e modeluar synon:

- T'u mësojë nxënësve shkrimin e dorës.
- T'u mësojë të shkruajnë dhe të lidhin drejt dhe saktë shkronjat e dorës në fjalë dhe fjali.
- Të shkruajnë me të kopjuar dhe me të diktuar, duke e kthyer shkrimin nga shkrim shtypi në shkrim dore.
- Të shkruajnë mendimin thjesht dhe bukur.

Pjesa e modeluar ofron modelin e shkronjave të mëdha dhe të vogla të dorës dhe mënyrën e bashkimit të tyre në fjalë dhe fjali.

Siç shihet edhe nga vetë pjesa e modeluar, ajo nuk krijon shumë mundësi për të ushtruar nxënësit brenda saj me shkrimin e dorës. Ajo vetëm jep modelin. Ushtrimi i tyre me modelin e shkrimit të dorës do të realizohet përmes fletoreve të tjera të shkrimit, të përafërta me këtë model. Modeli i kësaj abetareje nuk nxit njëtrajtësinë e shkrimit të dorës për të gjithë nxënësit, por rekomandon modelin e përafërt. Vetë mësuesit zgjedhin fletoren më të përshtatshme për nxënësit e tyre, fletore që ofron sot tregu.

Nisur nga modeli që ofrohet, mësuesit janë të lirë të gjejnë modelin alternativ si fletore të shkrimit të dorës.

Në fletoren që rekomandojmë jepen pak fjalë dhe më rrallë fjali e grupe fjalësh për t'u shkruar.

Mësuesi këshillohet të zgjedhë nga teksti ose nga materiale të tjera fjali, grupe fjalësh me qëllim që nxënësit t'i shkruajnë në orët e shkrimit të modeluar, duke i kopjuar, duke i shkruar me diktim ose të modeluara nga mësuesi në fletoret e tyre në të cilat praktikohen.

Ora që do të përdoret për mësimin e shkrimit të dorës synon të realizojë këta dy objektiva:

a- Të modelojnë shkronjat të dorës të vogla dhe të mëdha dhe bashkimin e tyre në fjalë.

b- Të shkruajnë bukur, të kopjojnë pjesë, të bëjnë diktime me pjesë leximi nga Abetarja ose nga libra të tjerë.

Ngarkesa mësimore për çdo veprimtari të mësipërme vendoset nga mësuesi.

Me grupe të ndryshme nxënësish, mësuesi mund të bëjë veprimtari të shkruari sipas nevojave të tyre:

- me një grup vazhdon shkrimin e shkronjave dhe fjalëve me shkronjën përkatëse;
- me grupin tjetër bën kopjim apo diktim;
- me një grup tjetër kopjim të pavaruar nga teksti etj.

Në këtë fletore pune kemi shtuar edhe rubrikën **diktim**. Përmes kësaj rubrike duam t'u themi mësuesve dhe prindërve që, për çdo shkronjë, ata duhet t'i lënë pak vend diktimit. Pra, sipas ngarkesës, në çdo orë mësimi, mësuesi duhet të japë me të diktuar dy-tri fjali, të cilat i nxjerrë nga teksti ose i krijojnë vetë.

Përmes diktimit synojmë që dalëngadalë ta çojmë nxënësin drejt aftësisë të shkruarit nëpërmjet të menduarit, pra të lexojnë mendimin e tij dhe të nisë ta shkruajë, fillimisht nga të dëgjuarit dhe përkthimin e tij nga ana tingullore në atë grafike.

Rekomandohet që fjalët dhe fjalitë, të cilat do të zgjidhen për diktim, të përmbajnë probleme drejtshkrimore të tilla, si: fjalë me tri rrokje, pozicioni i shkronjës në fillim në mes dhe në fund të fjalës, grup bashkëtingëlloresh *mb, nd, ng, ngj* etj., grup zanoresh *ua, ue*, përdorimi i ë-së fundore në pozicione të ndryshme.

Mësuesit dhe prindërit këshillohen që në shkronjat e pjesës së dytë të Abetares t'i ushtrojnë nxënësit

me sa më shumë veprimtari të lexuari dhe të shkruari të tipit kopjim, diktim pjesësh, përgjigje me shkrim për pyetje të caktuara, bërje pyetjesh me shkrim dhe dhënie përgjigjeje etj.

Në shkronjat e fundit të Abetares, mësuesit duhet të provojnë dhe të nxisin edhe shkrimin krijues të nxënësve të tilla, si: përgjigje, pyetje, përshkrime të thjeshta të sendeve dhe objekteve të drejtuara nga pyetjet:

### Si është? Çfarë ngjyre ka? Ku iku? Me kë iku?

Për t'i bërë më të larmishme orët e shkrimit të modeluar, mësuesi mund t'ju japë nxënësve tekste me shkrim shtypi dhe ata t'i shkruajnë me shkrim dore dhe e kundërta.

E rëndësishme është të kuptohet se modelimi i shkrimit nuk është thjesht një veprimtari që e nxit nxënësin të mësojë vetëm modelin e shkrimit të dorës, por edhe të shkruajnë me kuptim për atë që lexon dhe mendon.

Mësuesit nuk duhet të humbasin shumë kohë me modelime pa fund të shkrimit të dorës, por me prodhimin e shkrimit si proces nëpërmjet shkrimit të fjalëve, fjalive e teksteve të shkurtra me kuptim.

Këshillojmë t'i mësojmë nxënësit të shkruajnë dhe të lexojnë mendimin qartë, saktë, kuptueshëm, pa gabime dhe sigurisht bukur.

## li. B) Metoda, teknika e strategji mësimdhënieje

Programi “Gjuha shqipe 1” (Abetare) është një program që kërkon njohjen dhe përdorimin e metodave ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat kanë në qendër të mësimdhënies dhe të nxënies nxënësin.

Që ky program të fitojë këto karakteristika duhet që mësuesit t'i njohin metodat që nxisin **mësimdhënien me në qendër nxënësit**. Kështu, rekomandohen të përdoren metodat e zhvillimit të mendimit kritik, metoda të programit “Hap pas hapi”, “Montesori”, “të modelit të Rexhio Emilias”, “Mendimit kritik” etj.

**Puna në grupe** këshillohet si një veprimtari mësimore që jep shumë rezultat në mësimin e lexim-shkrimit fillestar.

**Punët me shkrim** të ofruara për nxënësit përmes fletoreve të punës ose mjeteve të tjera didaktike janë shumë frytdhënëse.

Rekomandohet **përdorimi i materialeve autentike (materiale të zakonshme të prodhura për qëllime të ndryshme, por që mësuesit mund t'ju japin vlera edukative, mësimore, të tilla si: etiketa, reklama, tituj, gazetash, postera** gjatë mësimdhënies.

Përveç librave bazë, mësuesi dhe prindërit duhet të krijojnë për fëmijët bibliotekën personale me libra për moshën e tyre.

Disa nga teknikat dhe strategjitë e mundshme, përveç atyre të përshkruara më lart në programin e abetares, për përdorimin gjatë orëve të mësimin të Abetares, po i përshkruajmë më poshtë

### a- Stuhi mendimi

*Breinstorming* ose stuhia e mendimeve është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të tregojnë gjithçka që dinë rreth një teme a ideje të veçantë, duke vënë në punë njohuritë që kanë. Nxënësit nuk mendohen nëse idetë që u vijnë në mendje janë të drejta ose të gabuara.

Nxënësit mund të punojnë në mënyrë individuale ose në çift, në fillim duke i hedhur të gjitha idetë që kanë dhe, më pas, duke i shkëmbyer me shokun ose anëtarët e tjerë të grupit. Mësuesi i hedh të gjitha idetë në dërrasën e zezë. Duke dëgjuar mendimet e të tjerëve, nxënësve mund t'u kujtohen gjëra të tjera ose mund t'u shtohet informacion i ri në kujtesën e tyre.

Kjo teknikë përdoret kur nxënësit kanë disa njohuri rreth një teme të caktuar. Është një veprimtari e mirë për fillimin e mësimin.

### Harta e mendimit (Kllasteri)

Kllasteri ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet “harta e mendimeve”, ose “pema e mendjes” është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë lirshëm dhe hapur rreth një çështjeje, i bën ata të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të shkruarit, sidomos për nxënësit që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizimin e kllasterit janë të thjeshtë dhe të lehtë për t’u mbajtur mend:

1. **Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, dërrasës së zezë apo një sipërfaqe të përshtatshme.**
2. **Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.**
3. **Kur idetë vijnë në mend dhe shkruhen, lidhen me njëra-tjetrën.**
4. **Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë, nxënësit nuk duhet të shqetësohen për sforcimet në shkrim apo në shqiptim.**

Përvoja e zbatimit të kllasterit ka treguar se kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ai mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa, ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar, si një rrugë për të ndërtuar lidhje apo grafikë të rinj që paraqesin arsyetimin e ri.

Fjala ose tema e gjetur për kllasterin, duhet të zgjidhet e tillë që i gjithë grupi të ketë mundësi të punojë për të si, për shembull, *atdheu, bimët, një personazh* etj.

Në pamje të parë kllasteri duket sikur ngjan me *Breinstorming*, pasi të dyja kanë të bëjnë me hedhjen e ideve rreth një teme ose çështje të caktuar. Kur përdorim kllasterin, gjatë kohës që hidhen idetë, bëhet grupimi i tyre, në nënçështje ose nëntema. Ndodh shoqërimi i mendimeve, ideve të dhëna. Nga ana tjetër, një gjë e tillë nuk ndodh me *Breinstorming*. Idetë hidhen pa bërë asnjë lidhje apo shoqërim ndërmjet tyre.

### Të lexuarit me kuptim i shoqëruar me shenja (INSERT<sup>2</sup>)

#### Përcaktimi

INSERT-i është një metodë që i lejon nxënësit të kontrollojnë gjallërisht shkallën e tyre të të kuptuarit gjatë leximit. Nëpërmjet kësaj teknike sigurohet pjesëmarrje e qëndrueshme e fëmijëve në mësim.

Gjatë leximit nxënësit udhëzohen që të vendosin shenjat e mëposhtme:

“ Ö ” vendoset shenja “ Ö ” (kontrollo), nëse diçka që lexoni pohon atë që dini ose mendoni se dini.

“ + ” vendosni një “ + ” (plus), nëse një pjesë e informacionit që ndeshni është i ri për ju.

“ - ” vendosni një “ - ” (minus), nëse një ose disa prej informacioneve që lexoni, kundërshton ose është e ndryshme nga ajo që dini ose mendoni se e dini.

“ ? ” vendosni një “ ? ” (pikëpyetje), nëse ka informacion të paqartë për ju ose ka diçka që duhet të dini më shumë rreth këtij informacioni.

Informacioni i shenjëzuar, hidhet më pas në tabelën INSERT sipas shenjave përkatëse.

√	+	-	?

Kjo teknikë përdoret në fazën e realizimit të kuptimit. Zbatimi i saj zgjat rreth 20-25 minuta. Përdoret në çdo lëndë e me çdo moshë fëmijësh. Për nxënësit e klasës së parë deri në atë të katërt rekomandohet të përdoren jo më shumë se dy shenja. Sugjerohet përdorimi i Ö “E di këtë” dhe – “Nuk e di këtë”.

Një formë e ngjashme e teknikës INSERT është teknika “Di/ Dua të di/ Nxë”. Në vijim skema:

Di	Dua të di	Nxë

Në kolonën e parë, “Di”, nxënësit do të shkruajnë atë informacion që nga leximi u duket si i njohur.

Në kolonën e dytë, “Dua të di”, do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër.

Në kolonën e tretë, “Nxë”, nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përveçësuar nga teksti.

### Pesëvargëshi<sup>3</sup>

Pesëvargëshi është një poemë që kërkon sintetizimin e informacionit dhe materialeve dhe një shprehje të saktë, e cila përshkruan apo reflekton idenë kryesore të një teme të caktuar.

Pesëvargëshi është një vjershë me pesë rreshta.

Pesëvargëshi ka një strukturë të caktuar:

1. **Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (zakonisht, emër).**
2. **Rreshti i dytë është përshkrimi me dy fjalë i temës (dy mbiemra).**
3. **Rreshti i tretë përmban tri fjalë që shprehin veprime të temës (tri folje).**
4. **Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë që shpreh qëndrimin, ndjenjën për temën (fjali).**
5. **Rreshti i fundit është një fjalë sinonime, që ripërcakton thelbin e temës (sinonim).**

Pesëvargëshi është një teknikë që përdoret zakonisht në fazën e reflektimit, sepse bën sintetizimin e informacionit të marrë. Gjen zbatim në çdo lëndë dhe në çdo klasë. Pesëvargëshi shërben shumë mirë si mjet për të bërë përmbledhjen e informacionit në tërësi, si një mënyrë e vlerësimit të gjykimit të nxënësve, si një mënyrë për shprehje krijuese.

### Veprimtaria e të menduarit dhe të lexuarit të drejtuar nga një sistem pyetjesh - DRTA

Veprimtaria e të menduarit dhe të lexuarit të drejtuar është një veprimtari gjatë së cilës lexuesit nxiten të mendojnë e të parashikojnë rreth asaj që lexojnë. Fëmijët do të mendojnë gjatë kohës që lexojnë, do të parashikojnë dhe do t’i mbajnë shënim parashikimet e tyre. Ky aktivitet ndërtohet në bazë të tri pyetjeve: Ç’mendoni se do të ndodhë më pas? Çfarë provash keni? Si ndodhi në të vërtetë?

Në mënyrë grafike organizohet në këtë mënyrë:

Ç’mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Për të plotësuar tabelën, mësuesi bën pyetje, të cilat e përqendrojnë vëmendjen e lexuesve në titujt ose në ilustrimet e zgjedhura. Mësimi mund të fillojë me një diskutim për titullin e librit ose të historisë dhe duke u bazuar në pyetjet: “Për çfarë mendoni se bën fjalë kjo histori/ ky libër?” “Pse mendoni kështu?” Para-

<sup>3</sup> Rrjedh nga frëngjishtja (*Cinquain*), që do të thotë diçka e lidhur me numrin pesë.

shikimet shkruhen në ndarjen e parë të tabelës ose në dërrasën e zezë. Mësuesi duhet të pranojë të gjitha parashikimet e bëra nga ana e nxënësve. Pas këtyre diskutimeve fillestare, nxënësit do të lexojnë në heshtje historinë/tekstin, deri në kohën e përcaktuar që më parë nga mësuesi, për të nxjerrë pikat apo provat, të cilat tregojnë nëse parashikimet e tyre janë të sakta apo jo. Në këtë pikë, diskutimi vazhdon me parashikime të tjera të dhëna nga nxënësit, bazuar në leximin e tyre deri në këtë fazë. Këto veprime përsëriten derisa historia apo teksti të mbarojë.

Mësuesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm që ndalesat e tepërta të pjesës mund të cenojnë të kuptuarin e përmbajtjes.

Aktiviteti i të menduarit e të lexuarit të drejtuar (DRTA) mund të përdoret mjaft mirë në fazën e realizimit të kuptimit. Realizohet kryesisht në lëndën e leximit, por mund të realizohet me sukses edhe në lëndë të tilla, si: historia dhe dituria e natyrës. Zgjidhen tema, përmbajtja e të cilave ka në qendër një problem, një personazh ose një ngjarje që ndryshon papritur rrjedhë. Kohëzgjatja ndryshon nga 20-25 minuta. Përdorimi i kësaj teknike mban gjallë kureshtjen e fëmijëve deri në fund të zbulimit të përmbajtjes së pjesës. Nxënësit kryejnë disa procese gjatë kësaj faze. Ata lexojnë me vëmendje dhe një nga një seksionet e pjesës, nxjerrin provat mbështetëse të paragrafit që lexojnë dhe parashikojnë se ç'mund të ndodhë më tej në tregim.

Për fëmijët e moshës së vogël, mësuesi mund ta lexojë vetë pjesën, ngjarjen, historinë dhe të kërkojë nga nxënësit të japin mendimet përkatëse. Në këtë rast kemi të bëjmë me veprimtarinë e të menduarit e të dëgjuarit të drejtuar – DLTA. Fazat e zbatimit janë njëlloj si të veprimtarisë DRTA.

## Rrjeti i diskutimit

Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit, gjithashtu mund të “orkestrohet” një mësim i ndërlikuar. Kjo veprimtari bën që nxënësit të jenë të vëmendshëm në leximin e tekstit për të kuptuar përmbajtjen dhe idenë kryesore të tij. Pjesëmarrja e nxënësve në këtë aktivitet është maksimale dhe argumentet e produktet e saj janë mjaft rezultative.

Mësuesi harton një **pyetje binare** (pyetje që pranon përgjigje pozitive ose negative), që prek drejt-përdrejt thelbin e çështjes që trajtohet në tekst. Ai u kërkon nxënësve që të argumentojnë pse.

**Podhe Jo** janë pro, ose kundër çështjes, të cilat shënohen në organizuesin grafik. Mendimet do të shkëmbehen në dyshe e në katërshe. Klasa do të pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre. Bëhet një raportim para klasës për arsyet që janë zgjedhur pro ose kundër çështjes. Për çdo paraqitje caktohet një kufi kohor prej një minute. Gjatë kohës që dy grupet raportojnë arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe të shkojnë në grupin që ka arsyet më bindëse.

Rrjeti i diskutimit përdoret në fazën e realizimit të kuptimit ose të reflektimit. Nga diskutimet që kryhen në klasë, çdo nxënës kupton se cili është thelbi, çështja e mësimin, shkruajnë ose argumentojnë dhe të gjithë janë përfshirë në diskutim.

Realizohet në lëndë të tilla, si: lexim, histori, dituri etj. Grupet e fëmijëve duhet të jenë mbi 20 vetë. Diskutimi vazhdon për rreth 15-20 minuta. Mund të realizohet me nxënësit e çdo moshe. Zhvillimi i kësaj veprimtarie u siguron fëmijëve lirshmëri maksimale në dhënien e mendimeve, shprehje mendimesh me zë të lartë, shkrim argumentesh në favor të një çështjeje, përpjekje për të bindur kundërshtarët, lirshmëri në ndërrimin e vendeve gjatë debatit etj.

## Ditaret e të nxënësve

Ditaret e të nxënësve janë ditare dy ose tri pjesësh, që përdoren për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e veta.

Për të bërë ditarin dypjesësh, hiqet një vijë vertikale në mes të fletës së fletores. Në anën e majtë shkruhen ato pjesë të tekstit që i tërheqin më shumë vëmendjen nxënësit, kryesisht ato që i kujtojnë diçka, që i intrigojnë më shumë, ose ato mendime dhe opinione me të cilat ata nuk pajtohen. Në anën e djathtë të fletës shkruhen komente për pjesën:

Pyetje ndihmëse për nxënësit janë:

- Çfarë elementesh kishte citati që i intrigoi më shumë?
- Çfarë menduan nisur nga ai citim?
- Çfarë pyetjesh lindin prej tij?

Gjatë leximit bëhen pushime për të shkruar citime të tjera dhe komente në fletore. Mund të caktohet edhe numri i citimeve që do të komentohen.

Ditari me tri pjesë është një formë tjetër ditari. Kolona e fundit i lihet mësuesit për të vlerësuar, për të gjykuar dhe për të dhënë mendime mbi komentet që kanë bërë nxënësit.

Duke e krahasuar me mësimin tradicional, ditaret e të nxënësve kanë këto përparësi:

Lexuesi ka një motiv për të lexuar, pra, leximi nuk është pasiv.

Bëhet lidhja e të lexuarit me të shkruarin.

Lexuesi mban qëndrim kritik ndaj tekstit.

Mësuesi mund t'i përshtasë ditaret e të nxënësve për klasa të ndryshme nxënësish. Për klasën e parë, mund të zgjidhen pjesët e tekstit nga mësuesi, ndërsa nxënësi vazhdon procedurën në vazhdim.

### Kubimi

Kubimi është një teknikë që ndihmon shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa, të cilat i përkasin çdo niveli pyetjesh: Përshkruaj, Krahaso, Shoqëro, Analizo, Zbato, Argumento (pro ose kundër).

Në fillim paraqitet tema. Më pas, nxënësit udhëzohen të mendojnë dhe:

1. Të **përshkruajnë**: Ç'formë ka? Cilat janë përmasat? Ç'ngjyrë ka?
2. Të **krahasojnë**: Me kë ngjason? Nga se ndryshon?
3. Të **rikujtojnë ndonjë ngjarje a histori**: Çfarë ju bën të mendoni? Çfarë ju vjen në mendje?

4. Të **analizojnë**: Si është ndërtuar? Nga se përbëhet?

5. Të **zbatojnë** në një situatë a kontekst të ri: Ç'mund të bëni me të? Si mund të përdoret?

6. Të **mbajnë një qëndrim të argumentuar**: Cili është qëndrimi juaj? Pse?

Duke vazhduar periudhën e shkrimit, nxënësit shkëmbejnë përgjigje për secilën faqe të kubit. Veprimtaria mund të organizohet në punë në çifte ose në grupe. Çdo partner zgjedh 2-3 faqe të kubit. Më pas shkëmbejnë mendime e lexojnë shkrimet e tyre me partnerin. Pasi një nxënës i çiftit lexon, tjetri përgjigjet duke e përgëzuar ose duke e pyetur. Kjo teknikë përdoret në fazën e realizimit të kuptimit, në të gjitha lëndët dhe në çdo klasë.

### Diagrami i Venit

Diagrami i Venit është një teknikë me anën e së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve, dukurive, historive, personazheve etj. Dy pyetjet mbi të cilat ndërtohet diagrami i Venit janë:

- *Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet ...?*
- *Po ndryshimet ndërmjet tyre?*

Diagrami i Venit ndërtohet me ndërprerjen e dy a më shumë rrathëve. Mund të përdoret për të bërë kontrastimin e ideve, duke treguar njëkohësisht të përbashkëtat që ato kanë me njëra-tjetrën.

Diagrami i Venit përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Njëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta, dallime midis koncepteve të ndryshme, si dhe mbajnë qëndrime personale në lidhje me to.

Përvoja ka treguar se është e mundur të përdoret në çdo lëndë, pothuajse në çdo orë mësimi. Veprimtaria zgjat 10-20', por është në varësi të specifikave lëndore, moshave dhe të kohës së përgjithshme në dispozicion të orës së mësimi.

### Gushëkuqi rrethor

Nxënësit lexojnë njëri pas tjetrit një tekst.

### Punë në grupe

Për veprimtari të caktuara, mësuesi mund ta organizojë klasën në grupe pune dyshe, treshe, katërshe, duke iu dhënë detyra të përbashkëta, por

duke i diferencuar.

### Parashikimi me terma paraprakë

Mësuesi përzgjedh nga pjesa që do të lexojë për nxënësit 5-6 terma, të cilët shërbejnë si fjalë kyç dhe u jep nxënësve orientimin që të ndërtojnë, të shkruajnë një tregim të shkurtër deri në 4-5 fjali, duke i përdorur termat e rekomanduara. Shpesh, mësuesi u rekomandon edhe temën për të cilën do të shkruajnë.

Zakonisht, kjo temë përdoret në hyrje të një ore mësimi. Me anën e saj, mësuesi kupton se sa janë të aftë nxënësit të parashikojnë rreth gjërave që do të ndodhin në një histori apo rreth asaj që dinë më parë.

### Të nxënit në bashkëpunim me grupe ekspertësh

Ndërtohen grupe me katër veta. Brenda grupit numërohet 1, 2, 3, 4. Më pas mësuesi orienton që të bashkohen 1-shat bashkë, 2-shat bashkë, 3-shat bashkë, 4-at bashkë. Pjesa që do të lexohet ndahet në katër pjesë, duke u vënë numrat 1, 2, 3, 4 çdo pjese.

Më pas u jepet detyrë nxënësve në grupet e ekspertëve që të lexojnë pjesët që i takojnë secilit grup. Pasi i kanë lexuar dhe kanë diskutuar gjatë për të, kthehen në grupet bazë duke riformuar edhe një herë grupet e fillimit dhe fillojnë të tregojnë ose të lexojnë pjesët sipas përkatësisë. Nxënësit e tjerë, të cilët janë ekspertë për pjesët e tjera, janë të lirë të pyesin për gjëra që kërkojnë më shumë informacion nga grupet e tjera. Zakonisht, kjo teknikë përdoret kur pjesët e leximit janë të gjata.

### Tryeza e rrumbullakët

Tryeza e rrumbullakët (ose gushëkuqi rrethor) është një teknikë bashkëpunuese, në të cilën përmes një letre dhe një lapsi, të cilat pasohen në mënyrë sistematike rreth një grupi të vogël nxënësish 4-5 veta. Kryen detyra të ndryshme të lexuari dhe të shkruari. P.sh., prej secilit nxënës kërkohet të shkruajë një fjalë që ka shkronjën **p** në fillim të saj, një cilësi për një objekt apo send, një ide rreth një

teme të caktuar, një përgjigje rreth një pyetjeje që mund të ketë drejtuar mësuesi apo ata vetë. Në të njëjtën letër shkruajnë përgjigje të gjithë nxënësit.

Kjo teknikë realizohet ose duke përdorur nxënësit lapsa me ngjyra të ndryshme ose duke e palosur letrën, pasi kanë shkruar përgjigjen duke formuar kështu një letër në formë fizarmonike.

Kjo teknikë mund të realizohet edhe me gojë. Përgjigjet e tyre, nxënësit mund t'i japin edhe me gojë njëri pas tjetrit.

### Dora e fshehtë

Mësuesi e ndan materialin që do të mësohet në pjesë, zakonisht në tre-katër pjesë. Nxënësit janë ndarë në grupe. Çdo nxënës i jepet një pjesë e materialit për të rindërtuar vargje të strofës së një vjershe ose fjali të prishura të një paragrafi. Pasi nxënësit brenda grupit e rindërtojnë pjesën, ata e krahasojnë me grupet e tjera për saktësinë. Nxënësit brenda grupit punojnë së bashku. Njëri e prezanton para të tjerëve. Diskutohet për mënyrën se si është lidhur dhe riformuar materiali. Pjesa lexohet e tëra disa herë dhe saktë. Në këtë mënyrë, nxënësit kuptojnë subjektin logjikën dhe pjesët hyrëse zhvilluese dhe mbyllëse të tregimit, përrallës apo vjershës. Mësuesi përcakton edhe shenja dalluese me ngjyra. P.sh., vendos njëra pas tjetrës disa ngjyra që janë të përafërta, që tregojnë radhën e fragmenteve të prera me ngjyrat e pjesëve të prera të fragmentit ose përdor numra dhe nxënësit i vendosin sipas radhës. Mund të mungojnë 1, 3 numra, për të cilat nxënësit duhet të bëjnë zgjedhjet e tyre.

### Turi i galerisë

Nxënësit pëlqejnë të shohin punët e tyre. Pas çdo pune me shkrim është mirë që mësuesi t'i ekspozojë në mure para klasës, pa shprehur më parë parapëlqimin e tij. Të gjithë nxënësit duhet t'i paraqesin punët e tyre në ekspozitën e murit. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin sipas mënyrave të tyre. Këto ekspozita duhet të jenë të shpeshta, fleksible dhe jo të qëndrojnë nëpër mure për një kohë të gjatë. Rekomandohet që çdo ditë të përdoret një metodë e tillë, pasi nxënësit nxiten dhe mobilizohen që të punojnë gjithnjë e më shumë.



## II.1. UDHËZIME PËR PERIUDHËN PËRGATITORE

(plani analitik, parime dhe udhëzime mësimore model)

### PARAABETARE

#### 1. HYRJE

Periudha e Paraabetares është një ndër pjesët e programit të Abetares, e cila duhet kuptuar, vlerësuar dhe zbatuar me seriozitet dhe korrektësi. Arritjet e synimeve të kësaj periudhe përmes librit të Abetares dhe Abetares së Punës që e shoqëron atë, u japin mundësi nxënësve për të arritur një sërë objektivash të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për sigurimin e një cilësie të mirë për fitimin e shprehive të lexim-shkrimit fillestar.

Duke qenë një periudhë që e lidh fëmijën parashkollor me shkollën, ajo duhet vlerësuar si një moment, ku përmes lojërave dhe veprimtarive argëtuese, nxënësit të mësojnë dhe të argëtohen.

Për këtë qëllim, në këtë pjesë të librit të mësuesit, jemi përpjekur t'u japim disa parime drejtuese dhe forma didaktike se si ato duhen kuptuar dhe zbatuar dhe, nga ana tjetër, jemi përpjekur që përmes veprimtarive, teknikave dhe strategjive ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse të përdorura në mësimet model të kësaj pjese, t'i japim mësuesit disa modele mësimesh për të gjitha orët që ka programi për këtë periudhë përgatitore.

Përmes këtyre veprimtarive, ne synojmë të aftësojmë nxënësit në disa veprimtari të thjeshta mësimore dhe të integruara me fusha të ndryshme të dijes, si: vizatimi, kënga, dramatizimi, loja në role etj., duke shpresuar që suksesin ta arrijmë që në këtë fazë përgatitore të mësimet të lexim-shkrimit. Me hyrjen në Abetare, nxënësit do t'i kenë të lehta veprimtaritë mësimore që lidhen me fitimin e shprehive të të lexuarit dhe të të shkruarit. Nëse nxënësi i mëson t'i shqiptojë dhe t'i shkruajë shkronjat e alfabetit gjatë kësaj periudhe (shkronjat e mëdha), kjo do të jetë një arritje e rëndësishme.

## 2. ZBËRTHIME KONCEPTUALE

### 2.1. Synimet

Periudha përgatitore synon të aftësojë nxënësit për të fituar disa shprehje të thjeshta për lexim-shkrimin.

a- Në paraabetares e këtij libri do të zbatohet metoda **ALFABETIKE-GLOBALE**, e cila mundëson mësimin e shkronjave të alfabetit përpara se të nisë Abetarja.

Kjo metodë shterohet sapo nxënësit nisin të mësojnë Abetaren. Në këtë mënyrë, herë pas here, kur gjatë Abetares dalin fjalë që mund të kenë një shkronjë të pamësuar, u kujtohet nga Paraabetarja se ajo shkronjë është mësuar në rrugë alfabetike. Në këtë mënyrë, Paraabetarja kontribuon në leximin tërësor të fjalëve edhe atëherë kur në trup të tyre mund të dalë ndonjë shkronjë e pamësuar deri në atë moment.

b. Përmes kësaj periudhe synohet të fitohen disa shprehje komunikimi të domosdoshme për fëmijët e kësaj moshe, të tilla si:

- Zhvillimi i të folurit
- Pasurimi i fjalorit
- Përmirësimi dhe saktësimi i strukturave gjuhësore folëse të shqipes
- Zhvillimi i disa aftësive motorike të domosdoshme për procesin e lexim-shkrimit
- Leximi global i disa fjalëve dhe i shprehjeve të shkurtra (elemente të metodës globale)

- Njohja me tingujt dhe shkronjat përkatëse sipas alfabetit të gjuhës shqipe (elemente të metodës alfabetike).

## 2.2. Struktura

Periudha përgatitore përbëhet nga dy linja:

### ☞ Zhvillimi i të folurit

### ☞ Elementet e shkrimit të shkronjave

Në strukturën e kësaj pjese, elementet e zhvillimit të të folurit ndërthuren me elementet e mësimit të anës tingullore dhe pamore. Ato do të zërthehen në mënyrë të ndërthurur me njëra-tjetrën.

Linja e të folurit dhe e njohjes së tingujve dhe elementeve të shkronjave do të jenë të integruara. Përmes zhvillimit të të folurit për tema të caktuara, do të gjenden, do të zbulohen dhe do të përdoren fjalë që përmbajnë tingullin përkatës dhe, më pas, do të bëhet lidhja e tingullit me shkronjën përkatëse.

### 2.3. Përmbajtja dhe struktura e faqes

Periudha e Paraabetares do të shtrihet:

- Në Abetare
- në Abetaren e Punës

Në faqen e Abetares do të jepen disa tema kryesisht të shpalosura me figura, të cilat lidhen me jetën e përditshme të fëmijëve dhe me përgatitjen e tyre për shkollën, si dhe veprimtari të të nxënës që lidhen me zhvillimin e të folurit të tyre.

Në faqen e Abetares së Punës, nxënësit do të ushtrohen:

- Për zhvillimin e të folurit për tema të caktuara
- Për shqiptimin e tingujve të shqipes dhe lidhjen e tyre me shkronjën përkatëse
- Për lexim global të fjalëve përmes të cilave të gjejnë tingujt dhe shkronjat përkatëse
- Për shkrimin e elementeve të shkrimit
- Për shkrimin e shkronjave kapitale
- Për leximin global të disa fjalëve

## 3. VEPRIMTARI DIDAKTIKE SHOQËRUESE GJATË PERIUdhËS PËRGATITORE

Gjatë periudhës përgatitore të Paraabetares do të synohet të kryhen veprimtari të ndryshme mësimore të nxënë të tilla, si: lojëra didaktike mësimore në shërbim të lexim-shkrimit të tilla, si:

- *vizatime* e punime me dorë,
- imitime të zhurmave të natyrës dhe tingujve të ndryshëm (ciu-ciu, mjau-mjau, tik-tak etj.),
- *lojë në role*,
- dramatizime, përrallash dhe tregimesh të ndryshme (*Iriqi dhe molla, Kësulëkuqja, Pinoku etj.*)
- *lojëra me pazëlla, me letra dhe lojëra të tjera me shkronja të ndryshme,*
- *këngë për fëmijë* për të fituar lartësinë mesatare të zërit,
- *biseda për tema të ndryshme* që lidhen me botën dhe aktivitetin e tyre jetësor duke pasuruar fjalorin me fjalë dhe shprehje që i takojnë kësaj teme,

- *tregime, përralla, gjëgjëza, vjersha, pyetje rrufe të ndryshme etj.*
- Aktivitetet e kësaj periudhe do të kryhen në mënyrë të integruar përmes bashkëveprimit të shprehive të të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit nga njëra anë dhe përmes veprimtarive tematike, të cilat do të bashkëshoqërohen me veprimtari argëtuese për fëmijët lojë në role, dramatizime, vizatime, punime me dorë, aplikime.
- Rekomandohet që temat që do të shoqërojnë këtë periudhë të lidhen me prezantimin: lojërat, kafshët, profesionet, ushqimet, shkollën, shokët, dëshirat etj.
- Do të mësojnë të shkruajnë shkronjat e shtypit kapitale.
- Do të mësojnë se si t'i përdorin mjetet e shkrimit, si dhe si të qëndrojnë në bankë gjatë të shkruarit, të lexuarit apo gjatë përdorimit të kompjuterit nëse e përdorin atë.

#### 4. Struktura e një ore mësimi

Për periudhën përgatitore, programi planifikuar rreth 32 orë mësimore. 8 javë mësimore sipas programit në Shqipëri dhe në mënyrë pothuaj të njëjtë edhe në programin e Kosovës.

Në orët e planifikuara mendohet që nxënësit të njihen me tingujt, shkronjat, fjalë globale etj., siç u përmend më lart.

Në çdo orë mësimi, mësuesi duhet:

- të njohë nxënësit me një tingull përkatës dhe me grafikun e tij. Në disa raste do të prezantohen edhe dy tinguj/shkronja pasi numri i orëve nuk na lejon që për çdo tingull/shkronjë të kemi një orë të veçantë,
- të pasurojnë fjalorin me fjalë dhe shprehje, të cilat përmbajnë tingullin përkatës,
- të aftësojnë nxënësit për të folur për një temë të caktuar sipas planifikimit,
- të përdorin fjalë e fjalor që përmbajnë tingullin përkatës,
- të ushtrohen për të shkruar e për të modeluar forma shkronjash të mëdha,
- të lexojnë e të shkruajnë në mënyrë globale 2-3 fjalë për çdo shkronjë, të cilat duhet ta kenë tingullin përkatës në fillim, në mes ose fund të fjalëve përkatëse,
- të tregojnë tregime, vjersha, përralla, përvoja të thjeshta që lidhen me tema të caktuara,
- të diskutojnë me njëri-tjetrin,
- të vizatojnë elemente të shkrimit, si vija të drejta, vertikale, horizontale, të lakuara etj.

#### 4. Materialet bashkëshoqëruese

Materialet bashkëshoqëruese për këtë periudhë janë shumë të rëndësishme. Duke njohur nevojat e fëmijëve në lidhje me zhvillimin e tyre mendor dhe psikomotor, mësuesit u duhet të përzgjedhin:

- **Libra për fëmijë**, të cilët mund të lexohen nga mësuesi dhe nxënësit mund të dëgjojnë e më pas të diskutojnë rreth tyre. Këta libra shërbejnë si hap i parë për të ngritur bibliotekën e klasës. Çdo fëmijë duhet të mësohet ta vlerësojë një libër si pasuri të përbashkët të klasës ku ai mëson.
- **Fletore pune për vizatim**, të cilat i zgjedh vetë mësuesi dhe nuk ka ndonjë rekomandim të posaçëm për ndonjë model, pasi në këtë periudhë, nxënësit nuk mund të kufizohen në vija të ngushta, të cilat i stresojnë. Këshillohet që në hapat e parë të kenë fletore vizatimi pa viza.

- **Fletore me vija të gjera**, kur është fjala për të shkruar me shkronja të mëdha ose fjalë globale.
- **Materiale vizatimi lapsa me ngjyra, goma prehëse, letra me ngjyra** etj., që do të përdoren nga nxënësit me porosi të mësuesit.
- **Tabela plastike** (shumëfunktionale, pasi nxënësit shkruajnë e përdorin për matematikën, për vizatimin dhe më gjerë, ku nxënësit shkruajnë me lehtësi). Kjo tabelë zëvendëson më së miri shkronjat lëvizore, duke bërë që nxënësit të mos humbasin kohë, por edhe për të krijuar një marrëdhnie të re të nxënësit me lexim-shkrimin, duke lexuar dhe shkruar shkrimin e tyre, të cilin mund ta ribëjnë disa herë, pasi tabela lejon dhe ndihmon për ta fshirë kur nuk e pëlqejnë shkrimin e tyre. Tabela mënjanon stresin e fëmijëve, pasi shërben njëherazi si lojë, për punë dhe për të mësuar.

Ka shumë rëndësi që nga mësuesit të kërkohet dhe të ngrihet një mjedis pune shumë i përshtatshëm në të cilin të kërkohet të theksohen dy elemente: librat, “bibliotekat personale”, kompjuteri, penela, në rastet kur këto janë të mundura. Nëpërmjet tyre nxënësit duhet ta ndiejnë veten se në mjedisin ku ndodhen atyre u duhet të punojnë dhe t’i vënë në punë ato.

## 5. Rezultatet e pritshme në fund të periudhës së Parabetares

### a. Për zhvillimin e të folurit dhe fitimin e disa elementeve fillestare të të lexuarit:

- Të flasin për tema jetësore të dashura dhe të njohura prej tyre nga përvojat jetësore, por edhe nga temat e planifikuara nga pjesa e parë e Abetares dhe e Abetares së Punës.
- Të pasurojnë fjalorin me fjalë dhe shprehje të thjeshta nga fusha të ndryshme tematike.
- Të zhvillojnë të folurin e tyre, në një nivel të mirë në përshtatje me moshën.
- Të ushtrohen për shqiptimin e të gjitha tingujve të gjuhës shqipe.
- Të shkruajnë të gjitha shkronjat e alfabetit të shqipes (ato të mëdha).
- Të njohin dhe të lexojnë në mënyrë alfabetike tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe.
- Të punohet në përshtatje me normën standarde të shqipes dhe të kihet kujdes për mënjanimin e deformimeve të jonormës.
- Të arrijnë të lexojnë në mënyrë globale 20-30 fjalë të tilla, si: emrat e pjesëtarëve të familjes, të shokëve, të objekteve personale dhe të atyre që i rrethojnë.
- Të dallojnë dhe të diferencojnë tregues të jashtëm të materialeve të shkruara të tilla, si: titullin, kapakun, faqet, vjershën, tregimin, përrallën.
- Të emërtojnë simbole që tregojnë detyra për nxënësit, p.sh., &, në vend të lexo, në vend të shkruaj një laps, O në vend të qarko, një hark me një shigjetë, në vend të vizato një laps me ngjyra.
- Të shkruajnë elemente të shkronjave të dorës dhe të shtypit.
- Të ushtrohen për të përdorur saktë në mënyrë intuitive intonacionin e zërit në përshtatje me situatën: kur pyesin, çuditen, a shprehin një dëshirë.

### Shënim.

Nëse në përfundim të periudhës së Paraabetares, nxënësit arrijnë të njohin shqiptojnë apo shkruajnë të gjitha shkronjat e alfabetit. Kjo gjë i ndihmon që të fillojnë të lexojnë sa më shpejt, duke e bërë të lehtë

procesin e analizës dhe të sintezës të fjalës, fjalisë dhe tekstit.

Në klasën e parë një pjesë e mirë e nxënësve, kryesisht ata që kanë frekuentuar kopshtin, i zotërojnë disa prej shprehive të mësipërme, por synimi i Parabetares është që t'i aftësojë nxënësit me disa shprehje të nevojshme për të hyrë në fazën e leximit shkruar me sa më shumë shprehje praktike të fituara në lidhje me lexim-shkrimin fillestar.

Mësuesi duhet të jetë i sigurt për këtë nivel të domosdoshëm aftësish për nxënësit e tij përpara se të nisë udhëtimin e gjatë nëpër tekste, fjali, fjalë, rrokje e shkronja.

#### **Në përfundim të Parabetares, çdo nxënës duhet:**

- Të tregojë një përrallë.
- Të tregojë një tregim me ose pa figura.
- Të tregojë gjëgjëza.
- Të recitojë vjersha.
- Të lexojë dhe shqiptojnë bukur tingujt e gjuhës shqipe.
- Të shkruajë me shkronja të mëdha shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe.
- Të dallojë shkronjën përkatëse në trup të fjalës ose në pozicione të ndryshme.
- Të shkruajë globalisht disa fjalë.
- Të plotësojë shkronjat e dhura atje ku mungojnë në fjalë të mësuara sipas shkronjave të shoqëruara edhe me figurën përkatëse.

## **6. PROCEDIME DIDAKTIKE PËR ÇDO FAQE NGA PARABETARJA**

Në çdo faqe të Parabetares do të ndiqet rruga metodike si më poshtë:

### **1.1 *Prezantohet tema se për çfarë do të flitet atë orë***

- Flitet për temën përkatëse. Bëhen pyetje, jepen përgjigje.
- Tregohet një tregim, një përrallë ose vjershë, bashkëbisedohet.
- Ritregohet tregimi, përralla ose gjëgjëza.
- Mësohet vjersha përmendsh.
- Nxiten nxënësit të shprehen rreth temës dhe të thonë sa më shumë fjalë që kanë shkronjën apo tingullin që do të mësojnë për këtë fazë të orës së mësimin.
- Mësuesi përdor shumë libra me tregime dhe përralla, të cilat janë në klasë apo janë sjellë dhe sillen në shkollë nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi thotë sot do të lexojmë librin e ... me titull..., i cili mund të jetë me përralla, tregime, vjersha, gjëgjëza etj.
- Loja në role, dramatizimi, imitimi i tingujve të ndryshëm mund të jenë pjesë përbërëse të orëve mësimore në këtë pjesë të mësimin të leximit-shkrimit.

### **6.2. Prezantohet shkronja dhe tingulli përkatës**

Përsëriten disa herë tingulli dhe shkronja, aq herë sa mësuesi bindet se të gjithë nxënësit e shqiptojnë qartë. Në këtë moment, mësuesi dallon vështirësitë që kanë nxënës të caktuar për shqiptimin e shkronjës ose të tingullit përkatës.

Shkruhet shkronja në madhësi të mëdha sa një fletë  $A_4$ , ushtrohen edhe nxënësit që ta shkruajnë në tabelën plastike ose në fletë të bardha  $A_4$ .

Ushtrohen nxënësit disa herë: thuhet tingulli, shkruhet shkronja, paraqitet shkronja, shqiptohet tingulli etj.

- Punohet me faqen e librit Abetare apo me Abetaren e Punës, sipas rastit dhe temës.
- Thuhet dhe lexohet globalisht titulli.
- Lexohen globalisht fjalët poshtë figurave.
- Qarkohet shkronja e mësuar në pozicionet në të cilat ajo ndodhet në fjalë.
- Lexohen fjalitë në faqet ku ka të tilla, jepen pak elemente të intonacionit të fjalisë.
- Shkruhet shkronja e madhe e shtypit dhe, po të mundet, edhe shkronja e vogël e shtypit.

### 6.3. Vizatohen dhe shkruhen elementet e shkrimit të dorës

- Në çdo faqe të Abetares së Punës ka elemente të shkrimit të dorës.
- Në fillim, mësuesi mund ta imitojë në ajër mënyrën se si shkruhet.
- Më pas, e ka vizatuar me elemente më të mëdha në një faqe A<sub>4</sub> ose më të madhe.
- Mund të formatohet me tela të hollë dhe të butë, me fije shkrepe, me shkopinj, me lapsa, si dhe me mjete të tjera të përthyeshme.
- Mësuesi i lejon nxënësit ta modelojnë përmes tabelave plastike në fletë formati apo fletore vizatimi etj.
- Gjatë kësaj periudhe, nxënësit edhe mund të vizatojnë p.sh., me kë ngjan a-ja? –me majën e malit. Mësuesi u thotë nxënësve të vizatojnë një mal.
- Me kë ngjan u-ja? - me urën; ai u thotë të vizatojnë urën.
- Me kë ngjan P-ja? - me pemën; mësuesi thotë të vizatojnë pemën etj.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka rekomandime për fletore të posaçme pune. Mësuesi mund të përdorë fletore të çfarëdollojshme nga nxënësit, duke filluar që nga fletoret e shkrimit, deri te fletoret e vizatimit, apo me fletë A<sub>4</sub>.

#### Shënim.

- |  |                 |  |    |
|--|-----------------|--|----|
|  | Po              |  | Jo |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Në rastet kur në të njëjtën faqe janë më shumë se një shkronjë, mësuesi ose i zhvillon ato veç e veç, duke ndjekur procedurë të njëjtë ose i bashkon temat kryesisht kur kemi shkronjat dyshe (s me sh, d me dh, z me zh, x me xh) dhe flet njëkohësisht për të dyja duke i diferencuar më pas shkronjat përkatëse dhe duke nxjerrë në pah ndryshimet.</li> <li>▪ Qëllimi i këtij bashkimi përveç ngjashmërisë që kanë dhe mënyrës së formimit të shkronjave dyshe vjen edhe si një nevojë e kohës jo të mjaftueshme që kemi për të punuar për çdo tingull dhe shkronjë në më shumë kohë.</li> <li>▪ Abetarja dhe Abetarja e Punës mundësojnë realizimin dhe arritjen e objektivave të kësaj periudhe.</li> <li>▪ Por, mësuesi mund të përdorë përveç tyre edhe materiale të tjera për të arritur objektiva të përcaktuar për këtë fazë.</li> <li>▪ Në Abetaren e Punës në një faqe dalin dy shkronja. Në pjesën më të madhe të rasteve, këto shkronja punohen në orë të veçanta, përveç disa rasteve siç përmendëm më lart.</li> </ul> | A duhet të ...? |  |    |

### MJETE MËSIMORE QË MUND TË PËRDOREN GJATË PUNËS ME PARAABETAREN

Citati	Komenti i



Për punën me Abetaren dhe Abetaren e Punës për pjesën e Paraabetares kërkohet dhe rekomandohen *mjete alternative*, të cilat mund të sigurohen sipas kushteve të shkollës, klasave dhe rajonit përkatës.

Citati	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit

Për ta lehtësuar dhe për të mos e standardizuar punën për gjetjen dhe përdorimin e mjeteve mësimore rekomandojmë për nxënësit mjete si më poshtë:

### Mjete personale


- *Tabela plastike* që ka një fushë në të cilën nxënësit mund të shkruajnë dhe të vizatojnë, duke i ndrequr dhe duke ribërë shkrimet e tyre sa herë të duan, që nuk e lejon nxënësin të stresohet nëse bën gabim, pasi shpejt mund ta prishë dhe ta ndreqë atë. Kjo tabelë shumëfunktionale është e tillë që mund të përdoret për shumë detyra mësimore, shkrimi, vizatimi, numërimi etj.
- *Libra për fëmijë* me përralla tregime, vjersha, gjëgjëza.
- *Minibiblioteka* e klasës (krijohen kutitë me libra për çdo nxënës).
- *Mjete vizatimi* lapsa me ngjyra, shkumësa me ngjyra.
- *Shkronja plastike të mëdha ose të vogla*, që mund të bashkohen si në lojërat me pazëlla.
- *Tabela e alfabetit* e madhe në klasë në një vend të dukshëm.
- *Alfabeti* për çdo nxënës në formë fizarmonike në çdo faqe një shkronjë një figurë dhe një fjalë apo fjali.
- Pazëlla të ndryshme, ngjitja e të cilave krijojnë fjalë, fjali dhe figura.
- Albabeti i gjuhës shqipe me shkronjat e mëdha dhe të vogla të dorës dhe të shtypit



### Mjetet kolektive të punës me Paraabetaren

Klasa e parë duhet të ketë pamjen e një klase që tregon se atje punohet dhe mësohet, lexohet dhe shkruhet. Në klasë duhet të vihen në raftet, tavolina dhe kënde, në mënyrë të dukshme, si:

- Alfabeti i gjuhës shqipe më shkronja të mëdha, të dallueshme, të lexueshme dhe me ngjyra
- Alfabeti me shkronjat e dorës të vogla dhe të mëdha



muar.

- Këndi i librave
- Këndi i mjeteve të shkrimit
- Këndi i dramës
- Tabela plastike
- Tabela magnetike
- Lojëra dhe kuti me pazëlla me figura që lidhen me përralla dhe shkronja për t'i riformuar.
- CD, i cili do të përmbajë në formën e një albumi të gjitha temat dhe fabulat në figurë të Abetares me qëllim leximin e tyre edhe përmes teknologjive të informacionit kompjuterit, videoprojektorit etj.
- Mjete për vizatim dhe aplikim, mjete punë dore.

### VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve në përfundim të kësaj periudhe do të bëhet me fletë vlerësimi nga mësuesi, i cili është mbështetur në vëzhgimet e përditshme të tij. Në këtë fletë vlerësimi, mësuesi do të shënojë shprehje

që lidhen me aftësitë dhe shprehjet e arritura nga nxënësi në këtë periudhë.

Mund të realizohen edhe dy faqe nga Abetarja e Punës në formë testi: njëra në përfundim të 18 shkronjave të para dhe tjetra në përfundim të të gjithë Paraabetares.

## PUNA ME TEKSTIN

Periudha e Paraabetares zë vend:

- Në tekstin e Abetares - Pjesa e parë
- Në Abetaren e Punës - Pjesa e parë


Teksti i Abetares përfshin 12 faqet e para me tema për zhvillimin e të folurit përmes të cilave nxënësve iu duhet:

Të përshkruajnë përvoja personale, të japin këshilla, të tregojnë ngjarje dhe histori, të tregojnë përralla, të flasim për lojërat, festat etj.

Në Abetaren e Punës, periudha e Paraabetares zë vend në tetëmbëdhjetë faqet e para të këtij libri.

Përmes temave të paraqitura në këto faqe, nxënësit artikulojnë saktë tingujt e shqipes, shkruajnë shkronjat e mëdha për çdo tingull zhvillojnë të folurit për tema të caktuara, lexojnë fjalë globale të shoqëruara me fotot përkatëse, plotësojnë në to shkronjën që mungon dhe vizatojnë apo ngjyrosin figura të ndryshme.

Mësuesi duhet të ndihet i lirë që për tema të caktuara mund të përdorë edhe materiale të tjera të pa-parashikuara në këtë material, kur ai mendon se plotëson më së miri objektivat e paracaktuar.



## MODEL FLETE VLERËSIMI

### LISTË VËZHGIMI

EMRI \_\_\_\_\_

**V = Vazhdimisht**

**N = Ndonjëherë**

**R = Rrallë**

	Shprehia /aftësia	V	N	R
<b>I</b>	<b>Zhvillimi i të folurit</b>			
	Flet lirshëm për tema për të cilat diskutohet.			
	Përdor fjalë që lidhen me temën për të cilën flitet.			
	Ka intonacion të saktë.			
	Artikulon saktë tingujt në fjalë.			
<b>II.</b>	<b>Shqiptimi i tingujve /shkrimi i shkronjave përkatëse</b>			
	Artikulon saktë tingujt bashkëtingëllorë.			
	Artikulon saktë zanoret.			
	Shkruan shkronjat e mëdha në përkatësi me tingujt.			
<b>III.</b>	<b>Lexim/shkrim global</b>			



	Gjen në fjalë të ndryshme shkronjat që i kërkohen			
	Zëvendëson aty ku mungon shkronjën në fjalë.			
	Shkruan 1-30 fjalë globale.			

**PROGRAMI ANALITIK I PARAABETARES 4 JAVË X 8 ORË = 32 ORË.** Të dëgjuarit

SHKURTIME		SHKURTIME	
Lexim	L	Të folurit	F
Shkrim	SH	Të vëzhguarit	D
Vizatim	V	Imagjinata	I
Muzikë	M	Të zhvilluarit e vëmendjes	V
Shkencë	SH	Të lexuarit global	G
Dramë	D	Shkrimi i shkronjave kapitale	SH

**Plani analitik i zbërthyer**

**(në tema, objektiva, strategji, ndërthurje, shprehi, burime)**

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehite	Burime
1.	Abetarja ime <b>Unë jam</b>	Të prezantohet Të përshkruajë emocione për ditën e parë të shkollës e shokët. Të lexojë dhe shkruajë globalisht emrin e vet dhe të shokëve.	Bashkëbisedim Punë në dyshe Dramatizim	L.SH.V.M, SH, D	F, D, I, V, SH	Teksti, fletore, materiale vizatimi, CD, tabela plastike Pazëlla të ndryshme
2.	Tingulli dhe shkronja A <i>Drejt shkollës</i>	Të komentojë figurën në libër. Të shqiptojë tingullin A. Të shkruajë shkronjën A. Të dallojë shkronjën A në fjalë. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në dyshe Bashkëbisedim Vizatim	L.SH.V.M, SH, D	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
3.	Tingulli dhe shkronja I <i>Drejt shkollës</i>	Të shqiptojë tingullin I. Të shkruajë shkronjën I. Të dallojë shkronjën I në fjalë. Të krahasojë shkronjën A dhe I. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Punë individuale Bashkëbisedim Dramatizim	Matematikë	Të zhvilluarit e vëmendjes	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

4.	Tingulli dhe shkronja M <i>Drejt shkollës</i>	Të shqiptojë tingullin M. Të shkruajë shkronjën M. Të dallojë shkronjën M në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë /shkruajë globalisht fjalë.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
5.	Tingulli dhe shkronja N <i>Në shtëpi</i>	Të shqiptojë tingullin N. Të shkruajë shkronjën N. Të dallojë shkronjën N në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim Vizatim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
6.	Tingulli dhe shkronja E, Ë <i>Në shtëpi</i>	Të shqiptojë tingujt E dhe Ë. Të shkruajë shkronjat E dhe Ë. Të dallojë shkronjat E dhe Ë në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
7.	Tingulli dhe shkronja B <i>Në mëngjes</i> <i>Unë bëj</i>	Të shqiptojë tingullin B. Të shkruajë shkronjën B. Të dallojë shkronjën B në fjalë.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
8.	Tingulli dhe shkronja F <i>Dita ime</i>	Të shqiptojë tingullin F. Të shkruajë shkronjën F. Të dallojë shkronjën F në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
9.	Tingujt dhe shkronjat C dhe Ç <i>Zërat e kafshëve</i> <i>c c</i>	Të shqiptojë tingujt C dhe Ç. Të shkruajë shkronjat C dhe Ç. Të dallojë shkronjat C dhe Ç në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
10.	Tingujt dhe shkronjat H dhe U <i>Zërat e natyrës</i>	Të shqiptojë tingujt H dhe U. Të shkruajë shkronjat H dhe U. Të dallojë shkronjat H dhe U në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, mate-riale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

11.	Tingujt dhe shkronjat <b>D</b> dhe <i>Dita ime</i>	Të shqiptojë tingujt D dhe Dh. Të shkruajë shkronjat D dhe Dh. Të dallojë shkronjat D dhe Dh në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, Materiale, vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
	Tingujt dhe shkronjat <b>Dh</b> <i>Dhuratat</i>	Të shqiptojë tingujt Dh. Të shkruajë shkronjat Dh. Të dallojë shkronjat Dh në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, Materiale, vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
12.	Tingulli dhe shkronja <b>K</b> <i>Kafshët</i>	Të shqiptojë tingullin K. Të shkruajë shkronjën K. Të dallojë shkronjën K në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
13.	Tingulli dhe shkronja <b>J</b> <i>Kafshët</i>	Të shqiptojë tingullin J. Të shkruajë shkronjën J. Të dallojë shkronjën J në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
14.	Tingulli dhe shkronja <b>G</b> <i>Përralla dhia dhe kecat</i>	Të shqiptojë tingullin G. Të shkruajë shkronjën G. Të dallojë shkronjën G në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
	Tingulli dhe shkronja <b>Gj</b> Gjeegjëza	Të shqiptojë tingullin Gj. Të shkruajë shkronjën Gj. Të dallojë shkronjën Gj në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
	Tingulli dhe shkronja <b>L, LL</b> Librat, tregimi vjersha I, II	Të shqiptojë tingujt I, II. Të shkruajë shkronjën I, II. Të dallojë shkronjën I, II në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
15.	<b>TEST</b>					

17.	Tingujt dhe shkronjat <b>R, RR</b>  Në rrugë	Të shqiptojë tingujt r dhe rr. Të shkruajë shkronjat r dhe rr. Të dallojë shkronjat r dhe rr në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
18.	Tingulli dhe shkronja <b>P</b>  <i>Në fshat</i>	Të shqiptojë tingullin P. Të shkruajë shkronjën P. Të dallojë shkronjën P në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
19.	Tingulli dhe shkronja <b>Nj</b>  <i>Në fshat</i>	Të shqiptojë tingullin Nj. Të shkruajë shkronjën Nj. Të dallojë shkronjën Nj në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
20.	Tingujt dhe shkronjat <b>O dhe Q</b>  <i>Qyteti</i>	Të shqiptojë tingujt O dhe Q. Të shkruajë shkronjat O dhe Q. Të dallojë shkronjat O dhe Q në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
21.	Tingulli dhe shkronja <b>S</b>  <i>Qyteti</i>	Të shqiptojë tingullin S. Të shkruajë shkronjën S. Të dallojë shkronjën S në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
21.	Tingulli dhe shkronja <b>Sh</b>  <i>Shkronjat</i>	Të shqiptojë tingullin Sh. Të shkruajë shkronjën Sh. Të dallojë shkronjën Sh në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
24.	Tingulli dhe shkronja <b>T</b>  <i>Mjetet e udhëtimit</i>	Të shqiptojë tingullin T. Të shkruajë shkronjën T. Të dallojë shkronjën T në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
25.	Tingulli dhe shkronja <b>Th</b>	Të shqiptojë tingullin Th. Të shkruajë shkronjën Th. Të dallojë shkronjën Th në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

26.	Tingulli dhe shkronja X <i>Në garë</i>	Të shqiptojë tingullin X. Të shkruajë shkronjën X. Të dallojë shkronjën X në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
27.	Tingulli dhe shkronja Xh <i>Në garë</i>	Të shqiptojë tingullin Xh. Të shkruajë shkronjën Xh. Të dallojë shkronjën Xh në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
28.	Tingulli dhe shkronja Z <i>Me vrap</i>	Të shqiptojë tingullin Z. Të shkruajë shkronjën Z. Të dallojë shkronjën Z në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
29.	Tingulli dhe shkronja Zh <i>Filmat vizatimorë</i>	Të shqiptojë tingullin Zh. Të shkruajë shkronjën Zh. Të dallojë shkronjën Zh në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
30.	Tingulli dhe shkronja V <i>Filmat vizatimorë</i>	Të shqiptojë tingullin V. Të shkruajë shkronjën V. Të dallojë shkronjën V në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
31.	Tingulli dhe shkronja Y <i>Ngjyrat vizatim</i>	Të shqiptojë tingullin Y. Të shkruajë shkronjën Y. Të dallojë shkronjën Y në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja
32.	Test					

Shënim. Ky program analitik për shkollat në Kosovë do të kryhet në 28 orë mësimore.

# MËSIMI MODEL PËR PARAABETAREN

## MËSIMI MODEL 1

### Tema: Prezantimi

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë	Burime
1.	Abetarja ime <i>Unë jam</i>	Të prezantojë emrin, mbiemrin, emrat e familjarëve. Të përshkruajë emocione për ditën e parë të shkollës. Të lexojë globalisht emrin e vet dhe të shokëve. Të shkruajë emrin globalisht.	Bashkëbisedim Shkrim global vizatim T Turi i galerisë	Të folurit, Art/vizatim, muzikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, mjete vizatimi, etiketa, tabela plastike

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

HAPAT	ÇFARË DO TË BËJË MËSUESI?	MATERIALE	ÇFARË DO TË BËJNË NXËNËSIT?
<b>Motivimi</b>	Bashkëbisedim/përshkrim emocionesh		
Hapi 1	Mësuesi ka përgatitur nga një etiketë me emrat e secilit nxënës. Secila etiketë mban një figurë që fillon me shkronjën e parë të emrit të nxënësve. Shkronja e parë është më e madhe sesa të tjerat. Thërret nxënësit me radhë dhe ua ngjit në gjoks etiketat me emrat përkatës. Për 5 minuta i lë nxënësit të bisedojnë me njëri-tjetrin. Mësuesi i drejton çdo nxënësi tri pyetje. Si e ke emrin? A ke motra e vëllezër? Si quhen mami dhe babi? Mësuesi i fton ta vendosin etiketën në pemën e klasës.	Etiketa emrash të futura në një shportë, Mjete vizatimi, Pemë e madhe e vizatuar në një <i>flipchart</i>	Nxënësit rreshtohen sipas radhës që i thërret mësuesi. Nxënësit për 5 minuta bisedojnë me njëri-tjetrin.  Prezantojnë veten dhe e vendosin etiketën pasi e kanë shkruar në pemën e klasës.
<b>Faza hyrëse</b>	<b>Bashkëbisedim/Ngjyrosje</b>		
Hapi i dytë	Lexon emrat dhe i jep çdonjërit etiketën me emrin e tij. Mësuesi i jep çdonjërit një etiketë në formën e një objekti që lidhet me shkronjën e parë të emrit të tij, brenda të cilave nxënësi do të mbushë me ngjyra shkronjat e emrit e tij.	Materiale vizatimi, bojërat	Nxënësit ngrihen me radhë dhe marrin etiketën dhe shqiptojnë emrin e tyre. Nxënësi me lapsa me ngjyra mbush shkronjat e emrit me ngjyra, si dhe vizatimin përkatës dhe e vendos mbi bankë.
<b>Zhvillimi dhe realizimi i kuptimit</b>	<b>Shkrim global</b>		

Hapi i tretë	Më pas, mësuesi pyet nëse nxënësit dinë ta shkruajnë emrin e tyre. Nxënësve që nuk dinë ta shkruajnë emrin e tyre u jep etiketën e parapërgatitur me emrin e tyre. Më pas, çdo nxënësi i jepet nga një fletë e bardhë ose tabela plastike për të shkruar emrin. Mësuesi nuk bën vërejtje për saktësinë e shkrimit, por i motivon nxënësit që kanë vështirësi për ta përsëritur disa herë, derisa t'ia dalin mbanë.	Materiale shkrimi, Abetarja e Punës, lapsa, stilolapsa	Nxënësi shkruajnë emrat duke kopjuar nga etiketa e parë dhe ngjyrosin shkronjat e emrave të tyre.  Ushtrohen për shkrimin e emrit globalisht.
<b>Reflektimi</b>	<b>Turi i galerisë, ushtrime manipuluese</b>		
Hapi i katërt	Mësuesi kërkon t'i ngjisin në një kënd të klasës dhe më pas i lexojnë së bashku. Mësuesi bën disa ushtrime manipuluese, duke i lexuar njëri pas tjetrit nga fundi në fillim, në mënyrë të çrregullt etj.	Etiketat e emrave	Pasi kanë përfunduar shkrimin e emrave të tyre, nxënësit i ngjisin ato në mure apo në një vend të dukshëm. Pasi i kanë ngjitur së bashku me mësuesen i lexojnë sipas komandave të mësuesit.
Detyrë	<b>Shkrimi global i emrit</b>		

## TEMA 2: TINGULLI DHE SHKRONJA A

### Struktura e orës së mësimit

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehite	Burime
	Tingulli dhe shkronja A  <b>Shkolla ime</b>	Të komentojë figurën në libër duke folur për klasën dhe shkollën. Të shqiptojë tingullin A duke e lidhur me shkronjën A. Të shkruajë shkronjën A me të madhe. Të gjejë tingullin dhe shkronjën A në fjalë të ndryshme. Të lexojë globalisht fjalë që kanë në trup shkronjën A.	Bashkëbisedim Punë në dyshe Vizatim	Të folurit Të shkruarit Art/vizatim, muzikë.	F, D, I, V, SH	Teksti, lapsa, fletore, mjete vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja, fletë formati, fletë me ngjyra, ngjitëse etj. Tela të hollë të përkulshëm, shkopinj, fije makaronash, tabela plastike

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>I. MOTIVIM</b>	Bashkëbisedim /dëgjim CD – vallja e shkronjave	
Hapi i parë	Mësuesi vendos në një CD në mangnetofon dhe kërkon që nxënësit të dëgjojnë këngën vallja e shkronjave. Mësuesi ndalon shpjegimin dhe kuptimin të fjalës-shkronjë.	Nxënësit këndojnë dhe përpiqen të kuptojnë dhe shpjegojnë me fjalët e tyre se çfarë kuptojnë me fjalën shkronjë.
<b>II. FAZA HYRËSE</b>	Stuhi mendimi	

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin për objektet që ndodhen në klasë dhe përse përdoren ato. Çfarë është kjo këtu? Ai vendos etiketën e fjalës së objektit, pasi nxënësit përgjigjen: Përse përdoret? Kush rri këtu? Mësesja kërkon nga nxënësit që në fjalët që kanë tingullin <b>A</b> të ngjisin një pikë të gjelbër në fletoren pranë tyre ose të shkruajnë një vijë në tabelën plastike.</p>	<p>Nxënësit emërtojnë objekte në klasë dhe thonë përse përdoren ato. Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve.  Nxënësit bëjnë një pikë në fletore (apo vijë), aq herë sa dëgjojnë fjalë që e kanë tingullin <b>A</b> në trup të tyre.</p>
<p><b>ZHVILLIM DHE NDËRTIM NJOHURISH</b></p>	<p><i><b>Punë individuale në tabelë plastike/punë në grupe</b></i></p>	
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Artikulimi dhe shkrimi i <b>A</b> së madhe Punë në grupe</p>	<p>Mësuesi merr shkronjën <b>A</b> të madhe të shtypit dhe u thotë se kjo është një shkronjë. Flet për formën e saj, e vizaton me dorë në ajër, e ndërton me fije shkrepe, me tela të përthyeshëm, e vizaton në dërrasë. Kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë. E shqipton disa herë. Kërkon që nxënësit në grupe dyshe të thonë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin <b>A</b>. Kërkon të gjejnë në klasë objekte që kanë në trup të tyre tingullin <b>A</b>.</p>	<p>Nxënësi kanë në tavolina tela të hollë plastike, që nuk rrezikojnë, fije shkrepe në tabelën plastike. Me ndihmën e tyre formojnë shkronjën <b>A</b>. Edhe nxënësit bëjnë të njëjtën gjë. Nxënësit në grupe dyshe thonë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin <b>A</b>. Nxënësit gjejnë: klasa, dritare, dërrasa, banka...</p>
<p><b>Hapi i katërt</b></p> <p>Ndërtim i mjedisit fonologjik të tingullit <b>A</b></p>	<p>Mësuesi shqipton tinguj të ndryshëm mes tyre dhe kërkon që nxënësit ta shqiptojnë disa herë tingullin <b>A</b>. Mësuesi kontrollon shqiptimin e tingullit <b>A</b>. Ai prezanton shkronjën <b>A</b>, e vizaton në ajër e vizaton në dërrasë, e bën me shkopinj apo materiale plastike. Pyet me kë ngjan (mali). Kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë. Më pas, u thotë se emrat e tyre mund të përbajnë shkronjën <b>A</b>.</p>	<p>Nxënësit thonë stop dhe të gjitha fjalët ku dëgjojnë tingullin <b>A</b>. Nxënësit e vizatojnë në ajër <b>a</b>, pastaj në tabelë plastike, në fletore pune.  Nxënësit shkruajnë në tabela plastike emrat e tyre globalisht e kërkojnë nëse ka shkronjë <b>A</b> e gjejnë dhe e qarkojnë.</p>
<p><b>Hapi i pestë</b></p>	<p>Pasi nxënësit e përfundojnë këtë ushtrim, mësuesi i orienton të shohin në dërrasë disa figura që kanë poshtë tyre edhe emrat përkatës (fig. banane, arra, ananasi, akullore, mami etj.), dhe të gjejnë ku është shkronja <b>a</b> në këto figura. Mësuesi duke bërë ushtrimin e ndarjes në rrokje me duar majtas-djathtas kërkon që nxënësit të dallojnë se në cilat rrokje mund të jetë tingulli <b>a</b>.</p>	<p>Nxënësit dallojnë shkronjën <b>A</b> te figurat me emrat poshtë tyre.  Nxënësit bëjnë <b>stop</b> atje ku e dëgjojnë.</p>
<p><b>Hapi i gjashtë</b> Vizatim dhe shkrim</p>	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të ngjyrosin figurat e Abetares së Punës që janë tek <b>a</b>-ja. Më pas kërkon që të shkruajnë elementet e shkrimit dhe së fundi të shkruajnë shkronjën <b>A</b> të madhe të shtypit.</p>	<p>Nxënësin ngjyrosin figurat e vijësuara dhe elementet e shkrimit. Nxënësit bëjnë vizatimet dhe elementet e shkrimit. Më pas, shkruajnë shkronjën <b>A</b> të madhe të shtypit.</p>
<p><b>Hapi i shtatë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të plotësojnë në fjalët globale të shkronjës shkronjën që mungon.</p>	<p>Nxënësit plotësojnë shkronjën që mungon dhe bëjnë lexim global të fjalës.</p>
<p><b>PËRFORCIM</b></p>		



Hapi i tetë Punë e pavarur	Kërkon që nxënësit në shtëpi të shkruajnë dy rreshta me A të madhe dhe fjalët globale në anë të Abetares së Punës ose në fletore të tjera pune.	Shkruajnë a-në dhe dy fjalë globale që kanë në trup të tyre A.
Detyrë shtëpie	Elementet e shkrimit Dy rreshta me A Dy fjalë globale	

### Tema 3: Tingulli dhe shkronja I

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë	Burime
	Tingulli dhe shkronja I  Shkolla ime	Të përshkruajë shkollën dhe klasën. Të shqiptojë tingullin I. Të shkruajë shkronjën I. Të dallojë shkronjën I në fjalë. Të krahasojë shkronjën A dhe I. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në dyshe Demonstrim Bashkëbisedim Dramatizim			Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

### Zhvillimi i mëimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
MOTIVIM	Imagjinatë e drejtuar	
Hapi i parë	Mësuesi kërkon që nxënësit të ulin kokën dhe të dëgjojnë mësuesin dhe të gjejnë se ku janë vendet që ai përshkruan.  Një oborr i madh me shumë fëmijë që luajnë e lodrojnë.  Një dhomë e madhe me shumë fëmijë, shumë tavolina e shumë libra e fletore.	Nxënësit gjejnë sipas radhës mjediset që përshkruan mësuesi: shkolla, klasa, mësuesi ...
Faza hyrëse	Bashkëbisedim	
Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë <b>stop</b> në fjalët që mësuesi shqipton dhe ku dëgjohet tingulli i.  Mësuesi kërkon që nxënësit të kërkojnë në klasë objekte dhe sende që e kanë tingullin i dhe t'i thonë.  E njëjta lojë përsëritet edhe kur nxënësit shqiptojnë fjalë të ndryshme.	Nxënësit gjejnë e thonë fjalë që kanë në trupin e tyre tingullin I.

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p><b>Bashkëbisedim</b></p>	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin për objektet që ndodhen në klasë dhe përse përdoren ato.</p> <p>Çfarë është kjo këtu? Mësuesi vendos etiketën e fjalës së objektit, pasi nxënësit përgjigjen.</p> <p>Përse përdoret libri? Kush qëndron në këtë tavolinë?</p> <p>Mësuesja kërkon nga nxënësit të bëjnë/ngjisin një pikë gjelbër në fletoren pranë tyre në fjalët që kanë tingullin I.</p>	<p>Nxënësit emërtojnë në klasë objekte dhe gjejnë nëse kanë ose jo tingullin i.</p> <p>Nxënësit japin përgjigje</p> <p>Nxënësit bëjnë një pikë në fletore aq herë sa dëgjojnë fjalë që e kanë tingullin a në trup të tyre.</p>
<p><b>Ndërtim njohurish të reja</b></p>	<p><b>Demonstrim/punë në grupe</b></p>	
<p>Hapi i tretë</p>	<p>Mësuesi merr shkronjën I të madhe të shtypit dhe u thotë se kjo është një shkronjë. Flet për formën e saj e vizaton me dorë në ajër e ndërton me fije shkrepe, me tela të përthyeshëm, vizaton në dërrasë. Kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë. Mësuesi shqipton tinguj të ndryshëm ndërmjet tyre dhe I, kërkon që nxënësit ta shqiptojnë disa herë tingullin I.</p> <p>Mësuesi kontrollon shqiptimin e tingullit I, por edhe shkrimin me shkronjë të madhe të I nga të gjithë nxënësit.</p> <p>Më pas u thotë se në disa nga emrat e tyre mund të jetë diku shkronja I. U jap kohë ta gjejnë se ku ndodhet.</p>	<p>Nxënësi kanë në tavolina tela të hollë plastike, që nuk rrezikojnë, fije shkrepe, tabela plastike. Me ndihmën e tyre formojnë shkronjën I.</p> <p>Nxënësit thonë <b>stop</b> dhe të gjithë bashkë apo individualisht shqiptojnë I.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë dhe shkruajnë I të madhe.</p> <p>Nxënësit kërkojnë në punë në grupe katërshe nëpër etiketat e emrave të tyre shkronjën I.</p>
<p>Hapi i katërt</p> <p>Punë individuale në fletore pune/tabelë plastike</p>	<p>Nxënësit kërkojnë nëpër emrat e tyre dhe qar-kojnë këtë shkronjë.</p> <p>Pasi nxënësit e përfundojnë këtë ushtrim, mësuesi i orienton të shohin në dërrasë disa figura që kanë poshtë tyre edhe emrat përkatës (<i>fig. banane, arra, ananasi, akullore, mami etj.</i>), dhe të gjejnë ku ndodhet shkronja I në këto figura.</p>	<p>Nxënësit dallojnë shkronjën I te figurat me emrat poshtë tyre.</p>
<p>Hapi i katërt</p> <p>Vizatim dhe shkrim</p>	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të ngjyrosin figurat e Abetares së Punës që janë në faqet përkatëse.</p> <p>Më pas kërkon që të shkruajnë elementet e shkrimit dhe, së fundi, të shkruajnë shkronjën I të madhe të shtypit.</p>	<p>Nxënësit ngjyrosin figurat e vijëzuara dhe elementet e shkrimit.</p> <p>Nxënësit bëjnë vizatimet dhe elementet e shkrimit.</p> <p>Më pas shkruajnë shkronjën I të madhe të shtypit.</p>
<p>Hapi i pestë</p>	<p>Kërkon që nxënësit të plotësojnë në fjalët e fjalorit shkronjën që mungon.</p>	<p>Nxënësit plotësojnë shkronjën që mungon dhe bëjnë lexim global të fjalës.</p>
<p><b>II.PËRFORCIM</b></p>	<p><b>Punë e pavarur</b></p>	
<p>Hapi i gjashtë</p> <p>Punë e pavarur</p>	<p>Kërkon që në shtëpi, nxënësit të shkruajnë dy rreshta me I të madhe dhe fjalët globale në anë të Abetares së Punës në faqen përkatëse.</p>	<p>Shkruajnë I dhe dy fjalë globale që kanë në trup të tyre I.</p>
<p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Elementet e shkrimit: Dy rreshta me A, Dy fjalë globale</p>	

## Tema 4: Tingulli dhe shkronja M

Tema mësimore	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehja që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja M <b>Në shtëpi</b>	Të komentojë figurën në libër. Të shqiptojë saktë tingullin M. Të shkruajë shkronjën M. Të dallojë shkronjën M në fjalë. Të lexojë globalisht fjalët.	Lojë enigmë Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.		Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>I. Motivimi</b>	<b>Lojë enigmë</b>	
Hapi i parë	Mësuesi ka futur brenda në një kuti një mollë. Fton të gjithë nxënësit të futin dorën në kuti dhe ta prekin. Asnjë nxënës nuk e di se çfarë është. Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë se çfarë është, dhe më pas kërkon ta vizatojnë. Ndërkohë, nxënësit kanë mbi bankë mjetet e vizatimit. Pasi nxënësit e kanë vizatuar, mësuesi nxjerr figurën e mollës, poshtë së cilës është shkruar fjala <i>molla</i> , ku shkronja M është ngjyrë tjetër dhe kërkon që të gjithë nxënësit të shqiptojnë fjalën <i>molla</i> . Mësuesi është i kujdesshëm që të dëgjojë nga të gjithë nxënësit se si shqiptohet tingulli M.	Nxënësit futin dorën në kuti e prekin. Gjejnë se çfarë është dhe e vizatojnë.
<b>II. Faza hyrëse</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë emrat e pjesëtarëve të familjes: mami, babi, motra, nëna; flasin për familjen. Të diskutojnë për familjet e tyre dhe rolin që ka çdo-njëri në fjalët që përdorin dhe, kur dëgjohet tingulli <b>m</b> , mësuesi porositi nxënësit të thonë një <b>stop</b> .	Nxënësit bashkëbisedojnë për familjet e tyre. Shqiptojnë fjalë që kanë <b>m</b> në trup të tyre. Gjejnë fjalë që kanë <b>m</b> në trup të tyre.
Hapi i tretë	Mësuesi shqipton edhe fjalë të tjera që kanë <b>M</b> dhe u thotë nxënësve që në ato fjalë që dëgjojnë <b>m</b> të thonë stop.	Nxënësit sipas komandës së mësueses gjejnë fjalë që kanë <b>M</b> dhe thonë stop. I shqiptojnë edhe ata fjalët që thotë mësuesi.
Hapi i katërt	Mësuesi kërkon që edhe nxënësit të thonë dhe të gjejnë fjalë të tjera që kanë <b>M</b> dhe që ndodhen brenda figurës së librit në temën “Në shtëpi”. Mësuesi nxjerr etiketa me figura që kanë <b>M</b> .	Nxënësit thonë fjalë që kanë tingullin <b>m</b> në trup të tyre. Nxënësit gjejnë se ku ndodhet tingulli i ri në emërtimet e fjalëve për figurat përkatëse.
Zhvillim, kuptim, ndërtim njo-hurish	Punë në grupe dyshe, ushtrime manipuluese	

Hapi i pestë	<b>Prezanton shkronjën M.</b> Pyet se me kë ngjan shkronja M, çfarë ka më shumë se shkronja a. I nxjerr të dyja që nxënësit t'i krahasojnë, bën shoqërimin me sy MAL, vizaton malet ose paraqet foto të tyre. E vizaton në ajër. E shkruan M në tabelë. Kërkon që nxënësit ta shkruajnë në tabelën plastike ose në një fletë të madhe vizatimi. Mësuesi kërkon që nxënësit për disa minuta të ushtrohen duke shkruar M.	Së bashku me mësuesen, nxënësit e vizatojnë në ajër. Vizatojnë në ajër dhe në tabelë, a edhe duke nxjerrë në pah se M formohet afërsisht duke bashkuar të dyja A bashkë. Nxënësit ushtrohen duke shkruar M në tabelën plastike/fletë të mëdha vizatimi.
Hapi i gjashtë	Më pas shkruajnë M në Abetaren e Punës.  Ushtrohen për të gjetur tingullin në trup të fjalës. Plotësojnë shkronjën M te fjalët e shkruara në anë të faqes.	Nxënësit shkruajnë M në Abetaren e Punës, në rreshtat përkatës. Thonë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin M. Plotësojnë M te fjalët e shkruara në anë të fletës.
<b>Përforcim njo-hurish</b>	<b>Punë e pavarur/vizatim</b>	
Hapi i shtatë	Mësuesi kërkon më pas të shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës të kësaj shkronje, por ndonjë nxënës mund të shkruajë edhe ndonjë fjalë tjetër. Mësuesi kërkon që nxënësit të tregojnë përrallën <i>Iriqi dhe molla</i> , pasi e ka treguar vetë ose përmes figurës ka pyetur fëmijët. Nxënësit i shqiptojnë disa herë fjalët me M, gjithashtu edhe mësuesi me etiketa. I nxjerr fjalët që fëmijët të dallojnë ku është <i>pema, molla, mori, miq</i> . Kërkon të vizatojnë vizatimet e fundfaqes.	Nxënësit shkruajnë globalisht fjalët që janë në Abetaren e Punës.  Pas ritregimit të përrallës, shqiptojnë fjalët që kanë në trup të tyre tingullin m.
<b>Detyrë shtëpie</b>	Të shkruajnë dy rreshta me m. Të shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.	Nxënësit me ndihmën e prindërve bëjnë detyrat e dhëna pa u mbingarkuar, aq sa i porositi mësuesi.

## 5. TINGULLI DHE SHKONJA N

Nr.	Tema mësimore	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehje që zhvillohen	Burime
4.	Tingulli dhe shkronja N  Klasa ime, numrat (fig. e Abetares së Punës)	Të komentojë figurën në libër. Të shqiptojë saktë tingullin N. Të shkruajë shkronjën N. Të dallojë shkronjën N në fjalë. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
-------	---------------------------	-----------------------------

Motivimi	Loja "Prek dhe gjej" - vizatim	
Hapi i parë	Mësuesi ka futur brenda në një kuti numra të mëdhenj, plastik ose druri. Fton të gjithë nxënësit të futin dorën në kuti dhe ta prekin. Asnjë nxënës nuk e di se çfarë janë. Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë se çfarë janë, dhe pastaj t'i vizatojnë. Nxënësit kanë mbi bankë mjete vizatimi.	Nxënësit fusin dorën në kuti dhe prekin. Gjejnë se çfarë janë dhe e vizatojnë. Vizatojnë edhe elementet e shkrimit të faqes së N-së.
Hyrje	<b>Bashkënisëdim/demonstrim</b>	
	Bashkëbisëdojnë pak për shkollën, për klasën, mjetet e punës dhe mënyrat e përdorimit të tyre. Mësuesi nxjerr figurën e numrit ku është shkruar fjala <i>numër</i> . Shkronja N është ngjyrë tjetër dhe kërkon që të gjithë nxënësit të artikulojnë fjalën <i>numri</i> . Mësuesi është i kujdesshëm që të dëgjojë nga të gjithë nxënësit sesi shqiptohet tingulli N. Mësuesi pyet se përse na duhen numrat?	Nxënësit flasin për klasën dhe punët, veprimtaritë që pritet të bëjnë në klasë. Nxënësit shqiptojnë të gjithë tingullin N. Nxënësit japin përgjigje se përse shërbejnë numrat: për numërim, për matematikë...
ZHVILLIM, KUPTIM, NDËRTIM	Lojëra manipuluese/demonstrim/vëzhgim	
	Mësuesi shqipton edhe fjalë të tjera që kanë N dhe u thotë nxënësve që në ato fjalë që dëgjojnë N të thonë stop. Mësuesi kërkon që edhe nxënësit të thonë e të gjejnë fjalë që kanë N. Mësuesi nxjerr figura me etiketa që kanë në trup të tyre shkronjën N. Paraqet shkronjën N.  Pyet se me kë ngjan shkronja N. Shkruan N në tabelë. Kërkon që nxënësit ta shkruajnë në tabelën plastike ose në një fletë të madhe vizatimi. Mësuesi kërkon që nxënësit të ushtrohen për disa minuta duke shkruar N.  Ushtrohen për të gjetur tingullin në trup të fjalës. Plotësojnë shkronjën N te fjalët e shkruara në anë të faqes.	Nxënësit sipas komandës së mësueses gjejnë fjalë që kanë N dhe thonë stop. I shqiptojnë edhe ata. Nxënësit thonë fjalë që kanë tingullin N në trup të tyre. Nxënësit gjejnë se ku ndodhet tingulli i ri në emërtimet e fjalëve për figurat përkatëse. Nxënësit së bashku me mësuesen e vizatojnë në ajër. Vizatojnë në ajër dhe në tabelë edhe A, I edhe M, duke nxjerrë në pah se si formohet N dhe duke i krahasuar me të tjerat. Ushtrohen duke shkruar N në tabelën plastike/fletë të mëdha vizatimi. Shkruajnë N në Abetaren e Punës në rreshtat përkatës. Thonë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin N. Plotësojnë N te fjalët e shkruara në anë të fletës. Shkruajnë globalisht fjalët.
Përforcim	Punë e pavarur/ punë me etiketa /vizatim	
Hapi i katërt	Kërkon fjalë me N dhe i shqipton disa herë edhe mësuesi me etiketa. I nxjerr fjalët që fëmijët të dallojnë fjalë me N: <i>numri, nëna, nota, nata</i> . <i>Kërkon të vizatojnë vizatimet e fundfaqes.</i>	Nxënësit shqiptojnë dhe dallojnë N në trup të fjalës. Vëzhgojnë dhe dallojnë fjalët që kanë n në trup të tyre. Bëjnë vizatimet e fundit të faqes përkatëse.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me N. Të shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës në faqen përkatëse. Kërkon të gjejnë në revista ose gazeta fjalë që kanë në trup të tyre shkronjën N (kryesisht në tituj).	Nxënësit, me ndihmën e prindërve, bëjnë detyrat e dhëna pa u mbingarkuar, aq sa i porositi mësuesi. Kërkojnë në titujt e revistave dhe gazetave shkronjën N.

## 6.TINGULLI DHE SHKRONJA E-Ë

Nr	Tema mësimore	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
6.	Tingulli dhe shkronja e, ë <i>Dita ime</i>	Të komentojë figurën në libër. Të shqiptojë dhe shkruajë tingujt E dhe Ë. Të shkruajë shkronjat E dhe Ë. Të dallojë shkronjat E dhe Ë në fjalë. Të lexojë globalisht fjalët me Ë. Të shkruajë dhe vizatojë elemente të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

## Zhvillimi i mëimit

Hapat	Çfarë bën mësuesi?	Çfarë bën nxënësi?
<b>Motivimi</b>	<b>Lojë enigmë-vizatim</b>	
Hapi i parë	Në një kuti, mësuesi ka futur një elefant lodër. Mësuesi kërkon të gjejë se çfarë është dhe ta vizatojnë. Mësuesi pyet se çfarë është? Kur e gjejnë, mësuesi pyet: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për çfarë nevojitet?</li> <li>• A mund të luajmë me të?</li> <li>• A mund të mësojmë?</li> </ul> A mund të jetë kjo lojë, pjesë e mëimit?	Nxënësit futin dorën dhe e prekin. Mbi bazë të të prekurit thonë se çfarë është. Nxënësit vizatojnë objektin, por nuk e thonë përgjigjen, derisa t'i pyesë mësuesi. Nxënësit thonë se çfarë është, në bazë të prekjes së objektit me gishta. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit.
Hyrje	<b>Loja me stop dhe përjashtojë/Ndërtim mjedisi fonologjik</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi së bashku me nxënësit komentojnë faqen e Abetares ku është pamja me temë: Dita ime. Mësuesi shqipton edhe fjalë të tjera që kanë E dhe Ë. U thotë nxënësve që në ato fjalë që dëgjojnë E dhe Ë, të thonë stop. Në fjalët që kanë dy tinguj, mësuesi kërkon të thonë dy herë stop. Mësuesi kërkon që nxënësit ta shqiptojnë në rrokje fjalën elefanti, ashtu si e shqipton vetë ai, e-le-fan-ti. Mësuesi kërkon që edhe nxënësit të thonë e të gjejnë fjalë që kanë N.	Nxënësit përshkruajnë figurën dhe flasin se si e organizojë ata vetë ditën e tyre. Sipas komandës së mësueses, nxënësit gjejnë fjalë që kanë tingullin E dhe thonë stop, i shqiptojnë edhe ata. Në fjalët që dëgjojnë dy tinguj thonë dy herë stop. Nxënësit e shqiptojnë sipas modelit.  Nxënësit thonë fjalë që kanë tingullin N në trup të tyre.
Zhvillim njohurish	<b>Punë me etiketa, ndërtim mjedisi fonologjik/imitim</b>	

	<p>Mësuesi nxjerr etiketa me figura që kanë në trup të tyre tingullin dhe shkronjën e, ë (në figura janë shkruar fjalët përkatëse).</p> <p>Prezanton shkronjën E. Më pas, edhe Ë.</p> <p>Pyet se me kë ngjan shkronja E, Ë, çfarë ka më shumë Ë se shkronja e. I nxjerr të dyja që nxënësit t'i krahasojnë dhe bën shoqërimin. Shkruan E, Ë në tabelë.</p> <p>Kërkon që nxënësit ta shkruajnë në tabelën plastike ose në një fletë të madhe vizatimi.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit për disa minuta të ushtrohen duke shkruar E, Ë.</p> <p>Më pas i vë të shkruajnë E, Ë në Abetaren e Punës.</p> <p>Ushtrohen për të gjetur tingullin në trup të fjalës.</p> <p>Plotësojnë shkronjën N te fjalët e shkruara në anë të faqes.</p> <p>Më pas, mësuesi kërkon të shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës të këtyre shkronjave.</p>	<p>Nxënësit gjejnë se ku ndodhet tingulli i ri në emëtimet e fjalëve për figurat përkatëse.</p> <p>Nxënësit, së bashku me mësuesen, e vizatojnë në ajër.</p> <p>Vizatojnë në ajër E dhe në tabelë Ë. Nxjerrin në pah se E dhe Ë ndryshojnë vetëm nga pikat e ë-së.</p> <p>Nxënësit ushtrohen duke shkruar në tabelën plastike/fletë të mëdha vizatimi E, Ë të shtypit.</p> <p>Nxënësit shkruajnë E, Ë në Abetaren e Punës në rreshtat përkatës.</p> <p>Thonë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin E, Ë.</p> <p>Plotësojnë E, Ë te fjalët e shkruara në anë të fletës.</p> <p>Shkruajnë globalisht fjalët.</p> <p>Nxënësit shkruajnë globalisht fjalët që janë në Abetaren e Punës.</p>
<b>Përforsim</b>	<b>Punë e pavarur me mjete individuale</b>	
	<p>Fjalët me E, Ë i shqiptojnë disa herë dhe mësuesi i nxjerr fjalët me etiketa që fëmijët të dallojnë ku ka E, Ë në fjalët: nënë, enë, elefant, urë, arë.</p> <p>Mësuesi tregon vijat e shkrimit të dorës dhe i vijëson në dërrasë, kërkon që nxënësit t'i bëjnë në tabelën plastike apo fletë vizatimi dhe, më pas, në Abetaren e Punës.</p>	<p>Nxënësit shqiptojnë dhe dallojnë E, Ë në trup të fjalëve.</p> <p>Nxënësit bëjnë vizatimet e fundit të faqes.</p>
<b>Detyrë</b>	<p>Të shkruajnë dy rreshta me E, Ë.</p> <p>Të shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.</p> <p>Kërkon që të gjejnë e qarkojnë në tituj artikujsh e gazetash shkronjën E, Ë.</p>	<p>Dy rreshta me E dhe dy me Ë.</p> <p>Elementet e shkrimit dhe shkrimi global i dy fjalëve për çdo shkronjë.</p> <p>Gjejnë e qarkojnë në tituj artikujsh revistash dhe gazetash shkronjat E, Ë.</p>

## 7. TINGULLI DHE SHKRONJA B

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë	Burime
	Tingulli dhe shkronja B	<p>Të shqiptojë tingullin B.</p> <p>Të shkruajë shkronjën B.</p> <p>Të dallojë shkronjën B në fjalë.</p> <p>Të komentojë figurën në libër.</p> <p>Të lexojë globalisht fjalët.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Të shkruarit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë.</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja</p>

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	Imagjinatë e drejtuar	

	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të ulin kokë dhe të dëgjojnë mësuesin. Pyet si quhet sendi që e lëshon këtë zhurmë: ty-ty-ty-boria. Që lëviz me dy rrota: biçikleta Që është një nga prindërit tanë: babi. Që mban bebi në gojë: biberon. Që bën ham-ham: bubi.</p>	Nxënësit emërtojnë sendet: boria, biçikleta, babi, biberon.
Hyrje	Vëzhgim/krijim fabule	
	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të tregojnë ndonjë histori që kanë në lidhje me borinë, biçikletën, bebin, biberonin. Mësuesi pyet se çfarë kanë të përbashkët këto fjalë. Mësuesi u thotë nxënësve që të vëzhgojnë faqen e Abetares së Punës, ku është shkronja B. U thotë nxënësve nëse mund të tregojnë një histori, duke e parë këtë figurë. Mësuesi kërkon që nxënësit të shqiptojnë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin B. Nxjerr figura dhe kërkon që nxënësit t'i emërtojnë. Midis figurave që e kanë tingullin B, nxjerr edhe të tjera që nuk e kanë dhe kërkon që nxënësit t'i përjashtojnë ato.</p>	<p>Nxënësit tregojnë histori të ndryshme, duke përdorur fjalët e prezantuara.  Nxënësit gjejnë tingullin B.  Nxënësit përpiqen të krijojnë një histori duke parë figurën.  Nxënësit gjejnë figurat dhe fjalët që e përmbajnë tingullin b dhe ato që nuk e përmbajnë i përjashtojnë.  Nxënësit thonë stop te fjalët që e kanë tingullin dhe përjashtojnë fjalët që nuk e përmbajnë këtë tingull. Ushtrimi bëhet me komandat <b>stop dhe përjashto</b>.</p>
Zhvillim/Ndërtim njohurish	Punë në grupe	
	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit t'i riprodhojnë edhe një herë fjalët që shqiptuan nga ushtrimi i mësipërm, kur ai nxjerr para tyre një bori me figurë. Pasi i shqiptojnë, mësuesi kërkon që t'i shqiptojnë përsëri të ndara në rrokje, duke i udhëhequr me lëvizjen e duarve majtas-djathtas. Kërkon që nxënësit të shkruajnë në tabelat plastike shkronjën B. Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë disa herë B në tabela pastaj në një fletore dhe, në fund, pasi është bindur se nxënësit e shkruajnë mirë, i lejon ta shkruajnë në Abetaren e Punës. Mësuesi i lë të lirë nxënësit të ngjyrosin pikturën në Abetaren e Punës dhe të vijëzojnë elementet shkrimit-vallëzimit.</p>	<p>Në këtë mënyrë, nxënësit shqiptojnë fjalët <b>boria, biçikleta, babi, biberoni, bubi</b> një herë të plota dhe një herë të ndara në rrokje: Bor-ri-a, bi-ci-kle-ta, ba-bi, bi-be-ron, bu-bi.  Nxënësit shkruajnë në tabelat plastike shkronjën B.  Nxënësit shkruajnë në mënyrë individuale B në tabelë plastike, dhe në Abetaren e Punës.  Nxënësit ngjyrosin dhe vizojnë sipas modelit.</p>



Përforsim	Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë shkronjën <b>b</b> te fjalët globale të faqes në Abetaren e Punës. Më pas, kërkon ta shkruajnë globalisht fjalën <i>bubi</i> dhe <i>bebi</i> .	Nxënësit plotësojnë shkronjën që mungon në fjalët <b>bubi</b> , <b>bebi</b> dhe më pas shkruajnë të plota këto fjalë në fletoren e punës.
Detyrë	Të shkruajnë me rreshta me <b>b</b> , dy rreshta me vija sipas modelit dhe dy fjalë globale.	Sipas modelit në Abetaren e Punës, nxënësit në shtëpi shkruajnë dy rreshta me <b>B</b> dhe dy fjalë globale: <b>bebi</b> , <b>bubi</b> dhe, nëse emri i tyre e ka shkronjën <b>b</b> , e shkruajnë edhe atë.

## 8. Tingulli dhe shkronja F

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet	Burime
	Tingulli dhe shkronja <b>f</b>  Festa	Të shqiptojë tingullin F. Të shkruajë shkronjën F. Të dallojë shkronjën F në fjalë. Të komentojë figurën në Abetaren e Punës. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.		Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	<b>Lojë enigmë-lojë bingo</b>	
	Mësuesi ka vendosur mbrapsht në dërrasë disa foto që nuk duken. Flamuri, flutura, fëmijë, fik. I zbulon pak nga pak elementet e fotove. Kërkon që nxënësit të gjejnë se për çfarë objekti bëhet fjalë.	Nxënësit marrin pjesë në lojën enigmë të përqendruar për të gjetur enigmën dhe fituar lojën.
<b>Hyrja</b>	<b>Vizatim, demonstrim, punë në grupe</b>	
	Më pas mësuesi porositi nxënësit të vizatojnë njëri grup një flamur, ndërsa tjetri një flutur. Kërkon që nxënësit të gjejnë se çfarë kanë të përbashkët.	Nxënësit vizatojnë flamurin, fluturën. Nxënësit flasin edhe për flamurin, edhe për fluturën, duke i përshkruar, por njëkohësisht evidentojnë elementin e përbashkët, tingullin <b>f</b> .
<b>Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish</b>	<b>Punë në grupe</b>	

	<p>Nxjerr disa figura dhe kërkon që nxënësit t'i emërtojnë: <i>flutur, festë, faqe, figurë, foto, fik etj.</i></p> <p>Midis figurave që e kanë tingullin F.</p> <p>Nxjerr edhe të tjera që nuk e kanë dhe kërkon që nxënësit t'i përjashtojnë ato.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit t'i riprodhojnë fjalët që shqiptuan edhe njëherë kur ai nxjerr para tyre një foto me figurë një flamur, një fik, një flutur.</p> <p>Pasi i shqiptojnë, mësuesi kërkon që t'i shqiptojnë përsëri të ndara në rrokje duke i udhëhequr me lëvizjen e duarve majtas-djathtas.</p> <p>Ky ushtrim bëhet me komandat <b>stop</b> dhe <b>përjashto</b>.</p> <p>Mësuesi kërkon që atje ku nxënësit dëgjojnë <b>f</b> të thonë <b>stop</b>, dhe kështu dallojnë fjalët që e kanë njëherë <b>f</b> dhe fjalët që e kanë dy herë në trup të tyre tingullin <b>f</b>.</p> <p>Mësuesi veçon <b>f</b> në fjalët e shqiptuara më sipër, fjalë të cilat i ka shkruar edhe nën figurat përkatëse dhe u thotë nxënësve se simboli F shqiptohet f, e shqipton disa herë vetë dhe e shkruan në ajër dhe në dërrasë.</p> <p>Kërkon që nxënësit ta shkruajnë shkronjën F në tabelat plastike.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë disa herë F në tabela, më pas në një fletoreje dhe në fund pasi është bindur se nxënësit e shkruajnë mirë i lejon ta shkruajnë në Abetaren e Punës.</p>	<p>Nxënësit thonë fjalë që e kanë tingullin <b>f</b>. Nxënësit të ndarë në grupe dyshe, gjejnë figurat dhe fjalët që e përmbajnë tingullin <b>F</b> dhe ato që nuk e përmbajnë i përjashtojnë. Nxënësit thonë <b>stop</b> te fjalët që e kanë tingullin dhe përjashtojnë fjalët që nuk e përmbajnë këtë tingull.</p> <p>Kështu nxënësit shqiptojnë fjalët foto, fik, flamur, flutur njëherë të plota dhe njëherë të ndara në rrokje: <b>fo-to, fik, fla-mur, flu-tur, fle-to-re</b>.</p> <p>Nxënësit ndalojnë me komandën e <b>stopit</b>, sa herë e gjejnë <b>f</b> në fjalët e mësipërme.</p> <p>Nxënësit imitojnë mësuesin sipas komandave që ai u jep.</p> <p>Nxënësit shkruajnë në tabelat plastike shkronjën F.</p> <p>Nxënësit shkruajnë në mënyrë individuale F në tabelë plastike, pastaj në fletore dhe në fund në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit ngjyrosin dhe vijëzojnë sipas modelit në Abetaren e Punës.</p>
<b>Përforcim</b>	<b>Punë e pavarur</b>	
	Mësuesi i lë të lirë nxënësit të ngjyrosin pikturën në <b>f</b> e <b>F</b> dhe të vijëzojnë elementet e shkrim-kryqëzimit e vijave.	Nxënësit plotësojnë shkronjën që mungon në fjalët <b>flutura, fiku</b> dhe, më pas, i shkruajnë të plota këto fjalë në Abetaren e Punës.
	Të shkruajnë dy rreshta me F, dy rreshta me vija sipas modelit dhe dy fjalë globale.	Sipas modelit në Abetaren e Punës, nxënësit në shtëpi shkruajnë dy rreshta me <b>f</b> dhe me vija të lakuara dhe dy fjalë globale <b>flutura, fiku</b> dhe nëse emri i tyre e ka shkronjën <b>f</b> e shkruajnë edhe atë.

## 9. TINGULLI DHE SHKRONJA C, Ç

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë	Burime
	Tingulli dhe shkronja C, Ç Zhurmat e kafshëve dhe të natyrës	Të shqiptojë tingullin C, Ç. Të shkruajë shkronjën C, Ç. Të dallojë shkronjën Ç në fjalë. Të komentojë figurën në Abetaren e Punës. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, shkronja

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	Imagjinatë e drejtuar	
Hapi i parë	Mësuesi ka incizuar në magnetofon disa cicërime zogjsh dhe disa të rrahura çekiçi dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë se nga vijën këto zhurma. Mësuesi pyet nga vjen kjo zile. Përgjigje: celular. Kush bën mjau-mjau: macja. Zhurma e ujit: Nga vjen kjo zhurmë?	Nxënësit gjejnë se janë cicërimat e zogjve dhe të rrahurat e çekiçit.  Nxënësit përgjigjen: celulari, macja, nga rubineti i çezmës etj.
Faza hyrëse		
	Mësuesi kërkon që nxënësit të shqiptojnë fjalë të tjera që kanë në trup të tyre tingullin c dhe ç  Mësuesi kërkon që nxënësit të ndahen në dy grupe: njëri grup të gjejë fjalë që kanë c në trupin e tyre dhe grupi tjetër të gjejë fjalë që kanë ç. Gara vazhdon derisa nxënësit nuk kanë më fjalë për të thënë.	Nxënësit thonë fjalë që e kanë tingullin C, Ç.  Nxënësit gjejnë fjalët që e përmbajnë tingullin C, Ç. Macja, celulari, ciu-ciu, çekiçi, çezmja, çorape, çizme etj.
Ndërtim njohurish		
	Mësuesi veçon <b>c, ç</b> në fjalët e shqiptuara më sipër, të cilat i ka shkruar edhe nën figurat përkatëse dhe u thotë nxënësve se simboli <b>c, ç</b> shqiptohet <b>c, ç</b> ; e shqipton disa herë vetë, e shkruan në ajër dhe në dërrasë. Kërkon që nxënësit ta shkruajnë në tabelat plastike shkronjën <b>C, Ç</b> . Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë disa herë <b>C, Ç</b> në tabela, pastaj në fletore dhe, në fund, pasi është bindur se nxënësit e shkruajnë mirë, i lejon ta shkruajnë në Abetaren e Punës. Mësuesi i lë të lirë nxënësit të ngjyrosin pikturën në c e ç dhe të vijëzjnë elementet shkrim–kryqëzimit të vijave.	Nxënësit imitojnë mësuesin sipas komandave që u jep.  Nxënësit shkruajnë në tabelat plastike shkronjën c dhe ç. Nxënësit shkruajnë në mënyrë individuale c dhe ç në tabelë plastike, pastaj në fletore dhe në fund në Abetaren e Punës.  Nxënësit ngjyrosin dhe vijëzjnë sipas modelit në Abetaren e Punës.
Përforcim		
	Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë shkronjën c dhe ç te fjalët globale të c e ç në Abetaren e Punës, më pas kërkon t'i shkruajnë globalisht fjalët <b>mace, celular, çadra, çekiçi</b> .	Nxënësit plotësojnë shkronjën që mungon në fjalët <b>mace, celular, çadra, çekiçi</b> dhe, më pas, i shkruajnë të plota këto fjalë në Abetaren e Punës.
Detyra	Të shkruajnë rreshta me <b>c, ç</b> : dy rreshta me vija sipas modelit dhe dy fjalë globale.	Sipas modelit në Abetaren e Punës, nxënësit shkruajnë në shtëpi dy rreshta me c dhe ç dhe me vija të lakuara dhe dy fjalë globale ciu-ciu dhe nëse emri i tyre e ka shkronjën c dhe ç e shkruajnë edhe atë.

## 10. TINGUJT DHE SHKRONJAT H, U

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë	Burime
	Tingujt dhe shkronjat H dhe U Zërat e kafshëve	Të shqiptojë tingujt H dhe U. Të shkruajë shkronjat H dhe U. Të dallojë shkronjat H dhe U në fjalë. Të komentojë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët.	Punë në grup Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit, Të shkruarit, Vizatim, muzikë, Matematikë	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, shkronja

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Fazat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	Imitim zërash kafshësh	
	<p>Gjuha e kafshëve <b>Gjuha e kafshëve</b></p> <p>Ciu, ciu, ciu o zog i vogël, Be, be, be, o qengj i vogël, Ciu, ciu qan apo këndon, Be, be qan apo këndon, Ciu, ciu flas me nënën time, Be, be flas me nënë time, Nëna gjuhën ma kupton. Nëna gjuhën ma kupton.</p> <p>Mjau, mjau, mjau ti kotele, Mjau, mjau qan apo këndon, Mjau, mjau flas me nënën time, Nëna gjuhën ma kupton.</p>	Nxënësit përsërisin vargjet e vjershë, por imitojnë edhe zëra të tjerë kafshësh.
Hyrja		
	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të shqiptojnë fjalë të tjera që kanë në trup të tyre tingullin h, u. Hurma, harta, hapi; Flutura, figura, piktura, ujku. Mësuesi kërkon që nxënësit të ndahen në dy grupe: njëri grup të gjejë fjalë që kanë h në trup të tyre dhe grupi tjetër të gjejë fjalë që kanë u në trup të tyre. Gara vazhdon derisa nxënësit nuk gjejnë më fjalë për të thënë.</p>	Nxënësit thonë fjalë që e kanë tingullin h dhe u. Nxënësit gjejnë fjalët që e përmbajnë tingullin h dhe u.
		Ky ushtrim bëhet me komandat <b>stop dhe përjashto</b> . Nxënësit thonë stop te fjalët që e kanë tingullin dhe përjashto te fjalët që nuk e përmbajnë këtë tingull.

Zhvillim dhe ndërtim njohurish		
	<p>Nxjerr disa figura dhe kërkon te nxënësit t'i emërtojnë: <i>hëna, hapi, harku etj., daulle, urban, bubbi, buburrec.</i></p> <p>Midis figurave që e kanë tingullin <b>h</b>, dhe pastaj <b>u</b> nxjerr edhe të tjera që nuk e kanë dhe kërkon që nxënësit t'i përjashtojnë. Prezanton shkronjat përkatëse: i vizaton në ajër dhe në dërrasë, i prezanton me foto dhe, më pas, kërkon që edhe nxënësit t'i vizatojnë me dorë a në tabelë plastike ose t'i bëjnë edhe me tela të hollë ose me objekte të tjera të buta dhe të përthyeshme.</p> <p>Mësuesi i vendos fotot në dy grupe dhe ndalon te shkronjat <b>h</b> dhe <b>u</b>; i shqipton dhe kërkon edhe nga nxënësit t'i shqiptojnë.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësi t'i riprodhojnë fjalët që shqiptuan nga ushtrimi i mësipërm edhe njëherë, kur ai nxjerr para tyre një foto me figurë.</p> <p>Mësuesi kërkon që atje ku nxënësit dëgjojnë <b>h</b>, <b>u</b> të thonë <b>stop</b> dhe kështu dallojnë fjalët që e kanë një herë <b>h</b>, <b>u</b> dhe fjalët që e kanë dy herë në trup të tyre tingullin <b>h</b>, <b>u</b>.</p> <p>Mësuesi veçon <b>h</b>, <b>u</b> në fjalët e shqiptuara më sipër fjalë, të cilat i ka shkruar edhe nën figurat përkatëse dhe u thotë nxënësve se simboli <b>h</b>, <b>u</b> shqiptohet <b>h</b>, <b>u</b>. E shqipton disa herë vetë dhe e shkruan në ajër dhe në dërrasë.</p> <p>Kërkon që nxënësit ta shkruajnë në tabelat plastike shkronjën <b>h</b>, <b>u</b>.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë disa herë <b>h</b>, <b>u</b> në tabela pastaj në fletore dhe në fund pasi është bindur se nxënësit e shkruajnë mirë i lejon ta shkruajnë në Abetaren e Punës.</p> <p>Mësuesi i lë të lirë nxënësit të ngjyrosin pikturën në <b>h</b> e <b>u</b> dhe të vijëzohen elementet e shkrimit, të ngjyrosin hënën, retë dhe urën.</p>	<p>Kështu nxënësit shqiptojnë fjalët <b>ciu-ciu celular, çekiç çizme</b> etj.</p> <p>Nxënësit ndalojnë me komandën e stop-it sa herë që së bashku me nxënësit gjejnë <b>h</b>, <b>u</b> në fjalët e mësipërme.</p> <p>Nxënësit imitojnë mësuesin sipas komandave që ai u jep.</p> <p>Nxënësit shkruajnë në tabelat plastike shkronjën <b>h</b> dhe <b>u</b>.</p> <p>Nxënësit shkruajnë në mënyrë individuale <b>h</b> dhe <b>u</b> në tabelë plastike, pastaj në fletë pune dhe në fund në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit ngjyrosin dhe vijëzojnë sipas modelit në Abetaren e Punës.</p>
<b>Përforcim</b>	<b>Punë e pavarur</b>	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë shkronjën <b>h</b> , <b>u</b> dhe te fjalët globale të <b>h</b> , <b>u</b> në Abetaren e Punës. Më pas kërkon ta shkruajnë globalisht fjalën.	Nxënësit plotësojnë shkronjën që mungon në fjalët <b>hëna, hunda, ura, ujku</b> dhe, më pas, i shkruajnë të plotë këto fjalë në fletoren e punës.
<b>Detyrë</b>	Të shkruajnë me rreshta me <b>h</b> , <b>u</b> dy rreshta me vija sipas modelit dhe dy fjalë globale.	Nxënësit në shtëpi sipas modelit në Abetaren e Punës shkruajnë dy rreshta me <b>h</b> dhe <b>u</b> dhe me vija të lakuara dhe dy fjalë globale dhe, nëse emri i tyre e ka shkronjat, <b>h</b> , <b>u</b> e shkruajnë edhe atë.

## 11. TINGULLI DHE SHKRONJA D

Nr.	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehinë	Burime
	Tingujt dhe shkronjat D <i>Flasim për detin</i>	Të shqiptojë tingullin D duke e dalluar pozicionin në fjalë. Të shkruajë shkronjën D. Të përshkruajë figurën në libër. Të lexojë globalisht fjalët. Të mësojë rreth pozicioneve të dorës gjatë të shkruarit me dorë.		Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit,	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, figura, shkronja

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	Stuhi mendimi	
	Mësuesi paraqet para nxënësve disa foto dhe u thotë të gjejnë se çfarë kanë të përbashkët fotot që shohin në figurë. Fotot janë <b>deti, dielli, delfini, dallga</b> .	Nxënësit duke u menduar përpiqen të gjejnë se çfarë kanë të përbashkët që lidhen me detin dhe kanë <b>d</b> të përbashkët.
Hyrja	Punë në grupe	Stop/përrjasht
	Poshtë fotove janë shkruar edhe emrat përkatës shkronja D ka ngjyrë të njëjtë në të gjitha fotot. Kërkon përsëri që nxënësit të dallojnë elementin e përbashkët.	Të ndihmuar edhe nga elementi ngjyrë, nxënësit gjejnë se shkronja <b>D</b> është tingulli që kanë në fillim të fjalës së çdo sendi të paraqitur në foto.
	Mësuesi u kërkon të tregojnë një tregim të shkurtër që lidhet me detin.	Disa nxënës tregojnë ngjarje që lidhen me detin, ku mund të përmendin edhe fjalët që mësuesi shfaq më parë përmes fotove.
	Mësuesi shqipton fjalë që kanë shkronjën <b>d</b> , por mes tyre dhe fjalë që nuk kanë <b>d</b> . Kërkon që nxënësit të luajnë me lojën <b>stop dhe përrjasht</b> . Fjalët janë: <b>deti, dora, dimri, dhëmbi, dëshirë, Adriatik, Jon, data, burri, dita, dera, dielli, daulle</b> etj.	Nxënësit ndjekin me vëmendje shqiptimin e fjalëve nga mësuesi dhe njëzëri thonë stop apo përrjasht.
	Mësuesi kërkon që këtë lojë nxënësit ta bëjnë edhe në grupe dyshe me njëri-tjetrin.	Nxënësit gjejnë fjalë me <b>d</b> dhe ia thonë njëri-tjetrit; përdorin edhe fjalë të tjera që nuk kanë <b>d</b> .
	Mësuesi kërkon që nxënësit të shqiptojnë fjalë të tjera që kanë në trup të tyre tingullin <b>d</b> .	Nxënësit thonë fjalë që e kanë tingullin <b>D</b> . Nxënësit gjejnë fjalët që e përmbajnë tingullin <b>d</b> .
Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish		

	<p>Nga grupi i fjalëve që përmendi më sipër, mësuesi nxjerr në një tabelë foto të tyre ku është shkruar dhe fjala në të cilën shkronja <b>D</b> është shkruar me të kuqe dhe iu thotë nxënësve se shkronja me ngjyrë të kuqe quhet <b>D</b> e shqipton me ta së bashku disa herë dhe kërkon që ta shqiptojnë nxënësit.</p> <p>Disa nga këto fjalë <b>deti, dora, dimri, Adriatik, dera, dielli daulle</b>, mësuesi i shqipton edhe duke i ndarë në rrokje dhe kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë.</p> <p>Mësuesi shkruan në dërrasë shkronjën <b>D</b> duke treguar dhe elementet që e përbëjnë atë.</p> <p>Kërkon që edhe nxënësit të shkruajnë në ajër shkronjën <b>d</b>, por edhe në një tabelë plastike, e cila përbëhet nga një vijë e drejtë që i bashkohet një gjysmë rreth.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të vërejnë në Abetaren e Punës, ushtrimin që lidhet me pozicionin e dorës gjatë të shkruarit dhe bën disa ushtrime me nxënësit për mënyrat sesi duhet të mbahet lapsi apo stilolapsi.</p> <p>Mësuesi udhëzon të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën <b>D</b>.</p> <p>Mësuesi i shqipton emrat e fotove, duke i ndarë edhe në rrokje dhe kërkon nga nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë.</p> <p>Prezanton shkronjat përkatëse dhe vizaton në ajër dhe në dërrasë, prezanton me foto dhe më pas kërkon që edhe nxënësit t'i vizatojnë me dorë në tabelë plastike ose t'i bëjnë edhe me tela të hollë ose me objekte të tjera të buta dhe të përthyeshme.</p> <p>Mësuesi i shqipton emrat e fotove, duke i ndarë edhe në rrokje dhe kërkon që nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë.</p> <p>Prezanton shkronjat përkatëse dhe vizaton në ajër dhe në dërrasë <b>d</b>; prezanton me foto dhe më pas kërkon që edhe nxënësit t'i vizatojnë me dorë në tabelë plastike ose t'i bëjnë edhe me tela të hollë ose me objekte të tjera të buta dhe të përthyeshme.</p> <p>Kërkon që nxënësit ta shkruajnë në tabelat plastike shkronjën <b>d</b>.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit ta shkruajnë disa herë <b>d</b> në tabelë, pastaj në fletore dhe, në fund, pasi është bindur se nxënësit e shkruajnë mirë, i lejon ta shkruajnë në Abetaren e Punës.</p> <p>Mësuesi i lë të lirë nxënësit të ngjyrosin pikturën në <b>d</b> dhe të vijëzjnë elementet e shkrimit, ngjyrosin detin, diellin dhe delfinin.</p>	<p>Nxënësit shqiptojnë shkronjën <b>d</b> dhe përcaktojnë se në çfarë pozicioni ndodhet ajo në fjalët përkatëse: në fillim, në mes, në fund.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë fjalët sipas radhës: <b>deti, dora, dimri, Adriatik, dera, dielli, daulle</b>, duke i ndarë edhe në rrokje sipas mënyrës se si mësuesi i shqipton ato.</p> <p>Nxënësit shkruajnë në ajër dhe në tabelë plastike shkronjën (një vijë dhe një gjysmë harku). Mund ta bëjnë edhe me sende të buta, bukë peshku ose plastelinë.</p> <p>Nxënësit mësojnë duke u ushtruar se cilat janë pozicionet e drejta dhe cilat jo.</p> <p>Shkruajnë shkronjën <b>d</b> disa herë në Abetaren e Punës dhe më pas në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit shkruajnë në mënyrë individuale <b>c</b> dhe <b>ç</b> në tabelë plastike, pastaj në fletë pune dhe në fund në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit ngjyrosin dhe vijëzojnë sipas modelit në Abetaren e Punës.</p>
<b>Përforcim</b>		
	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë shkronjën <b>d</b> te fjalët globale në Abetaren e Punës; më pas kërkon ta shkruajnë fjalën globalisht.</p>	<p>Nxënësit plotësojnë shkronjën që mungon në fjalët dhe më pas i shkruajnë të plota këto fjalë në fletoren e punës.</p>
<b>Detyrë</b>		

	Të shkruajnë dy rreshta me d, dy rreshta me vija sipas modelit dhe dy fjalë globale: dielli, delfini.	Sipas modelit në Abetaren e Punës nxënësit nshkruajnë ë shtëpi dy rreshta me <b>d</b> dhe me vija të lakuara dhe dy fjalë globale dielli, delfini dhe, nëse emri i tyre e ka shkronjën <b>d</b> , e shkruajnë edhe atë.
--	---	---

## 12.TINGULLI DHE SHKRONJA DH

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja <b>Dh</b> <i>Dhuratat dhe ditëlindja</i>	Të shqiptojë tingujt <b>Dh</b> duke shkruar në ajër edhe grafikën e <b>DH</b> . Të dallojë shkronjat <b>Dh</b> në fjalë. Të përshkruajë figurat në libër. Të lexojë globalisht fjalët. Të ngjyrosë figura dhe elemente shkrimi që lidhen me shkronjën <b>dh</b> .	Punë në grup Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale, vizatimi, CD, figura, shkronja

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b> Hapi i parë	Mësuesi u thotë nxënësve të mendojnë dhe të thonë se çfarë mendojnë pasi dëgjojnë fjalën <i>dhuratë</i> . Jepet në magnetofon melodia që këndohet kur kemi ditëlindjen "Shumë urime për ty" dhe e këndojnë.	Pasi mendojnë për disa minuta, përgjigjen duke kujtuar festat e Vitit të Ri ditëlindjet, festa të tjera etj., nxënësit këndojnë melodinë së bashku.
Hyrja		
Hapi i dytë <b>Plotësim grafiku</b>	Mësuesi ka bërë një grafik ashtu siç e ka libri i Abetares dhe fton të gjithë nxënësit që së bashku me mësuesen të vendosin ose të ngjyrosin një kuadrat dhe datën e ditëlindjes në kalendarin e ditëlindjeve.	Me ndihmën e mësueses, nxënësit plotësojnë grafikun dhe vendosin emrin e tyre në datën ku ndodhet ditëlindja.
<b>Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish</b>		
Hapi i katërt	Mësuesi shqipton disa fjalë dhe u thotë nxënësve të thonë se çfarë kanë të përbashkët fjalët që shqiptoi: <i>dhjeta, dhurata, dhëmbi, dhia, dhalli</i> . Mësuesi e shqipton disa herë dhe kërkon nga të gjithë nxënësit që ta shqiptojnë edhe ata.	Nxënësit dallojnë se fjalët që përmend mësuesi kanë të përbashkët tingullin <b>dh</b> . Nxënësit me radhë shqiptojnë tingullin <b>dh</b> .
Hapi pestë	Mësuesi nxjerr para klasës disa figura me objekte, emërtimet e të cilave përmbajnë tingullin <b>dh</b> , i cili është shkruar me ngjyrë të dallueshme në trup të fjalës. Prezanton dhe vizaton në ajër dhe në dërrasë; kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtat veprime.	Nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve të mësueses.  E shkruajnë <b>dh</b> në tabelë plastike dhe më pas në Abetaren e Punës.
Hapi i gjashtë	Nxënësi plotësojnë shkronjën <b>dh</b> te fjalët ku mungon dhe më pas lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale.	Nxënësit plotësojnë shkronjën <b>dh</b> te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës dhe më pas shkruajnë edhe fjalët globale.



<b>Përforcimi</b>		
Hapi i shtatë	Mësuesi kërkon të vizatojnë objektet e dhomës së gjumit. Të shkruajnë shkronjën e madhe.	Nxënësit vizatojnë objektet e dhomës së gjumit të paraqitur në fund të faqes së shkronjës dhe në Abetaren e Punës.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me <b>dh</b> dhe <b>dy me fjalë globale</b> .	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe dy fjalë globale.

### 13. TINGULLI DHE SHKRONJA K

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat <i>Ujku dhe kecat</i>	Të shqiptojë tingullin dhe të shkruajë K e madhe. Të përshkruajë figurën në librin e Abetares. Të lexojë globalisht fjalët dhe plotësojë K. Të ngjyrosë figura dhe elemente shkrimi që lidhen me shkronjën k.	<i>Breinstorming</i> Punë në grup, Bashkëbisedim, Vizatim, Lojë enigmë	Të folurit Të shkruarit Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit.	Teksti, lapsa, fletore, Materiale, vizatimi, CD, figura, shkronja

#### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	<b>Përralla: “Ujku dhe kecat”, lojë në role në faqen përkatëse të Abetares</b>	
<b>Hapi i parë</b>	Mësuesi u tregon nxënësve vetëm njërin nga fotot e përrallës: “Ujku dhe kecat” dhe nxënësit duhet të kujtojnë përrallën. Më pas e luajnë në role.	Nxënësit kujtojnë përrallën e tregojnë përmbajtjen me ndihmën e mësuesit. Mund të shikojnë edhe teatër kukullash. Luajnë në role.
<b>Hyrja</b>	<b>Bashkëbisedim/demonstrim</b>	<b>Lojë enigmë</b>
<b>Hapi i katërt</b>	Mësuesi u thotë nxënësve se ka në mend emrin e një kafshe. U kërkon që të gjejnë se për cilën kafshë e ka fjalën mësuesi. Mësuesi u thotë nxënësve se figurën e ka-fshës që ka në mend, e ka kthyer përmbys. Në momentin që njëri prej tyre e gjen, fiton lojën bingo. Në rast se nxënësit nuk e gjejnë, mësuesi fillon të tregojë disa cilësi të tij për t’i i ndihmuar ata: Është i madh/është i bukur/është punëtor. Pasi zbulon enigmën, mësuesi kërkon që nxënësit të thonë emra kafshësh që kanë tingullin K, kur i shqiptojmë <b>kali, krokodili, keci, kaprolli, ujku</b> .	Nxënësit marrin pjesë në këtë lojë-enigmë. Aktivizohen pjesa më e madhe e nxënësve.  Nxënësit vazhdojnë lojën derisa të gjejnë emrin e kafshës (kali). Nxënësit me ndihmën e mësueses plotësojnë grafikun. Nxënësit shqiptojnë emrat e kafshëve që kanë në trup të tyre tingullin k.
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Punë në grupe/demonstrim</b>	

<b>Hapi pestë</b>	Mësuesi nxjerr para klasës disa figura me objekte, emërtimet e të cilave përmbajnë tingullin k, i cili është shkruar me ngjyrë të dallueshme në trup të fjalës. Mësuesi pyet çfarë bën kali. Lidh. Kali kalëron Kaprolli kërkon Keci kërcen Krokodili kafshon  Prezanton dhe vizaton në ajër dhe në tabelë. Kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtat veprime.	Nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve të mësuesit. E shkruajnë k edhe në Abetare Pune dhe më pas në Abetaren e Punës. Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të mësuesit. Lidhin emrat e kafshëve e veprimet që ata bëjnë. Nxënësit veprojnë sipas porosisë së mësuesit. Shkruajnë në ajër shkronjën k dhe më pas në fletë.
<b>Hapi i gjashtë</b>	Nxënësi plotësojnë shkronjën <b>dh</b> te fjalët ku mungon dhe më pas lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale.	Nxënësit plotësojnë shkronjën k te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës: kali, makina, dhe më pas shkruajnë edhe fjalët globale.
<b>Hapi i shtatë</b>	Mësuesi kërkon të vizatojnë objektet e dhomës së gjumit.	Nxënësit plotësojnë vizatimet me kokat e kafshëve që u mungon trupi, duke zbuluar se cilat janë kafshët.
<b>Detyrë</b>	Shkruajnë dy rreshta me K	

## 14. TINGULLI DHE SHKRONJA J

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat J	Të shqiptojë qartë tingullin J Të shkruajë shkronjën J kapitale Të përshkruajë figurën në libër (duke folur për dhuratat dhe festat). Të lexojë globalisht fjalët. Të dallojë tingullin nga shkronja. Të vizatojë figura dhe elemente shkrimi që lidhen me shkronjën J.	<i>Breinstorming</i> , Bashkëbisedim, Vizatim, Lojë- enigmë	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global Të dëgjuarit Të folurit Imagjinata Të menduarit	Teksti, lapsa, fletore, Materiale, vizatimi, CD, figura, shkronja.

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b> Hapi i parë	Lojë-enigmë	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të ngjyrosin figurat përkatëse të Abetares së Punës: jaka, jastëk, jelek.	Nxënësit ngjyrosin figurat e Abetares së punës te shkronja j.
<b>Hyrja</b>		

Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë se çfarë kanë të përbashkët këto objekte.  Mësuesi lejon deri në tri alternativa.	Nxënësit kërkojnë dhe gjejnë që tingulli j është e përbashkëta që kanë tri objektet.
<b>Zhvillim dhe ndër- tim njohurish</b>		
Hapi i tretë	Mësuesi shqipton para klasës disa fjalë të tjera me objekte emërtimet e të cilave përmbajnë tingullin j, i cili është shkruar me ngjyrë të dallueshme në trup të fjalës:  <i>Jaka, ujku, lejleku, java, bujtina</i>  Mësuesi kërkon që nxënësit të shpjegojnë kuptimin e fjalëve.  Veçojnë shkronjën j dhe e shkruan në ajër dhe në dërrasë të zezë.	Nxënësit përsëri gjejnë j në fillim të fjalëve që shqiptojnë nxënësit.  Nxënësit shpjegojnë kuptimin e fjalëve, plotësojnë shkronjën që mungon dhe fjalën në tërësi.
Hapi i gjashtë	Mësuesi ndan fjalët në rrokje me duar dhe me përplasje dhe kërkon që nxënësit t'i ndajnë në rrokje.  Kërkon sa herë përplasen duart.	Nxënësit shqiptojnë, duke i ndarë në rrokje fjalët e mësipërme.  Numërojnë sa herë përplasen duart.
Hapi i shtatë	Shkrimi i shkronjës J.	Shkruajnë në tabela plastike dhe në fletore.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me J dhe dy fjalë globale.	Dy rreshta me J dhe dy fjalë globale.

## 15.TINGUJT DHE SHKRONJAT G, GJ

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehja që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat G, GJ  Gjëegjëza dhe për-ralla	Të shqiptojë saktë tingujt G, GJ. Të dallojë shkronjat G, GJ në fjalë. Të përshkruajë figurën në librin e Abetares dhe flasin për dhuratat dhe festat. Të lexojë globalisht fjalët. Të vizatojë figura dhe elemente shkrimi që lidhen me shkronjën G, GJ.	Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Gjëegjëza, Dramatizim.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes.	Teksti, lapsa, fletore, Materiale, vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja.

### Zhvillimi i mësimi

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	Gjëegjëza	

Hapi i parë	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë nga një gjëgjëzë Mësuesi thotë edhe vetë disa gjëgjëza:</p> <p>Dy sëpata lata-lata, Presin pala të thata. (Gërshërët)</p> <p>I fut gishtat, Një plakë, Thikat hapen, Me tepsi në kokë, I heq gishtat, (Gozhda) Thikat prapsen, Kur presin qeshin, Kur rrinë heshtin. (Gërshërët)</p>	Nxënësit tregojnë gjëgjëza të ndryshme.
Hyrja	Punë në grupe	
Hapi i dytë	<p>Mësuesi i ndan klasën në grupe <b>a b, a b, a b, a b</b>. Njërit grup i jep disa fjalë që kanë në trup të tyre <b>g</b> dhe grupit tjetër i jep disa foto, fjalët e të cilave kanë në trup të tyre shkronjën <b>gj</b>: <i>rruga, guri, gomari, grepi, gypi, gishti</i> <i>gjinkalla, gjembi, gjarpri, gjurmët, gjilpëra.</i></p>	Nxënësit shqiptojnë fjalët dhe të tjerët thonë <b>stop</b> te fjalët që kanë <b>g</b> apo <b>gj</b> , ndërsa në fjalët që nuk e kanë nxënësit thonë <b>përrjashto</b> .
Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish		
Hapi i tretë	<p>Mësuesi paraqet figura me fjalët që kanë <b>g</b> edhe <b>gj</b> në trup të tyre dhe kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë. Prezanton shkronjat përkatëse <b>g, gj</b>; i vizaton në ajër dhe në tabelë; tregon se <b>gj</b> është e ndërtuar nga një <b>g</b> dhe nga një <b>j</b> del shkronja dyshe në pah.</p>	Nxënësit shprehin shqiptojnë <b>g</b> dhe <b>gj</b> .
	<p>Mësuesi nxjerr para klasës disa figura me objekte emërtimet e të cilave përmbajnë tingullin <b>g, gj</b>, të cilat janë shkruar me ngjyrë të dallueshme në trup të fjalës. Prezanton dhe vizaton në ajër dhe në dërrasë. Kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtat veprime.</p>	<p>Nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve të mësuesit.</p> <p>E shkruajnë <b>g, gj</b> në Abetare dhe më pas në Abetaren e Punës.</p>
Hapi pestë	Nxënësi plotësojnë shkronjën <b>g, gj</b> te fjalët ku mungojnë dhe më pas lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale.	Nxënësit plotësojnë shkronjën <b>g, gj</b> te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës dhe më pas shkruajnë edhe fjalët globale.
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të vizatojnë objektet e dhomës së gjumit. Mësuesi kërkon që nxënësit të dramatizojnë përrallën.	Nxënësit vizatojnë dhe personazhet e përrallës së gjinkallës dhe milingonës, duke treguar edhe përmbajtjen e saj. Nxënësit dramatizojnë përrallën e Abetares së Punës.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Dy rreshta me <b>g</b> dhe dy rreshta plotësojnë me <b>gj</b> fjalët globale.
Detyrë	Të shkruajnë nga dy rreshta me <b>G, Gj</b> .	

## 16. TINGUJT DHE SHKRONJAT L, LL

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat L, LL	Të shqiptojë tingujt L, LL. Të shkruajë shkronjat L, LL.	Punë në dyshe, Bashkëbisedim,	Të folurit, Të shkruarit,	Të lexuarit global, Të folurit,	Teksti, lapsa, fletore,
Librat dhe vjershat	Të komentojë figurën në librin e Abetares, duke folur për dhuratat dhe festat. Të lexojë globalisht fjalët. Të ngjyrosë figura dhe elemente shkrimi që lidhen me shkronjën L, LL.	Ritregim, Recitim.	Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Imagjinata, Të zhvilluarit e vëmendjes.	Materiale, vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja.

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b> Hapi i parë	Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë nga një vjershë nga ato që kanë mësuar në kopsht.	Nxënësit thonë vjersha të ndryshme.
<b>Hyrja</b>	Recitim dhe interpretim	
Hapi i dytë	Mësuesi ka disa libra për fëmijë në tavolinën e tij dhe merr njërin prej tyre dhe u lexon nxënësve disa vjersha. U bën nxënësve disa pyetje Çfarë është ky? Çfarë ka brenda? Përse përdoren librat?  Çfarë kanë librat brenda? Përralla, tregime, vjersha. Më pas mësuesi kërkon që nxënësit t'i bëjnë pyetje. Ndalet te fjalët <i>titull, përrallë, kapak, faqe</i> .	Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit. Nxënësit bëjnë pyetje të ndryshme.  Nxënësit japin përgjigje se librat kanë brenda përralla, tregime, vjersha.  Nxënësit i shqiptojnë fjalët që kanë të bëjnë me <i>librin, kapak, titull, përrallë</i> etj.
Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish		
Hapi i tretë	Mësuesi paraqet disa libra dhe u thotë nxënësve: Ky është libri i ..... Ky është libri i..... Ky është libri..... Mundësisht të gjejë libra me fëmijë që kanë në titull të tyre shkronjën L ose LL. Kërkon që nxënësi të gjejnë se çfarë kanë të përbashkët librat? Ndërsa te libri “Kush e hëngri akulloren?”, mësuesi kërkon që nxënësit të shohin me kujdes titullin. Ai pyet nxënësit nëse <i>titull</i> dhe <i>akullore</i> kanë ndonjë tingull njësoj. I ndajnë në rrokje :A-ku-llo-re, ti - tull.	Nxënësit shprehin shqiptojnë L, LL  Nxënësit gjejnë se kanë L të përbashkët. Ndërsa te libri “Kush e hëngri akulloren?”, nxënësit gjejnë të përbashkëtat e fjalës titull dhe akullore.

	Mësuesi nxjerr para klasës disa figura me objekte, emërtimet e të cilave përmbajnë tingujt I, II, të cilat janë shkruar me ngjyrë të dallueshme në trup të fjalës: përrallë, titull, molla, libri, lule. Këto fjalë sugjerohet të nxirren nga titujt e librave. Mësuesi prezanton L, LL dhe vizaton në ajër dhe në dërrasë L, LL. Kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtat veprime.	Nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve të mësueses.  E shkruajnë L, LL dhe në Abetare dhe më pas në Abetaren e Punës.
Hapi pestë	Nxënësi plotësojnë shkronjën I, II te fjalët ku mungon dhe më pas lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale.	Nxënësit plotësojnë shkronjën L, LL te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës dhe, më pas, shkruajnë edhe fjalët globale.
<b>Përforsim</b>		
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat e mollës dhe llullës në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin <i>mollën dhe llullën</i> .
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në ajër L dhe LL. Shkruajnë në fletore <i>diell</i> . Plotësojnë L dhe LL atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me L, LL.	Dy rreshta me L, LL dhe plotësojnë me L, LL fjalët globale.

## 17. TINGULLI DHE SHKRONJA P

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehja që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat P  <i>Në park</i>	Të shqiptojë tingujt P. Të shkruajë shkronjat. Të përshkruajnë figurën në librin e Abetares/Abetares së Punës, duke folur për perimet e frutat. Të lexojë globalisht fjalët. Të ngjyrosë figura dhe elemente shkrimi që lidhen me shkronjën P.	Punë në dyshe Bashkëbisedim Ritregim Recitim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes	Teksti, lapsa, fletore, materiale, vizatimi, CD, figura, lodra për fëmijë, shkronja

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	Lojë-enigmë/vizatim	
Hapi i parë	Mësuesi ka futur në një kuti disa perime dhe kërkon që nxënësit të fusin dorën brenda dhe të gjejnë çfarë janë, më pas të vizatojnë njërin prej tyre.	Nxënësit fusin dorën në kuti dhe kthehen në bankë dhe nisin vizatimin.
Hyrja	Turi i galerisë	

Hapi i dytë	Pasi nxënësit kanë vizatuar, mësuesi merr disa nga vizatimet, i var në mur dhe i prezantojnë duke emërtuar objektet. Sapo gjendet e sakta, mësuesi vendos foton e rregullt të objektit në tabelë: <i>patate, patëllxhan, rrepa, presh</i> . Në etiketat dhe fotot e mësuesit, shkronja <b>P</b> është shkruar me ngjyrë të kuqe. Mësuesi kërkon se cilin tingull kanë të përbashkët fjalët.	Nxënësi prezantojnë vizatimin dhe emërtojnë objektin përkatës.  Nxënësit e përsërisin së bashku emrin e objektit.  Nxënësit dallojnë tingullin <b>P</b> dhe e shqiptojnë atë disa herë.
<b>Zhvillim dhe ndër-tim njohurish</b>		
Hapi i tretë	Mësuesi paraqet shkronjë <b>p</b> , e shqipton dhe kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë.  Mësuesi shkruan <b>P</b> në tabelë dhe kërkon që nxënësit ta shkruajnë në tabelat plastike ose në formate letre.	Nxënësit shqiptojnë <b>P</b> dhe më pas e vizatojnë në ajër, duke ndjekur lëvizjen e mësuesit.  Nxënësit shkruajnë <b>P</b> në tabelë ose në formate letre dhe më pas në Abetaren e Punës.
Hapi pestë	Nxënësit plotësojnë shkronjën te fjalët ku mungon dhe më pas lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale	Nxënësit plotësojnë shkronjën <b>P</b> te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës dhe më pas shkruajnë edhe fjalët globale.
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat e perimeve në Abetaren e Punës.	Nxënësit ngjyrosin perimet.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore <b>P</b> . Plotësojnë <b>P</b> atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
	Kërkon që nxënësit të vërejnë pamjen në Abetares së Punës dhe flasin për parkun e lojërave.	Nxënësit flasin për parkun e lojërave.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me <b>P</b> .	Dy rreshta me <b>P</b> dhe dy të tjera me fjalët globale.

## 18. TINGULLI DHE SHKRONJA NJ

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat <b>NJ</b>  Numrat	Të shqiptojë tingujt <b>NJ</b> . Të shkruajnë grafikën e <b>NJ</b> . Të komentojnë figurën në librin e Abetares, duke folur për numrat. Të lexojë globalisht fjalët. Të ngjyrosë figura dhe elemente shkrimi që lidhen me shkronjën <b>NJ</b> .	Punë në dyshe, Bashkëbisedim.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të menduarit	Teksti, lapsa, fletore, Materiale, vizatimi, CD, figura, shkronja

### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	Punime dore/formim objektivësh me volum	
Hapi 1	Mësuesi kërkon që nxënësit të bëjnë me plastelinë një njësh dhe më pas shpallin njëshin më të bukur.	Nxënësit bëjnë me plastelinë një njësh dhe më pas bëjnë një ekspozitë. Vendosin së bashku se cili është njëshi më i bukur.
Hyrja	Diagrami i Venit	

Hapi i dytë	Mësuesi shqipton disa fjalë dhe kërkon që nxënësit të thonë se çfarë kanë të përbashkët: 1, 100, 1000, 11, njolla, njeriu, njeh, njofton. E shkruar me ngjyrë të kuqe dallohet shkronja NJ.	Nxënësit dallojnë se në grupin e fjalëve që lexon mësuesi, e përbashkëta është tingulli NJ.  Nxënësit dallojnë shkronjën NJ.
Ndërtim njo- hurish Hapi i tretë	Mësuesi paraqet shkronjën Nj të shkruar në dërrasë ose në fletë të mëdha dhe e shqipton. Kërkon që edhe nxënësit ta shqiptojnë. Më pas e vizaton në ajër dhe në dërrasë.	Nxënësit shqiptojnë nj dhe më pas e vizatojnë në ajër, duke ndjekur lëvizjen e mësuesit.  Nxënësit shkruajnë nj në tabelë apo në formate letre, më pas në fletoren e punës dhe në fund në Abetaren e Punës.
Hapi pestë	Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë shkronjën nj te fjalët ku mungon dhe më pas të lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale.	Nxënësit plotësojnë shkronjën nj te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës dhe më pas shkruajnë edhe fjalët globale.
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin njëshat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin njëshat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore NJ. Plotësojnë Nj atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me NJ.	Dy rreshta me NJ dhe me fjalët globale.

## 19. TINGULLI DHE SHKRONJA O

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	NdërthuRja	Shprehi që zhvillohen	Burime
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjat O.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat O.</li> <li>Të dallojë shkronjat O në trup të fjalëve të ndryshme, si: ora, motori, torta, teta, topi, treni, tiktak etj.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat O dhe që lidhen me temën e lojërave.</li> </ul>	Punë në dyshe, Bashkëbisedim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imajjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat o të shoqëruara me emërtimet përkatëse; Kasetë me këngën "Tring zilja"; Vjersha "Ora".

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	<b>Rrjet diskutimi</b>	<b>Punë në grupe</b>
Hapi 1	<p>Mësuesi ka futur në kutinë e fshehtë disa ora dhe disa lodra robotësh.</p> <p>Mësuesi i ndan në dy grupe sipas pëlqimit: grupi që pëlqen orët dhe grupi i robotit.</p> <p>Organizohet një rrjet diskutimi: Çfarë pëlqen po, jo, pse?</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë objektet sipas disa cilësive të veçanta të tyre, si: <i>vjetërsia, bukuria, tik-taku që bëjnë, lartësia që kërcen (topi) etj.</i></p>	<p>Nxënësit i prekin dhe ndahen në dy grupe sipas pëlqimit.</p> <p>Nxënësit e ndarë në grupe diskutojnë dhe argumentojnë përse u pëlqen njëra apo tjetra (ora/roboti).</p> <p>Nxënësit do të ndahen në dy grupe. Në njërin grup do të mblidhen nxënësit që kanë sjellë <i>ora</i> dhe në grupin tjetër nxënësit që kanë sjellë <i>topa</i>.</p> <p>Nxënësit do të bëjnë përshkrimin e orës dhe të topit që kanë sjellë, duke përshkruar diçka të veçantë të tyre, si: <i>vjetërsia, bukuria, tik-taku që bëjnë, lartësia që kërcen (topi) etj.</i></p> <p>Nxënësit do të votojnë për orën dhe topin që u pëlqen më tepër.</p>



Hyrja	Vëzhgim /demonstrim	
Hapi i dytë	Mësuesi paraqet fjalën ora dhe roboti dhe kërkon që nxënësit të dallojnë se çfarë kanë të përbashkët.  Mësuesi me nxënësit shqiptojnë shkronjën o disa herë  Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë fjalë që kanë në trup të tyre shkronjën O.	Nxënësit gjejnë shkronjën O  Nxënësit shqiptojnë bashkë me më-suesin.  Nxënësit thonë fjalë që përmbajnë shkronjën o.
<b>Ndërtim njohurish</b>		
Hapi i tretë	Mësuesi paraqet shkronjën O të shkruar në dërrasë apo në fletë të mëdha dhe e shqipton.  Kërkon që edhe nxënësit ta shqiptojnë.  Më pas, e vizaton në ajër dhe në dë-rrasë.	Nxënësit shqiptojnë o dhe më pas e vizatojnë në ajër, duke ndjekur lëvizjen e mësuesit.  Nxënësit shkruajnë O në tabelë apo në formate letre.  Më pas në Abetaren e Punës.
Hapi pestë	Mësuesi kërkon që nxënësit plotësojnë shkronjën O te fjalët ku mungon dhe më pas lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale.	Nxënësit plotësojnë shkronjën O te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës dhe më pas shkruajnë edhe fjalët globale.
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin rrrathët në Abetaren e Punës.	Nxënësit ngjyrosin rrrathët në Abetaren e Punës.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore O.  Plotësojnë o atje ku mungon në fjalë.  Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me O.	Dy rreshta me O dhe me fjalët globale.

## TEST 1

EMRI 1. Qarko

A U O: A fig. ANANAS

U fig. UJKU

O fig. ROBOTI

### 2. PLOTËSO

FIG	FIG	FIG	FIG
<input type="text"/> R <input type="text"/> I <input type="text"/> U	<input type="text"/> R <input type="text"/> <input type="text"/> B <input type="text"/> <input type="text"/> T <input type="text"/> I	<input type="text"/> <input type="text"/> L <input type="text"/> <input type="text"/> F <input type="text"/> A <input type="text"/> N <input type="text"/> T <input type="text"/> I	<input type="text"/> <input type="text"/> I <input type="text"/> U

## 4. SHKRUAJ.

A
M
P
K

## 20. TINGULLI DHE SHKRONJA Q

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	NdërthuRja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjën Q  QYTETI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjën Q.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat Q.</li> <li>Të dallojë shkronjën Q në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjën Q dhe që lidhen me temën e qytetit.</li> </ul>	Punë në dyshe,  Bashkëbisedim.	Të folurit,  Të shkruarit  Art/vizatim,  muzikë,  Matematikë.	Të lexuarit global,  Të folurit,  Imagjinata,  Të dëgjuarit.	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat Q të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?															
Motivimi	Lojë-enigmë/gjëegjëza																
Hapi i parë	<p>Mësuesi bën pyetje, nxënësit duhet të gjejnë objektin:</p> <table border="1"> <tr> <td>Është kafshë</td> <td>Jetojmë së bashku.</td> <td>Ngado që të shkosh del</td> </tr> <tr> <td>Ka veshë të gjatë</td> <td>Ka shumë pal-late.</td> <td>Përsëri në të njëjtin vend.</td> </tr> <tr> <td>Luajmë me të</td> <td>Ka shumë parqe.</td> <td>Është e kuqe.</td> </tr> <tr> <td>Jeton edhe brenda,</td> <td>Ka shumë lulishte.</td> <td>Është rrumbullake.</td> </tr> <tr> <td>edhe jashtë</td> <td>Ka shumë makina.</td> <td>Është e ëmbël.</td> </tr> </table>	Është kafshë	Jetojmë së bashku.	Ngado që të shkosh del	Ka veshë të gjatë	Ka shumë pal-late.	Përsëri në të njëjtin vend.	Luajmë me të	Ka shumë parqe.	Është e kuqe.	Jeton edhe brenda,	Ka shumë lulishte.	Është rrumbullake.	edhe jashtë	Ka shumë makina.	Është e ëmbël.	Nxënësit në bazë të përshkrimit të mësuesi gjejnë emrat: qeni, qyteti, qendra, qershia etj.
Është kafshë	Jetojmë së bashku.	Ngado që të shkosh del															
Ka veshë të gjatë	Ka shumë pal-late.	Përsëri në të njëjtin vend.															
Luajmë me të	Ka shumë parqe.	Është e kuqe.															
Jeton edhe brenda,	Ka shumë lulishte.	Është rrumbullake.															
edhe jashtë	Ka shumë makina.	Është e ëmbël.															

<b>Hyrja</b>	<b>Ushtrime fonetike</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi paraqet me foto e me fjalë <b>qeni, qyteti, qendra</b> .  Mësuesi me nxënësit shqiptojnë shkronjën Q disa herë. Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë fjalë që kanë në trup të tyre shkronjën Q.	Nxënësit gjejnë shkronjën Q.  Nxënësit shqiptojnë bashkë me mësuesin.  Nxënësit thonë fjalë që përmbajnë shkronjën Q.
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Demonstrim</b>	<b>Ushtrime manipuluese</b>
Hapi i tretë	Mësuesi paraqet shkronjën <b>q</b> të shkruar në dërrasë apo në fletë të mëdha dhe e shqipton.  Kërkon që edhe nxënësit ta shqiptojnë. Më pas, e vizaton në ajër dhe në dërrasë.	Nxënësit shqiptojnë <b>q</b> dhe më pas e vizatojnë në ajër duke ndjekur lëvizjen e mësuesit.  Nxënësit shkruajnë një në tabelë apo në formate letre, më pas në Abetaren e Punës.
Hapi pestë	Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë shkronjën Q te fjalët ku mungon dhe më pas lexojnë dhe shkruajnë edhe fjalët globale.	Nxënësit plotësojnë shkronjën Q te fjalët e fjalorit të Abetares së Punës dhe më pas shkruajnë edhe fjalët globale.
Përforcim	Vizatim/shkrim global	
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin figurat e faqes përkatëse të Abetares së Punës.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore Q. Plotësojnë <b>nj</b> atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me Q.	Dy rreshta me Q dhe dy të tjerë me fjalët globale.

## 21. TINGULLI DHE SHKRONJA R, RR

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehje që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat R, RR  NË RRUGË	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjat R, RR.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat R, RR.</li> <li>Të dallojë shkronjat R, RR në trup të fjalëve.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat R, RR dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Punë në dyshe Bashkëbisedim	Të folurit Të shkruarit Art/vizatim, muzikë, Matematikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes.	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat R, RR të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Mjetet	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	<b>Rrjet diskutimi</b>		
Hapi i parë	Mësuesi u thotë nxënësve të dëgjojnë me vëmendje disa zhurma që ajo i ka incizuar në rrugë: bori makinash, frena, zëra, alarm policie, bilbili etj. Nxënësit duhet të gjejnë se ku është ky vend në të cilin dëgjohej kaq zhurma. Ai kërkon që nxënësit të flasin për zhurmat e qytetit për atë që u pëlqen dhe atë që nuk u pëlqen.		Nxënësit gjejnë se ku bëhen këto zhurma.  Nxënësit diskutojnë në lidhje me temën.
<b>Hyrja</b>	Demonstrim		
Hapi i dytë	Mësuesi u paraqet disa figura me emrat poshtë tyre, disa me një <b>R</b> dhe disa me dy <b>RR</b> . <i>Roboti, rërë, ariu</i> <i>Rripi, rruga, rrota</i> Kërkon që nxënësit të shqiptojnë më parë fjalët që janë më <b>R</b> të butë dhe më pas fjalët që janë më <b>RR</b> të fortë.		Nxënësit shqiptojnë fjalët sipas udhëzimeve.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Demonstrim pune, në grupe		
Hapi i tretë	Mësuesi i ndan fjalët në dy grupe në fjalë me <b>R</b> të butë dhe me <b>RR</b> të fortë. Kërkon nga nxënësit të ndarë në grupe dyshe të thonë fjalë me <b>RR</b> dhe të gjejnë nëse fjala është me <b>RR</b> të fortë apo me <b>R</b> të butë.		Nxënësit shqiptojnë fjalët dhe ndahen në grupe sipas fjalëve që kanë thënë: në njërin anë, ata që kanë thënë fjalë me <b>R</b> të butë dhe, në anën tjetër, grupi që ka thënë fjalë me <b>RR</b> të fortë.
Hapi i pestë	Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë në dy grupe fjalët që kanë <b>R</b> dhe <b>RR</b> Më pas shqipton <b>r</b> dhe <b>rr</b> dhe krahas tyre vendos shkronjat përkatës Vizaton në ajër <b>R</b> dhe <b>RR</b> . Kërkon të plotësojnë <b>R</b> dhe <b>RR</b> në fjalët që iu mungon në Abetaren e Punës. Kërkon të shkruajnë fjalët globale sipas shkronjave <b>R, RR</b> .		Nxënësit shqiptojnë dhe shkruajnë në ajër shkronjën <b>R</b> dhe <b>RR</b> .  Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin <b>r</b> dhe <b>rr</b> . Shkruajnë rreshta me <b>R RR</b> në Abetaren e Punës.  Nxënësit plotësojnë <b>r</b> dhe <b>rr</b> në fjalët e dhëna në libër në faqen përkatëse. Nxënësit shkruajnë fjalët globale.
<b>Përforcim</b>			
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.		Nxënësit ngjyrosin në faqen në faqen përkatëse të makinat në kryqëzim të qytetit.

Hapi i shtatë	Nxënësit shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.		Shkruajnë në fletore <b>R, RR</b> . Plotësojnë <b>R, RR</b> , atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
DETYRË	Të shkruajnë dy rreshta me <b>R, RR</b> .		Dy rreshta me <b>R, RR</b> dhe me fjalët globale.

## 22. TINGUJT DHE SHKRONJAT S, SH

	Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime	
	Tingulli dhe shkronjat <b>S, SH</b>  SEMAFORI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjat S, SH.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat S, SH.</li> <li>Të shkruajë dhe dallojë shkronjat S, SH në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje që përmbajnë shkronjat S, SH dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Punë në dyshe, Bashkëbisedim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit.	Objekte ose figura objektësh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat <b>s, sh</b> të shoqëruara me emërtimet përkatëse.	

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	<b>Loja e semaforit: Lojë në role</b>	
Hapi i parë	Nxënësit bëjnë një semafor me kuti kartoni. Në mes të klasës rri një nxënës, i cili ka hyrë në një kuti të bërë si semafor dhe mban në duar tre shirita me ngjyrë të kuqe, të gjelbër dhe të portokalli. Luhet roli i semaforit, klasa kthehet në një rrugë. Në mes të klasës rri një semafor nxënës ose mësues me komanda <b>kalo</b> .	Nxënësit lëvizin sipas komandave që jep nxënësi semafor në klasë. Loja vazhdon për pak minuta.
Hyrja	<b>Lojë në role/demonstrim</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi paraqet dy nxënës, të cilët mbajnë dy shkronja në dorë, njëra <b>S</b> dhe tjetra <b>H</b> , dhe thotë: “Kjo është shkronja <b>S</b> ”. Por po t’i bashkojmë e t’i lidhim përdore me <b>h</b> na del shkronja <b>SH</b> . Pra, sot do të mësojmë për <b>S</b> dhe për <b>SH</b> . Thoni tani dhe mendoni një fjalë që ka tingullin <b>S, SH</b> .	Nxënësit thonë fjalë që kanë në trup të tyre tingullin <b>S</b> .  Më pas thonë fjalë që kanë tingullin <b>SH</b> .
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Demonstrim</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi paraqet fotot dhe fjalët përkatëse në bashkësi: Bashkësia <b>a</b> , fjalë dhe foto që kanë <b>S</b> . Bashkësia <b>b</b> , fjalë dhe foto që kanë <b>SH</b> . Kërkon që nxënësit të shqiptojnë fjalët me <b>S</b> , më pas me <b>SH</b> .	Nxënësit shqiptojnë fjalët e të dyja grupeve që ka nxjerrë mësuesi

Hapi katërt	Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë dy shkronjat s dhe sh. Vizaton në ajër s dhe Sh. Kërkon të plotësojnë s dhe sh në fjalët që u mungon në Abetaren e Punës. Kërkon të shkruajnë fjalë globale sipas shkronjave S, SH.	Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin s dhe sh. Shkruajnë me S, SH rreshtat në Abetaren e Punës. Nxënësit plotësojnë s dhe sh në fjalët e Abetares së Punës në faqen përkatëse. Nxënësit shkruajnë fjalët globale.
<b>Përforsim</b>	Vizatim/ushtrime manipuluese	
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin njëshat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin në faqen përkatëse makinat në kryqëzim të qytetit.
Hapi i shtatë	Udhëzon të shkruajnë shkronjat, të plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore S, SH. Plotësojnë S, SH atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
Detyrë	Udhëzon të shkruajnë dy rreshta me S, Sh dhe fjalë globale.	Shkruajnë dy rreshta me S, SH dhe me fjalët globale.

## 23. TINGULLI DHE SHKRONJA T

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika		Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja T  <i>Mjetet e transportit</i>	Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjat T. Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat T. Të dallojë shkronjat T në trup të fjalëve të ndryshme. Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat T dhe që lidhen me temën.	Lojë në role, punë në grupe, bashkëbisedim, vizatim, imitim	Të folurit, Të shkruarit, Art/ vizatim, muzikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes.		Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat t, të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	Tregojmë histori, imitojmë zhurma, lojë në role	
Hapi i parë	Mësuesi paraqit në dërrasë disa foto: helikopter, traget, traktor, tren. Kërkon nga nxënësit që secili të zgjedhë njërin prej tyre dhe të thotë një histori rreth mjetit që ka zgjedhur. Mësuesi kërkon që nxënësit të imitojnë zhurmën e secilit mjet. Mësuesi pyet: «Çfarë kanë të përbashkët këto mjete? Përse na shërbejnë?»	Nxënësit zgjedhin mjetin dhe për disa minuta mendohen. Më pas, tregojnë një ngjarje, mbresa ose dëshira. Nxënësit imitojnë brenda mundësive zhurmën e ndryshme. Nxënësit përgjigjen T.
Hyrja	Demonstrim	

Hapi i dytë	Mësuesi, së bashku me fotot e mjeteve të mësipërme, shfaq edhe emrat përkatës, ku shkronja T është me ngjyrë të njëjtë të të gjithë emrat. Pyet se çfarë kanë të përbashkët. Mësuesi shqipton tingullin T dhe kërkon që edhe nxënësit ta shqiptojnë.	Nxënësit gjejnë shkronjën T. Nxënësit shqiptojnë T.
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Punë në grupe dyshe/demonstrim</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi nxjerr edhe foto të tjera, emrat e të cilave kanë T. I shqiptojnë së bashku me nxënësit të ndara në rrokje, të cilat i shoqëron më lëvizjet e duarve majtas-djathtas. Ti-ra-na, tre-ni, ta-vo-li-na pa-ta-te etj.  Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe, duke gjetur dhe shqiptuar fjalë që kanë T.	Nxënësit shqiptojnë emrat e fotove dhe duke i ndarë në rrokje, me duar gjejnë se në cilin pozicion qëndron T te këto fjalë. Nxënësit shqiptojnë fjalë të ndryshme duke imituar mësuesen. Nxënësit në grupe dyshe shqiptojnë fjalë që përmbajnë T.
Hapi katërt	Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë dy shkronjat T. Vizaton në ajër T dhe kërkon të plotësojnë T në fjalët që u mungon në Abetaren e Punës. Kërkon të shkruajnë fjalë globale me T.	Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin T Shkruajnë tre rreshta në Abetaren e Punës. Nxënësit plotësojnë në fjalët e dhëna në libër. Nxënësit shkruajnë fjalët globale.
<b>Përforcim</b>	<b>Vizatim/ shkrim global</b>	
Hapi i pestë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin në faqet përkatëse elementet e shkrimit ovale dhe ngjyrosin topin.
Hapi i gjashtë	Shkruajnë shkronjat plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale .	Shkruajnë në fletore T. Plotësojnë t kur mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës: topi dhe treni.
DETYRË	Të shkruajnë dy rreshta me T dhe dy me fjalë globale.	Dy rreshta me T dhe dy me fjalë globale.

## 24. TINGULLI DHE SHKRONJA Th

Tema	Objektiva	Teknika strategji	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja Th	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjën Th.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat Th.</li> <li>Të dallojë tingulli/shkronjat Th në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat Th dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Lojë në role, punë në grupe, bashkëbisedim, vizatim, imitim	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes.	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat TH të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	<b>Recitim dhe imitim/ dramatizim me figura të ngrira</b>	
Hapi i parë	Mësuesi lexon vjershën: “Thuthuqi” dhe kërkon që nxënësit të shprehën se çfarë ndiejnë pasi kanë dëgjuar vjershën. Mësuesi pyet: “Pse ju bën të qeshni kjo vjershë?” Cila është fjala që ju pëlqen më shumë në këtë vjershë? Ai kërkon që nxënësit ta dramatizojnë ose ta luajnë në role vjershën me figura të ngrira. Ua lexon edhe njëherë vjershën. Një nxënës që mban në trup etiketën e thuthuqit dhe të tjerët përreth e tallin; prindërit në sfond disi të turpëruar. Mësuesi bën një skenar të vogël dhe ndan rolet.	Nxënësit shprehën rreth sjelljes së thuthuqit.  Nxënësit përgjigjen: “...sepse fëmijët që shtrembërojnë fjalët dhe e flasin keq gjuhën të bëjnë për të qeshur”. Fjala <b>thuthuq</b> Pasi kanë dëgjuar disa herë vjershën e thuthuqit (nga mësuesi), nxënësit dramatizojnë finalen e vjershës sipas roleve.
Hyrja	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi ndal te fjala <b>thuthuq</b> e shkruar në një etiketë, që e ka një nxënës në gjoks dhe veçon prej saj shkronjën <b>TH</b> të shkruar me ngjyrë tjetër. E prezanton e shqipton dhe kërkon që edhe nxënësit ta shqiptojnë. Tregohet e vëmendshme që nëse ka ndonjë nxënës që e shqipton keq, ta ndihmon që ta shqiptojë drejt. Me ndihmën e një lapsi që e vendos horizontalisht mes buzëve dhe dhëmbëve të nxënësit që ka problem, ai mund ta kapërcejë problemin e shqiptimit. Këtë ushtrim, mësuesi mund ta ushtrojë edhe për tinguj të tjerë të shqipes, të cilët te disa nxënës nga përkëdhelia, ose nga ndonjë problem i thjeshtë dislektik, i shqiptojnë gabim.	Nxënësit shqiptojnë shkronjën <b>TH</b> . Nxënësit me probleme ushtrohen në mënyrë të veçantë për ndreqjen e defektit.
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Punë në grupe, ushtrime manipuluese</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi nxjerr edhe foto të tjera, ku ka tingull/shkronjë th, si: thesi, thika, thoi, thupra etj. Kërkon që edhe nxënësit të thonë fjalë që kanë th në trup të tyre. I shqiptojnë bashkë me nxënësit të ndara në rrokje, të cilat i shoqëron më lëvizjet e duarve majtas djathtas:Tha-të-si-rë, thate, the-llë-si. Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe, duke gjetur dhe shqiptuar fjalë që kanë <b>TH</b> .	Nxënësit shqiptojnë emrat e fotove duke i ndarë në rrokje. Me duar gjejnë se në cilin pozicion qëndron te këto fjalë th-ja. Nxënësit shqiptojnë fjalë të ndryshme, duke imituar mësuesen. Nxënësit në grupe dyshe shqiptojnë fjalë që përmbajnë <b>th</b> .
Hapi pestë	Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë shkronjën <b>TH</b> . Vizaton në ajër <b>TH</b> dhe kërkon të plotësojnë <b>TH</b> në fjalët ku mungon në Abetaren e Punës. Kërkon të shkruajnë fjalët globale me <b>th</b> .	Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin <b>TH</b> . Shkruajnë <b>th</b> në Abetaren e Punës. Nxënësit plotësojnë <b>th</b> në Abetaren e Punës. Nxënësit shkruajnë fjalët globale.
<b>Përforsim</b>		



Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin në faqen përkatëse elementet ovale të shkrimit dhe ngjyrosin thesin.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore TH. Plotësojnë th kur mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët në Abetaren e Punës: thesi, thika.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me th.	Dy rreshta me TH dhe dy me fjalët globale.

## 25. TINGULLI DHE SHKRONJA X

Tema	Objektiva	Teknika strategji	Ndërthurja	Shprehje që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronjat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjat X.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat X.</li> <li>Të dallojë shkronjat X në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat X dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	lojë-enigmë, punë në grupe, bashkëbisedim, vizatim.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat X të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	<b>Bashkëbisedim/Punë në grupe dyshe/Lojë bingo</b>	
Hapi i parë	Mësuesi u thotë fëmijëve se ka në mend emrat e dy gjërave: njëra është si një mizë që fluturon, por ka një cilësi të veçantë, ndërsa tjetra është një fjalë që tregon se si është. Kërkon që nxënësit ta gjejnë se për çfarë bëhet fjalë. Nxënësit kanë të drejtë të pyesin deri në pesë herë (alternativa). Kur gjendet fjala, mësuesi shpall fituesit e lojës bingo.	Nxënësit mendohen, bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin dhe pyesin mësuesin përmes alternativave që u ka lejuar.
<b>Hyrja</b> Hapi i dytë	Pasi nxënësit kanë gjetur emrin e xixëllonjës, mësuesi shfaq figurën ose foton e xixëllonjës dhe fjalën: emrin e saj nën foto. Mësuesi kërkon që nxënësit ta shqiptojnë së bashku me të emrin e xixëllonjës dhe të thonë se çfarë vënë re kur e shqiptojnë në rrokje xi-xë-llo-nja, sa herë e dëgjojnë tingullin x. Mësuesi paraqet tingullin x dhe u thotë nxënësve që ta shqiptojnë atë disa herë, nën udhëheqjen e tij. Ai pyet: “Çfarë bën xixëllonja?” Pyet çfarë e bashkon fjalën xixëllonja me fjalën xixëllon (paraqet të dyja etiketat dhe nxënësit duhet të dallojnë x e shkruar dy herë në të dyja etiketat.	Nxënësit përgjigjen duke dalluar se e dëgjojnë dy herë tingullin x. Nxënësit shqiptojnë tingullin x disa herë. Nxënësit përgjigjen: <i>xixëllon</i> . Nxënësit dallojnë x e shkruar dy herë në të dyja fjalët.

Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish	Demonstrim/Punë në grupe dyshe	
Hapi i tretë	Mësuesi nxjerr edhe fotot të tjera emrat e të cilave kanë <b>x</b> . Tregon si formohet: kryqëzon duart, merr dy lapsa dhe i kryqëzon: <i>nxënës, lexon, nxiton, nxin</i> . Kërkon që edhe nxënësit të thonë fjalë që kanë <b>x</b> në trup të tyre. I shqiptojnë bashkë me nxënësit të ndara në rrokje dhe i shoqëron me lëvizjet e duarve majtas–djathtas. Nxë-nës, le-xon, nxi-ton etj. Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe, duke gjetur dhe shqiptuar fjalë që kanë <b>x</b> .	Nxënësit e shkruajnë/vizatojnë në tabelën plastike apo në fletë letre në përmasa të mëdha. Kërkon që nxënësit të shqiptojnë fjalët që thotë mësuesi ose të lexojnë figurat. Nxënësit thonë fjalë të tjera që kanë tingullin <b>X</b> në trup të tyre. Nxënësit shqiptojnë fjalë që kanë <b>x</b> në trup të tyre të ndara në rrokje, duke dalluar pozicionin që kanë.
Hapi pestë	Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë dy shkronjat <b>X</b> . Vizaton në ajër <b>x</b> dhe kërkon të plotësojnë <b>X</b> në Abetaren e Punës. Kërkon të shkruajnë fjalët globale sipas shkronjave <b>X</b> .	Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin <b>X</b> . Shkruajnë <b>X</b> në rreshtat në Abetaren e Punës. Nxënësit plotësojnë <b>x</b> në Abetaren e Punës. Nxënësit shkruajnë fjalët globale.
<b>Përforsim</b>	<b>Punë e pavarur vizatim/shkrim global</b>	
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin në faqen përkatëse, elementet ovale të shkrimit dhe ngjyrosin figurën në faqen përkatëse.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore <b>X</b> . E plotësojnë atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët në Abetaren e Punës: xixa, xixëllonja.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me <b>X</b> dhe dy të tjerë me fjalë globale.	Dy rreshta me <b>X</b> dhe dy të tjerë me fjalët globale.

## 26. TINGULLI DHE SHKRONJA Xh


Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja Xh	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë, të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjën <b>Xh</b>.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjën <b>Xh</b>.</li> <li>Të dallojë shkronjën <b>Xh</b> në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat <b>Xh</b> dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Dramatizim me figura të ngrira, punë në grupe, bashkëbisedim, vizatim, punë e pavarur.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, dramë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit.	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat <b>XH</b> të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

## ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Motivimi	<b>Dramatizim përralle</b>	
Hapi i parë	<p>Mësuesi u thotë nxënësve se do të tregojë një përrallë dhe më pas nxënësit do të luajnë në role të ndarë në grupe.</p> <p>Mësuesi tregon përrallën e xhuxhmaxhuxhëve. Kërkon që ta tregojnë 1-2 nxënës.</p> <p>Mësuesi kërkon që 1-2 nxënës të ritregojnë vetëm pjesën e fundit, mënyrën si mbyllet përralla.</p> <p>Mësuesi e ndan klasën në grupe me nga 4 nxënës, njëri do të jetë princi, njëra borëbardha dhe dy të tjerë do të imitojnë kalin, ndërsa të tjerët, xhuxhmaxhuxhët, rrinë përreth tyre.</p> <p>Të katër së bashku do të krijojnë figurën e fundit të përrallës: borëbardha mbi kalë dhe princi duke shoqëruar princat përreth.</p> <p>Çdo grup do të jetë me nga 10-11 nxënës.</p> <p>Mësuesi kërkon të shpallet grupi fitues nga nxënësit, të cilët vlerësojnë interpretimet e tyre.</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë përrallën ose e shohin në monitor nëse krijohet mundësia.</p> <p>1-2 nxënës e tregojnë përsëri përrallën.</p> <p>1-2 nxënës tregojnë mbylljen e përrallës.</p> <p>Nxënësit të ndarë në grupe interpretojnë njëri pas tjetrit përfundimin e borëbardhës me shtatë xhuxhmaxhuxhët.</p> <p>Nxënësi pasi kanë bërë interpretimet vlerësojnë grupin që e interpretoi më mirë.</p>
Hyrja	Demonstrim	
Hapi i dytë	<p>Pasi nxënësit kanë përfunduar interpretimet, mësuesi mban pranë vetes xhuxhmaxhuxhët.</p> <p>Më pas kërkon që nxënësit ta shqiptojnë emrin xhuxhmaxhuxh 2-3 herë.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit ta shqiptojnë bashkë me të emrin e xhuxhmaxhuxhit dhe të thonë se çfarë vënë re kur e shqiptojnë në rrokje <b>xhuxh-ma xhu-xhët</b> sa herë e dëgjojnë tingullin <b>xh</b> në këtë fjalë.</p> <p>Mësuesi paraqet shkronjën <b>Xh</b> dhe u thotë nxënësve që ta shqiptojnë atë disa herë nën drejtimin e saj.</p>	<p>Nxënësit shqiptojnë emrin <b>xhuxhmaxhuxh</b>.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë tingullin <b>x</b> disa herë.</p> <p>Nxënësit përgjigjen <b>xhuxh-ma-xhu-xhët</b>.</p> <p>Nxënësit dallojnë <b>XH</b>.</p>
Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish	<b>Punë në grupe dyshe/demonstrim</b>	
Hapi i tretë	<p>Mësuesi nxjerr edhe foto të tjera emrat, e të cilave kanë <b>xh</b>: <i>xhami, xhupi, xhaketa, valixhe</i>.</p> <p>Kërkon që edhe nxënësit të thonë fjalë që kanë në trup të tyre <b>xh</b>.</p> <p>I shqipton bashkë me nxënësit të ndara në rrokje dhe i shoqëron me lëvizjet e duarve majtas-djathtas: <i>xha-ke-ta, va-li-xhe</i>.</p> <p>Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe, për të gjetur dhe shqiptuar fjalë që kanë <b>XH</b>.</p>	<p>Nxënësit e shkruajnë/vizatojnë <b>XH</b> në tabelën plastike ose në fletë letre në përmasa të mëdha.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë fjalët që thotë mësuesi ose lexojnë figurat.</p> <p>Nxënësit përmendin fjalë të tjera që kanë tingullin <b>Xh</b> në trup të tyre.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë fjalë që kanë <b>xh</b> në trup të tyre të ndara në rrokje, duke dalluar pozicionin që kanë.</p>
Hapi i katërt	<p>Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë shkronjën <b>Xh</b>.</p> <p>Vizaton në ajër <b>xh</b> dhe kërkon të plotësojnë <b>Xh</b> në fjalët që u mungon në Abetaren e Punës.</p> <p>Kërkon të shkruajnë fjalë globale sipas shkronjës <b>Xh</b>.</p>	<p>Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin <b>Xh</b>.</p> <p>Shkruajnë <b>Xh</b> në rreshtat në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit plotësojnë <b>xh</b> në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit shkruajnë fjalët globale.</p>

Përforcim	Vizatim	
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin në faqen përkatëse elementet ovale të shkrimit dhe ngjyrosin figurën qendrore, <i>xhuxhët</i> dhe xhupat në krye të faqes.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore <b>Xh</b> dhe e plotësojnë kur mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët në Abetaren e Punës: xixa, xixëllonja.
DETYRË	Të shkruajnë dy rreshta me <b>Xh</b> . Të gjejnë në gazeta dhe të qarkojnë fjalë që kanë në trup të tyre shkronjën <b>Xh</b> .	Dy rreshta me <b>Xh</b> dhe dy të tjerë me fjalët globale dhe qarkim fjalësh me <b>Xh</b> në gazeta.

## 27. TINGULLI DHE SHKRONJA Z

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehja që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja Z 	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjën Z.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat Z.</li> <li>Të dallojë shkronjat Z në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat Z dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Lojë-enigmë, punë në grupe, bashkëbisedim, vizatim.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Të lexuarit global, Të folurit, imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes.	Objekte ose figura objektësh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat Z të shoqëruara me emërtimet përkatëse.


### Zhvillimi i mësimit

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	Lojë-enigmë, bashkëbisedim, punë në grupe dyshe, vizatim	
Hapi i parë	<p>Mësuesi u thotë fëmijëve se ka në mend një emër. Ai do ta përshkruajë. Nxënësit do ta vizatojnë. Kush e vizaton më bukur shpallet piktori më i mirë i klasës.</p> <p>Të gjithë e kemi një të tillë. Është e kuqe. Është e rrumbullakët. Çdo ditë e dëgjojmë këtë fjalë. Për të këndohet, thuhet fjalë të bukura; vizatohet.</p> <p>Në momentin kur një nxënës e gjen i pari duartrokitet. Kush di ndonjë këngë për nënën edhe e këndon? Më pas, nxënësit lihen ta vizatojnë zemrën.</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë me vëmendje.</p> <p>Nxënësit mund të bëjnë edhe ndonjë pyetje për të saktësuar mendimet.</p> <p>Pasi kanë gjetur enigmën, nxënësit vizatojnë zemrën.</p>
Hyrja	Demonstrim	

Hapi i dytë	<p>Pasi nxënësit kanë gjetur emrin e zemrës, mësuesi shfaq figurën ose foton e zemrës me emrin nën foto. Mësuesi kërkon që nxënësit ta shqiptojnë bashkë me të emrin e zemrës.</p> <p>Mësuesi paraqet shkronjën Z dhe u thotë nxënësve që ta shqiptojnë atë disa herë nën udhëheqjen e tij.</p> <p>Mësuesi pyet: "Cilat janë shprehjet me fjalën zemër që ju pëlqejnë të përdorni?"</p> <p>Zemër, zemra e nënës. Mos u mërzi zemër, të dua zemër etj.</p>	<p>Nxënësit përgjigjen kur e dëgjojnë z.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë disa herë tingullin z.</p> <p>Nxënësit përgjigjen me shprehje që kanë fjalën zemër, të cilën e kanë dëgjuar nga më të rriturit.</p>
Ndërtim njohurish	<b>Punë në grupe dyshe/demonstrim</b>	
Hapi i tretë	<p>Mësuesi nxjerr edhe foto të tjera, emrat e të cilave kanë Z. Tregon se si formohet ajo dhe e vizaton në ajër; kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtin veprim.</p> <p>Mësuesi kërkon fjalë me Z zemër, zebër, vizatim, xhezve, zambak, zë, zakon etj.</p> <p>Kërkon që edhe nxënësit të thonë fjalë që kanë z në trup të tyre.</p> <p>I shqiptojnë bashkë me nxënësit të ndara në rrokje dhe i shoqëron më lëvizjet e duarve majtas-djathtas: ze-mër, vi-za-tim, xhe-zve.</p> <p>Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe për të gjetur dhe shqiptuar fjalë që kanë z.</p>	<p>Nxënësit vizatojnë në ajër siç vepron mësuesi. Nxënësit e shkruajnë/vizatojnë në tabelën plastike ose në fletë letre në përmasa të mëdha.</p> <p>Nxënësit thonë fjalë të tjera që kanë tingullin Z në trup të tyre.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë fjalë që kanë z në trup të tyre, të ndara në rrokje, duke dalluar pozicionin që ato kanë.</p> <p>Në grupe dyshe nxënësit thonë fjalë që kanë Z.</p>
Hapi i pestë	<p>Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë shkronjën Z.</p> <p>Vizaton në ajër x dhe kërkon që ta plotësojnë Z në vendet bosh në Abetaren e Punës.</p> <p>Kërkon të shkruajnë fjalë globale sipas shkronjave Z.</p> <p>Kërkon që nxënësit të gjejnë shkronjën Z në një faqe gazetash.</p>	<p>Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin Z.</p> <p>Shkruajnë Z në rreshtat në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit plotësojnë z në fjalët e librit në faqen përkatëse.</p> <p>Nxënësit shkruajnë fjalët globale në Abetaren e Punës.</p>
<b>Përforcim</b>	<b>Vizatim /shkrim global</b>	
Hapi i gjashtë	<p>Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në Abetaren e Punës.</p>	<p>Nxënësit ngjyrosin elementet ovale të shkrimit dhe ngjyrosin figurën në fillim të faqes.</p>
Hapi i shtatë	<p>Shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.</p>	<p>Shkruajnë në fletore.</p> <p>Plotësojnë z kur mungon në fjalë.</p> <p>Shkruajnë globalisht fjalët në Abetaren e Punës: zemra, zebra.</p>
DETYRË	<p>Të shkruajnë dy rreshta me Z.</p> <p>Në fletë reviste ose gazete të gjejnë 5 fjalë që kanë shkronjën Z.</p>	<p>Shkruajnë dy rreshta me z dhe dy të tjerë me fjalë globale.</p> <p>Në një faqe libri, gazete apo reviste gjejnë 5 fjalë që kanë shkronjën z në trup të tyre.</p>

## 28. TINGULLI DHE SHKRONJA V

### STRUKTURA E ORËS SË MËSIMIT

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehja që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja V  <i>Vrapojmë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjën V.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat V.</li> <li>Të dallojë shkronjat v në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat v dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Stuhi mendimi punë në grupe, bashkëbisedim, vizatim.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes.	Objekte ose figura objektsh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjën V të shoqëruara me emërtimet përkatëse.


### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi</b>	<b>Vizatim</b>	
Hapi 1	Mësuesi u thotë disa fjalë nxënësve dhe kërkon prej tyre të thonë se me çfarë lidhen ato: <i>vizatim vijë vizore, varkë, valë, vozit.</i> Mësuesi kërkon se çfarë kanë të përbashkët fjalët e mësipërme.	Nxënësit gjejnë se grupi i parë i fjalëve lidhen me vizatimin. Grupi i dytë lidhet me lëvizjen në det. Grupi i tretë lidhet me shkronjën V. Nxënësit dallojnë tingullin V.
<b>Hyrja</b>	<b>Demonstrim/dallim dhe veçim tingulli</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi paraqet disa foto dhe fjalët nën to. Duke i shqiptuar vetë kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë. Mësuesi kërkon që nxënësit të veçojnë tingullin që kanë të përbashkët.	Nxënësit shqiptojnë fjalët sipas përkatësisë së fotove. Nxënësit përgjigjen duke dalluar tingullin V. Nxënësit shqiptojnë tingullin z disa herë.
<b>Ndërtim njohurish</b>	<b>Punë në grupe dyshe</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi nxjerr edhe fotot të tjera, emrat e të cilave kanë v. I shqipton duke i ndarë me rrokje: vi- zo-re, ve-ra, va-po-ri. Tregon se si formohet V; e vizaton në ajër; kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtin veprim. Gjithashtu, nxënësit thonë fjalë që kanë V në trupin e tyre. I shqiptojnë bashkë me nxënësit të ndara në rrokje, të cilat i shoqëron me lëvizjet e duarve majtas-djathtas. Vazo, televizor etj. Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe, për të gjetur dhe shqiptuar fjalë që kanë V.	Nxënësit vizatojnë në ajër si mësuesi. Nxënësit e shkruajnë/vizatojnë në tabelën plastike apo në fletë letre në përmasa të mëdha.  Nxënësit thonë fjalë të tjera që kanë tingullin V në trup të tyre.  Nxënësit shqiptojnë fjalë që kanë V në trupin e tyre, të ndara në rrokje, duke dalluar pozicionin që kanë. Në grupe dyshe, nxënësit thonë fjalë që kanë V.

Hapi i pestë	Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë shkronjën V. Vizaton në ajër v dhe kërkon të plotësojnë V në fjalët që u mungon në Abetaren e Punës. Kërkon të shkruajnë fjalë globale sipas shkronjave V. Kërkon që nxënësit në një fletë gazete të gjejnë shkronjën V.	Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin V. Shkruajnë v në Abetaren e Punës. Nxënësit plotësojnë V në fjalët e Abetares së Punës. Nxënësit shkruajnë fjalët globale.
<b>Përforcim</b>	<b>Vizatim dhe shkrim global</b>	
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin figurat në faqen përkatëse të Abetares së Punës.	Nxënësit ngjyrosin të faqen përkatëse elementet e shkrimit ovale dhe ngjyrosin figurën në fillim të faqes.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore. Plotësojnë z atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës: zemra, zebra.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me V. Në fletë reviste ose gazete të gjejnë 5 fjalë që kanë V.	Shkruajnë dy rreshta me V dhe dy të tjerë me fjalë globale. Në një faqe libri, gazete ose reviste gjejnë 5 fjalë që kanë shkronjën V në trup të tyre.

## 29. TINGULLI DHE SHKRONJA Y

### STRUKTURA E ORËS SË MËSIMIT

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehja që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja Y  <i>Ylberi</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të shqiptojë e të shkruajë saktë</li> <li>shkronjën Y.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat Y.</li> <li>Të dallojë shkronjat Y në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat Y dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Lojë-enigmë, punë në grupe, bashkëbisedim, vizatim.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat Y të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

#### Zhvillimi i mësimi

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>MOTIVIMI</b>	<b>Gjëegjëza dhe vjersha për ylberin</b>	
Hapi i parë	Mësuesi thotë disa gjëegjëza për ylberin. Mësuesi kërkon që nxënësit të vizatojnë ylberin. Paraqet një foto para klasës.	Nxënësit gjejnë se për kë bëhet fjalë. Nxënësit vizatojnë ylberin.
<b>HYRJA</b>	<b>Demonstrim /dallim dhe veçim tingulli/artikulim saktë</b>	

Hapi i dytë	<p>Mësuesi paraqet disa foto: ylberi, ylli, pylli, dhe fjalët nën to. Duke i shqiptuar vetë kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtën gjë.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të veçojnë tingullin që kanë të përbashkët.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë disa fjalë në të cilat dëgjohet tingulli y.</p>	<p>Nxënësit shqiptojnë fjalët sipas përkatësisë së fotove.</p> <p>Nxënësit përgjigjen duke dalluar y-në.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë tingullin y disa herë.</p> <p>Nxënësit thonë fjalë që përmbajnë tingullin y.</p>
Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish	Punë në grupe dyshe	Qarkojnë Y në gazeta dhe revista, shkruajnë dy rreshta me Y dhe dy rreshta me fjalë globale.
Hapi i tretë	<p>Mësuesi nxjerr edhe foto të tjera, emrat e të cilave kanë Y. I shqipton emrat e tyre të plotë, më pas duke i ndarë me rrokje.</p> <p><i>Ylberi , ylli, zymbyli.</i></p> <p>I shqiptojnë bashkë me nxënësit të ndara në rrokje, të cilat i shoqëron më lëvizjet e duarve majtas djathtas.</p> <p>Tregon elementin e përbashkët në këto fjalë, që ndodhet në pozicione të ndryshme.</p> <p>Mësuesja tregon si formohet Y, e vizaton në ajër, kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtin veprim.</p> <p>Kërkon që edhe nxënësit të thonë fjalë që kanë y në trup të tyre.</p> <p>Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe, duke gjetur dhe shqiptuar fjalë që kanë Y.</p>	<p>Nxënësit shqiptojnë fjalët sipas mësueses duke e ndjekur atë.</p> <p>Nxënësit lexojnë globalisht fjalët e ndara në rrokje dhe dallojnë vendin ku ndodhet y në çdo fjalë.</p> <p>Nxënësit vizatojnë në ajër ashtu si mësuesi.</p> <p>Nxënësit e shkruajnë/vizatojnë në tabelën plastike ose në fletë letre në përmasa të mëdha.</p> <p>Në grupe dyshe, nxënësit thonë fjalë të tjera që kanë tingullin Y në trup të tyre.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë fjalë që kanë y në trup të tyre duke dalluar pozicionin që kanë.</p> <p>Në grupe dyshe, nxënësit thonë fjalë që kanë Y.</p>
Hapi i katërt	<p>Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë dy shkronjat Y.</p> <p>Vizaton në ajër y dhe kërkon të plotësojnë Y në fjalët në Abetaren e Punës ku kjo shkronjë mungon.</p> <p>Kërkon të shkruajnë fjalë globale sipas shkronjave Y.</p> <p>Kërkon që nxënësit në fletë gazete të gjejnë shkronjën Y.</p>	<p>Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin Y.</p> <p>Shkruajnë y në Abetaren e Punës.</p> <p>Nxënësit plotësojnë Y në fjalët e Abetares së Punës në faqen përkatëse.</p> <p>Nxënësit shkruajnë fjalët globale në faqen përkatëse.</p>
<b>Përforsim</b>		
Tregon si formohet y, e vizaton në ajër, kërkon që edhe nxënësit të bëjnë të njëjtin veprim. Kërkon që edhe nxënësit të thonë fjalë që kanë y në trup të tyre. Mësuesi kërkon të punojnë në grupe dyshe, duke gjetur dhe duke shqiptuar fjalë që kanë YH.		<p>Nxënësit në grupe dyshe thonë fjalë të tjera që kanë tingullin y në trup të tyre.</p> <p>Nxënësit shqiptojnë fjalë që kanë y në trup të tyre, të ndara në rrokje, duke dalluar pozicionin që ato kanë.</p> <p>Nxënësi në grupe dyshe thonë fjalë që kanë y.</p>
Hapi i pestë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin njëshat në Abetaren e Punës.	Nxënësit ngjyrosin ylberin, elementet ovale të shkrimit dhe ngjyrosin figurën në fund të faqes përkatëse.



Hapi i gjashtë	Shkruajnë shkronjat plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në fletore. Plotësojnë Y atje ku mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës: ylli, ylberi.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me Y. Në fletë reviste ose gazete të gjejnë 5 fjalë që kanë Y.	Dy rreshta me Y dhe me fjalët globale. Në një faqe libri gazete apo reviste gjejnë 5 fjalë që kanë shkronjën Y në trup të tyre.

### 30. TINGULLI DHE SHKRONJA ZH

#### STRUKTURA E ORËS SË MËSIMIT

Tema	Objektiva	Strategji dhe teknika	Ndërthurja	Shprehi që zhvillohen	Burime
Tingulli dhe shkronja zh	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të shqiptojë e të shkruajë saktë shkronjën ZH.</li> <li>Të shkruajë globalisht fjalë që përmbajnë shkronjat ZH.</li> <li>Të dallojë shkronjat Zh në trup të fjalëve të ndryshme.</li> <li>Të pasurojë fjalorin me fjalë që përmbajnë shkronjat ZH dhe që lidhen me temën.</li> </ul>	Lojë-enigmë, punë në grupe bashkëbisedim, vizatim.	Të folurit, Të shkruarit, Art/vizatim, muzikë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes	Objekte ose figura objektesh, emrat e të cilave i përmbajnë shkronjat ZH të shoqëruara me emërtimet përkatëse.

#### ZHVILLIMI I MËSIMIT

Hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>MOTIVIMI</b>	<b>Imagjinatë e drejtuar</b>	
Hapi i parë	Mësuesi u thotë nxënësve të dëgjojnë me vëmendje një tregim që do t'u tregojë. Disa fëmijë ndodheshin në buzë të detit dhe po shëtisnin me mësuesen. Papritur pranë bregut ata panë të afrohej një anije. Nga anija u hodhën në det dhe u zhytën disa zhytës. Ata vazhduan disa orë, duke u zhytur në det. Njëri nga zhytësit hipi në anije dhe nisi të... Mësuesi kërkon që nxënësit ta përfundojnë tregimin.	Nxënësit dëgjojnë me vëmendje. 2-3 nxënës tregojnë një mbyllje për tregimin.
<b>HYRJA</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi u drejton nxënësve disa pyetje: Ku ndodheshin nxënësit? Çfarë panë ata në det? Kush u hodh nga anija? Çfarë bënë ata? Mësuesi ndalon te fjala <i>zhytës</i> dhe <i>zhyt</i> . Kërkon që nxënësit të tregojnë kuptimin e fjalëve. Mësuesi kërkon që ata të gjejnë se çfarë tjetër kanë të përbashkët këto fjalë.	Nxënësit shpjegojnë me fjalët e tyre se çfarë kuptojnë me fjalët <i>zhytës</i> dhe <i>zhyt</i> .  Nxënësit gjejnë se tingulli zh është i përbashkët te të dyja fjalët.
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Punë në grupe dyshe/Demonstrim</b>	

Hapi i tretë	Mësuesi nxjerr foto me figura, emrat e të cilave kanë shkronjën ZH. I shqiptojnë së bashku: <i>zhapik, zhavorr, zhabë, zhytës</i> etj. I shqiptojnë duke i ndarë në rrokje dhe duke gjetur se ku ndodhet tingulli ZH. Tregon elementin e përbashkët në këto fjalë që është zh dhe që ndodhet në pozicione të ndryshme. Prezanton shkronjën zh, duke e shkruar në ajër dhe në dërrasë.	Nxënësit shqiptojnë fjalë me zh, duke e ndjekur mësuesen. I shqiptojnë së bashku me nxënësit, të ndara në rrokje, të cilat i shoqëron me lëvizjet e duarve majtas-djathtas. Nxënësit përsërisin veprimet e mësueses në ajër dhe në tabela plastike/fletë formati. Nxënësit vizatojnë në ajër ashtu si mësuesi. Nxënësit e shkruajnë/vizatojnë në tabelën plastike ose në fletë letre në përmasa të mëdha.
Hapi i pestë	Mësuesi shkruan ose paraqet në dërrasë shkronjën ZH. Vizaton në ajër zh dhe kërkon të plotësojnë zh në fjalët që mungon në Abetaren e Punës. Kërkon të shkruajnë fjalë globale sipas shkronjave ZH. Kërkon që nxënësit në një fletë gazete të gjejnë shkronjën ZH.	Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin ZH. Shkruajnë zh në Abetaren e Punës.  Nxënësit plotësojnë zh në libër. Nxënësit shkruajnë fjalët globale në Abetaren e Punës.
Përforsim	Bashkëbisedim/vizatim	
Hapi i gjashtë	Mësuesi kërkon të ngjyrosin njëshat në Abetaren e Punës.	Nxënësit ngjyrosin elementet ovale të shkrimit dhe ngjyrosin figurën në fund të faqes përkatëse.
Hapi i shtatë	Shkruajnë shkronjat, plotësojnë shkronjën që mungon dhe shkruajnë fjalët globale.	Shkruajnë në Abetaren e Punës. Plotësojnë ZH kur mungon në fjalë. Shkruajnë globalisht fjalët e Abetares së Punës.
Detyrë	Të shkruajnë dy rreshta me ZH. Në një fletë reviste ose gazete të gjejnë 5 fjalë që kanë ZH.	Shkruajnë dy rreshta me ZH dhe me fjalët globale. Në një faqe libri, gazete ose reviste gjejnë 5 fjalë që kanë shkronjën ZH në trup të tyre.

## TEST 2

EMRI

1. Qarko      A U O N T R: A Fig. ANANAS      U Fig. UJKU      O Fig. ROBOTI

2. PLOTËSO.

FIG	FIG	FIG	FIG
<input type="text"/> <input type="text"/> R <input type="text"/> I <input type="text"/> U	<input type="text"/> <input type="text"/> L <input type="text"/> B <input type="text"/> E <input type="text"/> R <input type="text"/> I	<input type="text"/> <input type="text"/> L <input type="text"/> <input type="text"/> F <input type="text"/> A <input type="text"/> N <input type="text"/> T <input type="text"/> I	<input type="text"/> <input type="text"/> I <input type="text"/> U

4. SHKRUAJ.

A
M

## MODELE MËSIMI PËR ABETAREN

Puna me Abetaren dhe mësimin e lexim-shkrimit përfshin pjesën e dytë të tekstit të Abetares. Në këtë pjesë të tekstit shtjellohet e gjithë përmbajtja e tekstit në përshtatje me objektivat dhe udhëzimet didaktike të parashtruara në program.

Mbështetur në udhëzimet e mësipërme, në këtë pjesë të Abetares po shtjellojmë mësim-model që lidhen me shkronjat e marra me radhë sipas parashikimit në program dhe tekst.

Programi analitik i zbërthyer në objektiva, strategji, lidhje ndërëndore, shprehi që zhvillohen dhe burime të mundshme për t'u përdorur, do të shoqërojë këtë tekst përmes një CD-je dhe një broshure shoqëruese për të, me qëllim që t'i ndihmojmë mësuesit për të bërë ndryshimet e tyre, në rast se duan të parashojnë këtë program në një mënyrë tjetër.

Programi në fjalë dhe mësimet model të ofruara përmes këtij teksti janë orientuese, pasi vetë mësuesit me përvojat e tyre, janë të lirë të ndërtojnë modele të përshtatshme për klasat dhe nxënësit e tyre siç dëshirojnë.

### Ora e parë

### 1. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës A, a

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën A, a.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën A në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën A në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit A, a sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti,lapsa,</p> <p>Fletore,</p> <p>Materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë</p>

**Fjalë çelës:** Abetarja, shkronja A, a, fjalori, titulli.

## Zhvillimi i mësimit

	<b>Aktivitetet që bëjnë mësuesi</b>	<b>Aktivitetet që bëjnë nxënësi</b>
<b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i>	<p>- <i>Fillon tregimin</i>: Është dita e parë e shkollës. Ani me Olën, së bashku me shokët dhe shoqet kanë hyrë në klasë. Të gjithë janë duke bërë diçka. Ola po bisedon me mësuesen. Ani është te dera e klasës...  <i>Përfundojeni ju ngjarjen, çfarë ka ndodhur në vazhdim?</i></p> <p>- Lexon fjalinë. Inkurajon nxënësit të bëjnë lexim individual (globalisht). <b>Ani e Ola me Abetare.</b></p> <p>- Pyet: Cilat shkronja kanë ngjyrë të kuqe?</p>	<p>Mendojnë, imagjinojnë (çfarë po bëjnë nxënësit e tjerë, çfarë ka në klasë...).</p> <p>Individualisht (globalisht) lexojnë fjalinë.</p> <p>Thonë shkronjën A.</p>
<p>1. Punimi i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik:  <i>Urra, urra, shkronja</i></p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik - <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën A, a.</p> <p>2. Shpjegon lojën: Unë do të them fjalë. Sa herë e dëgjoni tingullin A në fjalë do të bërtitni URRRA!          Thotë fjalët (anije, mami, babi, dritare...)</p> <p>3. Vendos në tabelë disa fotografi. Kërkon nga nxënësit t'i emërtojnë ato.          Pyet: Ku është tingulli A?          (Dera, ariu, kali ...)</p>	<p>1. E dallojnë tingullin a duke dëgjuar fjalët. Bërtasin URRRA kur dëgjojnë tingullin a.</p> <p>2. Ndajnë fjalën në tinguj dhe për secilin tingull që thonë ngrenë gishtin. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>
<b>Hapi i dytë</b> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p>	<p>1. Shkruan shkronjën A, a në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik në mes të shkronjës së madhe të shtypit A dhe të voglës së shtypit a.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë fotografinë në libër dhe të gjejnë dhe qarkojnë shkronjën A.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat, vërejnë dhe thonë çfarë dallojnë te shkronjat (madhësia, grafiku...)</p> <p>2. Gjejnë dhe qarkojnë shkronjën A në libër.</p>
<b>Hapi i tretë</b> <p>1. Dramatizim: <i>Unë jam A</i></p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Përpiquni që trupin tuaj ta ktheni në shkronjën A.</p> <p>2. Shkruan shkronjën A, a të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën A, a. Po ashtu të vizatojnë diçka që fillon me shkronjën A.</p> <p>3. Në copa gazetash të gjejnë shkronjën A, a, t'i qarkojnë dhe t'i sjellin në klasë.</p>	<p>1. Me anë të trupit nxënësit formojnë shkronjën A.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën A dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën A.</p>

## Ora e dytë. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shtypit A, a

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehinë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të shtypit A, a.</p> <p>Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë.</p> <p>Të lexojë shkronjën e mësuar.</p> <p>Të pasurojë fjalorin me sa më shumë fjalë të shkronjës A, a</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë kyç: Abetarja, ananas, avion, shkronjë, zanore.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p>Hapi i parë</p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën A të madhe, të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën a të vogël të shtypit.</p> <p>Mësuesi thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (A, a)”.</p>	<p>Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë secili shkronjën A të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruajnë secili shkronjën a të vogël të shtypit në fletën që kanë përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (A a).</p>
<p>Hapi i dytë</p>	<p>Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (abetare, ananas, avion). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?” ...</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën A në kutizat ku mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna (është abetare, nevojitet për të mësuar shkrimin dhe leximin, mua më pëlqen abetarja, aty mësoj shumë gjëra...)</p> <p>Lexojnë globalisht fjalët (abetare, ananas, avion ) dhe shkruajnë shkronjën A në kutizat ku mungon.</p>
<p>Hapi i tretë</p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit A a, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe kur bindet se i kanë bërë ashtu siç duhet, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit A a, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit si fillim, ndërsa më pas punojnë individualisht.</p> <p>Nxënësit, pasi bëjnë detyrën, shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>

## Ora e tretë. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit A,a

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës A,a.</p> <p>Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë.</p> <p>Të lexojë shkronjat e mësuara</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti,lapsa, fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë kyç: shkronja e shkrimit, Abetare Pune.

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai.</p> <p>Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.”</p> <p>Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu si janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës A,a.</p>	<p>Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Mësuesi njuh nxënësit për atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën A,a të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyrë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Kërkon që nxënësit të krahasojnë shkronjat e shtypit dhe të dorës A.</p> <p>Udhëzon që në fletoret e tyre të shkruajnë 4 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit, A,a.</p> <p>Vëzhgon dhe ndihmon nxënësit kur kanë vështirësi.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a.</p>	<p>Krahasojnë shkronjat dhe flasin për to (janë të mëdha dhe të vogla, kanë vija të drejta dhe të lakuara...)</p> <p>Shkruajnë në fletoret e tyre 4 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a.</p>

## Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit A,a

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehinë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës A,a.</p> <p>Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë.</p> <p>Të lexojë shkronjat e mësuara.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim.</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global, Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti,lapsa, fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë.</p>

Fjalë kyç: diktim, shkronjë e shkrimit, Abetare Pune.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p>Hapi i parë</p> <p>Motivimi</p> <p>Qëlloje shkronjën</p>	<p>U shpërndan nxënësve 4 etiketa me shkronjat e shtypit dhe të dorës A.</p> <p>Thotë: “Ju do të ngrini etiketën me shkronjën që kërkoj. P.sh., të ngrihet lart shkronja e vogël e shtypit a; të ngrihet lart shkronja e madhe e dorës A... Pastaj, të njëjtën lojë do ta vazhdoni me shokët në grup”.</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë më vëmendje mësuesin dhe ngrënë lart etiketën me shkronjën përkatëse.</p> <p>Vazhdojnë lojën në grup. Njëri prej nxënësve merr rolin e mësuesit, të tjerët ngrënë etiketat me shkronja.</p>
<p>Hapi i dytë</p> <p>Diktim</p>	<p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetare Pune shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Dikton shkronjën e madhe dhe të vogël A: a,A,a,a,A, a.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës A,a në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.</p> <p>Shkruajnë në fletore shkronjat e diktuar.</p>
<p>Hapi i tretë</p> <p>Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon. Nga letrat me ngjyra, që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a. Vendosini në këndin e shkronjave në klasë.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a.</p>	<p>Me letrat me ngjyra që shpërndan mësuesi, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit A,a dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>




## Ora e pestë. Tema: Gjetja e shkronjës A në fjalë, lexim i fjalëve dhe pasurim fjalori me fjalë të reja, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehinë e të zhvilluarit	Burimet
------------	-----------------------	--------------------	----------------------------	---------

<p>Të gjejë vendndodhjen e shkronjës a në trup të fjalës.</p> <p>Të komentojë figurat që shikon dhe t'i lidhë me fjalët përkatëse.</p> <p>Të krijojë fjalë që përmbajnë shkronjën a dhe të përpiqet t'i shkruajë dhe t'i lexojë globalisht ato.</p>	<p>Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.</p>	<p>Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.</p>	<p>Teksti,lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.</p>
---	--	--	--	---

Fjalë kyç: peshku, krokodili, flutura, lopa.

## Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p>Hapi i parë</p> <p>Motivimi</p> <p>Ngjyros shkronjën</p>	<p>Ushtrimet e përgatitura më parë u shpërndahen nxënësve që të punojnë individualisht. Thotë: Ngjyrosni me të njëjtën ngjyrë shkronjën A,a.</p> <p><small>Ngjyros me të njëjtën ngjyrë shkronjen e madhe dhe të vogël A,a.</small></p> 	<p>Nxënësit ngjyrosin në fletët e tyre shkronjën e mësuar, A,a.</p>
<p>Hapi i parë</p>	<p>Mësuesi udhëzon nxënësit që në ushtrimin e parë të dëgjojnë tingullin A dhe të ngjyrosin rrethin aty ku e dëgjojnë tingullin: në fillim, në mes apo në fund. Në të njëjtën mënyrë i udhëzon të vazhdojnë dhe në ushtrimin 2.</p> <p>1. Ku e dëgjon tingullin A? Ngjyros.</p>  <p>OOO    OOO    OOO</p> <p>2. Ku e sheh shkronjën A? Ngjyros.</p>  <p>ÇANTA    PEMA    KROKODILI</p> <p>OOO    OOO    OOO</p>	<p>Nxënësit emërtojnë figurat dhe ngjyrosin rrethin aty ku e dëgjojnë tingullin A. Në ushtrimin tjetër ngjyrosin rrethin aty ku e shohin shkronjën.</p>



<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit të ndahen në grupe dhe të gjejnë fjalë të reja me shkronjën A.	Nxënësit ndahen në grupe dhe gjejnë fjalë të reja me shkronjën A. Udhëheqësi i grupit i thotë ato përpara të tjerëve në klasë.
<b>Detyrë shtëpie</b>	I shkruan ato në tabelë dhe bisedon me nxënësit për fjalët e reja që gjejnë.  Gjeni fjalë të reja me shkronjën A në gazeta dhe sillini ato në klasë.	

## **Ora e parë Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës N, n**

<b>Objektivat</b>	<b>Strategji dhe teknika</b>	<b>Ndërthurja lëndore</b>	<b>Shprehitë e të zhvilluarit</b>	<b>Burimet</b>
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën M, m.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën M në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën M në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit M, m sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Punëdore</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti,lapsa,</p> <p>fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë.</p>

**Fjalë kyç:** Abetarja, shkronja N, n, fjalori, titulli.

## **Zhvillimi i mësimet**

	<b>Aktivitetet që bën mësuesi</b>	<b>Aktivitetet që bën nxënësi</b>
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p><i>Motivimi</i></p> <p><i>Muzika - Ninulla</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>Ndez muzikën: Si u ndiet derisa e dëgjuat muzikën? Çfarë kënaqësie të solli kjo muzikë? Kur këndohen ninullat? Kush i vë fëmijët në gjumë? Kur ëndërrojnë ata?</p> <p>Në mungesë të muzikës mund të këndonit vetë një ninullë: Nina-nin të marrt gjumi, Nina-nin, të marrt gjumi, nina-nin, të marrt në djep, të ka nana zog me fletë.</p> <p><i>Udhëzohen nxënësit të vëzhgojnë në Abetare. Cilin shohim në figurë? Ku janë ata? Çfarë bën nëna? Çfarë mban ajo? Pse mendoni se qeni Umi iu afrua nënës?</i></p> <p>- Lexon fjalinë. Inkurajon nxënësit të bëjnë lexim individual.</p> <p>-Pyet: “Cilat shkronja kanë ngjyrë të kuqe?”</p>	<p>Dëgjojnë muzikën. U përgjigjen pyetjeve dhe tregojnë për përvojat e tyre vetjake.</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë.</p> <p>Lexojnë secili fjalinë.</p> <p>Thonë shkronjën N.</p>

<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p><i>Muzika -Ninulla</i></p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik: Abetarja - “Kërkoj tingullin”.</p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën N,n.</p> <p>2. Dëgjohet përsëri ninulla. Mësuesi pyet: “Në cilat fjalë dëgjohet tingulli N?” Gjeni edhe fjalë tjera që kanë tingullin N.</p> <p>3. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë figurat në Abetare - “Kërkoj tingullin”. Ku është tingulli N?</p> <p>Pyet: Ku është tingulli N?</p>	<p>1. Dallojnë tingullin, duke dëgjuar ninullën. Numërojnë fjalët që kanë tingullin N.</p> <p>Gjejnë fjalë me këtë tingull.</p> <p>2. Ndajnë fjalën në tinguj. Përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p>	<p>1. Shkruan shkronjën N, n në tabelë ose i paraqet me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik në mes të shkronjës së madhe të shtypit N dhe të voglës së shtypit n.</p> <p>2. Mësuesi udhëzon nxënësit të vërejnë fotografinë në Abetare dhe të gjejnë dhe qarkojnë shkronjën N. Gjithashtu shkruajnë shkronjat që mungojnë në fjalë.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat, vërejnë dhe thonë çfarë dallojnë te shkronjat (madhësia, grafiku...)</p> <p>2. Gjejnë, qarkojnë dhe shkruajnë shkronjat në Abetare.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Punimi i shkronjës me plastelinë.</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Këron të punohet shkronja N,n me plastelinë.</p> <p>2. Shkruan shkronjën N,n të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën N,n. Gjithashtu vizatojnë një send që fillon me shkronjën N.</p> <p>3. Vizatojnë diçka që fillon me shkronjën N dhe shkruajnë fjalën poshtë vizatimit.</p>	<p>1. Nxënësit punojnë shkronjën me plastelinë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën N dhe vizatojnë një send që fillon me shkronjën N.</p>

**Ora e dytë. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shtypit N,n**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
------------	-----------------------	--------------------	----------------------------	---------

<p>Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të shtypit N,n.</p> <p>Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë.</p> <p>Të lexojë shkronjën e mësuar.</p> <p>Të pasurojë fjalorin me sa më shumë fjalë të shkronjës N, n.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim.</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa,</p> <p>fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë</p>
--	---	---	--	--

Fjalët çelës: nënta, nëna, numra.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Mësuesi shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>N</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>n</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave ( <b>N,n</b>)”.</p>	<p>Nxënësit ndahen në klasë në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>N</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>n</b> të vogël të shtypit në fletën që kanë përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>N,n</b>).</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (<b>nënta, nëna, numra</b>) për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Çfarë është ajo për ty? Sa e doni?” ...</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, të lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>N</b> në kutizat që mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna (njeriu më i dashur për mua është nëna).</p> <p>Lexojnë globalisht fjalët (<b>nënta, nëna, numra</b>) dhe shkruajnë shkronjën <b>N</b> në kutizat ku mungon.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>N n</b> në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast dhe kur bindet se i kanë bërë mirë i lë të punojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>N n</b>, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë, dhe më pas punojnë individualisht.</p> <p>Nxënësit, pasi përfundojnë detyrën, shkëmbejnë fletoret me shokun e bankës dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>

Ora e tretë. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit N, n

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës N,n.</p> <p>Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë.</p> <p>Të lexojë shkronjat e mësuara.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim.</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti,lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.</p>

Fjalët çelës: shkronja e dorës, Abetare Pune.

Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p>Hapi i parë</p> <p>Motivimi</p>	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai.</p> <p>Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini dorën me të cilën shkruani, ulni dorën duke bërë një lakim majtas, pastaj bëni një vijë të pjerrët djathtas”...</p> <p>Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu si shkruhet shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës N,n.</p>	<p>Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n.</p>
<p>Hapi i dytë</p>	<p>Njih nxënësit për atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën N,n të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyrë.</p>
<p>Hapi i tretë</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Kërkon që nxënësit të krahasojnë shkronjat e shtypit dhe të dorës N.</p> <p>Udhëzon që në fletoret e tyre të shkruajnë 4 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n.</p> <p>Vëzhgon dhe ndihmon nxënësit aty ku ata kanë vështirësi.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N, n.</p>	<p>Krahasojnë shkronjat dhe flasin për to (janë të mëdha dhe të vogla, kanë vija të drejta dhe të lakuara...)</p> <p>Shkruajnë në fletoret e tyre 4 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N, n.</p>

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit N,n

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehite e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të shtypit N,n.</p> <p>Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë.</p> <p>Të lexojë shkronjën e mësuar.</p> <p>Të pasurojë fjalorin me sa më shumë fjalë të shkronjës N,n.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim.</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti,lapsa,</p> <p>fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë.</p>

Fjalët çelës: fjalë, rrokje

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p> <p>“Qëlloje shkronjën”</p>	<p>U shpërndan nxënësve 4 etiketa me shkronjat e shtypit dhe të dorës N.</p> <p>Thotë: “Ju do të ngrini etiketën me shkronjën që kërkoj”. P.sh.: Ngrihet lart shkronja e vogël e shtypit n; ngrihet lart shkronja e madhe e dorës N....</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë më vëmendje mësuesin dhe ngrënë lart etiketën me shkronjën e qëlluar.</p> <p>Vazhdojnë lojën në grup. Njëri prej nxënësve merr rolin e mësuesit, të tjerët ngrënë etiketat me shkronja.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>Diktim</p>	<p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n, rrokje dhe fjalë, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Dikton nxënësit të shkruajnë në fletore: na, ni, in, an, nani, Nina. Më pas vlerëson diktimin.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës N,n, rrokje dhe fjalë në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.</p> <p>Shkruajnë rrokjet dhe fjalët që dikton mësuesi.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n”. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që i shpërndan mësuesi, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit N,n dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim i fjalëve dhe pasurim fjalori me fjalë të reja, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehite e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të gjejë vendndodhjen e shkronjës N në trup të fjalës.</p> <p>Të komentojë figurat që shikon dhe t'i lidhë me fjalët përkatëse.</p> <p>Të krijojë fjalë që përmbajnë shkronjën N dhe të përpiqet t'i shkruajë dhe lexojë globalisht ato.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim.</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa,</p> <p>fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë kyç: rrokje, fjalë.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi <b>Lexo rrokjen</b>	Ushtrimet e përgatitura më parë u shpërndahen nxënësve që të lexojnë në çift. Mësuesi thotë: “Lexon rrokjet njëri, tjetri dëgjon, pastaj ndërrojnë rolet”. Ma na mam Mi ni mim Im an nan am in nin	Nxënësit ndahen në dyshe dhe lexojnë rrokjet. Njëri lexon, tjetri dëgjon, pastaj ndërrojnë rolet.
<b>Hapi i dytë</b>	Paraqet para nxënësve fjalë, i lexon vetë dhe kërkon që ata të bëjnë lexim global të tyre dhe pastaj të qarkojnë rrokjet që dinë të lexojnë, p.sh.: Nëna qeni Ninulla rini Natë	Nxënësit lexojnë (globalisht) fjalët, emërtojnë figurat dhe ngjyrosin rrethin aty ku e dëgjojnë dhe e shohin tingullin N.
<b>Hapi i tretë</b>          <b>Detyrë shtëpie</b>	Shpërndan fletë të bardha dhe u thotë nxënësve të shkruajnë fjalën NANI. I kontrollon ata dhe i ndihmon kur kanë nevojë, më pas lexon në libër dhe udhëzon nxënësit të bëjnë lexim individual në libër.  Udhëzon nxënësit të ndahen në grupe dhe të gjejnë fjalë të reja me shkronjën N. I shkruan ato në tabelë dhe bisedon me nxënësit për fjalët e reja që ata gjejnë.  Gjeni fjalë të reja me shkronjën N në gazeta dhe sillni ato në klasë. Shkruani në fletore 4 rreshta <b>NINA.</b>	Shkruajnë në fletë të bardha fjalën NANI dhe lexojnë individualisht në libër.  Nxënësit ndahen në grupe dhe gjejnë fjalë të reja me shkronjën N. Udhëheqësi i grupit i thotë ato para të tjerëve në klasë.

**Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës E e**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të. <b>Të njohë</b> shkronjën M,m. <b>Të gjejë</b> shkronjën M në struktura fjalësh me ndihmën e figurave. <b>Të qarkojë</b> shkronjën M në pozicione të ndryshme të fjalës. <b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit M, m sipas modelit. <b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.	Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Punë dore, Mësimi me lojë.	Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.	Teksti,lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.

Fjalë kyç: Abetarja, shkronja E, e, fjalori, titulli.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b>  <i>Motivimi</i> <i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i>	<i>Udhëzohen nxënësit të vëzhgojnë në Abetare. Cilin shohim në figurë? Ku janë ata? Çfarë mban në dorë Ani? Kë përshëndet Ema? A keni hipur ndonjëherë në helikopter? Si do të ndiheshit po të ishit në helikopter?</i> - Lexon fjalinë. Inkurajon nxënësit të bëjnë lexim individual. Ema luan me Anin. -Pyet: “Cilat shkronja kanë ngjyrë të kuqe?”	Mendojnë, imagjinojnë (ndjenjat për shetitjet me helikopter...)  Individualisht lexojnë fjalinë.  Thonë shkronjën E.
1. Punim i tingullit  2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik <i>Vjersha - Ec</i>  3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik: Abetarja - “Kërkoj tingullin”.	1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën E,e. 2. Ec e ec e ec E Ec e ec e ec Ec e ec e ec Një bubrrec Për ta puthur Gjirafën në faqe! Lexon vjershën dhe inkurajon nxënësit të lexojnë individualisht (globalisht). 3. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë figurat në Abetare - “Kërkoj tingullin”. Pyet: Ku ndodhet tingulli E?	1. Dallojnë tingullin duke dëgjuar vjershën. Numërojnë fjalët që kanë tingullin E.  2. Ndajnë fjalën në tinguj. Përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p>	<p>1. Shkruan shkronjën E, e në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, E dhe të voglës së shtypit, e.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë fotografinë në Abetare, të gjejnë dhe të qarkojnë shkronjën E. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të shkruajnë shkronjat që mungojnë në fjalë.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku).</p> <p>2. Gjejnë, qarkojnë dhe shkruajnë shkronjat në Abetare. Ndajnë fjalët në rrokje dhe tregojnë numrin e tyre.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Bashkë me nxënësit shkruhet shkronja E, e në ajër. Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën E, e.</p> <p>3. Vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën E dhe shkruajnë fjalën në përfundim të vizatimit.</p>	<p>1. Shkronjën e shkruajnë me gisht në ajër dhe më pas në fletore.</p>

### Ora e dytë. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shtypit E, e/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të shtypit E, e.</p> <p>Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë.</p> <p>Të lexojë shkronjën e mësuar.</p> <p>Të pasurojë fjalorin me sa më shumë fjalë të shkronjës E, e.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: era, elefanti, ena.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën E të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën e të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (E, e)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën E të madhe të shtypit, në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruajnë individualisht shkronjën e të vogël të shtypit në fletën që kanë përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (E, e).</p>



<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>era, elefanti, ena</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse? ...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën E në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen për pyetjet e dhëna (është ena, nevojitet për ushqim, unë e përdora, ...) Lexojnë globalisht fjalët ( <b>era, elefanti, ena</b> ) dhe shkruajnë shkronjën E në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit E, e në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit E, e, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit E, e

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës E, e. Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë. Të lexojë shkronjat e mësuara.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, Abetare Pune.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart të veprojnë, ashtu siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani” dhe tregon lëvizjet që duhet të bëjnë për të shkruar shkronjën E, e.	Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të shtypit, E, e.
<b>Hapi i dytë</b>	Njofton nxënësit për atë që do të mësojnë, shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e.  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.	Shkruajnë shkronjën E, e të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.

Hapi i tretë	Kërkon që nxënësit të krahasojnë shkronjën E të shtypit dhe atë të dorës.  Udhëzon që në fletoret e tyre të shkruajnë 4 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e. Vëzhgon dhe ndihmon nxënësit aty ku kanë vështirësi.	Krahasojnë shkronjat dhe flasin për to (janë të mëdha dhe të vogla, kanë vija të drejta dhe të lakuara...)  Shkruajnë në fletoret e tyre 4 rreshta me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e.
Detyrë shtëpie	Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e.	

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit E, e/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të mësojë grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës E, e. Të shkruajë bukur, saktë dhe me të gjitha elementet këtë shkronjë. Të lexojë shkronjat e mësuara.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: fjalë, rrokje, Eni, mami.

#### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë  Motivimi  Gjeje shkronjën	U shpërndan nxënësve 4 etiketa me shkronjat e shtypit dhe të dorës, E.  Thotë: “Ju do të ngrini etiketën me shkronjën, të cilën unë e kërkoj p.sh.: ngrini lart shkronja e vogël e shtypit e; ngrini lart shkronja e madhe e dorës E... Pastaj të njëjtën lojë do ta vazhdoni me shokët në grup.	Nxënësit dëgjojnë me vëmendje atë që thotë mësuesi dhe ngrënë lart etiketën me shkronjën e gjetur.  Vazhdojnë lojën në grup. Njëri prej nxënësve merr rolin e mësuesit, ndërsa të tjerët ngrënë etiketat me shkronja.
Hapi i dytë  Diktim	Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e, <b>rrokje dhe fjalë</b> , i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.  Dikton nxënësit të shkruajnë në fletore: <b>me, ne, em, en, Eni e mami</b> . Më pas vlerëson diktimin.	Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës E, e, rrokje dhe fjalë në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.  Shkruajnë rrokjet dhe fjalët që mësuesi dikton.

<b>Hapi i tretë</b>		
Balona të lumtura	Udhëzon: “Nga letrat për kolazh, të cilat ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë.”	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.
Detyrë shtëpie	Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit E, e rrokje dhe fjalë.	

### Ora e pestë. Tema: Lexim i fjalëve dhe pasurim fjalori me fjalë të reja, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të gjejë vendndodhjen e shkronjës E në trup të fjalës. Të komentojë figurat që shikon dhe t'i lidhë me fjalët përkatëse. Të krijojë fjalë që përmbajnë shkronjën E dhe të përpiqet t'i shkruajë dhe t'i lexojë globalisht ato.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: elefanti, helikopteri, Ema, Ani.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bëjnë mësuesi	Aktivitetet që bëjnë nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi Gjeje fjalën shpejt	Shpërndan etiketa me fjalë të ndryshme në bankat e nxënësve dhe udhëzon ata që për një kohë të caktuar të gjejnë dhe të grumbullojnë etiketat me fjalët që kanë shkronjën E. Pastaj ato fjalë të lexohen para të tjerëve në klasë. Grupi që ka gjetur më tepër fjalë do të vlerësohet.	Nga etiketat me fjalë që u ka shpërndarë mësuesi do të gjejnë shpejtë fjalët që kanë shkronjën E dhe do t'i lexojnë ato para të tjerëve.
<b>Hapi i dytë</b>	Vendos etiketat me fjalë të shpërndara në pjesën e motivimit në tabelë dhe aty pastaj ngrihen nxënësit që të qarkojnë rrokjet në fjalë të ndryshme.	Gjejnë rrokjet në etiketat me fjalë dhe i qarkojnë ato.
<b>Hapi i tretë</b>	Lexon fjalinë në libër dhe kërkon që nxënësit individualisht (globalisht) të lexojnë fjalinë dhe fjalët. <b>EMA LUAN ME ANIN.</b> <b>Elefanti</b> <b>Telefoni</b> <b>Era</b> <b>Helikopteri</b>  Udhëzon nxënësit të ndahen në grupe dhe të gjejnë fjalë të reja me shkronjën E. I shkruan ato në tabelë dhe bisedon me nxënësit për fjalët e reja që ata gjejnë.  Gjeni fjalë të reja me shkronjën E në gazeta dhe sillini ato në klasë. Shkruani në fletore 4 rreshta <b>EMA ME ANIN.</b>	Lexojnë globalisht fjalinë dhe fjalët në libër.  Nxënësit ndahen në grupe dhe gjejnë fjalë të reja me shkronjën E. Udhëheqësi i grupit i thotë ato para të tjerëve në klasë.
Detyrë shtëpie		

**Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës S, s**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën S, s.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën S në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën S në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit S, s sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetaren e Punës.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Punëdore</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja S, s, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p><i>Motivimi</i></p> <p><i>Dramatizim</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>Improvizon në klasë një udhëkryq. Kërkon nga nxënësit të kalojnë rrugën dhe të respektojnë semaforin.</p> <p>Udhëzon nxënësit të përshkruajnë figurat në Abetare: “Kë shihni në figurë? Ku janë ata? Për çfarë mund ta kenë pyetur fëmijët xhaxhin? Çfarë këshille mund t’u thotë ai?”</p>	<p>Luajnë rolin e këmbësorit.</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë (çfarë bisedojnë fëmijët me xhaxhin...).</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p><i>Loja “unë e njoh këtë Gjë”</i></p> <p>3. Loja “gjej fjalët”</p>	<p>1. Pyeten nxënësit se për çfarë mësuam sot. Shkruhet fjalia në tabelë dhe analizohet: “Sa fjalë ka?” Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin S.</p> <p>Cili tingull përsëritet?</p> <p>2. Shpjegon lojën: “Secili nga ju do të mendojë një fjalë që ka shkronjën S. Do t’ua shpjegojë shokëve atë gjë me disa fjali. Kush e gjen vazhdon lojën.”</p> <p>3. Kërkon nga nxënësit të thonë tri fjalë, dy emra njerëzish dhe një emër sendi, që kanë tingullin S në fillim, në mes ose në fund të fjalës.</p>	<p>Thonë: “Sot mësuam për semaforin.” Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli S.”</p> <p>2. Mendojnë diçka. Thonë, p.sh.: “E di një gjë që luan, ushtron, ka trup të bukur, shënon gola... (sportisti).” Të tjerët e gjejnë për çfarë bëhet fjalë.</p> <p>3. Mendojnë për të gjetur sa më shumë emra njerëzish dhe sendesh, të cilat e kanë tingullin S.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën dhe e shkruaj atë.</p>	<p>1. Shkruan shkronjën S, s, në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, S, dhe të voglës së shtypit, s.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë fotografinë në Abetare, të gjejnë dhe të qarkojnë shkronjën S. Plotësojnë fjalët duke shkruar shkronjën S.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...)</p> <p>2. Gjejnë, qarkojnë dhe shkruajnë shkronjën.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Lexojnë fjalët dhe fjalinë</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon: "Lexoni fjalët dhe fjalinë në Abetare."</p> <p>2. Shkruan shkronjën S, s të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën S, s. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën S.</p> <p>3. Gjeni në gazeta fjalë që dini t'i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Lexojnë fjalët dhe fjalitë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën S dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën S.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: stop, kopsa, sëpata.

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën S të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën s të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: "Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (S, s)."</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën S të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën s të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (S, s).</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (<b>stop, kopsa, sopata</b>). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? Pse? ...”</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>S</b> në kutizat ku mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna (është kopsa, nevojitet për rroba ...)</p> <p>Lexojnë globalisht fjalët (<b>stop, kopsa, sëpata</b>) dhe shkruajnë shkronjën <b>S</b> në kutizat ku mungon.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>S s</b>, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>S, s</b>, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.</p> <p>Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>

Ora e tretë. Tema: **Lexim dhe teksti, grupe fjalësh dhe fjalish**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë</p> <p>Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën</p> <p>T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Respekto semaforin”</p> <p>Të dallojë titullin në pjesë</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: semafor, i kuq, e verdhë, e gjelbër.

**Zhvillimi i mësimit**

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Ndan nxënësit në grupe dhe u shpërndan shenjat e komunikacionit, të cilat duhet t’i ngjyrosin dhe të flasin për to. I ndihmon nëse kanë vështirësi.</p>	<p>Nxënësit ndahen në grup, ngjyrosin shenjat e komunikacionit me ngjyrat e duhura dhe bisedojnë për to dhe rëndësinë e tyre në komunikacion.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Secilit nxënës i shpërndan nga tri letra me ngjyra, një të verdhë një të kuqe dhe një të gjelbër          Thotë: “Kur unë të them NDALO, ju ngrini lart letrën me ngjyrë të kuqe. Kur unë të them NISU, ju ngrini lart letrën me ngjyrë të gjelbër, kur unë të them BËHU GATI, ju ngrini lart letrën me ngjyrë të verdhë. Do ta përsërisim disa herë.”</p> <p>Lexon fjalitë për semaforin dhe i komenton bashkë me nxënësit edhe një herë ato.</p>	<p>Nxënësit marrin letrat me ngjyra dhe i ngrënë ato lart sipas udhëzimeve të mësuesit.          Të kuqen: NDALO          Të verdhën: Bëhu gati          Të gjelbrën: Nisu</p> <p>Dëgjojnë dhe lexojnë bashkë me mësuesin fjalitë në libër dhe i komentojnë ato.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p><b>Detyrë shtëpie</b></p>	<p>Plotësoni ushtrimin në libër duke dhënë urdhra përbri ngjyrës së semaforit; vizatoni semaforin.</p> <p>Shkruani në fletore këshillat:          Respekto POLICIN!          Respekto SEMAFORIN!</p>	<p>Nxënësit plotësojnë urdhrat e semaforit dhe i plotësojnë ato.</p>

**Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës S, s, shkrim fjalësh (fjalish)**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës S, s.            Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup            Punë në dyshe            Bashkëbisedim            Dramatizim</p>	<p>Të folurit            Art/vizatim, muzikë            Matematikë            Dramë</p>	<p>Të lexuarit global            Të folurit            Imagjinata            Të dëgjuarit            Të zhvilluarit e vëmendjes            Të analizuarit            Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël.

**Zhvillimi i mësimit**

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai.</p> <p>Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.”</p> <p>Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu si janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës S, s.</p>	<p>Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, S, s.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p><b>Diktim</b></p>	<p>I njeh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit S, s.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit S, s dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit S, s, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Plotësoni ushtrimet në Abetaren e Punës.</p> <p>Dikton: “sa, si, se, su, so, së, sot, nesër, Pasnesër, Sara u nis sot për Kukës”.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën S, s të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës S, s në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.</p> <p>Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit S, s. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë”.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit S, s.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që u shpërndan mësuesi, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit S, s dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën S në trup të tyre.</p> <p>Të përdorin pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: mësoj, pastroj, banesa.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Udhëzon nxënësit që me fjalët e dhëna të krijojnë fjali:</p> <p>Sot_____.</p> <p>Nesër_____.</p> <p>Pasnesër_____.</p>	<p>Nxënësit mendojnë dhe krijojnë fjali me fjalët e dhëna, p.sh.:</p> <p>Sot është ditë e bukur.</p> <p>Nesër e kam ditë pushimi.</p> <p>Pasnesër do të shkoj në Prishtinë.</p>



<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Bisedon me nxënësit për fjalën e urtë: “Punën e sotme mos e lër për nesër”.</p> <p>Pyet: “Çfarë kuptoni me këtë fjalë të urtë? A mendoni që është e drejtë?”</p> <p>Udhëzon nxënësit të lexojnë rrokjet në tri kolona, t’i lidhin ato dhe të krijojnë fjalë.</p>	<p>Nxënësit lexojnë fjalën e urtë dhe japin mendimet e tyre për kuptimin e saj.</p> <p>Nxënësit lexojnë rrokjet në tri kolona, i lidhin ato dhe krijojnë fjalët: Më+so+i = mësoi; Pas+tro+i = pastroi; Ba+ne+sa = banesa; Ka+sa+pi = kasapi; Spor+ti+sti=sportisti.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të gjejnë sa fjalë janë në fjalinë: <b>Sot mësuam për semaforin.</b></p> <p>T’i gjejnë fjalët në fjali dhe t’i shkruajnë ato sipas modelit të dhënë në libër.</p>	<p>Nxënësit ndajnë fjalinë në fjalë dhe e shkruajnë sipas modelit të dhënë.</p>

### **Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Sh, sh**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Sh, sh</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Sh</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>Sh</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Sh, sh</b>, sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Sh, sh, fjalori, titulli.

### **Zhvillimi i mësimit**

	<p><b>Aktivitetet që bën mësuesi</b></p>	<p><b>Aktivitetet që bën nxënësi</b></p>
--	--	--

<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi Loja e shiut</p> <p>Loja “e gjeta”</p> <p>Përshkrimi i figurës në Abetare</p>	<p>Udhëheq lojën: Fërkimin e shuplakave të duarve, kërcitjen e gishtave, duartrokitjet, rrahjen e gjunjëve, kërcitjen e këmbëve për dysheme, imitimn e shiut me fuqi të ndryshme. Për çdo rreth, shiu bëhet më i fuqishëm.</p> <p>Shpjegon lojën. Nxjerr nxënësit jashtë. Fsheh në bankën e secilit nxënës etiketa me fjalë të shkruara gabim.</p> <p>Përshkruhet figura në Abetare: “Kë shihni? Çfarë kanë shkronjat? Pse ankohen ato? Po fjalët që i gjetët të shkruara gabim, çfarë mund të thonë?”</p>	<p>Qëndrojnë në rreth. E para fillon mësuesja me lëvizje (<i>fërkimin e shuplakave</i>), imiton i pari nxënës afër mësueses, vazhdon i dyti e kështu me radhë të gjithë. Kur vjen prapë radha te mësuesja, ajo ndërron lëvizjen (kërcet gishtat), vazhdojnë të imitojnë një nga një nxënësit. Kështu vazhdon deri në fund.</p> <p>Nxënësit gjejnë etiketat dhe thonë: “E gjeta!” Lexojnë fjalën dhe diskutojnë gabimet.</p> <p>Mendojnë, përshkruajnë, analizojnë.</p>
<p>1. Punim i tingullit Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik Gjej tingullin</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares: “Shkronjat nuk shkuan në shkollë”. Analizohet fjalia: “Sa fjalë ka?” Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin <b>Sh</b>. Cili tingull përsëritet? Ky tingull i takon bashkësisë së zanoreve apo të bashkëtingëlloreve? Pse?</p> <p>2. Gjej fjalë që kanë tingullin <b>Sh</b>, në fillim, mes ose në fund të fjalës.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli <b>Sh</b>”. Thonë: “Ky tingull është tingull bashkëtingëllor”.</p> <p>2. Gjejnë fjalë dhe përcaktojnë vendndodhjen e tingullit.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Alfabeti i murit</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Sh, sh</b>, në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>Sh</b>, dhe të voglës së shtypit, <b>sh</b>.</p> <p>2. U tregon nxënësve shkronjën e murit, udhëheq nxënësit në vëzhgimin e saj (pamja e shkronjës, pozita e vijave dhe krahasimi me shkronjat e tjera të mësuara).</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Nxënësit vëzhgojnë vijat e shkronjës, e analizojnë dhe e shkruajnë atë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Plotësim e lexim</p> <p>2. Këshillë shokut</p> <p>3. Shkrimi i shkronjës</p> <p>4. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon të shkruhen fjalët në Abetare, lexohen fjalët dhe fjalia.</p> <p>2. Ndan etiketa me emrat e nxënësve të klasës. Shpjegon detyrën: “Shkruaji një këshillë shokut, emrin e të cilit e ke në dorë, që të shkruajë pa gabime.”</p> <p>3. Shkruan shkronjën <b>Sh, sh</b>, të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>Sh, sh</b>. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares.</p> <p>4. Shkruani fjalë me shkronjën <b>Sh</b>.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë.</p> <p>2. Nga kutia bëjnë tërheqjen e emrit të një shoku të klasës.</p> <p>3. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta dhe fjali me shkronjën <b>Sh</b>.</p>

## Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali. Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shporta, shkronja, shtata.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Sh</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën <b>sh</b> të vogël të shtypit.  Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave ( <b>Sh, sh</b> )”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Sh</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>sh</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet ( <b>Sh, sh</b> ).
Hapi i dytë	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>shporta, shkronja, shtata</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? Pse?...”  Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Sh</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna (është shportë, nevojitet për të futur gjëra ...).  Lexojnë globalisht fjalët ( <b>shporta, shkronja, shtata</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>Sh</b> në kutizat ku mungon.
Hapi i tretë	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Sh sh</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Sh sh</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe pastaj punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë</p> <p>Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën</p> <p>T'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës: "Ankesa e shkronjave"</p> <p>Të dallojë titullin në pjesë</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Kreshniku, Shpresa, ankesa, shkronja.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>U tregon nxënësve se do të luajnë një lojë me librin dhe lapsin. Loja titullohet "Shpejt dhe saktë": "Hapni librin dhe gjeni rrokjet e dhëna në fjalët më poshtë, qarkojini ato".</p> <p>Udhëzon nxënësit që të lidhë fjalët në tri kolonat e dhëna për të krijuar fjali dhe t'i lexojnë ato.</p>	<p>Pasi marrin udhëzimet, nxënësit plotësojnë detyrën shpejt dhe saktë dhe duartrokiten nga mësuesja.</p> <p>Nxënësit të krijojnë fjali nga fjalët e dhëna dhe t'i lexojnë ato: Kreshniku mbushi shportën. Shokët shkuan në Prishtinë. Shpresa shkon në Shkodër.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Fillon të lexojë tekstin "Ankesat e shkronjave" dhe kërkon që nxënësit të lexojnë me vëmendje, sepse do të përgjigjen në pyetjet e bëra.</p> <p>Ndalesa e parë: Shkronjat ... Shkollë. Pyet: "Çfarë ndodhi me shkronjat? Pse nuk shkuan ato në shkollë?"</p> <p>Ndalesa e dytë: Suela ... shkruar shkoj Pyet: "Çfarë kishte ndodhur? Cilat fjalë i kishin shkruar fëmijët gabim? A bëni dhe ju gabime të tilla?"</p> <p>Ndalesa e tretë: Shkronjat ... në klasë. Pyet: "Çfarë ndodhi? Çfarë kishin shkruar shkronjat në letër? Ku shkoi mësuese Shpresa me nxënësit? Çfarë ndodhi më pas? Si do të kishit vepruar ju po të ndodhte e njëjta gjë?"</p>	<p>Dëgjojnë tekstin me vëmendje dhe u përgjigjen pyetjeve të bëra.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon nxënësit të plotësojnë ushtrimin në libër për të kuptuar tekstin.</p> <p>Nxënësit lexojnë në shtëpi tekstin: "Ankesat e shkronjave".</p>	<p>Nxënësit plotësojnë ushtrimin për të kuptuar tekstin dhe vendosin shenjat aty ku duhen.</p>

**Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Sh, sh, shkrim fjalësh (fjalish)**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës <b>Sh, sh</b> . Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël, diktim.

**Zhvillimi i mësimit**

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.” Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>Sh, sh</b> .	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Sh, sh</b> .
<b>Hapi i dytë</b>  <b>Diktim</b>	I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Sh, sh</b> .  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Sh, sh</b> dhe i udhëzon ata që t’i shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Sh, sh</b> , i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës. Dikton: “ <b>sha, shu, she, shë, shiu, shoku, Shpëtimi është shok i mirë</b> ”.	Shkruajnë shkronjën <b>Sh, sh</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>Sh, sh</b> në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë. Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.
<b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura  Detyrë shtëpie	Udhëzon: “Nga letrat me ngjyra, që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Sh, sh</b> . Vendorsini ata në këndin e shkronjave në klasë.”  Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Sh, sh</b> .	Me letrat me ngjyra që u shpërndan mësuesi, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Sh, sh</b> dhe i vendorsin në këndin e shkronjave në klasë.

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjtë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>Sh</b> në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimiti.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shkronjë, peshkatar, shitës, shofer.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	<p>Sjell në klasë letra me ngjyra dhe bashkë me nxënësit i plotësojnë ato me fjalët që thotë secila shkronjë zanore në libër.</p> <p><b>U</b> - Pse na shtrembëroni?</p> <p><b>E</b> - Më shkruani mirë!</p> <p><b>I</b> - Më shumë kujdes me mua!</p> <p><b>A</b> - Ku është vendi im?</p> <p><b>O</b> - Mos më ngatërro!</p> <p><b>E</b> - Mos më harroni!</p> <p>Të gjitha këto vendosen në një vend të klasës dhe titullohen: "Ankesat e shkronjave".</p>	
<b>Hapi i dytë</b>	<p>Udhëzohen nxënësit t'i vendosin fjalët e duhura për të plotësuar fjalitë në ushtrimin në libër. Fjalët e duhura janë: <b>peshkatar, shitës, shofer</b>. Pastaj kërkon që ata t'i lexojnë individualisht fjalitë e krijuara.</p>	<p>Plotësojnë fjalitë në libër me fjalët që mungojnë dhe i lexojnë ato individualisht.</p>
	<p>Thotë: "Ndani fjalinë në fjalë dhe tregoni sa janë".</p> <p><b>Prishtina është e bukur.</b></p> <p>Pastaj fjalinë e ndarë shkruajeni sipas modelit të dhënë në libër.</p> <p>Puno rubrikën "Thuhet/shkruhet".</p>	<p>Ndajnë fjalinë në fjalë dhe shkruajnë sipas modelit të dhënë në libër.</p>

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës F, f

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>F, f</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>F</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>F</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>F, f</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: **Abetarja, shkronja F, f, fjalori, titulli.**

### Zhvillimi i mësimimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p> <p>Pazlle</p> <p>Kompozitorët</p> <p>Përshkrimi i figurës në Abetare</p>	<p>Në tabelë ngjitet fotografia e flamurit të Shqipërisë dhe të Kosovës, e mbuluar me letra si në pazëll.</p> <p>Përgatit etiketa letre me shkronjat (<b>F, L, A, M, U, R</b>) nga një për secilin nxënës dhe kështu formon grupe. Shpjegon lojën: “Mendon një melodi të shkurtër duke i kënduar shkronjës që keni në grup”. (Mund të këndon edhe melodinë e ndonjë kënge që dini).</p> <p>Përshkruhet figura në Abetare: “Kë shihni? Çfarë bëjnë fëmijët? Çfarë kanë në duar? Si ndihen ata? Kur është Festa e Flamurit?”</p>	<p>Nxënësit i heqin një e nga një pjesët e letrës dhe e zbulojnë figurën.</p> <p>Nxënësit janë të ndarë në gjashtë grupe sipas shkronjave (<b>F, L, A, M, U, R</b>). Detyra e secilit grup është të mendojnë një melodi për shkronjën. Në shenjën e mësuesi, grupi këndon melodinë e shkurtër. Pasi këndojnë të gjitha grupet, atëherë këndojnë të gjithë si orkestër. Pas gjithë kësaj mund të këndojnë edhe këngën e flamurit nëse e dinë.</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë.</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>Gjej tingullin</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares. Analizohet fjalia: “Sa fjalë ka?” Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin <b>F</b>. “Cili tingull përsëritet? Ky tingull i takon bashkësisë së zanoreve apo të bashkëtingëlloreve? Pse?”</p> <p>2. Gjeni fjalë që kanë tingullin <b>F</b>, në fillim, në mes ose në fund të fjalës.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli <b>F</b>”.</p> <p>Thonë: “Ky tingull është bashkëtingëllore”.</p> <p>2. Gjejnë fjalë dhe përcaktojnë vendndodhjen e tingullit.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Alfabeti i murit</p> <p>3. Ndërtimi i shkronjës</p>	<p>1. Shkruan shkronjën F, f, në tabelë ose i paraqet me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, F, dhe të voglës të shtypit, f.</p> <p>2. U tregon nxënësve shkronjën e murit, udhëheq nxënësit në vëzhgimin e saj (pamja e shkronjës, pozita e vijave dhe krahasimi me shkronjat tjera të mësuara).</p> <p>3. Kërkon të punojnë shkronjën me lapsa.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Nxënësit vëzhgojnë vijat e shkronjës, e analizojnë dhe e shkruajnë atë.</p> <p>3. Punojnë shkronjën me lapsa.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Plotësim e lexim</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon të shkruhen fjalët në Abetare, lexohen fjalët dhe fjalia.</p> <p>2. Shkruan në tabelë shkronjën F, f, të shtypit dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën F, f. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares.</p> <p>3. Vizato qytetin tënd në Ditën e Flamurit.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta dhe fjalinë me shkronjën F.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën F të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën f të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (F, f)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën F të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën f të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (F, f).</p>



<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (<b>flamuri, flutura, fruta, flaka</b>). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>F</b> në kutizat ku mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna. Lexojnë globalisht fjalët (<b>flamuri, flutura, fruta, flaka</b>) dhe shkruajnë shkronjën <b>F</b> në kutizat ku mungon.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>F, f</b> në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>F f</b>, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe pastaj punojnë individualisht.</p> <p>Nxënësit pasi bëjnë detyrën shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e vjershës “Flamuri”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: himni, flamur, vjershë.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p>Motivimi</p>	<p>Lëshon himnin e flamurit në klasë dhe e këndon atë bashkë me nxënësit.</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë himnin e flamurit, dhe pastaj e këndojnë atë bashkë me mësuesin.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndan etiketa, ku janë shkruar vargjet veç e veç të vjershës së flamurit dhe i udhëzon ata, që me anë të etiketave, të ndërtojnë vjershën, ashtu siç është në libër, pastaj t’i hapin librat dhe të krahasojnë atë që kanë bërë me atë që është në libër.</p>	<p>Nxënësit në grupe, me etiketa ku janë shkruar vargjet e vjershës “Flamuri”, përpiqen të rendisin si duhet për të krijuar vjershën “Flamuri” si në libër. Pasi bëjnë punën, hapin librat dhe e krahasojnë vjershën e tyre me atë që është në libër. Rregullojnë përsëri etiketat nëse është e nevojshme.</p>

Hapi i tretë  Detyrë shtëpie	Bisedon me nxënësit për festën e 28 Nëntorit dhe i udhëzon të pikturojnë stemën e 100-vjetorit të Pavarësisë. Nxënësit mësojnë vjershën “Flamuri” përmendsh.	Pikturojnë stemën e 100-vjetorit të Pavarësisë.
------------------------------------	---	---

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës F, f. Shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës F, f. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronjat e shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël, diktim.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.” Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>F, f</b> .	Nxënësit veprojnë ashtu siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>F, f</b> .
Hapi i dytë	I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>F, f</b> .  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>F, f</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>F, f</b> ; i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësoni ushtrimet në Abetaren e Punës. Dikton: “ <b>fa, fu, fi, fe, flamur, flakë, festë Festa e Flamurit</b> ”.	Shkruajnë shkronjën <b>F, f</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>F, f</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë. Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.

<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat me ngjyra që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>F, f</b>. Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>F, f</b>.</p>	<p>Me letrat me ngjyra që u shpërndan mësuesi, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>F, f</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>
--	---	---

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën F në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Flaka, filmi, foka, floku, fleta.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Udhëzon që nxënësit me fjalët e dhëna të krijojnë fjali:</p> <p>Flaka _____.</p> <p>Filmi _____.</p> <p>Foka _____.</p> <p>Floku _____.</p> <p>Fleta _____.</p> <p>Fjalitë nxënësit i punojnë në çift dhe i lexojnë para të tjerëve në klasë.</p>	<p>Nxënësit punojnë në çift, i plotësojnë fjalitë dhe i lexojnë para të tjerëve.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Udhëzon nxënësit të krijojnë fjali nga grupe fjalësh të dhëna në libër dhe t'i shkruajnë ato në fletore. Do të vlerësohen për punën e bërë.</p>	<p>Nxënësit krijojnë fjali nga grupet e fjalëve dhe i shkruajnë ato në fletore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Flutura fluturon mbi lule</li> <li>2. Beni feston me Florën.</li> <li>3. Hëna flet bukur.</li> <li>4. Babi fik flakën.</li> </ol>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>Ndani fjalinë në fjalë dhe shkruajeni atë sipas modelit të dhënë.</p>	<p>Ndajnë fjalinë në fjalë dhe shkruajnë sipas modelit të dhënë me shkronja shtypi dhe shkrimi.</p>

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës J, j

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>J, j</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>J</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>J</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>J, j</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja J, j, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i></p>	<p>Shpjegon detyrën: “Kam menduar një kafshë” (ujku). Gjejeni cila është ajo. Secili prej jush mund të bëjë pyetje. Unë do të përgjigjem me <b>Po</b> ose <b>Jo</b>. Nëse përgjigjja është <b>Po</b>, atëherë ke të drejtë të bësh edhe një pyetje tjetër. Përgjigjen mund ta jepni vetëm kur t’ju vijë radha.”</p> <p>Pyet: “Cilat nga përrallat që dini, kanë si personazh ujku?”</p> <p>Sa tinguj ka fjala <b>ujku</b>? Cilët janë ata tinguj? Cilën shkronjë në këtë fjalë nuk e kemi mësuar ende?”</p> <p>Paraqet fjalën <b>KËSULËKUQA</b>, e lexon atë dhe inkurajon nxënësit që ta lexojnë (globalisht).</p>	<p>Secili nxënës bën nga një pyetje (A është kafshë e madhe?, A është e pyllit?, A është shtëpiake? ...)</p> <p>E gjejnë kafshën që ka menduar mësuesja.</p> <p>Nxënësit tregojnë titujt e përrallave që dinë (Kësulëkuqja, Dhia dhe shtatë kecat, Tre derrkucët...)</p> <p>Bëjnë analizën e fjalës <b>UJKU</b> dhe gjejnë shkronjën <b>J</b>.</p> <p>Bëjnë analizën e fjalës gjejnë shkronjën <b>J</b> dhe lexojnë fjalën (globalisht).</p>

<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik <i>Urra urra shkronja</i></p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik - <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën <b>J, j</b>.</p> <p>2. Shpjegon lojën: “Unë do të them fjalë. Sa herë të dëgjoni tingullin <b>J</b> në fjalë, do të bërtisni <b>URRA!</b>” (jastëk, lojtar, lojë, mjek, mbret, mace numëroj...) Orienton nxënësit të gjejnë dhe thonë emra ku është tingulli <b>J</b>.</p> <p>3. I ndan nxënësit në çift. Shpjegon veprimet që duhen bërë. Njëri thotë një fjalë ku është tingulli <b>J</b>, kurse tjetri e gjen vendin se ku është tingulli, pastaj ndërrojnë rolet.</p>	<p>2. E dallojnë tingullin <b>J</b> duke dëgjuar fjalët. Bërtasin <b>URRA</b> kur dëgjojnë tingullin <b>J</b>.</p> <p>Gjejnë dhe thonë emra ku është tingulli <b>J</b>.</p> <p>3. Njëri nxënës i çiftit thotë fjalën e tij, kurse tjetri e ndan fjalën në tinguj, për secilin tingull ngre njërin nga gishtat. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës. Pastaj ndërrojnë rolet.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>J, j</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>J</b> dhe të voglës së shtypit, <b>j</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurën në libër, të gjejnë, të qarkojnë dhe të plotësojnë aty ku mungon shkronja <b>J</b>.</p> <p>3. Lexon fjalinë: “<b>Kësulëkuqja u takua me ujkun</b>”. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Gjejnë, qarkojnë dhe plotësojnë aty ku mungon shkronja <b>J</b> në libër.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Formojmë shkronjën</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon: “Përpiquni që të formoni shkronjën <b>J</b> me spango”.</p> <p>2. Shkruan shkronjën <b>J, j</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>J, j</b>, si dhe të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>J</b>.</p> <p>3. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>J</b>, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Nxënësit, me anë të spangos formojnë shkronjën <b>J</b>.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>J</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>J</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: janari, ujku, lejleku.

## Zhvillimi i mësimit

	<b>Aktivitetet që bën mësuesi</b>	<b>Aktivitetet që bën nxënësi</b>
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>J</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën <b>j</b> të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave ( <b>J, j</b> )”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>J</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>j</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet ( <b>J, j</b> ).
<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>janari, ujku, lejleku</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>J</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>Janari, ujku, lejleku</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>J</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>J j</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>J j</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë, dhe pastaj punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

<b>Objektivat</b>	<b>Strategji dhe teknika</b>	<b>Ndërthurja lëndore</b>	<b>Shprehitë e të zhvilluarit</b>	<b>Burimet</b>
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Kësulëkuqja”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: Kësulëkuqe, gjuetar, ujku.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Secilit nxënës në klasë i vë në ballë një nga figurat më karakteristike të përrallave, si: (E Përhitura, Borëbardha, Sirena e vogël, Piter Pani...). Udhëzon nxënësit që të lëvizin nëpër klasë dhe të gjejnë pjesë tjera të përrallës së cilës ai i takon dhe të formojnë grupin e përrallave të tyre. Pyet: “A i njihni këto karaktere të përrallave që ju keni? Cilat janë ato? A dëshironi të lexoni përralla dhe tregime?”	Nxënësi me figurën në kokë lëviz nëpër klasë dhe gjen shokët e tij, të cilët i takojnë së njëjtës përrallë. Bëhen bashkë dhe formojnë grupin e përrallës së tyre.
Hapi i dytë	Paraqet para nxënësve titullin e përrallës “Kësulëkuqja”. Lexon përrallën. Pyet: “A e njihni këtë përrallë? Cila pjesë e saj është më e bukura? Pse?” Bisedon me nxënësit, lexon dhe punon me tekstin bashkë me ta. Pyet: “Përse vajza e kishe emrin Kësulëkuqe? Ku e dërgoi një ditë nëna e saj? Pse? Cilat janë këshillat që mami i dha para se të nisej? A e dëgjoi ajo mamin? Kë takoi në pyll? Çfarë biseduan ata? Çfarë bëri ujku, derisa Kësulëkuqja arriti në shtëpinë e gjyshes? Cili kaloi andej i pari dhe çfarë bëri ai? Përse i ndodhi Kësulëkuqes kjo ngjarje? Ç’mendoni për të?” Pyet: “Përse ekzistojnë rregullat? A jeni ndonjëherë të pabindur dhe i thyeni rregullat? Tregoni si përfundon kjo ngjarje.”	Tregojnë mbi përvojat e tyre vetjake.
Hapi i tretë	Shpjegon: “Imagjinoni se jeni në pyll dhe keni takuar Kësulëkuqen, ujkun, gjuetarin, gjyshen, mamin. Për çfarë do t’i kishit pyetur? Dramatizoni një bisedë me njërin prej këtyre personazheve.”	Dramatizojnë takimin me njërin prej personazheve të përrallës.
Detyrë shtëpie	Vizatoni pjesën më të bukur të përrallës.	

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës J, j. Shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës J, j. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël, diktim.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe të veprojnë duke ngritur dorën lart, siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke i bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.” Në këtë mënyrë i orienton ta lëvizin dorën në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës, <b>J, j</b> .	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>J, j</b> .
Hapi i dytë	I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>J, j</b> .  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>J, j</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>J, j</b> . I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësoni Abetaren e Punës.	Shkruajnë shkronjën <b>J, j</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>J, j</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.
Hapi i tretë Balona të lumtura  Detyrë shtëpie	Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>J, j</b> . Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë.”  Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>J, j</b> .	Me letrat e kolazhit që u shpërndan mësuesi, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>J, j</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.

## Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali. Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>J</b> në trup të tyre. Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: unë, ti ai, në ju, ata.



## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Përgatit fletëza me emra të personazheve nga përrallat. Thotë: “Bisedoni në grup rreth personazhit. Vizatojeni atë. Ata që dinë të shkruajnë nën figurën e dhënë të shkruajnë disa karakteristika për këtë personazh. Të tjerët le të flasin çfarë duhet të shkruhet nën figurë.”	Udhëheqësi i grupit tërheq fletëzën me një personazh të përrallave. Bisedojnë rreth këtij personazhi e vizatojnë atë dhe shkruajnë karakteristikat e tij.
<b>Hapi i dytë</b>	Udhëzohet nxënësit që të formojnë fjali me fjalët e dhëna në ushtrimin e librit dhe pasi t’i krijojnë t’i lexojnë ato me zë përpara të tjerëve.	Plotësojnë ushtrimin e dhënë në libër dhe formojnë fjali me fjalët e dhëna. Mund të përdorin rubrikën “Fjalor”.
<b>Hapi i tretë</b>	“Krijoni fjali duke përdorur fjalët që zëvendësojnë emrat ( <b>unë, ti, ai, në, ju, ata</b> ) dhe fjalitë e krijuara i diskutoni me shokun në krah.” Diskuton me nxënësit me rubrikën “Thuhet/Shkruhet”, i analizojnë fjalët e dhëna aty dhe shtojnë dhe të tjera, varësisht ku jetojnë.	Krijojnë fjali duke përdorur fjalë që zëvendësojnë emrat dhe i diskutojnë ato me shokun në krah.

### Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës V, v

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>V, v</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>V</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>V</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>V, v</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja V, v, fjalori, titulli.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i>	Fillon udhëzimin: “Iku vera, erdhi vjeshta. Ditët filluan të ftohen. Imagjiloni se ju jeni dallëndyshet. Duhet të udhëtoni shpejt në vende të ngrohta. Ngrihuni në këmbë dhe bëjeni formën se si udhëtojnë dallëndyshet në qiell.” Lexon fjalinë. Inkurajon nxënësit të bëjnë lexim individual <b>VITI DHE STINËT</b> . Pyet: “Cila shkronjë ka ngjyrë të kuqe?” Vendos etiketa në një pjesë të klasës ku ka shkruar muajt e vitit dhe thërret nxënësit të afrohen pranë muajit kur kanë ditëlindjen. Pastaj muajt i ndan me nga katër sipas stinëve dhe udhëzohet nxënësit të gjejnë stinën kur kanë lindur.	<p>Nxënësit grumbullohen në mes të klasës dhe pastaj marrin pozicionin e dallëndysheve në qiell kur fluturojnë në grup (forma e shkronjës <b>V</b>)</p> <p>Lexojnë fjalinë individualisht.</p> <p>Thonë shkronjën <b>V</b>.</p> <p>Secili nxënës afrohet tek etiketa e muajit kur ai ka lindur, pastaj, në bazë të muajve, dallon stinën kur ka lindur.</p>

<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik <i>Urra, urra, shkronja</i></p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njeh nxënësit me tingullin dhe shkronjën <b>V, v</b>.</p> <p>2. Përsëriti stinët e vitit: <b>Pranvera, Vera, Vjeshta Dimri</b>. Pyet: “Në cilën fjalë është tingulli <b>V</b>?” Kërkon që nxënësit të gjejnë fjalë të ndryshme me shkronjën ku ka tingull <b>V</b>.</p> <p>3. Kërkon që nxënësit të gjejnë fjalë të ndryshme ku tingulli <b>V</b> të jetë në fillim, në mes ose në fund të fjalës.</p>	<p>2. E dallojnë tingullin <b>v</b> duke dëgjuar fjalët.</p> <p>Nxënësit gjejnë fjalë të ndryshme, të cilat e kanë tingullin <b>V</b>.</p> <p>3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë, ngrenë njërin nga gishtat. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>V, v</b> në tabelë ose i paraqet me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit <b>V</b> dhe të voglës së shtypit <b>v</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurën në libër, të gjejnë dhe të qarkojnë shkronjën <b>V, v</b> dhe të plotësojnë me shkronja, katrorët bosh për të formuar fjalë.</p> <p>3. Lexon fjalinë: “<b>Vilma e Valoni</b> mësuan për <b>kalendarin e vitit</b>”. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë nga njëra-tjetra (madhësia, grafiku...)</p> <p>2. Gjejnë dhe qarkojnë shkronjën <b>V</b> në libër dhe plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>2. Shkruan shkronjën <b>V, v</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me këtë shkronjë. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>V</b>.</p> <p>3. Gjeni në gazeta shkronjën <b>V, v</b>, qarkojeni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>V</b> dhe vizatojnë fjalë që fillojnë me këtë shkronjë.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: vapori, violina, avioni.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën V të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën v të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizini në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (V, v)”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën V të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën v të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (V, v).
Hapi i dytë	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (vapori, violina, avioni). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën V në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna Lexojnë globalisht fjalët (vapori, violina, avioni) dhe shkruajnë shkronjën V në kutizat ku mungon.
Hapi i tretë	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit V v, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit V, v, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

## Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Kalendari i vitit”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: kalendari i vitit.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi

<p><b>Hapi i parë dhe i dytë</b> Motivimi</p>	<p>Përgatit grupe etiketash: 1. etiketa që përmbajnë stinët e vitit; 2. etiketa që përmbajnë muajt e vitit; 3. etiketa që përmbajnë ditët e javës. Së pari u shpërndan nxënësve në grupe etiketat me stinët e vitit. Thotë: “Renditni stinët e vitit me radhë dhe diskutoni punën e bërë me të tjerët në klasë.” Grupet që kanë bërë gabime i rregullojnë ato. Pastaj u shpërndan nxënësve etiketat me muajt e vitit. Thotë: “Renditni muajt e vitit me radhë dhe diskutoni punën e bërë me të tjerët në klasë. Grupet që kanë bërë gabime i rregullojnë ato.” U shpërndan nxënësve etiketat me ditët e javës. Thotë: “Renditni ditët e javës me radhë dhe diskutoni me të tjerët në klasë punën e bërë.” Grupet që kanë bërë gabime i rregullojnë ato. Në një kënd të klasës formon <i>Kalendarin e Vitit</i> dhe aty vendosin stinët, muajt dhe ditët e javës.</p>	<p>Nxënësit në grupe marrin me radhë etiketat me stinët e vitit, muajt e vitit dhe ditët e javës, i rendisin ato dhe i vendosin në këndin e klasës të titulluar <i>Kalendari i Vitit</i>.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>Lexon me zë tekstin “Kalendari i Vitit” dhe i angazhon nxënësit të lexojnë individualisht pjesë-pjesë tekstin.  Shkruajnë në fletoret e tyre stinët, muajt dhe ditët e javës.</p>	<p>Nxënësit lexojnë individualisht pjesë nga teksti “Kalendari i Vitit”.</p>

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës V, v, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës <b>V, v</b>. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël, diktim.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b>  Motivimi</p>	<p>Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsërite djathtas, bëni një vijë në mes.” Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës, <b>V, v</b>.</p>	<p>Nxënësit veprojnë, ashtu siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>V, v</b>.</p>

<b>Hapi i dytë</b>	<p>I njeh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>V, v</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>V, v</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>V, v</b>, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Dikton: “pranvera, vjeshta, vera Viti ka katër stinë”.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>V, v</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>V, v</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.</p>
<b>Hapi i tretë</b>  Balona të lumtura  Detyrë shtëpie	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>V, v</b>. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë.”</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>V, v</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>V, v</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën V në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: stinë, muajt, ditët e javës.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë dhe i dytë</b> Motivimi	<p>Ndan nxënësit në gjashtë grupe dhe u thotë atyre se dy e nga dy do të kryejnë të njëjtën detyrë. Grupet 1 dhe 2 do të punojnë me stinë e vitit, të cilat kanë gabime në drejtshkrim dhe do t'i rregullojnë ato.</p> <p>Grupet 3 dhe 4 do të punojnë me muajt e vitit, të cilat kanë gjithashtu gabime në drejtshkrim dhe do t'i rregullojnë ato.</p> <p>Grupet 5 dhe 6 do të punojnë me ditët e javës, të cilat kanë me gabime në drejtshkrim dhe do t'i rregullojnë ato.</p> <p>Për shembull: Stinë e vitit: Pravera, Era, Vieshta, Dir</p> <p>Ditët e javës: E hëne, E martë, E mërkurë, E enjte, E premte, E shtunë, E diel (Mësuesi ndjek në grupe punën e nxënësve dhe i ndihmon ata kur kanë nevojë.)</p>	

Hapi i tretë	Udhëzon nxënësit të plotësojnë kërkesat e ushtrimeve në libër dhe t'i diskutojnë ato zgjidhje me të tjerët në klasë.	Punojnë të pavarur në kërkesat e ushtrimeve në libër, i diskutojnë ato me mësuesin dhe me shokët në klasë.
--------------	--	--

### Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës LI, II

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën LI, II.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën LI në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën LI në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit LI, II sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja LI, II, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p>Hapi i parë</p> <p><i>Motivimi</i></p>	<p>- Përgatit lojën e asociacionit:</p> <p>E nxehtë Akulli E ëmbël</p> <p>Pushimet Bora E kaftë</p> <p>Deti Kohë E shkrirë</p> <p>VERË I/E FTOHTË ÇOKOLLATA AKULLORE</p> <p>Pyet: "Cilin tingull të ri e dëgjojmë te fjala akullorja?"</p>	<p>Hapin një nga një fushat e mbuluara. E gjejnë zgjidhjen.</p> <p>Bëjnë analizën e fjalës dhe gjejnë tingullin LL.</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>3. Vendosja e rrokjes në fjalë</p>	<p>1. Njoftohen nxënësit me tingullin dhe shkronjën LL, II.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të shikojnë figurën në libër: "Kë po shihni në figurë? Çfarë ka në duar? Po në figurat tjera, çfarë shihni?"</p> <p>Pyet: "Në cilat fjalë është tingulli LI? Gjeni dhe ju disa fjalë që kanë tingullin LI?"</p> <p>3. Lexoni fjalët dhe qarkoni rrokjet në fjalët e dhëna. Tregoni ku është rrokja, në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>	<p>1. Përshkruajnë figurën qendrore në libër dhe emërtojnë figurat e tjera të dhëna.</p> <p>Nxënësit dëgjojnë dhe gjejnë tingullin LI në fjalët e dhëna. Gjejnë fjalët e reja me tingullin LI.</p> <p>3. Ndajnë fjalën në rrokje dhe qarkojnë rrokjen e dhënë në libër. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet rrokja: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>LI, II</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>LI</b> dhe të voglës së shtypit, <b>II</b>.</p> <p>2. Lexon fjalinë: <b>“Arush veshllapushi mori akullore”</b> Pyet: <b>“Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</b></p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Formimi i shkronjës</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon: Formoni shkronjën <b>LI</b> me lapsa.</p> <p>2. Shkruan shkronjën <b>LI, II</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>LI, II</b>. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>LI</b>.</p> <p>3. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>LI</b>, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini në klasë.</p>	<p>1. Formojnë shkronjën <b>LI</b> me lapsa.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>LI</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>LI</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: kukulla, akullore, molla.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>LI</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>II</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: <b>“Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (LI, II)”</b>.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>LI</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>II</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>LI, II</b>).</p>

Hapi i dytë	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>kukulla, akullore, molla</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën LI në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>kukulla, akullore, molla</b> ) dhe shkruajnë shkronjën LI në kutizat ku mungon.
Hapi i tretë	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit LI, II, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit LI II, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Nxënësit pasi bëjnë detyrën shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Kush e hëngri akulloren?”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: akullore, arushi.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	“Përshkruani akulloren: Si duket akullorja? Si është nëse e prek? Si është nëse e provon? Çfarë ngjyre ka? Kush e pëlqen më shumë?”	Nxënësit përshkruajnë akulloren duke u përgjigjur në pyetjet që drejton mësuesi. Ata japin mendime të ndryshme dhe debatojnë me njëri-tjetrin nëse nuk pajtohen. Mësuesi drejton bisedën.



<b>Hapi i dytë</b>	Lexon vjershën: “Kush e hëngri akulloren?” dhe pyet nxënësit: “A ju bëri për të qeshur kjo vjershë? Pse? Pse arushi kërkoi dy akullore? Çfarë gabimi bëri arushi me akulloren? Si do të kishit vepruar ju po të ishit në vend të tij? Çfarë mendoni se i tha mami arushit për akulloren?”	Nxënësit lexojnë vjershën bashkë me mësuesin dhe u përgjigjen pyetjeve të bëra.
<b>Hapi i tretë</b>	Kërkon që nxënësit të vizatojnë akulloren e tyre me shijen e parapëlqyer dhe të shkruajnë disa fjali për të. Punohet rubrika “Thuhet/Shkruhet”.	Nxënësit vizatojnë akulloren e tyre të parapëlqyer dhe shkruajnë disa fjali për të.

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës LI, II, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës LI, II. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël, llamba.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë siç i drejton mësuesi. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.” Në këtë mënyrë, mësuesja i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës LI, II.	Nxënësit veprojnë, ashtu si i orienton mësuesi duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, LI, II.

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>I njeh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit LI, II.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit LI, II dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit LI, II, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësojnë Abetaren e Punës Dikton: “llamba, molla e ëmbël Unë i ha shumë mollët”.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën LI, II të shkrimit të dorës në fletç të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës LI, II në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit LI, II. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë.”</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit LI, II.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që u shpërndan mësuesi, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit LI, II dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën LI në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: kukulla, shalli, populli.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Shkruan në tabelë fillimet e fjalive dhe kërkon që nxënësit të vazhdojnë t'i përfundojnë ato: Kukulla e Mirës _____ Shalli i Llambit ka _____ Populli ynë ka _____</p>	<p>Nxënësit përfundojnë fjalitë e nisura në tabelë nga mësuesit: Kukulla e Mirës ka flokë të verdhë. Shalli i Llambit ka vija të bardha. Populli im ka kulla prej guri.</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të formojnë fjali nga bashkësi fjalësh të dhëna në libër, për të cilat ata do të vlerësohen.	Nxënësit formojnë fjali me bashkësi fjalësh të dhëna si: Akullorja kullon pikë-pikë. Dielli është në qiell. Pëllumbi solli letrën. Drini mori akulloren.
<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit që me grupe fjalësh të dhëna të krijojnë fjali. shumë        janë ullinj        e kuqe në            mollët ka            të ëmbla Shqipëri	Nxënësit krijojnë fjali nga grupe fjalësh të dhëna: 1. Në Shqipëri ka shumë ullinj. 2. Mollët e kuqe janë të ëmbla.

### Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Q, q

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehësit e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Q, q</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Q</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>Q</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Q, q</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim,</p> <p>muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Q, q, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i>	<p>Vendos në tabelë etiketa me këto fjalë: <b>Qeni, Era, Rëra, Shiu, Iriqi</b> dhe kërkon që nxënësit të shkëpusin shkronjat e para të secilës fjalë.</p> <p>Pyet: "Cilën fjalë formuat? Kur piqen qershitë? Si duken ato?"</p> <p>- Lexon fjalinë. Inkurajon nxënësit të bëjnë lexim individual: <b>QERSHITË U POQËN</b></p> <p>-Pyet: "Cilat shkronja kanë ngjyrë të kuqe?"</p>	<p>Nxënësit shkëpusin shkronjën e parë të fjalëve të dhëna dhe formojnë fjalën e re (<b>Qershi</b>).</p> <p>Thonë fjalën <b>qershi</b> dhe tregojnë (që piqen në qershor, ngjyrën, formën, madhësinë, shijen...)</p> <p>Individualisht lexojnë fjalinë.</p> <p>Thonë shkronjën <b>Q</b>.</p>

<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën <b>Q, q</b>.</p> <p>2. Shpjegon lojën: “Secili do të imagjinojë një objekt që ka shkronjën <b>Q</b>. Do ta përshkruani atë me disa fjali përpara shokëve në klasë. Kush e gjen vazhdon lojën.”</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të shohin figurat në libër dhe t’i emërtojnë ato. Pyet: “Ku është tingulli <b>Q</b>?”</p>	<p>2. E mendojnë atë gjë. Thonë p.sh., është diçka që hyn në bashkësinë e perimeve. Mami e përdor për të përgatitur gjellën. Sa herë e qëron i dalin lotët ... (edhe hahet edhe qahet).</p> <p>3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë, ngrenë gishtin. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku shkronjës</p> <p>2. Kërkoj fjalën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Q, q</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik mes shkronjës së madhe të shtypit, <b>Q</b> dhe të voglës së shtypit, <b>q</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e nevojshme për të krijuar fjalën.</p> <p>3. Lexon fjalinë: <b>Në qershor piqen qershitë.</b> Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Plotësojnë katrorët bosh dhe krijojnë fjalën.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Formo shkronjën</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon: “Formoni shkronjën <b>Q</b> me mjete të ndryshme (fasule, kokrra orizi, spango etj.).</p> <p>2. Shkruan shkronjën <b>Q, q</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>Q, q</b>. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Q</b>.</p> <p>3. Gjeni në gazeta shkronjën <b>Q, q</b>, t’i qarkojë dhe t’i sjellë të nesërmen në klasë.</p>	<p>1. Me anë të mjeteve të ndryshme formojnë shkronjën <b>Q</b>.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>A</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Q</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: qengji, manushaqe, qen.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Q</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën <b>q</b> të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave ( <b>Q, q</b> )”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Q</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>q</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet ( <b>Q, q</b> ).
Hapi i dytë	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>qengji, manushaqe, qeni</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Q</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>qengji, manushaqe, qeni</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>Q</b> në kutizat ku mungon.
Hapi i tretë	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Q, q</b> në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur. Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Q q</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë, dhe pastaj punojnë individualisht.  Nxënësit pasi bëjnë detyrën shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “U poqën qershitë”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: Qemali, qershi, qershor.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Pyet: “Çfarë karakteristikash ka muaji Qershor? Numëroni disa prej tyre”.	Nxënësit mendojnë dhe përgjigjen për pyetjet që shtrohen. (Në qershor piqen qershitë, fillon stina e verës, përfundon viti shkollor, fillojnë pushimet verore...).
Hapi i dytë	Fillon bisedën me fjalinë që nxënësit e kanë thënë më parë: “Në qershor piqen qershitë” dhe u thotë atyre se titulli i tekstit që do të mësojnë është: “U poqën qershitë”. Lexon tekstin dhe udhëzon nxënësit të dëgjojnë me vëmendje, sepse më pas do të përgjigjen në pyetje. Pyet: “Cili muaj ishte dhe cilat fruta ishin pjekur? Ç’bënë fëmijët? A do të kishit vepruar edhe ju njëlloj? Cili ishte gabimi që bënë fëmijët? Pse i qortoi xhaxhi Qemali? Si mendoni ju me cilat fjali fëmijët i kërkuan falje xhaxhi Qemalit?”	Bisedojnë për titullin e tekstit dhe u përgjigjen pyetjeve që bën mësuesi, mendojnë, argumentojnë etj.
Hapi i tretë Detyrë shtëpie	Udhëzon nxënësit që të përshkruajnë qershinë si frutë dhe të shkruajnë diçka rreth saj. Lexoni në shtëpi tekstin: “U poqën qershitë”.	

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Q, q, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës <b>Q, q</b> . Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart të veprojnë siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.” Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>Q, q</b> .	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Q, q</b> .

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>I njeh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Q, q</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit, <b>Q, q</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Q, q</b>, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Dikton: <b>“qan, qep Shoku im quhet Qemal”</b>.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>Q, q</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>Q, q</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që u kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Q, q</b>. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë.”</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Q, q</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Q, q</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, dhe ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>Q</b> në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: skeda.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Udhëzon nxënësit të hapin tekstin “U poqën qershitë” dhe të qarkojnë të gjitha fjalët që kanë shkronjën <b>q</b>, pastaj të numërojnë se cila fjalë është përsëritur disa herë në tekst.</p>	<p>Nxënësit qarkojnë fjalët që kanë shkronjën <b>q</b> dhe numërojnë se cila fjalë është përsëritur disa herë në tekst.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të plotësojnë skedën e dhënë në libër, duke krijuar fjali me fjalët e dhëna.</p> <p>Pastaj të plotësojnë ushtrimin ku gjejnë rrokjen në fjalët e dhëna dhe e qarkojnë atë.</p> <p>Bisedon për rubrikën “Thuhet/Shkruhet” dhe shton fjalë të tjera nga zona ku jeton.</p>	<p>Nxënësit krijojnë skedën dhe krijojnë fjalitë.</p> <p>Plotësojnë ushtrimin dhe gjejnë rrokjet në fjalët e dhëna, i lexojnë ato me kujdes duke e shqiptuar mirë tingullin <b>q</b>.</p>

Hapi i tretë	U jep detyrë nxënësve që të shkruajnë nga një fjali, të cilën do ta lexojnë individualisht dhe do ta vendosin në një kënd të klasës.	Nxënësit e shkruajnë individualisht dhe e lexojnë fjalinë, pastaj e vendosin në këndin e klasës.
--------------	--	--

### Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Gj, gj

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Gj, gj</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Gj</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>Gj</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>GJ, gj</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Gj, gj, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë <i>Motivimi</i>	<p>Ndan nxënësit në grupe. Secili grup do të përgatisë një gjëegjëzë, do ta thotë para të tjerëve në klasë, të cilët do të përipiqen të gjejnë gjëegjëzën.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shikojnë figurën në libër: “Kë shihni në figurë? Si duken fëmijët? Çfarë po bëjnë ata? Cilin tingull të ri dëgjojmë te fjalët <b>gjëegjëza, gjyshi</b>? A dini ta shkruani këtë fjalë? Cilën shkronjë duhet të mësojmë për të shkruar këtë fjalë?”</p>	<p>Nxënësit formojnë grupet, përgatisin gjëegjëzën dhe mundohen të gjejnë gjëegjëzat që lexojnë të tjerët.</p> <p>Shikojnë figurën dhe përgjigjen në pyetjet e shtruara.</p> <p>Bëjnë analizën e fjalëve <b>gjëegjëza, gjyshi</b> duke dalluar tingujt. Dallojnë shkronjën që duhet mësuar.</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njoftohen nxënësit me tingullin dhe me shkronjën <b>Gj, gj</b></p> <p>Lexon bashkë me nxënësit fjalinë: <b>Gjyshi tregon gjëegjëza</b>.</p> <p>Pyet: “Në cilat fjalë dëgjoni tingullin <b>Gj</b>?”.</p> <p>3. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë figurat e dhëna në libër.</p> <p>Pyet: “Ku është tingulli <b>Gj</b>?”.</p>	<p>2. Lexojnë fjalinë. Thonë fjalët në të cilat dëgjojnë tingullin <b>Gj</b>.</p> <p>3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë, ngrënë nga një gisht. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>



<p><b>Hapi i dytë</b> 1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Gj, gj</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>Gj</b> dhe të voglës së shtypit, <b>gj</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurat në libër dhe të plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe të formojnë fjalën sipas numrit të dhënë afër figurës.</p> <p>3. Lexon fjalinë: <b>“Gjyshi tregon gjëgjëza”</b>. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe formojnë fjalën, i lexojnë fjalët e formuara.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja</p>
<p><b>Hapi i tretë</b> 1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>2. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Gj, gj</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>Gj, gj</b>. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Gj</b>.</p> <p>2. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>Gj</b>, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>Gj</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Gj</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjale, fjali. Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: gjarpri, gjashta, qengji.

#### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Gj</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën <b>gj</b> të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>Gj, gj</b>)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Gj</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>gj</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>Gj, gj</b>).</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (<b>gjarpri, gjashta, qengji</b>). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Gj</b> në kutizat ku mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna Lexojnë globalisht fjalët (<b>gjarpri, gjashta, qengji</b>) dhe shkruajnë shkronjën <b>Gj</b> në kutizat ku mungon.</p>

<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Gj, gj</b>, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Gj, gj</b>, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.</p> <p>Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>
----------------------------	--	---

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë gjëegjëzat. Të gjejë zgjidhjet e gjëegjëzave. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: top, laps, mollë.

#### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Udhëzon nxënësit që të nxjerrin gjëegjëzat, të cilat kanë pasur për detyrë t'i sjellin në klasë. Ata duhet t'i lexojnë dhe t'i diskutojnë ato në grup dhe të zgjedhin njëren gjëegjëzë, të cilën do ta thonë para të tjerëve në klase.</p>	<p>Nxënësit lexojnë secilën gjëegjëzë në grup dhe pastaj zgjedhin njëren për ta thënë përpara të tjerëve në klasë. Kjo punë përsëritet në të gjitha grupet.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Udhëzon nxënësit që të lexojnë gjëegjëzat në libër dhe të shkruajnë zgjidhjen e secilës gjëegjëzë në vendin përkatës.</p>	<p>Nxënësit lexojnë gjëegjëzat dhe shkruajnë zgjidhjen për secilën veç e veç.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>I shpërndan secilit grup nga një objekt (top, laps, mollë, elefant, çokolatë...) dhe i udhëzon që me pak fjalë, të thonë një gjëegjëzë për objektin që kanë.</p>	<p>Secili grup merr objektin që mësuesi u jep dhe krijojnë një gjëegjëzë për të.</p>

## Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Gj, gj, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës <b>Gj, gj</b> . Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronjë e madhe, shkronjë e vogël.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë siç i drejton ai. Thotë: "Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes." Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës, <b>Gj, gj</b> .	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Gj, gj</b> .
<b>Hapi i dytë</b>	I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Gj, gj</b> .  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Gj, gj</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Gj, gj</b> . I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësoni faqet në Abetaren e Punës.  Dikton: " <b>Gjuha, gjeli, gjethe</b> <b>Gjuha shqipe është e bukur</b> ".	Shkruajnë shkronjën <b>Gj, gj</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>Gj, gj</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.
<b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura  Detyrë shtëpie	Udhëzon: "Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Gj, gj</b> . Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë".  Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit, <b>Gj, gj</b> .	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Gj, gj</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.

## Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>Gj</b> në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Gjakova, Gjirokastra, Gjadri.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shkruan në tabelë fjalën: "Gjuha shqipe" dhe kërkon që nxënësit të shkruajnë nga një fjali për gjuhën shqipe. Fjalitë e bukura i vendos në këndin e klasës që e titullon "Gjuha jonë".	Nxënësit shkruajnë individualisht fjali për gjuhën shqipe dhe i vendosin ato në këndin e klasës.
<b>Hapi i dytë</b>	Udhëzon nxënësit të plotësojnë ushtrimet në libër: 1. Qarkojnë rrokjet në fjalët e dhëna dhe i lexojnë ato. 2. Lidhin me shigjetë rrokjen me pjesën tjetër të fjalës. 3. Shkruajnë fjali duke plotësuar atë me fjalën që mungon.	Nxënësit qarkojnë, lidhin me shigjetë dhe shkruajnë fjali sipas udhëzimeve në libër.
<b>Hapi i tretë</b>	Kërkon që nxënësit në grup të gjejnë deri në pesë emra që kanë shkronjën <b>gj</b> dhe që janë sende, kafshë, emra apo qytete.	Nxënësit në grup përpiqen të gjejnë emra të sendeve, kafshëve, emra njerëzish apo edhe qytetesh.

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës B, b

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>B, b</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>B</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>B</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>B, b</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja B, b, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i> <i>Unë tregoj</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>“Imagjino sikur je flokë bore. Çfarë do të bëje?”</p> <p>Udhëzohen nxënësit të vëzhgojnë në Abetare. “Çfarë shohim në figurë? Cila stinë është? Si duket qyteti? Si ndihen fëmijët?”</p>	<p>Imagjinojnë sikur janë flokë bore.</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë.</p>
<p>1. Punim i tingullit Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik-Loja: Është e njohur për mua</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares. Analizohet fjalia: “Sa fjalë ka?” Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin B. “Cili tingull përsëritet? Ky tingull i takon bashkësisë së zanoreve apo të bashkëtingëlloreve? Pse?”</p> <p>2. Udhëheq lojën. Flet për diçka që nxënësve u pëlqen të hanë: është si hënë e re, qërohet, është e butë dhe shumë e shijshme... Lojën e vazhdojnë nxënësit.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli B”. Thonë: “Ky tingull është bashkëtingëllore”.</p> <p>2. Gjejnë sendin që përshkroi mësuesi. Më pas përshkruajnë ushqime që kanë tingullin <b>B</b>. Shokët e gjejnë.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Alfabeti i murit</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>B, b</b>, në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>B</b> dhe të voglës së shtypit, <b>b</b>.</p> <p>2. U tregon nxënësve shkronjën e murit, udhëheq nxënësit në vëzhgimin e saj (pamja e shkronjës, pozita e vijave dhe krahasimi me shkronjat tjera të mësuara).</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Nxënësit vëzhgojnë vijat e shkronjës, analizojnë dhe shkruajnë atë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Plotësim dhe lexim</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon të shkruhen shkronjat që mungojnë në fjalët e Abetares, lexohen fjalët dhe fjalja.</p> <p>2. Shkruan shkronjën <b>B, b</b>, të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>B, b</b>. Shkruhen fjalët nga libri i Abetares.</p> <p>3. Shkruaj fjalët dhe fjalinë nga libri i Abetares.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta dhe fjalë me shkronjën <b>B</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël, bleta, bebi, banane.

### Zhvillimi i mësimimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>B</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën <b>b</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>B, b</b>)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>B</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>b</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>B, b</b>).</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (<b>bleta, bebi banana</b>). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...”</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>B</b> në kutizat ku mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna (është bleta, nevojitet për t’i marrë mjaltin, mua më pëlqen mjalti...)</p> <p>Lexojnë globalisht fjalët (<b>bleta, bebi, banana</b>) dhe shkruajnë shkronjën <b>B</b> në kutizat ku mungon.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>B, b</b>, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>B, b</b>, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.</p> <p>Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>

### Ora e tretë. Tema: Lexim teksti, grupe fjalësh dhe fjalish

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë.</p> <p>Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën.</p> <p>T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Burrë bore”.</p> <p>Të dallojë titullin në pjesë.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: burrë borë, dordolec.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Gjeni: “Një djalë, një ditë pranvere hodhi shikimin në oborrin e shokut të tij Benit. U çudit kur pa në një pjesë të oborrit një karotë, një fshesë, një kovë, një shall, disa kopsa, të gjitha ishin në një vend. Beni pyeti veten: Pse janë të gjitha këto gjëra në një vend? Po shkoj ta pyes Benin (Çfarë do t’i ketë thënë Beni?).”</p>	<p>Nxënësit mendojnë dhe përgjigjen se kjo gjëja mund të ketë qenë burrë bore (ata mund të thonë dhe njeri prej bore ose dordolec).</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Lexon tekstin me ndalesa dhe bën pyetje.          Ndalesa e parë: Tërë natën...qytetin          Pyet: “Çfarë ka ndodhur natën? Kë ka mbuluar bora? A ka ndodhur ndonjëherë kjo gjë në vendin ku ju jetoni?”</p> <p>Ndalesa e dytë: Babi... flokë-flokë.          Pyet: “Kush ka dalë në oborr? Pse babi doli me fëmijët? Çfarë do të bëjnë ata?”</p> <p>Ndalesa e tretë: Ata po... u bë ai.          Pyet: “A ndodhi ashtu si menduat? Secili prej tyre bëri nga një pyetje. Cilat ishin ato? A keni bërë ju ndonjëherë burrë bore(dordolec)? A ishte i bukur si ky në figurë?”</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë leximin që bën mësuesi dhe përgjigjen për pyetjet e bëra. Flasin për përvojat.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të lexojnë tekstin “Burrë borë” në formën zinxhirore (Njëri lexon, vazhdon tjetri.)          Udhëzon të plotësojnë ushtrimin për të kuptuarin e tekstit dhe i vlerëson ata.</p>	<p>Nxënësit lexojnë në formën zinxhir dhe plotësojnë ushtrimin për të kuptuarin e tekstit.</p>

### Ora e katërt. Tema:Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës B, b, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës B, b.            Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup            Punë në dyshe            Bashkëbisedim            Dramatizim</p>	<p>Të folurit            Art/vizatim, muzikë            Matematikë            Dramë</p>	<p>Të lexuarit global            Të folurit            Imagjinata            Të dëgjuarit            Të zhvilluarit e vëmendjes            Të analizuarit            Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shkronja madhe, shkronja e vogël.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b>            Motivimi</p>	<p>Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart të veprojnë ashtu si i drejton ai.            Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.”            Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu si janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës B, b.</p>	<p>Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, B, b.</p>



<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p><b>Diktim</b></p>	<p>I nje nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit, <b>B, b</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>B, b</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>B, b</b>, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Plotësoni ushtrimet në Abetaren e Punës. Dikton: “<b>ba, bi, bu, be, babi, bota, buka Babi im bleu makinë</b>”.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>B, b</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>B, b</b> në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.</p> <p>Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat me ngjyra që u kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>B, b</b>. Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë”.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>B, b</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>B, b</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën B në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: burrë bore, dordolec.

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Në grupet e formuara shpërndan etiketa ku janë shkruar veç e veç të gjitha fjalitë e tekstit “Burrë bore”. Kërkon që nxënësit t’i rendisin etiketat me fjali, ashtu si është i ndërtuar vetë teksti “Burrë bore”.</p>	<p>Në grupe marrin etiketat me fjali dhe ato i rendisin në mënyrë që të krijojnë njëjtë si në libër tekstin “Burrë bore”. E lexojnë atë.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Udhëzon të plotësojnë ushtrimin e rrokjeve: Lexoni me kujdes rrokjet dhe fjalët përbri. Lidhni me shigjetë rrokjet me fjalë sipas udhëzimit në libër.</p>	<p>Nxënësit lexojnë rrokjet dhe fjalët dhe i lidhin ato me shigjetë, sipas udhëzimit në libër.</p>

<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>Gjeni sa fjalë ka fjalia “Bebi ka biberon”. Shkruajeni atë në libër me shkronja të shkrimit.</p> <p>Bisedon për nxënësit për rubrikën “Thuhet/ Shkruhet”. Thotë: “Këtu janë disa fjalë që ndryshe thuhen, ndryshe shkruhen. Ju duhet të mësoni se si shkruhen drejt ato.” (Mësuesi ka mundësi të shtojë dhe fjalë të tjera, në varësi të zonës ku punon.)v</p>	<p>Nxënësit gjejnë që fjalia: “Bebi ka biberon”, ka tri fjalë dhe e shkruajnë atë në libër.</p>
----------------------------	---	---

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës H, h

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën H, h.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën H në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën H në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit H, e, sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> individualisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Punëdore</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja H, h, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p><i>Motivimi</i></p> <p><i>Gjëegjëza</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>Tregohet gjëegjëza: “Herë e plotë, herë e re, por gjithnjë me dritë je.”</p> <p>Udhëzon nxënësit të vëzhgojnë në Abetare: “Kë shohim në figurë? Si e ka emrin vajza? Me kë bisedon ajo? Çfarë kanë të përbashkët ato? Imagjino se çfarë bisedojnë ato.”</p>	<p>Thonë: “Hëna”.</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë (biseda mes Hënës dhe Hënës...).</p>

<p>1. Punim i tingullit- Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik Loja- <i>Ejani këtu</i></p> <p>3. Ndërto shkronjën</p> <p>4. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik: Abetarja- kërkoj tingullin. Fjala nën figurë</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares. Analizohet fjalia: “Sa fjalë ka? Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin H. Cili tingull përsëritet? Ky tingull i takon bashkësisë së zanoreve apo të bashkëtingëlloreve? Pse?”</p> <p>2. Fton të dalin para të tjerëve nxënësit, emri ose mbiemri i të cilëve përmban tingullin H.</p> <p>3. Kërkon që nxënësit të ndërtojnë shkronjën me lapsa.</p> <p>4. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë figurat në Abetare. Pyet: “Ku është tingulli H?”</p>	<p>1. Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli H”.</p> <p>Thonë: “Ky tingull është bashkëtingëllore”.</p> <p>2. Tregojnë vendndodhjen e tingullit H.</p> <p>3. Punojnë shkronjën me lapsa.</p> <p>4. Ndajnë fjalën në tinguj. E përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>3. Kërkoj shkronjën</p>	<p>1. Shkruan shkronjën H, h në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, H dhe të voglës së shtypit, h.</p> <p>3. Udhëzon nxënësit të vërejnë fotografinë në Abetare të gjejnë dhe qarkojnë shkronjën H. Gjithashtu shkruajnë shkronjat që mungojnë në fjalë.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>3. Gjejnë, qarkojnë dhe shkruajnë shkronjat në Abetare. Ndajnë fjalët në rrokje dhe tregojnë numrin e tyre.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën H, h dhe disa fjalë që kanë këtë shkronjë.</p> <p>3. Vizatojnë personazhin e Hirushes dhe shkruajnë emrat e personazheve tjera.</p>	<p>1. Shkruajnë në fletore shkronjën dhe disa fjalë.</p>

## Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali. Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: krahu, harku, hekuri.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën H të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën h të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (H, h)”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën H të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën h të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (H, h).
Hapi i dytë	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>krahu, harku, hekuri</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën H në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna (është hekuri, nevojitet për të hekurosuar,...) Lexojnë globalisht fjalët ( <b>krahu, harku, hekuri</b> ) dhe shkruajnë shkronjën H në kutizat ku mungon.
Hapi i tretë	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit H, h, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit H, h, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

## Ora e tretë. Tema: Lexim teksti, grupe fjalësh dhe fjalish

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Hëna”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: hëna, dielli, planetë.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Vendos etiketa në tabelë, të cilat nxënësit i renditin dhe krijojnë fjali.  1. Hektori 2. Holta 3. Hasani  Harkun këpucën kapakun  Humbi kërkon hapi	Nxënësit me etiketat e paraqitura krijojnë fjalitë:  1. Hektori humbi harkun.  2. Holta kërkon këpucën.  3. Hasani hapi kapakun.
<b>Hapi i dytë</b>	Pyet: “Cilët nga këta emra janë dhe emra njerëzish: Dielli, libër, Hëna, pema, pranvera, lapsi... A dini dhe ndonjë emër tjetër të ngjashëm me këta?” (Ndihmon nxënësit të thonë disa emra planetësh)  Lexon tekstin “Hëna” dhe pyet fëmijët për bisedën që bëjnë Hëna vajzë dhe Hëna e qiellit. “A Ju pëlqeu teksti? Cila pjesë ju pëlqeu më tepër? Përse? Cilat janë motrat e Hënës në qiell?”	Nxënësit gjejnë se emrat e njerëzve janë emrat: Dielli, Hëna, Pranvera, Mërkuri, Marsi, Venera...  Dëgjojnë tekstin me vëmendje, u përgjigjen pyetjeve të bëra dhe thonë emrat e planetëve dhe të yjeve në qiell.
<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin “Hëna” individualisht dhe të qarkojnë që kanë shkronjën H.	Lexojnë tekstin individualisht dhe qarkojnë fjalët me shkronjën H.

**Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës H, h, shkrim fjalësh (fjalish)**

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës H, h. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronjë e madhe, shkronjë e vogël.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini dorën me të cilën shkruani lart, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes”. Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës H, h.	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, H, h.

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>I njeh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>H, h</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>H, h</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>H, h</b>, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Plotësoni ushtrimet në Abetaren e Punës. Dikton: “<b>ha, hi, he, hu, hëna, Hëna ka hapur librin</b>”.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>H, h</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>H, h</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë. Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.</p>
<p><b>Diktim</b></p>	<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Udhëzon: “Nga letrat me ngjyra që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>H, h</b>. Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>H, h</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>H, h</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>
<p>Detyrë shtëpie</p>		

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>H</b> në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: harku, krehër, hotel.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bëjnë mësuesi	Aktivitetet që bëjnë nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Udhëzon nxënësit që të shkruajnë fjalë me shkronjën <b>H</b>, t'i thonë ato para të tjerëve dhe i shkruan në tabelë.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë fjalë me shkronjën <b>H</b> dhe i lexojnë para të tjerëve, ndërsa mësuesi i shkruan këto fjalë në tabelë.</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Udhëzon nxënësit të vërejnë figurat, të gjejnë shkronjat që mungojnë dhe të plotësojnë vijat bosh për të krijuar fjalët: <b>Harku, hapi, krehër, hotel.</b>  Thotë: “Lexoni rrokjet në hapësirat e dhëna dhe ngjyrosni hapësirat e rrokjeve me shkronjën H me ngjyrë të verdhë. Çfarë zbuluat?”	Nxënësit plotësojnë vijat bosh në figura dhe formojnë fjalët.  Lexojnë rrokjet në hapësira, ngjyrosin hapësirat me shkronjën H dhe zbulojnë Hënën.
<b>Hapi i tretë</b>	Lexoni fjalët e dhëna në ushtrimin e fundit dhe shkruajini ato sipas udhëzimit të dhënë.	Nxënësit lexojnë fjalët e dhëna dhe shkruajnë sipas udhëzimit.

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës T, t

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën T, t</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën T në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën T në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit T, t sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Punëdore</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja T, t, fjalori, titulli.

## Zhvillimi i mësimin

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p><i>Motivimi</i></p> <p><i>Asociacion</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>Paraqiten fjalët: miu, tastiera, ekrani, shtëpiza... Çfarë ju kujtojnë këto fjalë?</p> <p>Udhëzon nxënësit të përshkruajnë figurat në Abetare: “Kë shohim në figurë? Çfarë kanë ata përpara? Për çfarë përdoret kompjuteri? A e përdorni shumë atë? Çfarë tjetër shohim në dhomën e Teutës dhe Artanit?”</p>	<p>Nxënësit gjejnë zgjidhjen</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë.</p>

<p>1. Punim i tingullit - Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik <i>Kërkoj tingullin</i></p>	<p>1. Shkruhet në tabelë fjalia: “Artani e Teuta kanë kompjuter të ri”. Analizohet fjalia: “Sa fjalë ka?” Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin T. “Cili tingull përsëritet?”</p> <p>2. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë fjalë që kanë tingullin T në fillim, në mes ose në fund të fjalës.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: tingulli T.</p> <p>2. Gjejnë fjalë dhe tregojnë vendndodhjen e tingullit.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Ndërto shkronjën</p> <p>3. Kërkoj shkronjën dhe e shkruaj atë.</p>	<p>1. Shkruan shkronjën T, t në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, T dhe të voglës së shtypit, t.</p> <p>2. Kërkon që nxënësit të ndërtojnë shkronjën me lapsa.</p> <p>3. Udhëzon nxënësit të vërejnë fotografinë në Abetare, të gjejnë dhe të qarkojnë shkronjën T. Plotësojnë fjalët duke shkruar shkronjën T.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Punojnë shkronjën me lapsa.</p> <p>3. Gjejnë, qarkojnë dhe shkruajnë shkronjën T.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Lexojnë fjalët dhe fjalinë</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon: “Lexoni fjalët dhe fjalinë në Abetare”.</p> <p>2. Shkruan shkronjën T, t të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me këtë shkronjë. Shkruajnë edhe disa fjalë që fillojnë me shkronjën T.</p> <p>3. Sillni në klasë ndonjë punim të bërë në kompjuter.</p>	<p>1. Lexojnë fjalët dhe fjalitë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën T dhe disa fjalë që fillojnë me shkronjën T.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: topi, treni, patina.



## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve të shkruajnë shkronjën T të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën t të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave(T, t)”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën T të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruajnë individualisht shkronjën t të vogël të shtypit në fletën që kanë përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (T, t).
<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>topi, treni, patina</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën T në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna (është topi, nevojitet për të luajtur, mua më pëlqen topi, me të kënaqem...) Lexojnë globalisht fjalët ( <b>topi treni, patina</b> ) dhe shkruajnë shkronjën T në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit T, t, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur. Plotësoni ushtrimet në Abetaren e Punës. Dikton: “ <b>ta, to, tapa, topi, Tirana ka park të bukur</b> ”.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit T, t, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe pastaj punojnë individualisht.
	Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

## Ora e tretë. Tema: Lexim teksti, grupe fjalësh dhe fjalish

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Kompjuteri i ri”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: Artani, Teuta, kompjuter.

## Zhvillimi i mësimit

	<b>Aktivitetet që bën mësuesi</b>	<b>Aktivitetet që bën nxënësi</b>
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Udhëzon nxënësit të shikojnë figurat në libër dhe të krijojnë një ngjarje në bazë të tyre.	Nxënësit mendojnë, imagjinojnë, dhe krijojnë një ngjarje rreth figurave në libër.
<b>Hapi i dytë</b>	Pyet: “Cili nga ju ka kompjuter në shtëpi? Për çfarë shërben ai? Për çfarë e përdorni? Po anëtarët e familjes për çfarë e përdorin?”  I njuh nxënësit me titullin e tekstit, e lexon tekstin duke kërkuar që ata ta ndjekin gjatë leximit. Pyet: “Si quhen personazhet e këtij teksti? Çfarë bën Artani me kompjuter? Po Teuta? Çfarë mësojnë tjetër ata nga kompjuteri?”	Nxënësit përgjigjen në pyetjet e bëra, tregojnë për përvojat e tyre dhe për përdorimin e kompjuterit që ata bëjnë ose anëtarët e familjes.  Ndjekin mësuesin gjatë leximit dhe u përgjigjen pyetjeve të bëra.
<b>Hapi i tretë</b>  <b>Detyrë shtëpie</b>	Udhëzon nxënësit që të plotësojnë ushtrimin “Kuptojmë tekstin” dhe qarkojnë fjalët që kanë shkronjën T në tekst.  Ushetrojnë leximin e tekstit “Kompjuteri i ri” dhe shkruajnë fjalë me shkronjën T.	Plotësojnë ushtrimin “Kuptojmë tekstin” dhe qarkojnë fjalët që kanë shkronjën T në tekst.

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës T, t, shkrim fjalësh (fjalish)

<b>Objektivat</b>	<b>Strategji dhe teknika</b>	<b>Ndërthurja lëndore</b>	<b>Shprehitë e të zhvilluarit</b>	<b>Burimet</b>
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës T, t. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël.

## Zhvillimi i mësimit

	<b>Aktivitetet që bën mësuesi</b>	<b>Aktivitetet që bën nxënësi</b>
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton ai.  Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsërite djathtas, bëni një vijë në mes”.  Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës T, t.	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, T, t.

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p><b>Diktim</b></p>	<p>I njej nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit T, t.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit T, t dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit T, t. I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Plotësoni ushtrimet në Abetaren e Punës.</p> <p>Dikton: <b>“ta, ti, to, te, tu,</b></p> <p><b>Tirana ka park të bukur”.</b></p>	<p>Shkruajnë shkronjën T, t të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës T, t në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.</p> <p>Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat me ngjyra që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit T, t. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë”.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit T, t.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit T, t dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti dhe ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën T në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Tirana, Tina, Titi.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Udhëzon nxënësit të krijojnë fjali me fjalët e dhëna në grupe dhe t’i lexojnë ato:</p> <p>Tina trokiti në park.</p> <p>Tani takoi me metër.</p> <p>Meti mbeti fort.</p> <p>Titi mat motrën.</p>	<p>Nxënësit krijojnë fjali me fjalët e dhëna dhe i lexojnë ato:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tina takoi motrën.</li> <li>2. Tani trokiti fort.</li> <li>3. Meti mat me metër.</li> <li>4. Titi mbeti në park.</li> </ol>

Hapi i dytë	Thotë: “Gjeni sa fjalë janë në fjalinë; ‘Tirana është e bukur’, pastaj shkruajeni atë në vendin e caktuar në libër. Vazhdoni me ushtrimin tjetër në libër dhe plotësoni vizat bosh me shkronjat që mungojnë”.	Tregojnë sa fjalë ka fjalia, “Tirana është e bukur”, dhe e shkruajnë atë në vendin e caktuar. Plotësojnë vizat bosh me shkronjat e duhura dhe formojnë fjalët <b>komputer</b> dhe <b>termometër</b> .
Hapi i tretë	Udhëzon nxënësit të shkruajnë fjalët nën figurat e dhëna dhe të bisedojnë për to, për çfarë nevojiten dhe sa janë të rëndësishëm.	Shkruajnë fjalët nën figurat e dhëna dhe flasin për rëndësinë e secilës prej tyre.

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës K, k

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër.</p> <p>Të njohë shkronjën K, k.</p> <p>Të gjejë shkronjën K në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të shqiptojë, ta lexojë dhe ta shkruajë tingullin dhe shkronjën K, k në struktura të ndryshme fjalësh.</b></p> <p>Të gjejë dhe të lexojë struktura fjalësh e fjalish, në të cilat ndodhet shkronja K</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: tingull, shkronjë, Keli, kalë, fjalë, rrokje.

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p>Hapi i parë</p> <p><i>Motivimi</i></p>	<p>Fillon tregimin: “Ishte ditë e bukur vere. Fëmijët dolën në natyrë të luanin. U befasuan kur panë shokun e tyre K... Përfundoni ju ngjarjen, çfarë ka ndodhur në vazhdim...”</p> <p>Lexon fjalinë. Inkurajon nxënësit të bëjnë lexim individual (globalisht): <b>KELI NË KALË</b></p> <p>Pyet: “Cilat shkronja kanë ngjyrë të kuqe?”</p>	<p>Mendojnë, imagjinojnë (çfarë po bëjnë nxënësit tjerë, çfarë ka tjetër në klasë...).</p> <p>Individualisht (globalisht) lexojnë fjalinë.</p> <p>Thonë shkronjën K.</p>

<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik- <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën K, k.</p> <p>2. “Unë do të lexoj fjalinë. Sa herë ta dëgjoni tingullin K në fjalë, ngrini dorën lart.” Thotë: “Keli ka kalë”. Orienton nxënësit të gjejnë fjalë të reja ku gjendet tingulli K.</p> <p>3. Vendos në tabelë disa figura. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë ato. Pyet: “Ku është tingulli K? (karkalec, makinë, maçok, kaktus...)”</p>	<p>2. E dallojnë tingullin k duke dëgjuar fjalët në fjali dhe duke ngritur dorën lart.</p> <p>Nxënësit gjejnë dhe thonë fjalë të ndryshme me tingullin K.</p> <p>3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë ngrënë nga një gisht. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën K, k në tabelë ose e paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit K dhe të voglës së shtypit k.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurën në libër, të gjejnë dhe të qarkojnë shkronjën K.</p> <p>3. Lexon fjalinë: “Keli ka kalë”. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Gjejnë dhe qarkojnë shkronjën K në libër.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Ndërtoj shkronjën</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon: “Përpiquni që me fasule, me kokrra orizi ose me spango të formoni shkronjën K.</p> <p>2. Shkruan shkronjën K, k të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën K, k. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën K.</p> <p>3. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën K, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Me anë të mjeteve të ndryshme, nxënësit formojnë shkronjën K.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën K dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën K.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: kali, lekë, makina.

## Zhvillimi i mësimit

	<b>Aktivitetet që bën mësuesi</b>	<b>Aktivitetet që bën nxënësi</b>
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën K të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën k të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave(K, k)”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën K të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (K, k).
<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (kali, lekë, makina). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën K në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna (është leku, nevojitet për të blerë gjëra...) Lexojnë globalisht fjalët (kali, lekë, makina) dhe shkruajnë shkronjën K në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit K, k, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur. Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit K, k, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht. Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

## Ora e tretë. Tema: Lexim teksti, grupe fjalësh dhe fjalish

<b>Objektivat</b>	<b>Strategji dhe teknika</b>	<b>Ndërthurja lëndore</b>	<b>Shprehitë e të zhvilluarit</b>	<b>Burimet</b>
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Kali i Kelit”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: karamelle, Keli.

## Zhvillimi i mësimit

	<b>Aktivitetet që bën mësuesi</b>	<b>Aktivitetet që bën nxënësi</b>
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Sjellë në klasë karamete, Një karamete e mbanë në dorë, të tjerat u shpërndahen nxënësve. Kërkon që të plotësohet ushtrimi i paraqitur në tabelë. Unë kam <u>karamete</u> . Ti ke <u>karamete</u> . Ai ka <u>karamete</u> . Pastaj të gjithë i hanë kamelet dhe plotësojnë ushtrimin në vazhdim. Unë nuk kam <u>karamete</u> . Ai nuk ka <u>karamete</u> . Ne nuk kemi <u>karamete</u> .	Nxënësit bashkërisht me mësuesin plotësojnë ushtrimin e dhënë me karamete.
<b>Hapi i dytë</b>	Bisedon me nxënësit për Kelin dhe kalin e tij të cilin ata e njohin nga mësimi i mëparshëm.  Udhëzon nxënësit të lexojnë titullin e tekstit dhe fjalitë në vazhdim për të cilat pyet: “Sa fjali ka teksti? Numëroni fjalët në fjali? Qarkoni fjalët që kanë shkronjën K.”	Nxënësit lexojnë tekstin dhe u përgjigjen pyetjeve të bëra.
<b>Hapi i tretë</b>	Fillon bisedën me nxënësit me këto pyetje: “ <b>Ku</b> ishte Keli? <b>Kur</b> doli me kalë Keli? <b>Me kë</b> luante Keli?”  Vëmendje të veçantë u kushton pyetjeve: <b>Ku? Kur? Me kë?</b> Kërkon që nxënësit të plotësojnë ushtrimin rreth të kuptuarit të tekstit, të bëjnë me shenjë fjalën e duhur.	Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të bëra dhe përpiqen të krijojnë pyetje të ngjashme duke përdorur <b>Ku? Kur? Me kë?</b> .
<b>Detyrë shtëpie</b>	Lexojnë tekstin “Kali i Kelit” dhe shkruajnë disa fjali në fletore.	Plotësojnë ushtrimin sipas kërkesës në libër.

**Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës K, k, shkrim fjalësh (fjalish)**











<b>Objektivat</b>	<b>Strategji dhe teknika</b>	<b>Ndërthurja lëndore</b>	<b>Shprehitë e të zhvilluarit</b>	<b>Burimet</b>
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës <b>K, k</b> . Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël.





## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë dhe i dytë</b></p> <p>Motivimi</p> <p>Lexim dhe plotësim</p>	<p>Plotësoni me KA dhe NUK KA në vendet e caktuara.</p>          	<p>Nxënësit plotësojnë rubrikat me ka dhe nuk ka dhe thonë:</p> <p>Rosaku ka tortë.</p> <p>Kësulëkuqja ka lule.</p> <p>Lopa ka zile.</p> <p>Qeni nuk ka fustan.</p> <p>Barka nuk ka pemë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>Udhëzon nxënësit që të plotësojnë ushtrimin e dhënë në libër dhe ta shkruajnë në fletore.</p>	<p>Plotësojnë ushtrimin në libër dhe e shkruajnë në fletore.</p>

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës O, o

Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>O, o</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>O</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të shqiptojë, ta lexojë dhe ta shkruajë tingullin dhe shkronjën O, o në struktura të ndryshme fjalësh.</b></p> <p><b>Të gjejë dhe të lexojë</b> struktura fjalësh e fjalish, në të cilat ndodhet shkronja <b>O</b>.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: tingull, shkronjë, Ola, robot, fjalë, rrokje.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p><i>Motivimi</i></p>	<p>Në një qese të errët vë një orë. I afrohet secilit nxënës, që ta prekë dhe të gjejë se çfarë ka brenda, por duke e mbajtur në fshehtësi.</p> <p>“Vizatoni në fletën e bardhë atë që mendoni se është në qese”.</p> <p>Lexon fjalinë. Inkurajon nxënësit të bëjnë lexim individual (globalisht): <b>OLA ME ROBOT</b></p> <p>Pyet: “Cilat shkronja kanë ngjyrë të kuqe?”</p>	<p>Prekin orën brenda në qese pa folur. Atë që e kanë prekur dhe mendojnë se e dinë çfarë është, e vizatojnë në fletën që kanë përpara. Të gjithë përnjëherë ngrenë vizatimet dhe zbulojnë çfarë prekën në qese.</p> <p>Individualisht (globalisht) lexojnë fjalinë.</p> <p>Thonë shkronjën <b>O</b>.</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik - <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe me shkronjën <b>O, o</b>.</p> <p>2. Orienton nxënësit në fjalinë e lexuar më parë: <b>Ola me robot</b>.</p> <p>Pyet: “Në cilën fjalë është tingulli <b>O</b>?”</p> <p>Kërkon që nxënësit të gjejnë fjalë të ndryshme me shkronjën ku ka tingull <b>O</b>.</p> <p>3. Vendos në tabelë disa fotografi. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë ato.</p> <p>Pyet: “Ku është tingulli <b>O</b>?” (kockë, limon, mollë, oktapod, pallto...)</p>	<p>2. E dallojnë tingullin <b>o</b> duke dëgjuar fjalët.</p> <p>Nxënësit individualisht gjejnë fjalë të ndryshme ku ka tingull <b>O</b>.</p> <p>3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë, ngrenë nga një gisht. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>O, o</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>O</b> dhe të vogëlës së shtypit, <b>o</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe të gjejnë dhe qarkojnë shkronjën <b>O</b>.</p> <p>3. Lexon fjalinë: Ola luan me robot. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndani ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato”.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...)</p> <p>2. Gjejnë dhe qarkojnë shkronjën <b>O</b> në libër.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Dramatizim: <i>Unë jam O</i></p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon: “Përpiquni që me pjesë të trupit tuaj të formoni shkronjën <b>O</b>”.</p> <p>2. Shkruan shkronjën <b>O, o</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>O, o</b>. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>O</b>.</p> <p>3. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>O</b>, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Nxënësit me anë të pjesëve të trupit formojnë shkronjën <b>O</b>.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>O</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>O</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: ora, balona, koka.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>O</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>o</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>O, o</b>)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>O</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>o</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>O, o</b>).</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>ora, balona, koka</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>O</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna (është ora, nevojitet për të ditur kohën...) Lexojnë globalisht fjalët ( <b>ora, balona, koka</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>O</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>O o</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>O, o</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim teksti, grupe fjalësh dhe fjalish

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës Ola mëson me orar”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: Ola, roboti, numra, orë.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fletë ku ka shkruar ushtrimin dhe udhëzon nxënësit të plotësojnë fjalitë me fjalët e dhëna:  Ola ka _____.  Ora ka _____.  _____ ka orë.  (Roboti, numra, orë.)	Nxënësit plotësojnë ushtrimin dhe e krahasojnë me shokun e bankës.

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Pyet nxënësit: “Kur i bëni detyrat? Kush ju ndihmon? Kur është koha për të bërë detyrat? Kush gëzohet kur ju punoni me orar dhe i bëni detyrat në kohë? Pse?”</p> <p>Bisedon me nxënësit:</p> <p>“Sot do të lexojmë për Olën dhe orarin e saj të mësimit dhe lexon tekstin e dhënë në libër”.</p> <p>Pyet: “Çfarë mori Ola? Kur mëson abetaren dhe kur matematikën? A mësoni dhe ju në të njëjtën kohë?...”</p>	<p>Nxënësit tregojnë për orarin e tyre të mësimit, kush i ndihmon ata dhe si i ndihmon.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të bëra. Flasin për Olën dhe për orarin e saj të mësimit.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p><b>Detyrë shtëpie</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të lexojnë tekstin “Ola mëson me orar”.</p> <p>Leximi do të jetë zinxhir dhe pas leximit nxënësit do të plotësojnë ushtrimin për të kuptuarit e tekstit.</p> <p>Nxënësit lexojnë tekstin dhe shkruajnë fjali sipas dëshirës.</p>	<p>Nxënësit lexojnë tekstin dhe plotësojnë ushtrimin për të kuptuarin e tekstit.</p>

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës O, o, shkrim fjalish (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës <b>O, o</b>.</p> <p>Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shkronjë e madhe, shkronjë e vogël.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart të veprojnë ashtu siç i drejton ai.</p> <p>Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.</p> <p>Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu si janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>O, o</b>.</p>	<p>Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>O, o</b>.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>I njej nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>O, o</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>O, o</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>O, o</b>. I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Plotësoni ushtrimet në Abetaren e Punës.</p> <p>Dikton: <b>“mo, no, mora, ora</b></p> <p><b>Ola ka orë”</b>.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>O, o</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>O, o</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>O, o</b>. Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë”.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>O, o</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>O, o</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

## Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën O në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimiti.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: fjalë, fjali, Nora, Ori.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Vendos etiketa në tabelë, të cilat nxënësit i renditin dhe krijojnë fjali:</p> <p>1. kaloi 2. Nora 3. luan</p> <p>Ori orarin Ola me makinë mori me numra</p>	<p>Nxënësit nga etiketat e dhëna formojnë fjali me kuptim:</p> <p>1. Ori kaloi me makinë.</p> <p>2. Nora mori orarin.</p> <p>3. Ola luan me numra.</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Udhëzon nxënësit të lexojnë rrokjet dhe duke i lidhur ato të krijojnë fjali në ushtrimin e dhënë në libër. Vëzhgon punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë nevojë.	Nxënësit lidhin rrokjet dhe formojnë fjalë:  Mora, orë, kalon, mali, limon, kamion.
<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit që të përshkruajnë fjalët në libër dhe t'i kontrollojnë me shokun e bankës.	Nxënësit shkruajnë fjalët sipas kërkesës në libër dhe i kontrollojnë me shokun në krahë.

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës P, p

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojnë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>P, p</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>p</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>P</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>P, p</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja P, p, fjalori, titulli, perime, pemë.

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bëjnë mësuesi	Aktivitetet që bëjnë nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i> <i>Loja - kutia magjike</i></p> <p><i>Diskutim</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>Në kuti futet një perime e freskët ose e vizatuar. Mësuesi u përgjigjet me <b>Po</b> ose <b>Jo</b> pyetjeve të nxënësve.</p> <p>Lexo: “Nëna përgatiti supë me perime. Hani fëmijë të dashur se është me plot vitamina – tha nëna. Fëmijët kërkuan vitaminat në pjatën e supës. Çfarë mendoni për fëmijët? A mund t’i shohin ata vitaminat? Me çfarë i ngatërruan ata vitaminat? Çfarë këshille do t’u jepnit ju fëmijëve?”</p> <p>Kërko të përshkruajnë sendet në tryezë dhe të emërtojnë perimet.</p>	<p>Bëjnë pyetje për perimen në kuti. Gjejnë se çfarë është e fshehur. Ai që e gjen vazhdon lojën.</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë.</p> <p>Emërtojnë të gjitha sendet që shohin në figurë.</p>

<p>1. Punim i tingullit - Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik - Gjej tingullin</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares. Analizohet fjalia. Sa fjalë ka? Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin P. “Cili tingull përsëritet? Ky tingull i takon bashkësisë së zanoreve apo bashkëtingëlloreve? Pse?”</p> <p>2. Analizohen figurat dhe fjalët në Abetare. Numërohen shkronjat dhe caktohet vendndodhja e tingullit P.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli P”.</p> <p>Thonë: “Ky tingull është bashkëtingëllore”.</p> <p>2. Numërojnë shkronjat dhe caktohet vendndodhja e tingullit P.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Alfabeti i murit</p> <p>3. Ndërtimi i shkronjës</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>P, p</b>, në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit P dhe të voglës së shtypit p.</p> <p>2. U tregon nxënësve shkronjën e murit, udhëheq nxënësit në vëzhgimin e saj (pamja e shkronjës, pozita e vijave dhe krahasimi me shkronjat tjera të mësuara).</p> <p>3. Kërkohet të punojnë shkronjën me tel, me spango ose me ndonjë fije tjetër.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Nxënësit vëzhgojnë vijat e shkronjës, e analizojnë dhe e shkruajnë atë.</p> <p>3. Punojnë shkronjën me fije të ndryshme.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Plotësim dhe lexim</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon të shkruhen shkronjat që mungojnë në fjalët e Abetares, lexohen fjalët dhe fjalia.</p> <p>2. Shkruan shkronjën <b>P, p</b>, të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>P, p</b>. Shkruhen fjalët nga libri i Abetares.</p> <p>3. Shkruaj dhe vizato perimet që të pëlqejnë më shumë.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta dhe fjalë me shkronjën P.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali. Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: pema, parku, kapelë.



## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>P</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>p</b> të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave( <b>P, p</b> )”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>P</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>p</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet ( <b>P, p</b> ).
<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>pema, parku, kapelë</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>P</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna (është kapela, nevojitet për ta mbajtur në kokë, mua më pëlqen kapela,...) Lexojnë globalisht fjalët ( <b>pema, parku, kapelë</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>P</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>P p</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>P, p</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Nxënësit pasi që bëjnë detyrën shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

## Ora e tretë. Tema: Lexim teksti, grupe fjalësh dhe fjalish

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Në shitore” Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalë çelës: pemë, perime.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Motivimi	Vendos në tavolinë dy shporta dhe i emërton ato: “Shporta e pemëve dhe Shporta e perimeve.” Ka sjellë në klasë pemë dhe perime, të cilat nxënësit do t’i klasifikojnë dhe do t’i vendosin në shportat e caktuara. Nëse nxënësit gabojnë, atëherë me pyetje të ndryshme i drejton ata të rregullojnë gabimin.	Nxënësit marrim pemët dhe perimet dhe i vendosin në shportat e duhura. Pemët në shportën e pemëve dhe perimet në shportën e perimeve.

<b>Hapi i parë</b>	<p>Bisedon me nxënësit për furnizimin që prindërit e tyre bëjnë me peme dhe perime, ku i bëjnë dhe çfarë sjellin me tepër në shtëpi. U tregon nxënësve se leximi i tekstit sot dallon nga tekstet e mëparshme. Ky tekst lexohet me role dhe ka dy personazhe: mami Pranvera dhe Ola.</p> <p>Lexon tekstin dhe bisedon me nxënësit për pemët dhe perimet që përmenden aty.</p> <p>Pyet: “Çfarë kanë të përbashkët pemët: pjeshkë, pjepër, portokall? Çfarë kanë të përbashkët perimet: qepë, presh patate dhe panxhar? Çfarë kanë të përbashkët shpendët: pula e pata; dhe kafshët: lopa e lepuri?”</p>	<p>Nxënësit tregojnë për përvojat e tyre në familje rreth furnizimit me pesë dhe perime.</p> <p>Dëgjojnë tekstin dhe përgjigjen në pyetjet e bëra nga mësuesi.</p>
<b>Hapi i tretë</b>  <b>Detyrë shtëpie</b>	<p>Udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin globalisht dhe të përpiqen të lexojnë në role duke i ndihmuar kur ata kanë vështirësi.</p> <p>Me ndihmën e prindërve, nxënësit t’i mësojnë rolet për të aktruar të nesërmen në klasë.</p>	<p>Lexojnë tekstin globalisht dhe lexojnë në role, të ndarë nga mësuesi.</p>

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës P, p, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës <b>P, p</b>.</p> <p>Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, diktim.

#### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	<p>Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton ai.</p> <p>Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini dorën me të cilën shkruani lart, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsërite djathtas, bëni një vijë në mes”.</p> <p>Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>P, p</b>.</p>	<p>Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>P, p</b>.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>I njuh nxënësit për atë që do të mësojnë, shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>P, p</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>P, p</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>P, p</b>. I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Plotësojnë ushtrimet e Abetares së Punës.</p> <p>Dikton: <b>“pu, pa, pi, pe, pata, pula Në park ka pemë”</b>.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>P, p</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>P, p</b> në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.</p> <p>Plotësojnë ushtrimet në Abetaren e Punës.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>P, p</b>. Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë.”</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>P, p</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>P, p</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>P</b> në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: shitore, pemë, perime, presh, panxhar.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë dhe i dytë</b> Motivimi Dramatizim</p>	<p>Në klasë organizon një shitore ku shiten pemë dhe perime. Nxënësit luajnë rolet e tekstit “Në shitore”.</p>	<p>Në shitoren e improvizuar në klasë, nxënësit luajnë rolet e tyre të mësuara në shtyp.</p>

<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit të lexojnë dhe të plotësojnë ushtrimet në libër dhe t'i kontrollojnë me shokun në krah.	Lexojnë dhe plotësojnë ushtrimet në libër dhe i kontrollojnë me shokun në krah.
---------------------	--	---

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Z, z

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Z, z</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Z</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>Z</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Z, z</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Z, z, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p><i>Motivimi</i></p>	<p>Shkruan në tabelë shkronjat: A, I, E, Ë, O, U, Y</p> <p>Pyet: “Çfarë kanë të përbashkët këto shkronja? Cilin tingull të ri e dëgjojmë te fjala <b>zanore</b>? A dini ta shkruani këtë fjalë? Cilën shkronjë duhet ta mësojmë për të shkruar këtë fjalë?”</p> <p>Udhëzon nxënësit të shikojnë fotografinë në libër.</p> <p>Pyet: “Kush është në këtë fotografi? Çfarë dini ju për Nënë Terezën?”</p> <p>(Nëse ka nevojë jep informacione për jetën dhe punën e Nënë Terezës)</p>	<p>Nxënësit vërejnë çfarë kanë të përbashkëta shkronjat dhe zbulojnë fjalën zanore.</p> <p>Bëjnë analizën e fjalës, <b>zanore</b>, duke dalluar tingujt. Dallojnë shkronjën që duhet mësuar.</p> <p>Vërejnë fotografinë e Nënë Terezës dhe thonë atë që dinë për të.</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik-<i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën <b>Z, z</b>. Lexon bashkë me nxënësit fjalinë <b>Zemra</b> e <b>Nënë Terezës</b>.</p> <p>Pyet: “Në cilat fjalë dëgjon tingullin Z?”</p> <p>3. Vendos në tabelë disa figura. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë ato.</p> <p>Pyet: “Ku është tingulli Z?”</p> <p>(Zero, zambak, zezak, zjarr, kazan, kornizë, oriz....)</p>	<p>2. Lexojnë fjalinë. Thonë fjalët në të cilat dëgjojnë tingullin Z.</p> <p>3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë, ngrenë nga një gisht. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Z, z</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>Z</b> dhe të voglës së shtypit, <b>z</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurat në libër dhe të plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe të formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexon fjalinë: <b>“Zemra e Nënë Terezës”</b>. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>2. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Z, z</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>Z, z</b>. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Z</b>.</p> <p>2. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>Z</b>, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>Z</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Z</b>.</p>

## Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Z</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>z</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>Z, z</b>)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Z</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>z</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>Z, z</b>).</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>zogu, zemra zambaku</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën Z në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>zogu, zemra, zambaku</b> ) dhe shkruajnë shkronjën Z në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit Z z, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit Z z, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe pastaj punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Nënë Tereza”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Pyet nxënësit: “Çfarë dini për Nënë Terezën? Nga ishte ajo? Ku jetoi ajo gjatë jetës së saj? Cilat ishin veprat e mira që ajo bëri? A do të kishe dëshirë ta takoje?” (Sjell fotografi, libra, shënime, mbi jetën dhe veprën e Nënës Terezë).	Nxënësit mendohen dhe përgjigjen me aq sa dinë për veprën dhe për jetën e Nënës Terezës.

<b>Hapi i dytë</b>	I njeh nxënësit me titullin e tekstit: “Nënë Tereza”. Pyet: “Çfarë i tregon babai Zamirit?” (Shpjegon fjalën shenjtore). “Kush e njeh Nënë Terezën dhe sa e kishte ajo zemrën? Kur një njeri e ka zemrën e madhe: - kur ndihmon të tjerët; - kur fal të tjerët; - kur shëron të tjerët. Porosia e Nënë Terezës ishte: “Të jemi shpirtmirë, të duam njëri-tjetrin, të ndihmojmë njeriun që kemi pranë”. Cila ishte puna më e madhe që bëri Nënë Tereza?”	Dëgjojnë tekstin dhe u përgjigjen pyetjeve të drejtuara.
<b>Hapi i tretë</b>	Shkruani me disa fjali për temën: “Unë jam krenare për Nënë Terezën”	Shkruajnë individualisht në temën e caktuar dhe punimet e tyre i vendosin në këndin e klasës, që e titullojnë “E jona Nënë Tereza”.

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Z, z, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës <b>Z, z</b> . Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes.” Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>Z, z</b> .	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Z, z</b> .

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>I njeh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Z, z</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Z, z</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Z, z</b>. I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotëson Abetaren e Punës. Dikton: <b>“zemra, Nënë Tereza ishte zemërmirë”</b>.</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>Z, z</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>Z, z</b> në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Z, z</b>. Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë”.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Z, z</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Z, z</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën Z në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimin

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Shkruan në tabelë tri gjëgjëza, të cilat nxënësit duhet t'i zbulojnë: “1. Natë e ditë pa pushim rreh e rreh me rrëmbim nuk ka mjeshtëri në botë të bëjë mall më të fortë. 2. Hekur përçark e mish në bark 3. Rreth e rrotull bardhësi brenda argjend dhe flori”.</p>	<p>Lexojnë gjëgjëzat i diskutojnë në mes vete dhe zbulojnë se ato janë: 1. Zemra 2. Unaza 3. Veza</p>



<b>Hapi i dytë</b>	I udhëzon nxënësit që të shikojnë figurat e dhëna në libër, të shkruajnë emrin nën të dhe ndan për secilin nga një figurë, për të cilën do të flasin.	Nxënësit shkruajnë emrat nën figurë dhe secili flet për figurën që mësuesi i cakton, p.sh., “Zogu është një shpend i bukur, në dimër unë e ushqej atë. Kur vjen pranvera ai këndon në dritaren time”.
<b>Hapi i tretë</b>	Drejtohen nxënësit që të gjejnë fjalët në ushtrimin me kutiza dhe të diskutojnë me shokët afër për mënyrën se si i kanë gjetur dhe sa kanë gjetur.	Gjejnë fjalët në ushtrimin në libër, p.sh., Zamira, Mira, Moza, Roza, oriz, Rozafa, raft, zero...

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës X, x

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krahasojë atë me klasën e tij</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>X, x</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>X</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>X</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>X, x</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja X, x, fjalori, titulli.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i>	Udhëzon nxënësit të vërejnë figurën në libër: “Kë shihni në figurë? Si duken fëmijët? Çfarë po bëjnë ata?A do të dëshiroje që të ishe në mesin e tyre?”	Nxënësit përshkruajnë figurën.
1. Punim i tingullit	1. I njuh nxënësit me tingullin dhe shkronjën <b>X, x</b> .	
2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik	Lexon bashkë me nxënësit fjalët <b>Xixëllonja, xixëllon</b> Pyet: “Në cilat fjalë dëgjoni tingullin <b>X</b> ?”	2. Lexojnë fjalinë. Thonë fjalët në të cilat dëgjojnë tingullin <b>X</b> .
3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik- <i>Kërkoj shkronjën</i>	3. Udhëzon nxënësit që me shkronja lëvizore të krijojnë fjalë me tingullin <b>X</b> dhe të tregojnë vendndodhjen e tij. Pyet: “Ku është tingulli <b>X</b> ?”	3. Krijojnë fjalën me shkronja lëvizore, ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë ngrenë nga një gisht. Kështu përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>X, x</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit <b>X</b> dhe të voglës së shtypit <b>x</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurat në libër dhe të plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe të formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexon vjershën: <b>Xixëllonja</b>. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato.”</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>2. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>X, x</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>X, x</b>. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>X</b>.</p> <p>2. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>X</b>, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>X</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>X</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>X</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>x</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>X, x</b>)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>X</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>x</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>X, x</b>).</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>xixa, lexon xixëllonja</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>X</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>xixa, lexon, xixëllonja</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>X</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>X, x</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>X x</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e vjershës “Ylli i vogël lart në qiell”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bëjnë mësuesi	Aktivitetet që bëjnë nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shkruan fjalët në tabelë: Xixëllonja xixëllon _____ Xixëllonja shihet _____ Xixëllonja është _____ Unë e dua _____	Nxënësit plotësojnë fjalitë me gojë.
<b>Hapi i dytë</b>	Lexon vjershën xixëllonja. Pyet: “Si duket xixëllonja dhe çfarë mban në shpinë? Kush gëzohet më tepër për xixëllonjat dhe ku i dërgojnë ata kur i kapin? A do të dëshiroje të ishe me këta fëmijëve. Kujt do t’ia dhuroje xixëllonjën? Pse?”	Nxënësit dëgjojnë vjershën dhe u përgjigjen pyetjeve të drejtuara.

<b>Hapi i tretë</b>	Përshkruani me fjalët tuaja përse xixëllonjat duken të bukura: - se kanë dritë të veçantë; - se vijnë tufa tufa; - se duken si xixa të vogla; - se ngjajnë me yjet.	Nxënësit përshkruajnë me fjalë bukurinë e xixëllonjave.
---------------------	---	---

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës X, x, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës X, x. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton ai. Thotë: "Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes". Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës X, x.	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, X, x.
<b>Hapi i dytë</b>	I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit X, x.  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit X, x dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit X, x, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësoni Abetaren e Punës. Dikton: "xixa, Xixëllonja xixëllon natën".	Shkruajnë shkronjën X, x të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës X, x në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.

<b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtur	Udhëzon:Nga letrat për kolazh të cilat ju kam dhënë vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>X, x</b> . Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë.	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>X, x</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.
Detyrë shtëpie	Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>X, x</b> .	

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali. Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>X</b> në trup të tyre. Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	“Shkruani fjali me fjalët: <b>xixëllonjë, xixa, xixëllon, shkëndijë.</b> ”  Fjalitë që shkruani i diskutoni me shokët dhe i zgjidhni në grup disa më të bukurat. Ato fjali i vendosni në një fletë të bardhë të madhe dhe i shoqëroni me vizatime të bukura. Shkruani një titull në këtë fletë.	Nxënësit shkruajnë fjalitë me fjalët e dhëna, i përzgjedhin ato më të bukurat në grup dhe i shkruajnë në fletën e madhe të bardhë, të cilat i shoqërojnë me vizatime dhe i vënë një titull.
<b>Hapi i parë</b>	Udhëzon nxënësit të punojnë në ushtrimet e dhëna në libër:  1. Të shkruajnë saktë fjalitë.  2. Të formojnë fjali me fjalët e dhëna.  3. Të shkruajnë sipas modelit të dhënë në libër.	Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna dhe, pasi i plotësojnë, i diskutojnë me shokun dhe i krahasojnë detyrat.
<b>Hapi i tretë</b>	Imagjinoni të jeni xixëllonja për disa çaste, kë do të takonit, kujt do t’i dhuronit dritë...	Nxënësit mendojnë, imagjinojnë dhe shprehin lirshëm mendimet e tyre.

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Zh, zh

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Zh, zh</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Zh</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>Zh</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Zh, zh</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Zh, zh, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p><i>Motivimi</i></p>	<p>Mësuesi u thotë nxënësve të dëgjojnë me vëmendje tregimin që do t'u tregojë:</p> <p>“Disa fëmijë ndodheshin në buzë të detit dhe po shëtisnin me mësuesen. Papritur, pranë bregut ata panë të afrohej një anije. Nga anija u hodhën në det dhe u zhytën disa zhytës. Ata vazhduan disa orë, duke u zhytur në det. Njëri nga zhytësit hipi në anije dhe nisi të...”</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit ta përfundojnë tregimin.</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë me vëmendje.</p> <p>2-3 nxënës tregojnë një mbyllje për tregimin.</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p><i>Urra, urra, shkronja</i></p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik - <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>Mësuesi u drejton nxënësve disa pyetje:</p> <p>Ku ndodheshin nxënësit?</p> <p>Çfarë panë ata në det?</p> <p>Kush u hodh nga anija?</p> <p>Çfarë bënë ata?</p> <p>Mësuesi ndalon te fjala <b>zhytës</b> dhe <b>zhyt</b>.</p> <p>Kërkon që nxënësit të tregojnë kuptimin e fjalëve.</p> <p>Mësuesi kërkon që ata të gjejnë se çfarë tjetër kanë të përbashkët këto fjalë.</p>	<p>Nxënësit shpjegojnë me fjalët e tyre se çfarë kuptojnë me fjalët <b>zhytës</b> dhe <b>zhyt</b>.</p> <p>Nxënësit gjejnë se tingulli <b>zh</b> është i përbashkët te të dyja fjalët.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Zh, zh</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>Zh</b> dhe të voglës së shtypit, <b>zh</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurat në libër dhe të plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe të formojnë fjalën.</p> <p>3. Vizaton në ajër <b>zh</b> dhe kërkon të plotësojnë <b>zh</b> në fjalët ku ajo mungon në Abetaren e Punës.</p> <p>Kërkon të shkruajnë fjalë globale sipas shkronjave <b>ZH</b>.</p> <p>Kërkon që nxënësit në një fletë gazete të gjejnë shkronjën <b>ZH</b>.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku....)</p> <p>2. Plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe formojnë fjalën.</p> <p>Nxënësit plotësojnë zh në libër.</p> <p>Nxënësit shkruajnë fjalët globale në Abetaren e Punës.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>2. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Zh, zh</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>Zh, zh</b>. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Zh</b>.</p> <p>2. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>Zh, zh</b> të cilat dini t'i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>Zh</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Zh</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Zh</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>zh</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>Zh, zh</b>)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Zh</b> madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>zh</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>Zh, zh</b>).</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (<b>gozhdë, lëvozhgë, zhapiku</b>). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...”</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Zh</b> në kutizat ku mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen në pyetjet e dhëna. Lexojnë globalisht fjalët (<b>gozhdë, lëvozhgë, zhapiku</b>) dhe shkruajnë shkronjën <b>Zh</b> në kutizat ku mungon.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Zh zh</b>, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe kur bindet se i kanë bërë mirë i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Zh, zh</b>, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.</p> <p>Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Zhurmat e pyllit” Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Pyet: “Si mendoni ju, kur një pylli i mungon bukuria?” Mendoni dhe përgjigjuni lirshëm për ato që ju vijnë ndërmend.</p>	<p>Nxënësit mendojnë për pyetjen e drejtuar dhe përgjigjen: - Kur priten shumë pemë? - Kur nuk ka cicërima zogjsh? - Kur ikin kafshët e pyllit...</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Lexon tekstin, nxënësit e ndjekin dhe bashkëbisedojnë, pastaj do të plotësojnë tabelën e ndarë në tri shtylla: Shtylla e parë – si është pylli; Shtylla e dytë – detyrat e të tjerëve; Shtylla e tretë – idetë e fëmijëve.</p>	<p>Nxënësit lexojnë tekstin dhe bashkë me mësuesin plotësojnë shtyllat në tabelë.</p>



<b>Hapi i tretë</b>	<p>Pyet: "Po të ishit në grupin e fëmijëve në tekstin "Zhurmat e pyllit", cilat do të ishin detyrat që do të bënit për të ndihmuar pyllin në rrezik."</p> <p>Bisedon për shprehjen: "Me një pemë bëhen shumë shkrepëse. Me një fill shkrepëseje digjet një pyll i tërë".</p>	Nxënësit japin mendimin e tyre për angazhimet që do të merrnin për ruajtjen e pyllit.
---------------------	--	---

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Zh, zh, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës <b>Zh, zh</b> . Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	<p>Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai.</p> <p>Thotë: "Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes".</p> <p>Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>Zh, zh</b>.</p>	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Zh, zh</b> .
<b>Hapi i dytë</b>	<p>I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Zh, zh</b>.</p> <p>Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Zh, zh</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Zh, zh</b>. I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.</p> <p>Plotësoni Abetaren e Punës.</p> <p>Dikton: "<b>zhurma Zhurmat e pyllit</b>".</p>	<p>Shkruajnë shkronjën <b>Zh, zh</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.</p> <p>Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>Zh, zh</b> në Abetaren e Punës sipas modelit të dhënë.</p>

<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Zh, zh</b>. Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë”.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Zh, zh</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Zh, zh</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>
--	---	--

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën Zh në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Shkruan në tabelë fjalët dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë fjalët me kuptim të kundërt nga këto:</p> <p>Vesh Bërje Dukje Veshje</p>	<p>Nxënësit shkruajnë fjalët me kuptim të kundërt nga ato që mësuesi i ka shkruar në tabelë:</p> <p>Vesh – zhvesh Bërje – zhbërje Dukje – zhdukje Veshje - zhveshje</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Bisedon me nxënësit:</p> <p>“Sa shkronja të alfabetit kemi mësuar deri tani? Cila ishte e fundit ? Si mendoni, a është mërzitur ajo duke na pritur? Pse? Cila prej shkronjave mendoni që ka qenë më e lumtura?”</p> <p>Lexon vjershën dhe flet për përgjigjet që jep shkronja <b>zh</b>.</p>	<p>Nxënësit përgjigjen në pyetjet e drejtuara dhe shprehin mendimet e tyre për shkronjën <b>zh</b>.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon nxënësit që të shkruajnë një letër të shkurtër falënderimi, e cila priti kaq gjatë që ne të arrinim deri tek ajo. Letrat me shkrimet e nxënësve do të vendosen në një kënd të klasës.</p> <p>Mësoni vjershën përmendsh.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë një letër drejtuar shkronjës <b>zh</b> dhe e falënderojnë atë që i priti kaq gjatë, derisa erdhën aty.</p>

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Nj, nj

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Nj, nj</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Nj</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>NJ</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Nj, nj</b>, sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë</p>	<p>Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Nj, nj, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi bisedo</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>Pyet: “A e dini cilat janë sëmundjet e fëmijërisë? A të ka rënë ty ndonjëra? Çfarë të ka bërë mami kur ishe i sëmurë? Pse bëhen vaksinat?”</p> <p>Përshkruhet figura në Abetare. Kë shohim? Çfarë ka Njomëza? Pse është mbushur me njolla? Çfarë ëndërron ajo?</p>	<p>Nxënësit shprehen lirshëm gjatë diskutimit.</p> <p>Mendojnë, përshkruajnë, analizojnë.</p>
<p>1. Punim i tingullit - Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik - Gjej tingullin</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares: “Njomëzës i kanë dalë njolla në faqe”. Analizohet fjalia: “Sa fjalë ka?” Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin <b>Nj</b>. “Cili tingull përsëritet?” Ky tingull i takon bashkësisë së zanoreve apo të bashkëtingëlloreve? Pse?”</p> <p>2. Gjej fjalë që kanë tingullin <b>Nj</b>, në fillim, në mes ose në fund të fjalës.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli <b>Nj</b>”. Thonë: “Ky tingull është bashkëtingëllore”.</p> <p>2. Gjejnë fjalë dhe përcaktojnë vendndodhjen e tingullit.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Alfabeti i murit.</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Nj, nj</b>, në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>Nj</b> dhe të voglës së shtypit, <b>nj</b>.</p> <p>2. U tregon nxënësve shkronjën e murit, i udhëheq në vëzhgimin e saj (pamja e shkronjës, pozita e vijave dhe krahasimi me shkronjat tjera të mësuara).</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Nxënësit vëzhgojnë vijat e shkronjës, e analizojnë dhe shkruajnë atë.</p>

<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Plotësim dhe lexim</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon të shkruhen fjalët në Abetare, lexohen fjalët dhe fjalia.</p> <p>2. Shkruan shkronjën <b>NJ, nj</b>, të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>Nj, nj</b>. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares.</p> <p>3. Shkruaj tri fjalë me shkronjën <b>Nj</b> dhe krijo fjali me to.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta dhe fjalinë me shkronjën <b>Nj</b>.</p>
--	---	--

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bëjnë mësuesi	Aktivitetet që bëjnë nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Nj</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>nj</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>Nj, nj</b>)”.</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Nj</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>nj</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>Nj, nj</b>).</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat (<b>njëshi, shkronja, shqiponja</b>). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse? ...”</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Nj</b> në kutizat ku mungon.</p>	<p>Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna. Lexojnë globalisht fjalët (<b>njëshi, shkronja, shqiponja</b>) dhe shkruajnë shkronjën <b>Nj</b> në kutizat ku mungon.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>U tregon nxënësve modelin se si do ta shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Nj nj</b>, në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Nj, nj</b>, në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.</p> <p>Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.</p>

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë.</p> <p>Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën.</p> <p>T'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës "Njollat e Njomëzës".</p> <p>Të dallojë titullin në pjesë.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Pyet: "Si jeni ndier kur keni qenë sëmure? Kush ju qëndroi pranë? A keni pasur oreks? Çfarë ju pëlqen të hani ose të pini kur jeni të sëmure?"	Nxënësit mendojnë dhe flasin për përvojat e tyre, sëmundjet, kujdesin e prindërve, kërkesat e tyre etj...
<b>Hapi i dytë</b>	<p>"Cili nga ju ka qenë i sëmure prej një sëmundjeje, për shkak të së cilës fytyra dhe trupi të mbushet me njolla? Si jeni ndier kur e keni parë veten në pasqyrë? I mërzhitur, i trishtuar, i frikësuar..."</p> <p>I njeh nxënësit me tekstin e ri, "Njollat e Njomëzës", e lexon atë dhe u drejton pyetjet:</p> <p>"Përshkruani se si u ngrit në një mëngjes Njomëza. Kush e pastroi fytyrën e saj me njolla?</p> <p>Si e vlerësoni sjelljen e fluturës dhe kërpudhës? Si u ndje Njomëza kur u ngrit nga gjumi?"</p>	Nxënësit e lexojnë tekstin bashkë me mësuesin dhe u përgjigjen pyetjeve të drejtuara.
<b>Hapi i tretë</b>	Nënvizoni në tekst fjalët që kanë shkronjën <b>nj</b> dhe krijoni fjali me dy prej tyre.	Nënvizojnë fjalët që kanë shkronjën <b>nj</b> dhe me dy prej tyre krijojnë fjali, të cilat i lexojnë para të tjerëve.

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Nj, nj, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës <b>Nj, nj</b>.</p> <p>Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes”. Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>Nj, nj</b> .	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Nj, nj</b> .
<b>Hapi i dytë</b>	I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Nj, nj</b> .  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Nj, nj</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Nj, nj</b> . I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësoni Abetaren e Punës. Dikton: “ <b>njëshi, njolla</b> <b>Njëshi është numër</b> ”.	Shkruajnë shkronjën <b>Nj, nj</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>Nj, nj</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.
<b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura  Detyrë shtëpie	Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Nj, nj</b> . Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë.  Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Nj, nj</b> .”	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Nj, nj</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali. Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën U në trup të tyre. Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Dramatizojnë tekstin “Njollat e Njomëzës” duke i ndarë rolet: Njomëza, Flutura, Kërpudha, Improvizojnë situatat në klasë dhe realizojnë dramatizimin.	Ndajnë rolet, improvizojnë situatat dhe realizojnë dramatizimin.

<b>Hapi i dytë</b>	Udhëzon nxënësit që ta plotësojnë ushtrimin në libër, duke qarkuar shkronjën <b>nj</b> në fjalët e dhëna. Pastaj me këto fjalë të krijojnë fjali të reja. Vlerësohen për punën e bërë.	Qarkojnë shkronjën <b>nj</b> në fjalët e dhëna dhe krijojnë fjali me ato fjalë.
<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit që me fjalët e dhëna, por duke shtuar edhe fjalë të tjera, të krijojnë edhe tekst të shkurtër, kjo detyrë mund të vazhdojë edhe në shtëpi. Fjalët: <b>“flamur, popull, shqiponjë, i bukur, im, krenari”</b> .	Me fjalët e dhëna, duke shtuar edhe të tjera, nxënësit krijojnë një tekst të shkurtër.

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Y, y

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Y, y</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Y</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>Y</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Y, y</b>, sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p> <p>Mësimi me lojë</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim,</p> <p>muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Y, y, fjalori, titulli

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i> <i>Analizo barazimin</i>	<p>Në tabelë shkruhet barazimi: Shiu + Dielli = Ylberi “Çfarë është kjo që kam shkruar? Si mund ta shpjegoni këtë barazim? Cilët janë mbledhorët? Po shuma? A e ke parë ndonjëherë ylberin? Si duket? Kur del ai?”</p>	Nxënësit analizojnë barazimin dhe flasin për ylberin.
<i>Vizatim</i>	Kërkon që nxënësit të vizatojnë në një fletë ngjyrat e ylberit dhe të krahasojnë me njëri-tjetrin me sa ngjyra kanë vizatuar atë.	Paraqesin ylberin me ngjyra.
<i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i>	Përshkruhet figura në Abetare: “Kë shohim? Cila po mban ylberin? Numëro ngjyrat e ylberit. Cilat janë ato? A i ke bërë edhe ti ato ngjyra? Cila të mungon?”	Mendojnë, përshkruajnë, analizojnë.

<p>1. Punim i tingullit - Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik- Gjej tingullin</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares: Ylberi ka shumë ngjyra. Analizohet fjalia: “Sa fjalë ka?” Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin Y. “Cili tingull përsëritet? Ky tingull i takon bashkësisë së zanoreve apo të bashkëtingëlloreve? Pse?”</p> <p>2. Gjej fjalë që kanë tingullin Y, në fillim, në mes ose në fund të fjalës.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe i ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: “Tingulli Y”.</p> <p>Thonë: Ky tingull është tingull zanor.</p> <p>2. Gjejnë fjalë dhe përcaktojnë vendndodhjen e tingullit.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Alfabeti i murit.</p> <p>3. Ndërtimi i shkronjës</p>	<p>1. Shkruan shkronjën Y, y, në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, Y dhe të voglës të shtypit, y.</p> <p>2. U tregon nxënësve shkronjën e murit, udhëheq nxënësit në vëzhgimin e saj (pamja e shkronjës, pozita e vijave dhe krahasimi me shkronjat tjera të mësuara).</p> <p>Kërkon të punojnë shkronjën me lapsa.</p>	<p>1. Vërejnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Nxënësit vëzhgojnë vijat e shkronjës, e analizojnë dhe e shkruajnë atë.</p> <p>Punojnë shkronjën me lapsa.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Plotësim dhe lexim</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon të shkruhen fjalët në Abetare, lexohen fjalët dhe fjalia.</p> <p>2. Shkruan shkronjën Y, y, të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën Y, y. Shkruhet fjalia nga libri i Abetares.</p> <p>3. Vizato një ditë kur shihet ylberi dhe shkruaj një fjali për të.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta dhe fjalinë me shkronjën Y.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim,</p> <p>muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>



### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Y</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën <b>y</b> të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave( <b>Y, y</b> )”.	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Y</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>y</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet ( <b>Y, y</b> ).
<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>dyshi, ngjyra, ylberi</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Y</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>dyshi, ngjyra, ylberi</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>Y</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Y, y</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Y y</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Lapsat me ngjyra”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të marrin në dorë lapsin me ngjyrë të bardhë, të mendojnë, të provojnë në fletë dhe të tregojnë se çfarë do të kishin ngjyrosur po të kishin në dorë vetëm atë ngjyrë.	Nxënësit marrin lapsin me ngjyrë të bardhë në dorë dhe tregojnë se çfarë do të kishin vizatuar me të.

<b>Hapi i dytë</b>	Mësuesi lexon tekstin dhe u drejton pyetjet: “Si reagues ngjyrat në çantë, kur mësuesja u tha fëmijëve të pikturojnë ylberin? Përse u mërzi ngjyra e bardhë? Si e gëzoi atë Yllka? A e gjetët edhe ju se për çfarë nevojitet lapsi me ngjyrë të bardhë?”	Nxënësit lexojnë tekstin dhe përgjigjen në pyetjet e drejtuara.
<b>Hapi i tretë</b>	Shkruani disa emra ngjyrash.	Nxënësit shkruajnë disa emra ngjyrash dhe i lexojnë ato.

### Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Y, y, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës Y, y. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global, Të folurit Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b>  Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë siç i drejton ai.  Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes”.  Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Y, y.	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, Y, y.
<b>Hapi i dytë</b>	I njuh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Y, y.  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Y, y dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Y, y. I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi.  Plotësoni Abetaren e Punës.  Dikton: “ylberi,  Ylberi ka shumë ngjyra”.	Shkruajnë shkronjën Y, y të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës Y, y në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.

<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Y, y</b> . Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë”.	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Y, y</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.
Balona të lumtura		
Detyrë shtëpie	Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Y, y</b> .	

## Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti dhe ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>Y</b> në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	<p>Udhëzon nxënësit që të vendosin një emër për bri secilit mbiemër:</p> <p>E kuqe si _____</p> <p>E bardhë si _____</p> <p>E verdhë si _____</p> <p>E gjelbër si _____</p> <p>E kaltër si _____</p> <p>E zezë si _____</p>	<p>Nxënësit vendosin emrat për bri mbiemrave.</p> <p>E kuqe si molla.</p> <p>E bardhë si bora.</p> <p>E verdhë si banania.</p> <p>...</p>
<b>Hapi i dytë</b>	<p>Pyet: “Cilat janë ngjyrat e ylberit, kur dalin ato, kush e pikturon ylberin? Pikturoni ylberin.”</p>	<p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të bëra, përdorin imagjinatën dhe më pas pikturojnë ylberin.</p>
<b>Hapi i tretë</b>	<p>Formoni fjali me fjalët e dhëna:</p> <p>Ylberi _____</p> <p>Ylli _____</p> <p>Syri _____</p> <p>Fytyra _____</p> <p>Pylli _____</p> <p>Lexojini para të tjerëve fjalitë e krijuara dhe përzgjidhni më të bukurat.</p>	<p>Formojnë fjalitë me fjalët e dhëna dhe përzgjedhin ato më të bukurat.</p>

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës Th, th

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>Th, th</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>Th</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>Th</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Th, th</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja Th, th, fjalori, titulli.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i></p>	<p>Udhëzon nxënësit të shikojnë figurën në libër: “Kë shihni në figurë? Çfarë po bëjnë ata? Cili nga ju e di këtë ngjarje?”</p> <p>Pyet: “Kush ka qenë Skënderbeu?”</p>	<p>Nxënësit përshkruajnë figurën dhe bisedojnë për të.</p> <p>Flasin për Skënderbeun.</p>
<p>1. Punim i tingullit</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik</p> <p>3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik - <i>Kërkoj shkronjën</i></p>	<p>1. Njoftohen nxënësit me tingullin dhe shkronjën <b>Th, th</b>.</p> <p>Lexon bashkë me nxënësit fjalinë: “<b>Gjini nuk i theu thuprat</b>”.</p> <p>Pyet: “Në cilat fjalë dëgjoni tingullin <b>Th</b>?”</p> <p>3. Vendos në tabelë disa fotografi. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë ato.</p> <p>Pyet: “Ku është tingulli <b>Th</b>?” (thanë, thika, Thethi, thembër, thesi, thesar... thnegël, thonjtë, syth, shkathtësi...)</p>	<p>2. Lexojnë fjalinë. Thonë fjalët në të cilat dëgjojnë tingullin <b>Th</b>.</p> <p>3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë, ngrenë nga një gisht. Kështu përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Th, th</b> në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit, <b>Th</b> dhe të voglës së shtypit, <b>th</b>.</p> <p>2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurat në libër dhe të plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe të formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexon fjalinë: <b>“Gjini nuk i theu thuprat”</b>. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? Ndajini ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndajini ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndajini ato”.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat dhe thonë në çfarë dallojnë ato (madhësia, grafiku...).</p> <p>2. Plotësojnë katrorët bosh me shkronjat e duhura dhe formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>2. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>Th, th</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me këtë shkronjë. Gjithashtu i udhëzon e i ndihmon që të vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Th</b>.</p> <p>2. Gjeni në gazeta disa fjalë që kanë shkronjën <b>Th</b>, të cilat dini t’i lexoni dhe sillini nesër në klasë.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>Th</b> dhe vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën <b>Th</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>Th</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve, shkronjën <b>th</b> të vogël të shtypit.</p> <p>Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>Th, th</b>).</p>	<p>Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Th</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruan individualisht shkronjën <b>th</b> të vogël të shtypit në fletën që ka përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>Th, th</b>).</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>thesi, gjethe, thuqthuqi</b> ). Për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?...” Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Th</b> në kutizat ku mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna Lexojnë globalisht fjalët ( <b>thesi, gjethe, thuqthuqi</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>Th</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Th th</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe, kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Th, th</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe më pas punojnë individualisht.  Pasi bëjnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehite e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë dhe saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Porosia e fundit e Skënderbeut”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Vendos fotografinë e Skënderbeut në tabelë dhe kërkon që nxënësit të mendojnë për pak çaste dhe të thonë krejt çka dinë për Skënderbeun. Fjalët e nxënësve shkruhen në tabelë dhe diskutohet për to.	Nxënësit mendojnë dhe thonë ato që dinë për Skënderbeun.
<b>Hapi i dytë</b>	I njuh nxënësit me tekstin e ri “Porosia e fundit e Skënderbeut”. Ndalea e parë: para....thyej. Pyet: “Kur i thirri Skënderbeu trimat? Pse i thirri ata? Çfarë i tha Gjinit? Çfarë mendoni që do të ndodhë?Pse?” Ndalea e dytë: Gjini... dot. Pyet: “A ndodhi ashtu si menduat? Çfarë ndodhi?” Ndalea e tretë: “Gjon... deri në fund”. Pyet: “Çfarë i tha Skënderbeu Gjinit? Çfarë ndodhi? Cili ishte porosia e fundit e Skënderbeut?”	Nxënësit dëgjojnë tekstin dhe u përgjigjen pyetjeve të mësuesit.
<b>Hapi i tretë</b>	Shkruani fjali për Skënderbeun. Punimet tuaja do t’i vendosni në këndin e klasës.	Shkruajnë ose vizatojnë për Skënderbeun. Punimet i vendosin në këndin e klasës.

## Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Th, th, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe dhe të vogël të dorës Th. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Të krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, uleni duke bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtas, bëni një vijë në mes”. Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu siç janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>Th, th</b> .	Nxënësit veprojnë siç i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës, <b>Th, th</b> .
<b>Hapi i dytë</b>	I njeh nxënësit me atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Th, th</b> .  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Th, th</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Th, th</b> . I vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësoni Abetaren e Punës. Dikton: “thesi, <b>Thuthuqi thith gishtin</b> ”.	Shkruajnë shkronjën <b>Th, th</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>Th, th</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.
<b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura  Detyrë shtëpie	Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Th, th</b> . Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë”.  Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Th, th</b> .	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Th, th</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.

## Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe të sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, të lexojë dhe të shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën <b>Th</b> në trup të tyre.</p> <p>Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimi

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Udhëzon nxënësit që me mbiemrat: i thartë, i thellë, i thinjur, i thyer, i thatë, të krijojnë fjali dhe pastaj t'i diskutojnë në grup dhe të përzgjedhin fjalitë më të bukura, për t'i paraqitur para të tjerëve.	Nxënësit krijojnë fjali me mbiemrat e dhënë, pastaj në grup bëjnë përzgjedhjen e tyre për t'i prezantuar para të tjerëve.
Hapi i dytë	Ndani nxënësit në çift dhe i udhëzon ata që të plotësojnë ushtrimin në libër, ku duhen shkruar fjalët që mungojnë nën figurë dhe pastaj t'i vendosni ato në kutizat e dhura sipas numrave që kanë.	Nxënësit në çift plotësojnë ushtrimin në libër.
Hapi i tretë	Kërkon që nxënësit të plotësojnë individualisht ushtrimin e fundit dhe ta shkruajnë atë në fletore.	Plotësojnë ushtrimin e fundit dhe e shkruajnë atë në fletore.

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe i shkronjës C, c

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krahasojë atë me klasën e tij</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën <b>C, c</b>.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën <b>C</b> në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën <b>C</b> në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>C, c</b> sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Të krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalë çelës: Abetarja, shkronja C, c, fjali, titulli.



## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i>	Udhëzon nxënësit të shikojnë figurën në libër: “Kë shihni në figurë? Si duken fëmijët? Çfarë po bëjnë ata? Cilën këngë po këndojnë?” Pyet: “Si keni dëshirë ta festoni ju ditëlindjen? Cilin tingull të ri e dëgjojmë te fjala <b>cicërima</b> ? A dini ta shkruani këtë fjalë? Cilën shkronjë duhet ta mësojmë për të shkruar këtë fjalë?	Nxënësit përshkruajnë figurën, këndojnë këngën e ditëlindjes dhe këngë të tjera.  Tregojnë për dëshirat e tyre. Bëjnë analizën e fjalës <b>cicërima</b> duke dalluar tingujt. Dallojnë shkronjën që duhet mësuar.
1. Punim i tingullit  2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik  3. Vendosja e tingullit në mjedisin fonologjik - <i>Kërkoj shkronjën</i>	1. Njoftohen nxënësit me tingullin dhe shkronjën <b>C, c</b> . Lexon bashkë me nxënësit fjalinë: Cicërimat e trumcakut. Pyet: “Në cilat fjalë dëgjoni tingullin <b>C</b> ?”  3. Vendos në tabelë disa fotografi. Kërkon nga nxënësit t’i emërtojnë ato. Pyet: “Ku është tingulli <b>C</b> ?” (Cilindër, cirk, cjap, dac,...)	2. Lexojnë fjalinë. Thonë fjalët në të cilat dëgjojnë tingullin <b>C</b> .  3. Ndajnë fjalën në tinguj, për secilin tingull që thonë, ngrenë nga një gisht. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet tingulli: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.
<b>Hapi i dytë</b> 1. Grafiku i shkronjës  2. Kërkoj shkronjën  3. Lexoj	1. Shkruan shkronjën C, c në tabelë ose i paraqet aty më shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik në mes të shkronjës së madhe të shtypit C dhe të voglës së shtypit c.  2. Udhëzon nxënësit të vërejnë figurat në libër dhe të plotësojnë katrorët e zbrazët me shkronjat e dhura dhe të formojnë fjalën. 3. Lexon fjalinë: <b>Trumcaku cicëron i gëzuar.</b> Pyet: Sa fjalë ka kjo fjali? Ndani ato. Sa rrokje ka secila fjalë? Ndani ato. Sa shkronja ka secila fjalë? Ndani ato.	1. Shikojnë me vëmendje shkronjat, vërejnë dhe thonë në çka dallojnë shkronjat (madhësia, grafiku....)  2. Plotësojnë katrorët e zbrazët me shkronjat e dhura dhe formojnë fjalën.  3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja
<b>Hapi i tretë</b> 1. Shkrimi i shkronjës  2. Detyrë shtëpie	1. Shkruan shkronjën C, c të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën C, c. Po ashtu të vizatojnë diçka që fillon me shkronjën C. 2. Në copa të gazetave gjeni disa fjalë që kanë shkronjën C, të cilat dini t’i lexoni dhe sillni nesër në klasë.	1. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën C dhe vizatojnë diçka që fillon me shkronjën C.

## Ora e dytë    Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/ Abetare Pune

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të analizoje e sintetizojë rrokje, fjale, fjali. Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/Vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Te krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fleta të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve në klasë të shkruajnë shkronjën <b>C</b> te madhe te shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>c</b> te vogël të shtypit. Thotë: Kur unë të them TANI ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave ( <b>C, c</b> ).	Nxënësit në klasë ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>C</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruajnë individualisht shkronjën <b>c</b> të vogël të shtypit në fletën që kanë përpara. Ngritën në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet ( <b>C, c</b> ).
<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>çirku, mace, këpucë</b> ) për secilën nga këto figura pyet: Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?... Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat t'i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>C</b> në kutizat që mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>çirku, mace, këpucë</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>C</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>C c</b> , në Abetare Pune dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast, i sheh dhe kur bindet se i kanë bërë mirë i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur. Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>C c</b> , në Abetare Pune. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë dhe pastaj punojnë individualisht.  Nxënësit pasi që bëjnë detyrën shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë.</p> <p>Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën.</p> <p>T'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës "Cicërima e trumcakut"</p> <p>Të dallojë titullin në pjesë.</p> <p>Të analizojë dhe sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/Vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Te krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi I parë</b></p> <p>Motivimi</p>	<p>U shpërndan nxënësve rrethë prej letrave me ngjyrë dhe pyet: si cila shkronjë duket ky rreth? (O)</p> <p>Këputeni një pjesë nga kjo letër. Cila shkronjë u është formuar? (C)</p>	<p>Nxënësit marrin fletët në formë të rrethëve, i krahasojnë ato me shkronjën O, pastaj e këpusin atë në një pjesë dhe formojnë shkronjën C.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Lexon bashkë me nxënësit pjesën dhe drejton pyetjet:</p> <p>Çfarë e pyeti babai Olën ? Çfarë tha ajo ? A kishit shtuar edhe ju ndonjë gjë tjetër që ka formën e O-së? Cilat? Çfarë ndodhi me byrekun?Pse u çuditën të gjithë?Çfarë kishte bërë trumcaku?Si reagoi Ola?Pse trumcaku fluturoi i kënaqur?</p>	<p>Nxënësit bashkë me mësuesin lexojnë pjesën dhe përgjigjen në pyetjet e drejtuara.</p>
<p><b>Hapi I tretë</b></p>	<p>Zgjedhe një melodi të një kënge dhe udhëzon nxënësit të përcjellin atë melodi me ciu ciu ...Ata duhet të jenë të gëzuar sikur trumcaku.</p>	<p>Përcjellin me ciu ciu melodinë që mësuesi e ka lëshuar në klasë.</p>

### Ora e katërt Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës C, c, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës C, c.</p> <p>Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup</p> <p>Punë në dyshe</p> <p>Bashkëbisedim</p> <p>Dramatizim</p>	<p>Të folurit</p> <p>Art/Vizatim, muzikë</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë</p>	<p>Të lexuarit global</p> <p>Të folurit</p> <p>Imagjinata</p> <p>Të dëgjuarit</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes</p> <p>Të analizuarit</p> <p>Te krijuarit</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë</p>

Fjalët çelës:

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lartë të veprojnë ashtu si i drejton ai. Thotë: mbyllni sytë, ngrini dorën me të cilën shkruani lartë, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsërite djathtash, bëni një vije në mes. Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër ashtu si janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>C, c</b> .	Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>C, c</b> .
<b>Hapi i dytë</b>	Njofton nxënësit për atë që do të mësojnë, shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>C, c</b> .  Paraqet par nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>C, c</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetare Pune shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>C, c</b> , i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësoni Abetare Pune faqe 51. Dikton: copa-copa, tullumbace Keci i vogël ngacmon kecat.	Shkruajnë shkronjën <b>C, c</b> të shkrimit të dorës në fleta të bardha me lapsa me ngjyrë.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>C, c</b> në Abetare Pune sipas modelit të dhënë.
<b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtur  Detyrë shtëpie	Udhëzon: Nga letrat për kolazh të cilat ju kam dhënë vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>C, c</b> . Vendosini ata në këndin e shkronjave në klasë.  Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>C, c</b> .	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>C, c</b> dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.

### Ora e pestë Tema: Lexim dhe kuptim teksti dhe ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre. Të analizojë dhe sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali. Të gjejnë, lexojnë dhe shkruajnë emra njerëzish që kanë shkronjën C në trup të tyre. Të përdorin pikën si shenjë të pikësimit.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit Art/Vizatim, muzikë Matematikë Dramë	Të lexuarit global Të folurit Imagjinata Të dëgjuarit Të zhvilluarit e vëmendjes Të analizuarit Te krijuarit	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë

Fjalët çelës:

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi I parë dhe I dytë</b> Motivimi	Organizon në klasë dramatizimin e tekstit “Cicërimat e trumcakut”. Ndan rrolet. Përgatitë skenën. Veshjen. Koreografinë.	Nxënësit marrin rrolet e tyre, ndihmojnë në përgatitjen e skenës dhe dramatizojnë.
<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit që të plotësojnë ushtrimet në libër. 1.Shkruani saktë fjalitë: Trumcaku cicëron bukur. Coli ngacmon ca fëmijë. 2.Gjeni dhe lexoni fjalët (mace , cuca, ora, kocka, tapa, ...) 3.Shkruani sipas modelit të dhënë fjalinë: Cicërimat e trumcakut.	Nxënësit plotësojnë ushtrimet në libër sipas udhëzimeve të shkruara dhe ato që I thotë mësuesi.

<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë.</p> <p>Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën.</p> <p>T'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës "Çizmet e palaços".</p> <p>Të dallojë titullin në pjesë.</p> <p>Të analizojë dhe sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim.</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa,</p> <p>fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë.</p>
---	---	---	--	---

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bëjnë mësuesi	Aktivitetet që bëjnë nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Shpërndan fletë të bardha në grupe dhe drejton nxënësit të vizatojnë një palaço, por që të jetë sa më interesant në dukje. Pastaj, udhëheqësi i grupit do të paraqesë palaçon e vizatuar para të tjerëve dhe do të tregojë çdo detaj se pse dhe si e kanë bërë atë ashtu.	Nxënësit vizatojnë palaçon, duke përdorur imagjinatën e tyre dhe, si përfundim, ata tregojnë para të tjerëve çdo detaj të palaços që kanë bërë.
<b>Hapi i dytë</b>	Paraqet tekstin: "Çizmet e palaços". Lexon tekstin dhe bisedon me nxënësit. Pse shkoi palaçoja në shitore? Pse u çudit ai? Çfarë zgjodhi ai për të veshur në këmbë? A u çuditët edhe ju me përzgjedhjen e tij? A do të qeshnit edhe ju, po të ishit aty?	Lexojnë tekstin dhe bisedojnë me mësuesin rreth pyetjeve të drejtuara.
<b>Hapi i tretë</b>	Udhëzon nxënësit që të qarkojnë në libër fjalët që kanë shkronjën c dhe të krijojnë një fjalor me to. Kjo për arsye që ata të dallojnë shkronjat c dhe q në të shkruar.	Qarkojnë në tekst fjalët që kanë shkronjën c dhe i shkruajnë ato në fjalorin e shkronjave.

## Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Ç, ç, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës Ç, ç.</p> <p>Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim.</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë,</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa,</p> <p>fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë.</p>

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën, duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsërite djathtas, bëni një vijë në mes. Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu si janë shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Ç, ç.	Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Ç, ç.
<b>Hapi i dytë</b>	Njih nxënësit për atë që do të mësojnë, shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Ç, ç.  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Ç, ç dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Ç, ç, i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësojnë Abetaren e Punës. Dikton: çanta; Çimi mban çokollatë në çantë.	Shkruajnë shkronjën Ç, ç të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyrë.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës Ç, ç në Abetares e Punës, sipas modelit të dhënë.
<b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura  Detyrë shtëpie	Udhëzon: “Nga letrat për kolazh, të cilat ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Ç, ç”. Vendosini ato në këndin e shkronjave në klasë.  Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Ç, ç.	Me letrat e kolazhit që mësuesi u shpërndan, bëjnë balona, mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit Ç, ç dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti dhe ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre. Të analizojë dhe sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali. Të gjejë, lexojë dhe shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën Ç në trup të tyre. Të përdorë pikën si shenjë pikësimi.	Punë në grup Punë në dyshe Bashkëbisedim Dramatizim	Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Qarkoni fjalët e shkruara drejt: qorapë – qorapë qajnik – çajnik qelës – çelës çati – qati qen – çen çarçaf – qarçaf	Nxënësit lexojnë fjalët dhe qarkojnë fjalët e shkruara drejt.
<b>Hapi i dytë dhe i tretë</b>	Udhëzon nxënësit që të shkruajnë për palaçon, por të imagjinojnë momentin kur ai arrin në cirk me atë veshjen siç doli nga shitorja. Nxënësit shkruajnë individualisht, pastaj i lexojnë shkrimet me shokun në krah. Si përfundim, grupi do të krijojë një tekst, të cilin do ta paraqesë para të tjerëve në klasë. Secili grup do ta titullojë tekstin sipas dëshirës së tij.	Nxënësit imagjinojnë dhe shkruajnë për palaçon dhe momentin kur ai arrin në cirk, pastaj si grup e përfundojnë shkrimin dhe e lexojnë para të tjerëve.

### Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe shkronjës Dh, dh

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjet e të zhvilluarit	Burimet
<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe ta krahasojë atë me klasën e tij.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën Dh, dh.</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën Dh në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën Dh në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit Dh, dh, sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.</p>	<p>Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.</p>

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Formon grupe të nxënësve. Secilit grup i jep nga një figurë me këto pamje (dhëmb, dhuratë, dhelpër, dhomë, dhia ...). E shpjegon detyrën: "Krijoni një ngjarje të shkurtër rreth figurave që morët".	Formojnë grupet. Shohin me kujdes figurat dhe krijojnë ngjarjet rreth tyre. Nxënësi udhëheqës i grupit e tregon ngjarjen e krijuar para të tjerëve në klasë.



<p>1. Punim i tingullit.</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik.</p> <p>3. Vendosja e rrokjes në fjalë.</p>	<p>1. Njihen nxënësit me tingullin dhe shkronjën DH, dh.</p> <p>2. Udhëzoni nxënësit të shikojnë figurën e dhënë në libër dhe të lexojnë fjalët mbi të: <b>“Dhëmbi i Bardhit”</b>. Në cilën fjalë dëgjohet tingulli <b>DH</b>? A dini ju fjalë të tjera që kanë tingullin <b>DH</b>?</p> <p>3. Lexon fjalët dhe qarkon rrokjet në fjalët e dhëna. Tregon ku është rrokja, në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>	<p>1. E shohin figurën në libër dhe diskutojnë rreth saj, lexojnë dhe thonë fjalë me tingullin DH.</p> <p>2. Ndajnë fjalën në rrokje dhe qarkojnë rrokjen e dhënë në libër. Kështu e përcaktojnë se ku gjendet rrokja: në fillim, në mes apo në fund të fjalës.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Kërkoj shkronjën</p> <p>3. Lexoj</p>	<p>1. Shkruan shkronjën Dh, dh në tabelë ose i paraqet aty me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik në mes të shkronjës së madhe të shtypit DH dhe të voglës së shtypit dh.</p> <p>2. Udhëzoni nxënësit të vërejnë figurat në libër dhe të plotësojnë katrorët e zbrazët me shkronjat e duhura, dhe të formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexon fjalinë: <b>Bardhit i dhemb dhëmbi</b>. Pyet: “Sa fjalë ka kjo fjali? I ndani ato”. “Sa rrokje ka secila fjalë? I ndani ato”. “Sa shkronja ka secila fjalë? I ndani ato”.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat, vërejnë dhe thonë ku dallojnë shkronjat (madhësia, grafiku...)</p> <p>2. Plotësojnë katrorët e zbrazët me shkronjat e duhura dhe formojnë fjalën.</p> <p>3. Lexojnë fjalinë në libër. Ndajnë fjalinë në fjalë, fjalët në rrokje dhe në shkronja.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Shkrimi i shkronjës</p> <p>=</p> <p>2. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Shkruan shkronjën <b>DH, dh</b> të shtypit në tabelë dhe udhëzoni e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>DH, dh</b>. Po ashtu të vizatojnë diçka që fillon me shkronjën <b>DH</b>.</p> <p>2. Në copa të gazetave të gjejnë shkronjën <b>DH, dh</b>, t'i qarkojnë dhe t'i sjellin të nesërmen në klasë.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta me shkronjën <b>DH</b> dhe vizatojnë sende që fillojnë me shkronjën <b>DH</b>.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish)/Abetare e Punës

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e sintetizojë rrokje, fjalë, fjali.</p> <p>Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.</p>	<p>Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.</p>

Fjalët çelës: dhurata, kërpudha, dhelpa

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve të klasës të shkruajnë shkronjën <b>Dh</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>dh</b> të vogël të shtypit.  Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave ( <b>Dh, dh</b> )”.	Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>Dh</b> të madhe të shtypit në fletoren që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruajnë individualisht shkronjën <b>dh</b> të vogël të shtypit në fletoren që kanë përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet ( <b>Dh, dh</b> ).
Hapi i dytë	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>dhurata, kërpudha, dhelpira</b> ), për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?” ... Udhëzon nxënësit që, pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>Dh</b> në kutizat që mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna.  Lexojnë globalisht fjalët ( <b>dhurata, kërpudha, dhelpira</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>Dh</b> në kutizat ku mungon.
Hapi i tretë	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Dh, dh</b> , në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që ata të bëjnë vetëm njërin rast dhe kur bindet se i kanë bërë mirë i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që pasi të bëjnë detyrën të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>Dh, dh</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë, ndërsa më pas punojnë individualisht.  Pasi përfundojnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë e saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës “Bardhi te dentisti”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.	Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.

Fjalët çelës: Bardhi, dentisti, klinikë.

## Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
Hapi i parë Motivimi	Pyet nxënësit: Keni qenë ndonjëherë te dentisti? Si jeni ndier? Përshkruani klinikën e dentistit, çfarë keni parë aty?	Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të bëra, flasin për përvojat e tyre dhe e përshkruajnë klinikën e dentistit.

<b>Hapi i dytë</b>	Thotë: “Tregoni gjithçka që dini për dhëmbin, çdo gjë që thoni ju, unë do ta shkruaj në tabelë”. I nje nxënësit me tekstin e ri: “Bardhi te dentisti”, fillon të lexojë dhe të drejtojë pyetjet për nxënësit: Çfarë kishte Bardhi? Ku shkoi ai me mamin? Pse kishte frikë? Çfarë i bëri dentista? Si mendoni ju, cilat janë këshillat që dentista i dha Bardhit?	Nxënësit mendojnë për pak çaste dhe thonë gjithçka që u kujtohen dhe dinë për dhëmbin. Nxënësit bashkë me mësuesin lexojnë tekstin dhe përgjigjen në pyetjet e bëra.
<b>Hapi i tretë</b>	Lexoni individualisht tekstin “Bardhi te dentisti”, qarkoni fjalët që kanë shkronjën <b>dh</b> dhe shkruani këshillat që mësoi Bardhi në klinikë.	Nxënësit lexojnë individualisht tekstin, qarkojnë fjalët që kanë shkronjën <b>dh</b> dhe shkruajnë këshillat që pa Bardhi në klinikë.

## Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës Dh, dh, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehite e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës Dh, dh. Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronjat e shkrimit të dorës.	Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.	Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.

Fjalët çelës: shkronja e madhe, shkronja e vogël.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe, duke ngritur dorën lart, të veprojnë ashtu si i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën, duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtash, bëni një vijë në mes”. Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu si formohet shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>Dh, dh</b> .	Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>Dh, dh</b> .

## Ora e parë. Tema: Punimi i tingullit dhe shkronjës G, g

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehite e të zhvilluarit	Burimet

<p><b>Të flasë</b> për situatën e figurës së dhënë në libër dhe të krijojë një ngjarje me të.</p> <p><b>Të njohë</b> shkronjën G, g</p> <p><b>Të gjejë</b> shkronjën G në struktura fjalësh me ndihmën e figurave.</p> <p><b>Të qarkojë</b> shkronjën G në pozicione të ndryshme të fjalës.</p> <p><b>Të shkruajë</b> shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit G, g, sipas modelit.</p> <p><b>Të lexojë</b> globalisht fjalët në Abetare.</p>	<p>Punë në grup,</p> <p>Punë në dyshe,</p> <p>Bashkëbisedim,</p> <p>Dramatizim,</p> <p>Mësimi me lojë.</p>	<p>Të folurit,</p> <p>Art/vizatim, muzikë,</p> <p>Matematikë</p> <p>Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global,</p> <p>Të folurit,</p> <p>Imagjinata,</p> <p>Të dëgjuarit,</p> <p>Të zhvilluarit e vëmendjes,</p> <p>Të analizuarit,</p> <p>Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa,</p> <p>fletore,</p> <p>materiale vizatimi,</p> <p>CD, libra për fëmijë.</p>
--	--	--	--	---

Fjalët çelës: Abetarja, shkronja G, g, fjalori, titulli.

## Zhvillimi i mësimimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> <i>Motivimi</i> <i>Shkronjat e para fshedin një kafshë</i></p> <p><i>Përshkrimi i figurës në Abetare</i></p>	<p>Në tabelë shkruhen fjalët: GOMA, ORA, MIU, ARIU, ROSA, IRIQI Pyet: "Cilën kafshë fshedin SHKRONJAT E PARA të fjalëve"?</p> <p>Përshkruhet figura në Abetare. Çfarë shohin? Çfarë kafshe është gomari? Çfarë mendoni se po bën ai? Çfarë mendon, si ndihet gomari kur sheh veten në pasqyrë? A ke bërë ti ndonjëherë maskë? Për cilën festë maskohemi? Mendimet e nxënësve shkruhen në një fletë dhe ato më vonë lexohen nga nxënësit.</p>	<p>Thonë emrin gomari.</p> <p>Mendojnë, imagjinojnë.</p>
<p>1. Punim i tingullit - Analizë e fjalisë</p> <p>2. Njohja e tingullit në mjedisin fonologjik - Loja - Urra</p>	<p>1. Shkruhet fjalia nga Abetarja. <i>Gomari përgatiti një maskë.</i> Analizohet fjalia. Sa fjalë ka? Ndahen fjalët në rrokje. Shqiptohen rrokjet me tingullin G. Cili tingull përsëritet? Cilës bashkësi i takon ky tingull: bashkësisë së zanoreve apo të bashkëtingëlloreve? Pse?</p> <p>2. Mësuesi/ja thotë fjalë që kanë dhe nuk kanë tingullin G. Nxënësit dallojnë fjalën që ka tingullin G.</p>	<p>Numërojnë fjalët në fjali dhe ndajnë ato në rrokje.</p> <p>Thonë: Tingulli G. Thonë: Ky tingull është tingull bashkëtingëllor.</p> <p>2. Dallojnë kur fjala ka tingullin G dhe bërtasin "Urra".</p>

<p><b>Hapi i dytë</b></p> <p>1. Grafiku i shkronjës</p> <p>2. Alfabeti i murit</p> <p>3. Ndërtimi i shkronjës</p>	<p>1. Shkruan shkronjën G, g, në tabelë ose i paraqet me shkronja lëvizore. I drejton nxënësit të bëjnë dallimin grafik ndërmjet shkronjës së madhe të shtypit G dhe të voglës së shtypit g.</p> <p>2. U tregon nxënësve shkronjën e murit, udhëheq nxënësit në vëzhgimin e saj (pamja e shkronjës, pozita e vijave dhe krahasimi me shkronjat tjera të mësuara).</p> <p>Kërkon të punojnë shkronjën me fije të ndryshme.</p>	<p>1. Shikojnë me vëmendje shkronjat, vërejnë dhe thonë ku dallojnë shkronjat (madhësia, grafiku...)</p> <p>2. Nxënësit vëzhgojnë vijat e shkronjës, analizojnë dhe e shkruajnë atë.</p> <p>Punojnë shkronjën me fije të ndryshme.</p>
<p><b>Hapi i tretë</b></p> <p>1. Plotësim e lexim</p> <p>2. Shkrimi i shkronjës</p> <p>3. Detyrë shtëpie</p>	<p>1. Kërkon të shkruhen fjalët në Abetare, lexohen fjalët dhe fjalia. Lexohet edhe teksti që është shkruar në fillim të orës, i cili është i krijuar nga nxënësit.</p> <p>2. Shkruan shkronjën G, g, të shtypit në tabelë dhe udhëzon e ndihmon nxënësit të shkruajnë në fletoren e tyre 3-4 rreshta me shkronjën <b>G, g</b>. Shkruhet fjalia nga Abetarja.</p> <p>3. Shkruaj tre emra njerëzish, kafshësh dhe sendesh që kanë shkronjën G.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë në fletoret e tyre disa rreshta dhe fjalën me shkronjën G.</p>

### Ora e dytë. Tema: Analizë dhe sintezë fjalësh (fjalish) / Abetare e Punës

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të analizojë e sintetizojë rrokje, fjalë, fjali. Të përcaktojë pozicionin e kësaj shkronje në trup të fjalës: nistore, në mes, fundore.</p>	<p>Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.</p>	<p>Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.</p>

Fjalët çelës: Globi, gërshëra, gështenja.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Shpërndan fletë të bardha dhe udhëzon që gjysma e nxënësve të shkruajnë shkronjën <b>G</b> të madhe të shtypit, kurse gjysma tjetër e nxënësve shkronjën <b>g</b> të vogël të shtypit. Thotë: “Kur unë të them TANI, ju duhet të lëvizni në klasë dhe të formoni çiftet e shkronjave (<b>G, g</b>)”.</p>	<p>Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha. Nxënësit e grupit të parë shkruajnë individualisht shkronjën <b>G</b> të madhe të shtypit në fletën që kanë përpara. Grupi i dytë i nxënësve shkruajnë individualisht shkronjën <b>g</b> të vogël të shtypit në fletën që kanë përpara. Ngrihen në këmbë, lëvizin në klasë dhe formojnë çiftet (<b>G, g</b>).</p>

<b>Hapi i dytë</b>	Kërkon që nxënësit të komentojnë figurat ( <b>globi, gërshëra, gështenja</b> ), për secilën nga këto figura pyet: “Çfarë është? Për çfarë nevojitet? A ju pëlqen? Pse?” ... Udhëzon nxënësit që pasi të komentojnë figurat, t’i lexojnë fjalët në mënyrë globale dhe të shkruajnë shkronjën <b>G</b> në kutizat që mungon.	Komentojnë figurat në libër dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna. Lexojnë globalisht fjalët ( <b>globi, gërshëra, gështenja</b> ) dhe shkruajnë shkronjën <b>G</b> në kutizat ku mungon.
<b>Hapi i tretë</b>	U tregon nxënësve modelin se si do të shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>G, g</b> në Abetaren e Punës dhe u shpjegon se si do të punohet në të. Kërkon që të bëjnë vetëm njërin rast dhe kur bindet se i kanë bërë mirë, i lë të vazhdojnë në mënyrë të pavarur.  Udhëzon nxënësit që, pasi të bëjnë detyrën, të shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe të kontrollojnë se si ka punuar shoku.	Nxënësit shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit <b>G, g</b> , në Abetaren e Punës. Presin ndihmën e mësuesit në rastin e parë, ndërsa më pas punojnë individualisht.  Pasi përfundojnë detyrën, nxënësit shkëmbejnë fletoret me shokun në krah dhe kontrollojnë njëri-tjetrin se si kanë punuar.

### Ora e tretë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti, grupe fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të lexojë fjalitë qartë e saktë. Të përshkruajë figurat që ilustrojnë pjesën. T’u përgjigjet pyetjeve që i bëhen në lidhje me përmbajtjen e pjesës: “Gomari në festë”. Të dallojë titullin në pjesë. Të analizojë dhe sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.	Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.	Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.

Fjalët çelës: Gomari, maska, karnavalet.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Thotë: “Është Dita e Karnavaleve dhe ju duhet të përgatitni një maskë për të dalë në rrugë. Si do të dukej ajo maskë dhe me çfarë do ta bënit?”	Nxënësit mendojnë dhe imagjinojnë; më pas secili tregon se si do të duket maska e tij.
<b>Hapi i dytë</b>	I njofton nxënësit se do të lexojë me ndalesa dhe do të bëjë pyetje. Ndalesa e parë: “Një ditë... <b>deri te</b> e njohu”. Pyet: “Çfarë përgatiti gomari? Ku shkoi ai? Çfarë bënë kafshët tjera, kur e panë? Si mendoni ju që u ndje gomari në ato çaste? Çfarë do të ndodhë më vonë?” Ndalesa e dytë: “Nga gëzimi... <b>deri te</b> për në shtëpi”. Pyet: “A ndodhi ashtu si menduat? Çfarë ndodhi? Si u ndje gomari dhe si reagoi ai?”	Nxënësit dëgjojnë tekstin dhe u përgjigjen pyetjeve që drejton mësuesi.

<b>Hapi i tretë</b>	Kërkon që nxënësit të dëgjojnë me vëmendje pyetjen: “A kanë të drejtë kafshët të tallen me gomarin?” Më pas drejtohen në njërin kënd të klasës nxënësit që mendojnë se kafshët kanë të drejtë, kurse në këndin tjetër të klasës, nxënësit që mendojnë se kafshët nuk kanë të drejtë.	Në pyetjen që drejton mësuesi, nxënësit ndahen në dy grupe dhe argumentojnë mendimet e tyre.
---------------------	--	--

## Ora e katërt. Tema: Shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës **G, g**, shkrim fjalësh (fjalish)

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
Të modelojë bukur grafikun e shkronjës së madhe e të vogël të dorës <b>G, g</b> . Të shkruajë fjalë dhe fjali me shkronja të shkrimit të dorës.	Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.	Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.	Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.	Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.

Fjalët çelës: glob, shkronjë e madhe, shkronjë e vogël.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<b>Hapi i parë</b> Motivimi	Kërkon që nxënësit të mbyllin sytë dhe duke ngritur dorën lart të veprojnë siç i drejton ai. Thotë: “Mbyllni sytë, ngrini lart dorën me të cilën shkruani, ulni dorën duke e bërë një lakim majtas, pastaj përsëriteni djathtash, bëni një vijë në mes”. Në këtë mënyrë i orienton të bëjnë lëvizjen e dorës në ajër, ashtu siç formohet shkronja e madhe dhe e vogël e shkrimit të dorës <b>G, g</b> .	Nxënësit veprojnë ashtu si i orienton mësuesi, duke lëvizur dorën në ajër për të bërë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>G, g</b> .
<b>Hapi i dytë</b>	Njeh nxënësit për atë që do të mësojnë: shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>G, g</b> .  Paraqet para nxënësve shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>G, g</b> dhe i udhëzon ata që të shkruajnë shkronjat në fletë të bardha me lapsa me ngjyra.  Udhëzon nxënësit të shkruajnë në Abetaren e Punës shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>G, g</b> , i vëzhgon ata dhe i ndihmon kur kanë vështirësi. Plotësojnë Abetaren e Punës Dikton: globi madh. Genta e Gimi kanë glob.	Shkruajnë shkronjën <b>G, g</b> të shkrimit të dorës në fletë të bardha me lapsa me ngjyrë.  Shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit të dorës <b>G, g</b> në Abetaren e Punës, sipas modelit të dhënë.

<p><b>Hapi i tretë</b> Balona të lumtura</p> <p>Detyrë shtëpie</p>	<p>Udhëzon: “Nga letrat për kolazh që ju kam dhënë, vizatoni dy balona dhe mbi to shkruani shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>G, g</b>. Vendosi ato në këndin e shkronjave në klasë.</p> <p>Shkruani disa rreshta në fletore me shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>G, g</b>.</p>	<p>Me letrat e kolazhit që shpërndan mësuesi, bëjnë balona, mbi të cilat shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shkrimit <b>G, g</b>, dhe i vendosin në këndin e shkronjave në klasë.</p>
--	--	--

### Ora e pestë. Tema: Lexim dhe kuptim teksti dhe ushtrime gjuhe

Objektivat	Strategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehitë e të zhvilluarit	Burimet
<p>Të lexojë fjalitë qartë e saktë dhe të tregojë kuptimin e tyre.</p> <p>Të analizojë dhe sintetizojë rrokje, fjalë dhe fjali.</p> <p>Të gjejë, lexojë dhe shkruajë emra njerëzish që kanë shkronjën G në trup të tyre.</p> <p>Të përdorin pikën si shenjë pikësimi.</p>	<p>Punë në grup, Punë në dyshe, Bashkëbisedim, Dramatizim.</p>	<p>Të folurit, Art/vizatim, muzikë, Matematikë, Dramë.</p>	<p>Të lexuarit global, Të folurit, Imagjinata, Të dëgjuarit, Të zhvilluarit e vëmendjes, Të analizuarit, Të krijuarit.</p>	<p>Teksti, lapsa, fletore, materiale vizatimi, CD, libra për fëmijë.</p>

Fjalët çelës: Kali, gomari, gazeta, gishta, gozhdë.

### Zhvillimi i mësimit

	Aktivitetet që bën mësuesi	Aktivitetet që bën nxënësi
<p><b>Hapi i parë</b> Motivimi</p>	<p>Shpërndan etiketa me fjalë (gazetë, gishta, gozhdë, gatuaj, gripi, goma) dhe kërkon që nxënësit në grupe të krijojnë fjali me to.</p>	<p>Me etiketat me fjalë nxënësit krijojnë fjali dhe udhëheqësi i grupit i lexon para të tjerëve në klasë.</p>
<p><b>Hapi i dytë</b></p>	<p>Udhëzon nxënësit që të krahasojnë kalin dhe gomarin.</p> <p>Kali                      Gomari</p> <p>I urtë I punëtor I bindur I fortë I ngadaltë I bukur I shpejtë</p>	<p>Nxënësit krahasojnë kalin dhe gomarin, duke i lidhur me shigjetë ata me mblemrat e dhënë.</p>



<p><b>Hapi i tretë</b></p>	<p>Mësuesi prezanton titullin e tregimit “Hunda e Pinokut”.</p> <p><i>Ndalesa e parë</i></p> <p>Mësuesi lexon pjesën e parë të tregimit, ku Zana e pyet Pinokun se ku i ka çuar monedhat e arit.</p> <p>Në vazhdim, mësuesi pyet: Çfarë ka ndodhur me Pinokun? Ku mendoni ju se i ka çuar monedhat? Përse i janë dashur? <i>Ndalesa e dytë</i></p> <p>Mësuesi lexon pjesën tjetër të tregimit, që ka të bëjë me gënjeshtren e Pinokut, dhe i pyet nxënësit: A janë të vërteta fjalët që po thotë Pinoku? <i>Ndalesa e tretë</i></p> <p>Lexohet pjesa e tretë dhe e fundit nga mësuesi. Pasi lexon fragmentin, mësuesi pyet nxënësit: Si ju duken përgjigjet e Pinokut? Keni nisur t’i besoni dhe pse? Nëse me hundën e gjatë do ta kishit Pinokun para, si mendoni se do të ndihej ai? Po ju çfarë do të bënit me të? Mësuesi bën pyetje të tjera, nëse nxënësit kanë nevojë.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit, në grupe dyshe, ta lexojnë me role tregimin.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të nënvizojnë fjalitë që flasin për gënjeshttrat e Pinokut.</p>	<p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit, ashtu siç i kuptojnë.</p> <p>Mësuesi plotëson në rast se nxënësit kanë nevojë.</p> <p>Nxënësit përgjigjen duke sjellë edhe argumente pse pranojnë ose jo argumentet e Pinokut.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit, ashtu si ata i kuptojnë.</p> <p>Nxënësit, në grupe dyshe, lexojnë tregimin.</p> <p>Nxënësit nënvizojnë fjalitë që flasin për gënjeshttrat e Pinokut.</p>
<p><b>Pas leximit Përforcimi</b></p>	<p>Dramatizim, rrjet diskutimi, thuhet-shkruhet</p>	
<p><b>Hapi i katërt</b></p>		

# ORËT E PËRSËRITJEVE

## Abetare

### Përsëritje 1

#### Tema: Përsëritje e 6 shkronjave të para (a, i, m, n, e, ë)

	Orët
Abetare	2
Abetare Pune 1	1
Veprimtari shkrimi	1

(Kjo përsëritje do të bëhet pasi të kenë mbaruar 6 shkronjat e para të Abetares.)


	Objektivat	T e k n i k a / strategji	Ndërthurja	Shprehi	BURIME
ORA 1	<ol style="list-style-type: none"> <li>Të <b>mbajë mend</b> gjashtë shkronjat e grupit të parë: <b>a, i, m, n, e, ë</b>.</li> <li>T'i <b>shqiptojë</b> drejt shkronjat dhe fjalët.</li> <li>Të <b>zbërthejë</b> strukturat e fjalive në fjalët përbërëse.</li> </ol>	<p>Breinstorming</p> <p>Analizë dhe sintezë</p> <p>Diagrami i Venit</p>		L e x i m shkrim	Abetarja, E t i k e t a f j a l i s h , fjalësh dhe rrokjesh, Materiale të sjella nga nxënësit, Histori ku përfshihen fjalët e fjalorit.
ORA 2	<ol style="list-style-type: none"> <li>Të <b>formojë</b> dhe të rindërtojë rrokje dhe fjalë të tjera me shkronjat e mësuara.</li> <li>Të <b>formojë</b> fjali të thjeshta me fjalët e fjalorit, ose të tregojë histori të shkurtra që kanë lidhje me to.</li> <li>Të <b>krijojë</b> rrokje që nisin me zanore, ose me bashkëtingëllore, duke iu përshtatur modelit të dhënë.</li> </ol>	Demonstim	L e x i m S h k r i m Matematikë	A n a l i z ë sintezë	Etiketa, t a b e l a plastike
ORA 3	<ol style="list-style-type: none"> <li>Të <b>ushtrohet</b> në leximin e shkronjave, rrokjeve, fjalëve dhe fjalive.</li> <li>Të <b>njihet</b> me disa elemente treguese të fjalisë, si: pika, fjala e shkurtër dhe e gjatë.</li> <li>Të <b>ushtrohet</b> në leximin e shkronjave, rrokjeve, fjalëve dhe fjalive.</li> <li>Të <b>njihet</b> me disa elemente treguese të fjalisë, si: pika, fjala e shkurtër dhe e gjatë.</li> </ol>	Numërim, Vëzhgim	Art	Vëzhgimi	Të gjyrosë etiketa nën fjalë dhe fjali, Numra

ORA 4	<p>11. Të <b>shkruajë</b> fjalë, nisur nga rrokjet dhe shkronjat e dhëna.</p> <p>12. Të <b>lidhë</b> fjalën me figurën.</p> <p>13. Të <b>plotësojë</b> modelin e dhënë me grupe fjalësh.</p> <p>14. Të shkruajë sipas modeleve dhe kërkesave të dhëna.</p> <p>15. Të shkruajë me shkrim dore.</p>	Punë të pavarur	Të shkruarit	Imaginatë, Art	Material shkrimi. Fletore e modeluar. Fletore për ushtrim dore.
-------	---	-----------------	--------------	----------------	---

## Përsëritje, fjali, pikë, rrokje, etiketa

### Zhvillimi i mësimit

Ora e parë dhe e dytë

	<b>Çfarë do të bëjë mësuesi?</b>	<b>Çfarë do të bëjnë nxënësit?</b>																					
Hapi i parë	1. Mësuesi pyet nxënësit: - “Cilat shkronja kemi mësuar deri tani”?	2. Ngrihen nxënës të ndryshëm për t’i shkruar në tabelë me shkronja të mëdha, me të vogla, të shtypit e të dorës.																					
Hapi i dytë	<p>Mësuesi nxjerr një shportë me shkronja dhe u jep nxënësve të marrin nga një etiketë.</p> 	Nxënësit marrin etiketa, ku mund të jenë shkronja, rrokje, fjalë, grupe fjalësh që duhet t’i shkruajnë.																					
Hapi i tretë	Hapet libri i Abetares dhe mësuesi kërkon që nxënësit të përsërisin shkronjat e alfabetit të mësuara në Paraabetare dhe ndërmjet tyre të gjejnë ato që kanë mësuar në Abetare.	Nxënësit përsëritin shkronjat e alfabetit të shkruara në krye të faqes së saj, pavarësisht se ata nuk i kanë mësuar të gjitha shkronjat. Më pas ndalojnë përsëri te shkronjat që kanë mësuar.																					
Hapi i katërt	Nxënësve u kërkohet të formojnë rrokje e fjalë me gjashtë shkronjat e mësuara.	Ato shkruhen nga nxënësit në tabelë, ashtu siç duan nxënësit, me shkronja shtypi.																					
Hapi i pestë	<p>Nëse nxënësit ndeshin vështirësi, mësuesi u vizaton këtë tabelë si model.</p> <table border="1" data-bbox="368 1690 823 1816"> <tr> <td></td> <td>a</td> <td>e</td> <td>i</td> <td>ë</td> </tr> <tr> <td>M</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>N</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </table>		a	e	i	ë	M					N					<table border="1" data-bbox="909 1627 1246 1753"> <tr> <td>fjalë që</td> <td>krijohen</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> </table>	fjalë që	krijohen				
	a	e	i	ë																			
M																							
N																							
fjalë që	krijohen																						

Hapi i gjashtë	Punohet me fjalorin e shkruar në të dyja anët e faqeve. Nxënësit i lexojnë me radhë. Mësuesi mund t'i nxisë të tregojnë ndonjë histori që ka lidhje me këto fjalë. Punohet me figura dhe gjejnë figura që në fjalët e tyre tingëllon tingulli që i përket shkronjës.	Komentohen figurat dhe shkronjat që mund të kenë brenda tyre në trup.
Hapi i shtatë	Lexohen dhe komentohen fjalitë. Komentohet shkronja e madhe në fillim të tyre, numri i fjalëve, pika në fund të fjalisë. P.sh.: Ani ka në dorë librin e Abetares. Ola shkoi në shkollë. Po ju a keni libër të tillë? A ju pëlqen ajo? Çfarë ju pëlqen më shumë? <b>Ema:</b> Po me ç'kafshë ju pëlqen të luani? A mbani kafshë në shtëpi? Ç'emër i keni vënë?	Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të mësuesit.
Hapi i tetë	Për pesë minuta, mësuesi i lë nxënësit të lexojnë fjalitë e dhëna. Para se të lexohen ato bëhen komente rreth asaj që shohin nxënësit. Ata mund të rikujtojnë se në ç'mësim i kanë ndeshur këto figura. Lexohen me radhë të katër fjalitë. Diskutohet rreth tyre. Sa ngjyra janë përdorur në fjalinë e parë? Pse? Sa fjalë ka fjalia e parë? Numëroni me gisht. Sa ngjyra janë përdorur në fjalinë e dytë? Pse? Sa fjalë ka në fjalinë e dytë? Cilat janë ato?	Nxënësit gjejnë fjalët, rrokje fjalësh brenda strukturave të fjalisë. Kjo procedurë ndiqet edhe në të dyja fjalitë e tjera.  Të gjithë nxënësit do t'i lexojnë me radhë fjalitë.
Hapi i nëntë	Nxënësve u kërkohet të japin edhe kuptimin e fjalëve të krijuara.	Lexohen fjalët nga nxënësit. Nxënësit mund të ndjekin edhe një rregull të tillë për të lexuar fjalët: <b>MA + MI= MAMI</b> <b>NË-NA</b> <b>NI-NA</b>
Hapi i dhjetë	Punohet ushtrimi me pazëll. Mësuesi udhëzon se nxënësit duhet të gjejnë fjalë të ndryshme. Ky ushtrim sugjerohet të zhvillohet në fillim me gojë dhe më pas të plotësohet nga nxënësit. Edhe me këto rrokje, nxënësit mund të krijojnë fjalë të reja. Shkruhen ato.	Nxënësit do të krijojnë rrokje të drejta dhe të zhdrejta, të cilat fillojnë një herë me zanore e një herë me bashkëtingëllore.
Hapi i njëmbëdhjetë	Lexohen katër fjalitë e dhëna në ushtrimin 4. Sa ngjyra janë përdorur në fjalinë e parë? Pse? Sa fjalë ka fjalia e parë? Numërojini ato. Sa ngjyra do të përdorim në fjalinë e dytë? Pse? Sa fjalë ka në fjalinë e dytë? Cilat janë ato? Sa ngjyra do të përdorim në fjalinë e tretë? Pse? Sa fjalë ka në fjalinë e tretë? Cilat janë ato? Nxënësve u tërhiqet vëmendja në pikën e vendosur në fund të fjalive.	Nxënësit do të kalojnë të njëjtat procedura si në fjalitë e tjera.

Hapi i 12	Mësuesja kërkon që nxënësit të shkruajnë me shkronja shtypi dhe dore fjalinë në fund të faqes. Mësuesja kërkon të imitojnë zëra kafshësh. Mësuesja nxjerr figurën.	Nxënësit plotësojnë me shkrim fjalët në fund të faqes.  Nxënësit imitojnë zëra kafshësh.
Hapi i 13	Shkruajnë e plotësojnë fjalë, rrokje, fjali. Shkruajnë me shkrim dore.	

Nxënësve u tërhiqet vëmendja në pikën e vendosur në fund të fjalive dhe në shkronjën e parë të madhe me të cilën fillon çdo fjali.

Nxënësit do të krahasojnë secilin rresht me njëri-tjetrin.

Rreshti	Cfarë ka:			Pse?
	Shkronjë	Rrokje	Fjalë	
I parë				
I dytë				
I tretë				
I katërt				

### Ora 3. Punohet në Abetaren e Punës me ushtrime përforcimi me shkrim dore dhe diktim

Siç shihet në këtë faqe janë bashkuar ushtrimet e përforcimit, ashtu edhe shkrimi i dorës. Kemi menduar t'i shkrijmë në këtë mënyrë për ta bërë më të lehtë kalimin nga shkrimi i shtypit në shkrimin e dorës.

Lexohen shkronjat e dhëna. Nxënës të ndryshëm ngrihen t'i shkruajnë në tabelë.

#### Ushtrimi 1.

Komentohen figurat e dhëna në krahun e majtë. Nxënësit do të emërtojnë figurat, do të lexojnë fjalët e dhëna e më pas do t'i lidhin me shigjetë.

Secila fjalë do të shkruhet nga dy herë.

#### Ushtrimi 2.

Me shkronjat A, E dhe I, me rrokjet e dhëna, si dhe duke ndjekur drejtimin e shigjetës, nxënësit do të formojnë fjalë me kuptim dhe do t'i shkruajnë ato. Nxënësit mund të diskutojnë nëse ato përdoren ose jo si emra njerëzish.

#### Ushtrimi 3.

Nxënësit do të lexojnë fjalët në etiketë dhe më pas do t'i kombinojnë në grupe të reja fjalësh.

Mësuesi kontrollon dhe vlerëson punën e secilit nxënës.

Ai mund të kërkojë nga nxënësit të formojnë fjali me fjalët e punuara, ose të bëjë konkurs mes tri rreshtave se cili do të gjejë fjalë të reja me shkronjat e mësuara dhe t'i shkruajë saktë në tabelë, si dhe lojërë të tjera si këto.

Veprimtaritë e shkrimit bashkëshoqërojnë gjatë gjithë kohës, si punën me Abetaren, ashtu edhe punën me Abetaren e Punës. Ato janë mjaft të larmishme dhe mësuesi është i lirë t'i shfrytëzojë kur e shikon të nevojshme.

Nxënësit do të vlerësohen se cilët nxënës shkruajnë më bukur, më saktë dhe më qartë.

Shkruajnë fjalë me shkronja dore dhe diktim.

## PËRSËRITJA E DYTË

### Tema: Rimarrja e gjashtë shkronave të dyta R, U, L, K, O, P

#### Objektivat

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të fitojë gradualisht shprehitë e të lexuarit,
- të formojë fjalë, duke u nisur nga shkronja ose rrokje bazë,
- të lidhë fjalët me figurat përkatëse,
- të manipulojë me fjalëkryqe për të krijuar fjalë të reja,
- të gjejë përgjigjen, duke lexuar fjali pyetëse,
- të lexojë në mënyra të ndryshme, i udhëhequr nga materiale të ndryshme, të shkruara më parë.

#### Mjetet e nevojshme

Libra jashtë klasë, etiketa, bileta, fatuara e materiale të tjera të shkruara

#### Terma kryesorë

Libra për fëmijë, etiketa, reklama, fjalëkryqe, lojëra gjuhësore etj.

#### Shprehi që zhvillohen

Të folurit, të lexuarit, të shkruarit, manipulimi, imagjinata etj.

#### Struktura e mësimit

Evokim: Stuhi mendimesh

Realizim kuptimi: Lexim dhe shkrim fjalësh e fjalish.

## Zhvillimi i mësimit

Mësuesja nxjerr një figurë ose një send dhe nxënësit shkruajnë shkronjën e parë të emrit të objektit (mësuesi bën kujdes të paraqesë figura ose sende, emrat e të cilave fillojnë me shkronja që nxënësit i kanë mësuar që më parë).

Nxënësit shkruajnë në fletë të mëdha  $A_4$  ose në tabela plastike shkronjat e para të emrave të figurave, të cilat paraqet mësuesi. Mësuesi i vëzhgon dhe i ndihmon, në rastet kur ata kanë gabuar.

Ky ushtrim mund të zhvillohet edhe me anë të dëgjuarit të nxënësve. Mësuesi shqipton fjalën, nxënësit shkruajnë shkronjën e parë të emrit të fjalës që dëgjojnë. Ky ushtrim mund të bëhet edhe nga vetë nxënësit në grupe në formë loje, cili gabon, del nga loja ose dënohet që ta shkruajë 10 herë shkronjën që gaboi.

Mësuesi i orienton nxënësit të marrin nga një libër, të cilët i kanë sjellë vetë në klasë dhe që janë biblioteka e tyre, e cila duhet të pasurohet çdo ditë me libra të rinj. Pasi nxënësit kanë marrë librat në dorë, mësuesi u thotë t'i mbajnë të pahapur.

- Shikoni kapakun, - thotë mësuesi. - Lexoni titullin, me radhë dhe më zë.

Qarkoni me laps shkronjat që keni mësuar deri tani ose fjalët që mund t'i lexoni të plota.

Mësuesi u thotë të hapin librin në një faqe të caktuar. E rëndësishme është që nxënësit të mësohen të shfletojnë sipas udhëzimevetë mësuesit.

Mësuesi u jep detyrë që në shtëpi, nxënësit të marrin një libër dhe të lexojnë një faqe (në faqen që kanë zgjedhur, të lexojnë fjali, fjalë ose shkronja që dinë t'i lexojnë). Mësuesi u thotë nxënësve të hapin librin e Abetares në faqen 40-41 dhe të lexojnë shkronjat në krye të faqes. U thotë të pyesin për shkronjat që nuk i njohin. Ka shumë rëndësi që nxënësit të pyesin vazhdimisht për shkronjat që nuk i njohin, pasi duhet t'i njohin edhe para se t'u vijë radha, me qëllim që ta kenë më të lehtë kur të fillojnë ta mësojnë atë.

Mësuesi i orienton nxënësit të lexojnë shkronjat me ngjyra të ndryshme të faqes përkatëse. Mësuesi diferencon:

Grupi i shkronjave të kuqe quhen zanore, sepse kanë më shumë zë.

Grupi i shkronjave bojë qielli quhen bashkëtingëllore. Ato kanë më pak zë.

Kur bashkohen një bashkëtingëllore me një zanore, kemi një rrokje, le ta provojmë!

Prezanton shkronjat e zëshme dhe të pazëshme të njohura nga nxënësit.

Del në pah njohja:

- E zanoreve**
- E bashkëtingëlloreve**

Kalohet në ushtrimin e tretë, në të cilin mësuesi kërkon që nxënësit të qarkojnë shkronjën e njohur në fjalët e shkruara në ushtrimin e fundit.

Por mund të qarkojnë edhe rrokje kur ato dalin në trup të fjalëve që mund t'i lexojnë, p.sh: **ma, mi, me.**

Mësuesi jep modelin e parë, nxënësit e plotësojnë atë më tej me shembuj të tjerë.

U jepet kohë e mjaftueshme për të bërë këtë ushtrim.

Mësuesi i orienton fëmijët të vërejnë figurën dhe të flasin rreth saj, duke bërë edhe pyetje (përalla “Iriqi dhe molla”). Pyetjet e fëmijëve duhet të zënë vend të mirë gjatë kësaj bisede, pasi ato i ndihmojnë të depërtojnë në kuptimin e përrallës, duke lidhur anën pamore me leximin dhe kuptimin e asaj që shohin. Kërkon të tregohet përralla “Iriqi dhe molla”.

Mësuesi kërkon që nxënësit të tregojnë përrallën. Nxënësit tregojnë përrallën dhe u përgjigjen edhe pyetjeve.

Punohet ushtrimi “lidh me shigjetë” dhe më pas ushtrimi në të cilin duhet të lexojnë drejt fjalët e shkruara mbrapsh.

Hapi i fundit për këtë orë është ndarja e fjalëve në degën e pemës dhe më pas shkrimi i fjalëve me shkronja dore në tabelat dhe kutizat përkatëse.

## Ora e tretë

### Tema: Përsëritje

#### Objektivat

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të plotësojë fjalët,
- të formojë fjalë, nisur nga rrokjet e dhëna,
- të plotësojë fjalinë me fjalën e duhur,
- të krijojë fjali, nisur nga foljet e dhëna dhe figurat në anë.

#### Mjetet e nevojshme

Libri i punës, materiale të Abetares së Punës, tabela plastike e shkrimit

**Fjalë kyç:** Formim, fjalë, formim fjalie, plotësim pjese.

#### Shprehitë që zhvillohen

Të shkruarit, të lexuarit, të manipuluarit, të menduarit, analiza, sinteza.

## Zhvillimi i mësimit

Nxënësit vihen para detyrës për të lexuar shkronjat e shtypit dhe të dorës të shkruara në fillim të faqes së përsëritjes 2 në Abetaren e Punës. Ndërkohë, mësuesi nxjerr shkronja dhe nxënës të caktuar sipas zgjedhjes së tij, të cilët i lexojnë ato. Mësuesi i ngatërron shkronjat e shtypit me ato të dorës, me qëllim që nxënësit të tregojnë vëmendje maksimale. Ky ushtrim mund të vazhdojë për 5 minuta.

Mësuesi i orienton nxënësit që në fjalët në anë të figurave të plotësojnë pjesën e fjalës që mungon.

Në kërkesën e ushtrimit të tretë ka rëndësi që nxënësit të lidhin me shigjetë sipas radhës rrokjet brenda kutisë, duke formuar fjalë me to. Më pas, në vizën poshtë kutisë duhet të shkruhet fjala përkatëse.

Në këtë ushtrim kërkohet që nxënësit të shkruajnë në viza fjalën që duhet, duke u orientuar edhe nga figura në anë të fjalisë.

Mësuesi orienton nxënësit se, ata duhet të shkruajnë një fjali, ku të përdorin fjalët: **iku, kapi, luan**. Figurat në anë të fjalive mund të shërbejnë dhe ndihmojnë për të formuar fjalinë. Mësuesi e bën vetë modelin.

### Shënim.

Kjo faqe, e cila përmban edhe ushtrime përforcimi dhe ushtrime për shkrimin e dorës, duhet të shërbejë në cilësinë e një testi pas punimit të gjashtë shkronjave të dyta të Abetares.

Për këtë, në këtë faqe mos harroni: **DUHET VENDOSUR PATJETËR VLERËSIM PËR NXËNËSIT!**

### Ora e katërt e përsëritjes

Tema: *Modelim i shkrimit të dorës*

#### Objektivat:

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të shkruajë të gjitha shkronjat e dorës të vogla dhe të mëdha të mësuara deri në këtë çast,
- të përforcojë aftësitë shkruese me shkrimin e dorës,
- të aftësohet me të shkruarin përmes diktimit,
- të kopjojë pjesë të shkruara sipas nevojave.

#### Mjetet e nevojshme

Fletoret e shkrimit dhe të diktimit

#### Fjalë kyç

Diktim, shkrim dore, kopjim

#### Shprehitë që zhvillohen

të shkruarit, të kuptuarit e leximit dhe shkrimit

## Zhvillimi i mësimit

Në këtë orë mësimi, mësuesi duhet të rimarrë një aktivitet të gjerë pune të diferencuar.

Ai duhet të punojë për të realizuar aktivitete, të tilla si diktim, modelim shkronjash të vogla e të mëdha, të cilat mund të mos jenë punuar mirë, kopjim tekstesh të ndryshme.

Por në këtë orë mund të bëhen edhe aktivitete të ndryshme shkrimi dhe leximi, të cilat mësuesi i quan si shumë të nevojshme për fazën deri ku ka arritur.

Është mirë që mësuesi të mos vazhdojë më tej, në rastet kur kanë nevojë edhe për disa orë.



Ai është i lirë të bëjë edhe modifikime në program, nëse e sheh të nevojshme, duke lajmëruar drejtorin e shkollës dhe inspektorin e DA-së.

### Shënim.

Mësuesit nuk duhet të harrojnë se, për çdo problem që u lind, duhet të mbajnë shënimet përkatëse.

## Përsëritja e tretë

### Shkronjat B, H, T, S, SH, F

#### Objektivat

#### Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

1. të lexojë të gjitha shkronjat e shtypit të bëra deri tani, të vogla e të mëdha,
2. të flasë për kompjuterin,
3. të krijojë lidhje për funksionet e pjesëve të ndryshme të kompjuterit.
4. të plotësojë fjalitë me fjalët që mungojnë,
5. të plotësojë një kartolinë me urime që lidhen me një festë.

#### Mjetet e nevojshme

Libra jashtë klasë, etiketa, bileta, fatuara e materiale të tjera të shkruara.

#### Terma kryesorë

Kompjuter, komandë, maus, klik, tastiera, kartolinë

#### Shprehi që zhvillohen

Të folurit, të lexuarit, të shkruarit

#### Struktura e mësimit

E	Diskutim	10'
R	Lexim i tekstit me ndalesa e diskutim i vazhdueshëm për të	25'
R	Shkrim i lirë	10'

## Zhvillimi i mësimit

### Evokimi

Lexohen shkronjat me ngjyrë blu të vendosura në fillim të faqeve. Shkronjave që u përkasin grupit të katërt (rr, j, v, q, d, dh) u vendosin një kryq sipër. Shkruhen nga nxënës të ndryshëm në tabelë dhe në fletoret e tyre. Nga nxënës të ndryshëm kërkohet të thonë rrokje e fjalë dhe më pas shkruhen në fletore. Ndërkohë, mësuesja kalon në çdo bankë për të kontrolluar punën e nxënësve.

### Realizimi i kuptimit

Mësuesja i pyet nxënësit se si formohen fjalët, punon me rrokjet, më pas lexojnë tekstin dhe nisin edhe vetë lojën e trenit të fjalëve. Idetë e tyre shkruhen në tabelë. Nxënësit mund të tregojnë për lojërat që luajnë me fjalë.

Lexohet teksti me paragrafë dhe në secilin prej tyre mësuesi ndalet dhe evidenton fjalë që janë të reja për nxënësit. I shkruan në tabelë dhe bën shpjegimin e tyre.

Kryhen veprime manipuluese (analizë, sintezë) për fjalë të ndryshme.

Punohen ushtrimet 1 dhe 2. Nxënësit i punojnë në mënyrë individuale dhe më pas në grupe. Ushtrimin 1, fëmijët mund ta shoqërojnë edhe me vizatim, i cili mund të nisë në klasë e të vazhdojë në shtëpi.

Në ushtrimin 2, mësuesja ndalet për të provuar alternativa të ndryshme përgjigjesh dhe nxënësit të tregojnë zgjidhje të ndryshme.

## Ora II

### Struktura e mësimit

Hapi i parë	Shkrim i lirë	10'
Hapi i dytë	Lexim i tekstit me ndalesa e diskutim i vazhdueshëm për të	25'
Hapi i tretë	Diskusim Shkrim i letrave	10'

### Zhvillimi i mësimit

#### Hapi i parë

Të bëjnë lojëra fjalësh: “fillon me m nbaron me i...” etj.

#### Hapi i dytë

Komentohet figura e dhënë.

Zhvillohet një diskutim për letrat. Lexohen urimet e dhëna në kartolinën e verdhë. Shpjegohet kuptimi i tyre.

#### Hapi i tretë

Nxënësit shkruajnë urimet që duan t’u bëjnë njerëzve të tyre të dashur.

Secili nxënës lexon urimet që ka shkruar.

### Abetarja e Punës

#### Objektivat

Në fund të orës së mësimit, nxënësi të jetë në gjendje:

1. të plotësojë saktë fjalët me rrokjet e shkronjat që mungojnë,
2. të lexojë e shkruajë fjalët e formuara sipas drejtimit të shigjetës,
3. të renditë shkronjat e të formojë fjalën e saktë,
4. të mësojë si të shkruajë një skedë.

#### Mjetet e nevojshme

Fletorja e punës, materialet e Abetares së Punës për të shkruar, tabela plastike e shkrimit

#### Fjalë kryesore

Rrokje, lidh me shigjetë, skedë, fjalë ndihmëse

### Shprehinë që zhvillohen

Të shkruarit, të lexuarit, të menduarit, analiza, sinteza.

### Struktura e mësimin

E	Breinstorming	10'
R	Manipulime me rrokje e fjalë	25'
R	Diskutim	10'

## Zhvillimi i mësimin

### Evokimi

Zhvillohet një "stuhi mendimesh" me shkronjat e mësuara deri tani. Ngrihen nxënës të ndryshëm për t'i shkruar në tabelë me shkronja shtypi e dore, të vogla e të mëdha.

Formohen rrokje dhe më pas fjalë të ndryshme, duke i pasur shkronjat në fillim, në mes apo në fund të fjalëve.

### Realizimi i kuptimit

Hapet Abetarja e Punës. Emërtohen figurat e ushtrimit. Lexohen rrokjet e dhëna. Analizohet secila fjalë dhe kërkohet të plotësohet pjesa që mungon. Disa nxënës i shkruajnë fjalët në tabelë.

Në ushtrimin 2, nxënësit do të tregojnë kujdes që të lexojnë fjalë, duke ndjekur drejtimin e shigjetës. Fjalët e krijuara shkruhen poshtë rrokjeve.

Në ushtrimin 3 do të renditen shkronjat sipas radhës së përcaktuar me numra. Lexohen fjalët e krijuara. Korrigjohen gabimet.

Në ushtrimin 4 nxënësit duhet të plotësojnë skedën e dhënë. Së pari shpjegohet se çfarë është skeda dhe vendet ku njerëzve u duhet ta plotësojnë (p.sh., kur regjistrohen në bibliotekë). Secili nxënës plotëson në mënyrë individuale skedën e më pas e diskutojnë në grup.

### Reflektimi

Nxënësve u kërkohet të plotësojnë një skedë individuale ku japin të dhëna për veten e tyre. Lexohen disa prej tyre.

## Tema: Modelim i shkrimit të dorës

### Objektivat

#### Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

1. të shkruajë të gjitha shkronjat e dorës të vogla dhe të mëdha të mësuara,
2. të përforcojë aftësitë shkruese me shkrimin e dorës,
3. të aftësohet me të shkruarin përmes diktimit, të kopjojë pjesë të shkruara sipas nevojave,
4. të përgjigjet për pyetje të thjeshta me shkrim.

### Mjetet e nevojshme

Fletoret e shkrimit dhe të diktimit, tabela plastike

### Fjalë kryesore

Diktim, shkrim dore, kopjim

### Shprehinë që zhvillohen

Të shkruarit, të kuptuarit e leximit dhe shkrimit

## Zhvillimi i mësimi

Në këtë orë mësimi, mësuesi duhet të kryejë veprimtari që lidhen me shkrimin e shkronjave të mësuara në këtë grup dhe fjalëve të cilat i përmbajnë. Mund të kryhen diktme, modelime shkronjash të vogla e të mëdha, kopjim tekstesh të ndryshme. Por në këtë orë mund të bëhen edhe aktivitete të ndryshme shkrimi, të cilat bëjnë një përmbledhje të ushtrimeve kryesore të këtij grupi shkronjash. Këtu mund të rendisim:

- shkrimin e shkronjave të shtypit e dorës, të vogla e të mëdha,
- shkrimi i fjalëve të diktuar nga mësuesi,
- shkrimi i fjalëve të gjetura në libra të sjellë nga fëmijët,
- shkrimi rreth një dëshire,
- shkrimi i urimeve,
- shkrimi i fjalive të thjeshta,
- fjalë të thëna nga vetë nxënësit,
- çështje të ndryshme rreth ndonjë përralle, personazhi nga mësimet, dhurate, frute, shoqeje etj.

### Mos harroni të shkruarit

Të shkruarit është një pjesë e rëndësishme e të mësuarit të të lexuarit. Shpesh, fëmijët përdorin gjuhën e shkruar në mënyrë të veçantë, sikur janë duke shqiptuar një shkronjë apo një fjalë të lexuar. Mos e korrigjoni gjithmonë fëmijën. Bëni që ai të ndihet i sigurt në këtë proces. Ju mund ta mbikëqyrni fëmijën gjatë kohës që bën detyrat e shtëpisë, por mos i jepni gjithmonë përgjigjen e saktë, kur ai ua kërkon; në vend të kësaj, lëreni ta gjejë vetë gabimin. Sa më tepër të shkruajë fëmija, aq më i shpejtë do të bëhet ai. Për të realizuar këtë mbani parasysh këto këshilla:

1. **Krijoni mundësi për të shkruar.** Jepini për të shkruar fëmijës një situatë nga jeta reale. P.sh., mund t'i jepni një letër dhe një laps dhe të shkruajë një listë të gjërave që do të blejë në dyqan, ose të listojë librat që lexon etj.
2. **Vëreni fëmijën të shkruajë për gjëra të ndryshme.** Shkrimi i një ngjarjeje nga jeta e përditshme, e një tregimi a përralle që lexoi, e një vjershe, plotësimi i një fjalëkryqi, shkrim rreth një personazhi, shkrime me imagjinatë, shkrim i një njoftimi, urimi, kartoline etj., janë mundësi të mira për ta vënë fëmijën të shkruajë.
3. Siguroni një material të shkruarit të formave të ndryshme.
4. Lejojeni fëmijën të shkruajë në kompjuter, nëse keni në shtëpi.
5. Shkruani edhe vetë para fëmijës suaj.
6. I përgatisni së bashku urimet për festa dhe ditëlindje.
7. Shkruani duke kopjuar pjesë ose duke i diktuar pjesë të ndryshme.
8. Shkruani në letra të mëdha, duke i ngjitur pas dyerve ose në mure.

## LISTË KONTROLLI DHE VLERËSIMI PËR TË DËGJUARIT

Simbolet: R = Rrallë, S = Shpesh, V = Vazhdimisht

	Shprehia	R	S	V
1	Nxënësi vendos kontakt të drejtpërdrejtë me folësin.			
2	Dëgjon me interes.			
3	Dëgjon duke drejtuar trupin nga folësi.			
4	Dëgjon dhe ndjek një drejtim.			
5	Dëgjon dhe ndjek dy drejtime ku flitet.			
6	Përqendrohet në bisedë një për një.			
7	Përqendrohet në bisedat që zhvillohen në klasë.			
8	Përqendrohet në bisedë gjatë ritregimeve.			
9	Përqendrohet në bisedë gjatë ritregimeve të përrallave.			

## LISTË KONTROLLI DHE VLERËSIMI PËR TË FOLURIT

Simbolet: R = Rrallë, S = Shpesh, V = Vazhdimisht

	Shprehia	R	S	V
1	<b>Përdor gjuhë shprehëse kur:</b>			
1.1	Përshkruan, krahason			
1.2	Ndjek ngjarjen			
1.3	Dallon të rëndësishmen nga më pak e rëndësishmja			
1.4	Flet për nevoja personale			
1.5	Flet për ndodhi personale			
2	<b>Gjatë bashkëbisedimeve:</b>			
2.1	Di të fillojë bisedën			
2.2	Pret të flasë			
2.3	Kërkon sqarime			
2.4	Zhvillon më tej temën			
2.5	Përgjigjet për pyetjet që i bëhen			
2.6	Emërton objekte			
2.7	Mban mend ide			
2.8	Ka fjalor të pasur për tema të caktuara			
3	<b>Gjatë artikullimit të tingujve dhe të fjalëve:</b>			
3.1	Shqipton saktë tingujt e gjuhës shqipe			
3.2	Shqipton saktë fjalët			
3.3	Nuk dallon nuancat dialektore			

## LISTË KONTROLLI DHE VLERËSIMI PËR TË LEXUARIT

Simbolet: R = Rrallë, S = Shpesh, V = Vazhdimisht

	Shprehia	R	S	V
1	<b>Nxënësi tregon interes për leximin:</b>			
1.1	Tregon gatishmëri për të lexuar			
1.2	Rrezikon të gabojë gjatë leximit			
1.3	Ka besim në vetvete si lexues			

## PLANI ANALITIK I PERIUdhës PASABETARE

### A.LEXIMI

	<b>Tema mësimore</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Shtrategji dhe teknika</b>	<b>Ndërthurja lëndore</b>	<b>Shprehëtitë</b>	<b>Fjalë kyçe</b>	<b>Burime</b>
	<b>1. Abetare, abetare</b>	Të lexojnë me intonacionin e duhur vjershën Të shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe grupeve të fjalëve në dhe strofa Të interpretojnë vjershën përmendsh.	Recitim DLTA Shkrim i lirë	Të lexuarit të shkruarit, recitimi	Të lexuarit, të folurit të shkruarit arti i recitimit	Fjalë kyç Vjershë Varg strofë	Vjersha të ndryshme për gjuhën dhe Abetaren
	<b>2. Për një shkronjë që ti se vë</b>	Të lexojnë me intonacionin e duhur vjershën Të shpjegojnë kuptimin e fjalëve në vjershë Të krahasojnë personazhin me veten e tyre.	Lojë në role DLTA/diagramë Veni Ushtrime gjuhësore	Të lexuarit, të shkruarit, recitimi	Të lexuarit, të folurit të shkruarit arti i recitimit	Vjershë, varg, strofë, shkronjë, gabim	Vjersha të ndryshme për gjuhën dhe Abetaren
	<b>3. Miq të e pyllit</b>	Të lexojnë me intonacionin e përrallën Të kuptojnë dhe ritregojnë përmbajtjen e përrallës Të gjejnë cilësi të pjesëmarësve në përrallë.	Stuhi mendimi Imagjinatë e drejtuar Punë në grupe DLTA	Të lexuarit, të kuptuarit, të shkruarit,	Të lexuarit, të folurit, të shkruarit	Përrallë, personazhe,	Përralla të ndryshme
	<b>4. Alfabeti i gjyshe Rozës</b>	Të lexojnë me intonacionin e duhur. Të kuptojnë dhe ritregojnë përmbajtjen e përrallës. Të gjejnë cilësi të pjesëmarësve në përrallë. Të lexojnë me intonacionin e duhur. Të kuptojnë dhe ritregojnë përmbajtjen e përrallës. Të gjejnë cilësi të pjesëmarësve në përrallë.	Lojë e alfabetit Pyejtje përgjigje Gushëkuqi rrethor Shkrim dhe vizatim	Të lexuarit/ të folurit/ të shkruarit/ vizatim	Të lexuarit, të kuptuarit, të shkruarit, të vizatuarit	tregim, personazhe,	Materiale për vizatim, bojëra, fletore vizatimi

	<b>5. Edukata</b>	Të lexojnë me intonacionin e duhur vjershën. Të shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe grupeve të fjalëve vargje dhe strofa. Të interpretojnë vjershën përmendsh.	Recitim DLTA Shkrim i lirë	Të lexuarit dhe të folurit dhe të shkruarit	Të lexuarit të shkruarit, recitimi	Vjershë, varg, strofë	Vjersha të ndryshme për gjuhën dhe abetaren
	<b>6. Hunda e Pino-kut</b>	Të lexojnë tregime që kanë dialog në tekst. Të tregojnë përmbajtjen e fabulës. Të reflektojnë rreth mesazhit të pjesës.	Vizatim shkrim i lirë DRTA Lojë në role	Vizatimi, të folurit, të lexuarit	Të lexuarit, dialogu të shkruarit	Dialog, tregim personazh	Libra me tregime për pinokun, CD me film për pinokun.
	<b>7. Mendime të ngjyrosura</b>	Të lexojnë tregime që kanë dialog në tekst. Të tregojnë përmbajtjen e fabulës. Të reflektojnë rreth mesazhit të pjesës.	Vizatim shkrim i lirë DRTA Lojë në role	Art, të folurit, të lexuarit	Të lexuarit, dialogu, të shkruarit	Titull, dialog, tregim, personazh, shenja pikësimiti.	Mjete vizatimi dhe ngjyra
	<b>8. Para televizorit</b>	Të lexojnë tregime nga jeta e përditshme. Të gjejë hyrjen zhvillimin mbylljen në tregim. Të reflektojnë rreth mesazhit të pjesës.	Dora e fshehtë Punë në grupe	Të folurit, të lexuarit, media	Të lexuarit, të shkruarit, të folurit	Titull, pjesë, tregim, personazh, hyrje, mbyllje	CD me filma për fëmijë, TV, tregime
	<b>9. Në zyrën e babait</b>	Të lexojnë tregime nga jeta e përditshme. Të përshkruajnë prindërit e tyre. Të reflektojnë rreth pjesë duke folur për profesionet e prindërve.	Stuhi mendimi Di, dua të di, mësova Diskutim në grupe	Të folurit, të lexuarit, teknologji	Të lexuarit, të shkruarit, të folurit, përshkrimi	Titull, pjesë, tregim, personazh	

	<p><b>10. Legjenda e lules së diellit</b></p>	<p>Të lexojnë me kuptim përralla/legjenda duke thënë përmbajtjen e tyre. Të gjejnë hyrjen zhvillimin mbylljen në fabulën që lexojnë. Të reflektojnë rreth mesazhit të pjesës.</p>	<p>Dora e fshehtë Punë në grupe</p>	<p>Të folurit, të lexuarit, arti, gjuha</p>	<p>Të lexuarit, të folurit, fjalëformim, të shkruarit,</p>	<p>Titull, pjesë, legendë, personazh, hyrje, mbyllje</p>	<p>Cd me filma për fëmijë, TV, tregime</p>
	<p><b>11. Një gjuhë për të gjithë</b></p>	<p>Të lexojnë pjesë që lidhen me artin dhe muzikën dhe të flasin për to. Të pasurojnë fjalorin me fjalë dhe shprehje që lidhen me muzikën. Të luajnë në role një orkestrë duke imituar orkestrantë.</p>	<p>Dëgjim muzikor Lexim me ndalesa DLTA</p>	<p>Muzika Leximi</p>	<p>Të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, edukim muzikor</p>	<p>Një gjuhë për të gjithë: muzikantë dirigjentë, koncert, balet, piano</p>	<p>Vegla muzikore</p>
	<p><b>BIÇIKETA</b></p>	<p>Të lexojnë pjesë që lidhen me jetën e tyre. Të përdorin fjalor nga fusha e shkencave. Të gjejnë pjesën hyrëse zhvilluese dhe mbyllëse të tregimit</p>	<p>Imagjinatë e drejtuar DRTA Shkrim i lirë</p>	<p>Art, teknologji, lexim shkrim</p>	<p>Të lexuarit, të folurit, të diskutuarit</p>	<p>Tregim, pjesë hyrëse, pjesa mbyllëse</p>	
	<p><b>13. Zemërimi i luleve</b></p>	<p>Të lexojnë duke përdorur intonacionin e duhur në pjesët me dialog. Të gjejnë pjesën hyrëse zhvilluese dhe mbyllëse të tregimit. Të lexojnë duke krahasuar cilësitë e objekteve të ngjashme</p>	<p>Kllaster Di/dua të di/mësova Diagramë Veni</p>	<p>Lexim/ shkrim/ shkencë /teknologji</p>	<p>Të lexuarit, të folurit, të diskutuarit, imagjinata</p>	<p>Përrallë përmbajtje, personazh</p>	<p>Fjalor lule natyrale dhe artificiale</p>



<b>14. Dielli dhe reja</b>	Të lexojnë pjesë që lidhen me problematik të ndryshme. Të shprehin ndjenja dhe dëshira që lidhen me raste situatash. Të gjejnë pjesën hyrëse zhvilluese dhe mbyllëse të tregimit.	Kllaster, Gushkuqi rrethor, Diskutim/Shkrim i lirë	Lexim/ shkrim/ shkencë/fantazi	Të lexuarit, të folurit, të diskutuarit	Përrallë, përmbajtje, personazh	Fjalor, Cd, foto, të dhëna nga stacion metereologjik
<b>15. Piktura e Edlirës</b>	Të lexojnë pjesë që lidhen me talentin e fëmijëve. Të shprehin ndjenja dhe dëshira. Të përshkruajnë personazhe dhe t'i vizatojnë ato.	Stuhi mendimi Gushëkuqi rrethor Turi i galerisë	Lexim/shkrim/art	Të lexuarit, të folurit, të diskutuarit,	Përrallë përmbajtje, personazh	Ekspozitë në foto e piktura kafshësh.
<b>16. Miq nga hapësira</b>	Të lexojnë tregime me karakter fantastik. Të përshkruajnë personazhe. Të krahasojnë personazhe të tregimit.	Imaginatë e drejtuar/ Stuhi mendimi/ Film Punë në grupe/ Diagramë veni	Të lexuarit , shkencë, drama	Të lexuarit, të kuptuarit, imagjinata	Cd me film fantashkencë për fëmijë të moshave të ulëta shkollore.	Veshje për personazhe dramë
<b>17. Librat rrinë radhë-radhë</b>	Të lexojnë vjersha për librat. Të kuptojnë vargjet e vjershës. Të interpretojnë strofa për-mendsh.	Interpretim/konkurs	Të lexuarit/arti i recitimit	Të lexuarit	Vjershë, varg, bibliotekë, Vjershë, tregim përrallë	Libra për fëmijë me vjersha, përralla, tregime
<b>18. Flasim për filmat vizitmorë</b>						

## B. USHTRIME GJUHE

	Tema mësimore	Objektivat	Shtrategji dhe teknika	Ndërthurja lëndore	Shprehjtë	Fjalë kyçe	Bunime
1	Bashkësi fjalësh	Të nënvizojë në tekste të ndryshme fjalë. Të gjejë grupe fjalë që emërtojnë njerëz kafshë sende. Të grupojë emra njerëzish dhe emra vendesh.	Punë e pavarur demonstrim/grupim/klasifikim/diagramë veni		Të shkruarit, të menduarit	Fjalë, emra njerëzish, emra kafshësh, emra njerëzish, emra sendesh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
2	Emra njerëzish dhe sendesh	Të nënvizojë në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra njerëzish. Të shkruajnë emra njerëzish femra dhe meshkuj.	Punë e pavarur/punë në grupe/demonstrim/grupim/klasifikim/diagramë		Të shkruarit/të menduarit/kujtesa	Emra njerëzish, emra femrash emra meshkujsh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
3	Emra kafshësh	Të nënvizojë në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra kafshësh. Të formojnë grupe fjalësh që emërtojnë emra kafshësh. Të shkruajnë emra kafshësh të veçanta (të përveçëm/këtu për mësuesin).	Punë e pavarur/ grupim /klasifikim/diagramë/demonstrim		Të shkruarit	Emra kafshësh, emra sendesh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
4	Emra njerëzish	Të nënvizojë në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra njerëzish. Të shkruajnë emra njerëzish që mbarojnë me a dhe me i sipas modelit.	Punë e pavarur, grupim, klasifikim		Të shkruarit, të menduarit kujtesa, imagjinata	Emra sendesh që mbarojnë me a dhe me i	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
5	Emra njerëzish	Të grupojë emrat sipas modelit: kalë-kali, lopë-lopa. Të grupojë emrat sipas modelit burrë-burri, vajzë-vajza. Të grupojnë dhe shkruajnë emrat sipas modelit: televizor-televizori, derë-dera.	Demonstrim/punë e pavarur, grupim klasifikim, diagramë		Të shkruarit klasifikimi	Emra sendesh kafshësh, njerëzish	Abetarja e Punës, libra jashtë klase

6	Emra njerëzish	Të shkruajë dhe lidhë fjalë sipas një fushe të përbashkët semantike.  Të shkruajë fjali me emra profesionesh.  Të shkruajë emrat e të vegjëlive të kafshëve dhe të sendeve të mëdha.	Punë e pavarur, grupim klasifikim.		Të shkruarit klasifikimi	Emra të përafërt, emrat e të vegjëlive të kafshëve emrat e sendeve të mëdha	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
7	Emra	Të shkruajë fjali dhe pyetje nisur nga figurat përkatëse.  Të shkruajë fjalë dhe të ngjyrosë objekte.  Të plotësojë format e fjalëve sipas modeleve të dhëna.	Punë në grupe/punë e pavarur.		Të shkruarit / klasifikimi/grupimi/kujtesa	Pyetje, fjali, fjalë, një fjalë - shumë fjalë, shumëshumës	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
8	Fjalë që tregojnë cilësi	Të lidhë emrat e kafshëve të ndryshme me cilësitë e tyre.  Të plotësojë pjesë të fjalëve që tregojnë cilësi dhe që mungojnë në grupin e fjalëve.  Të shkruajë fjali me grupet e fjalëve (fjalë + cilësi).	Vëzhgim demonstrim, punë e pavarur, grupim, klasifikim.		Të shkruarit, klasifikimi	Fjalë, cilësi, grup fjalësh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
9	Përshkruajmë shokun	Të përshkruajë shokun mbështetur në modelet e dhëna.  Të formojë fjali duke lidhur grupe fjalësh: fjalë, cilësi.  Të shkruajë fjalitë e krijuar nga ushtrimi i mësipërm.	Vëzhgim, demonstrim, punë e pavarur, grupim, klasifikim.		Të shkruarit, klasifikimi	Fjalë, cilësi, grup fjalësh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
10	Përshkruajmë sende dhe objekte	Të përshkruajë objekte dhe kafshë mbështetur në një listë pyetjesh ndihmëse.  Të shkruajë fjalë-cilësi me kuptim të kundërt.	vëzhgim/demonstrim/punë e pavarur, punë në grupe grupim, klasifikim.		Të shkruarit, klasifikimi	Fjalë, cilësi, grup fjalësh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase

11	Fjalë që tregojnë cilësi	<p>Të përshkruajë fjalë që tregojnë cilësi sendesh njerëzish.</p> <p>Të shkruajë cilësi dhe të lidhë me shigjetë fjalën me cilësinë e saj.</p> <p>Të shkruajë fjali me grupet e fjalëve (fjalë + cilësi).</p>	vëzhgim, demonstrim punë e pavarur, grupim, klasifikim.	Të shkruarit, klasifikimi	fjalë, cilësi, grup fjalësh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
12	Fjalë që tregojnë veprime	<p>Të gjejnë fjalë që tregojnë se çfarë bëjnë kafshët.</p> <p>Të shkruajnë fjali me fjalë që tregojnë veprime të kafshëve.</p> <p>Të lidhin objektin me veprimin që kryen.</p> <p>Të shkruajnë fjali duke përdorur fjalë që tregojnë veprime të ndryshme.</p>	Vëzhgim demonstrim, punë e pavarur, punë në grupe, grupim, klasifikim.	Të shkruarit, klasifikimi	fjalë, veprimi, grup fjalësh	
13	Fjalët që tregojnë veprime	<p>Të formojnë fjali me grupe fjalësh.</p> <p>Të shkruajnë fjali sipas modelit duke përdorur fjalën (folja ka në forma të ndryshme)</p> <p>Të përshkruajë veprime që bëjnë fëmijët.</p> <p>Të shkruajnë fjali ku të përdoren drejt fjalët që tregojnë veprime.</p>	Vëzhgim, demonstrim punë e pavarur, punë në grupe, grupim, klasifikim.	Të shkruarit, klasifikimi	fjalë veprimi, grup fjalësh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
14	Fjalët që tregojnë veprime	<p>Të njihen dhe përdorin fjalëzat (unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato).</p> <p>Të shkruajnë përemrat e mësipërm të shokëtuar me foljen kam, jam, mësoj.</p> <p>Të shkruajë fjali me fjalë që tregojnë veprime të ndryshme.</p>	Vëzhgim demonstrim, punë e pavarur, punë në grupe, grupim, klasifikim.	Të shkruarit, klasifikimi	fjalë, cilësi, grup fjalësh	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
15	Fjalët që tregojnë veprime	<p>Të përdorin fjalë që tregojnë veprim në kohë të ndryshme.</p> <p>Të shkruajnë në formën e duhur fjalët – veprim në tabelë.</p> <p>Të plotësojnë fjalitë duke gjetur fjalët -veprim në formën e duhur.</p>	Vëzhgim, demonstrim, punë e pavarur, punë në grupe, grupim, klasifikim.	Të shkruarit, klasifikimi	fjalë, veprim, fjali	Abetarja e Punës, libra jashtë klase

16	Fjalët që tregojnë veprime	Të përshkruajnë një situatë pikniku duke plotësuar fjalët që mungojnë. Të shkruajnë fjali me grupe fjalësh orientuese.	Vëzhgim, demonstrim, punë e pavarur, punë në grupe, tabelë koncepti.	Art, lexim shkrim	Të shkruarit, klasifikimi	Fjalë, fjali, tregim, përshkrim	Abetarja e Punës, libra jashtë klase
17	Përshkruajmë ditëlindjen	Të përshkruajnë një situatë ditëlindjeje duke plotësuar fjalët që mungojnë. Të shkruajnë fjali me grupe fjalësh orientuese.	Vëzhgim/përshkrim/PTP, demonstrim, punë e pavarur	Art, lexim shkrim	Të shkruarit përshkrues	Fjalë, fjali, përshkrim	Foto, CD, përvoja personale
	Përshkruajmë ditë pushimi	Të përshkruajnë një situatë pikniku duke plotësuar fjalët që mungojnë. Të shkruajnë fjali me grupe fjalësh orientuese.	Punë në grupe, përshkrim përvojash personale Punë e pavarur me shkrim	Edukim mjedisor, edukim fizik, diskutim, shkrim	Kujtesa, Imagjinata, Të lexuarit, Të shkruarit.	Përshkrimi, imagjinata, ngjarje	Foto, albume, lexime
18	Përshkruajmë një ditë me shi	Të përshkruajnë një situatë dite me shi. Të shkruajnë duke iu përgjigjur pyetjeve.	Përshkrim përvojash personale, punë e parur me shkrim	Edukim mjedisor, të shkruarit	Kujtesa, Imagjinata, Të lexuarit, Të shkruarit.	Përshkrimi, imagjinata, ngjarje	CD, film, lexime, vëzhgime
19.	Kush? Çfarë? Ku? Si? Me kë?	Të shkruajnë dhe t'ju përgjigjen pyetjeve të ndryshme. Të plotësojnë fjalë që mungojnë në fjali. Të shkruajnë fjali pohore dhe mohore sipas modelit.	Të pyeturit, punë në grupe	Piktura, leksi, shkrimi	Të pyeturit, Mendimi, Vëzhgimi.	Pyetje, përgjigje	Foto, piktura
20	Përshkruajmë stinët	Të përshkruajë stinët. Të shkruajnë duke iu përgjigjur pyetjeve.				Fjalë, fjali, tregim, përshkrim	

# PASABETARE

Pasabetarja synon të aftësojë nxënësit për perfeksionimin e shprehive të të lexuarit të kuptimshëm dhe në përshtatje me standardin e gjuhës. Për këtë qëllim, mësimet model që do të zërthejnë këtë pjesë të tekstit të Abetares, do të synojnë të realizojnë objektivin e mësipërm.

Për të aftësuar mësuesit për realizimin me sukses të kësaj pjese të tekstit, mësimet model, të ofruara më poshtë, mundësojnë zbatimin e formave të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënës, duke ofruar veprimtari ndërvepruese gjithëpërfshirëse për nxënësit.

Këto mësimet për tregimet, vjershat, përrallat që përmban periudha “Pasabetare”, përfshijnë veprimtari që strukturohen sipas skemës:

- I. Para leximit
- II. Gjatë leximit
- III. Pas leximit

Në tekstin e nxënësit, kjo skemë përfaqësohet nga një aparat didaktik që nis që në fillim të faqes me një gjethe, e cila ofron një veprimtari motivuese që lidhet me **fazën e paraleximit**, kurse në tekstin e mësuesit zërthehet me një veprimtari nxehjeje, ku përfshihen të gjithë nxënësit.

**Faza e dytë e zërthimit didaktik** të teksteve të ofruara ka të bëjë me leximin e kuptimshëm të fabulave të ofruara. Për këtë qëllim, nën tekstin bazë, është vendosur një aparat didaktik, i cili përfshin veprimtari leximi të tekstit dhe ushtrime të ndryshme gjuhësore për t'i kthyer nxënësit disa herë te teksti, me qëllim që të realizojnë të lexuarin si të tillë. Kështu, kërkesa të tilla si: lexo tekstin, nënvizo fjalë që shprehin veprim, që kanë në trup të tyre dy bashkëtingëllore njëra pas tjetrës, apo kërkesa të tjera me karakter gjuhësor, jo vetëm e aftësojnë nxënësin për të lexuar, por edhe i rikujtojnë dukuri gjuhësore që rimerren me qëllim ngulitjeje.

Kjo fazë shoqërohet edhe me pyetje rreth kuptimit të përmbajtjes.

**Faza e tretë e strukturës didaktike** të teksteve në Pasabetare synon të aftësojë nxënësit për të ngulitur përmbajtjen, por edhe për të reflektuar për situata të caktuara që lidhen me botën e tyre feminare, si: diskutimi, loja në role, të shkruarit, dramatizimi, arti i vizatimit etj.

Gjithashtu, përmes kësaj faze, mësuesi do të synojë të përfshijë nxënësit në veprimtari të gjera të punës në grup, por edhe në veprimtari individuale për të reflektuar me shkrim apo me gojë rreth dukurive të caktuara.

## MËSIMET MODEL

### Mësimi model 1

**Tema: Abetare, Abetare**

**Objektivat:**

1. Të lexojë me intonacionin e duhur vjershën.
2. Të shpjegojë kuptimin e fjalëve dhe grupeve të fjalëve në vargje dhe strofa.
3. Të interpretojë vjershën përmendsh.

**Teknika dhe strategji:**

- Recitim
- DLTA
- Shkrim i lirë

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të shkruarit, recitimi.

**Fjalë kyç:** vjershë, varg, strofë.

**Ndërthurja:** Të lexuarit, të folurit, të shkruarit, arti i recitimit.

**Burime dhe mjete:** Vjersha të ndryshme për gjuhën dhe Abetaren.

### Zhvillimi i mësimi:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Para leximit Motivimi	<b>Recitim/dëgjim</b> në magnetofon i këngës së shkronjave	
Hapi i parë	Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë përmendsh vjershat e mësuara në pjesën e Abetares: <i>Flamuri, Kush e hëngri akulloren, Zh moj zh, mos je mërztur?</i> etj.	Nxënësit kujtojnë dhe recitojnë vjershat e mësuara në Abetare, por edhe të tjera të mësuara që në kopsht.
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi u drejton nxënësve disa pyetje: Keni mësuar vjersha/këngë për gjuhën shqipe? Po për shkronjat a keni dëgjuar?	Nxënësit kujtojnë vjersha, recitojnë apo këndojnë.
Gjatë leximit: kuptimi/zbërthimi i pjesës	<b>DLTA</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi prezanton titullin e vjershës “Shkronjë, shkronjë”. <u>Ndalesa e parë</u> Më pas lexon strofën e parë, e lexon atë dhe pastaj u drejton nxënësve pyetje: Çfarë kuptoni me shprehjen “Sillma diellin në dritare”? Pse thuhet: <i>Lehtë-lehtë, butë, bukur/dora ime sa e lumtur?</i> <i>Hap një faqe, kthen një fletë/nëpër shkronja dorë vetë?</i> <u>Ndalesa e dytë</u> Çfarë kuptoni me shprehjet: <i>Rrjedh një fjalë plotë kumbim,</i> <i>Gjuhë e lashtë e vendit tim,</i> <i>Me ty mendjen lartësoj,</i> <i>Me ty zemrën e gëzoj,</i> <i>Bëhem zog e fluturoj?</i> <u>Ndalesa e tretë</u> Pse vjersha mbyllet me vargjet: <i>Abetare, Abetare,</i> <i>sillma diellin në dritare?</i>  Mësuesi kërkon që nxënësit ta lexojnë vjershën dhe të mësojnë përmendsh strofën e parë.	Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit thjesht, ashtu si ata i kuptojnë. Mësuesi plotëson, në rast se nxënësit kanë nevojë.  Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit thjesht, ashtu si ata i kuptojnë. Mësuesi plotëson, nëse nxënësit kanë nevojë.  Nxënësit ndalojnë te këto vargje, duke e krahasuar Abetaren me një diell që ndriçon dhe ngroh.  Nxënësit lexojnë dhe përpiqen të mësojnë përmendsh 6 vargjet e para të vjershës.
Pas leximit, përforsimi	<b>Lexim - Gushëkuqi rrethor/Recitim/Shkrim i lirë</b>	

Hapi i katërt	Mësuesi kërkon që nxënësit të lexojnë përmes teknikës “Gushkuqi rrethor”. E nis një nxënës vargun e parë, pastaj njëri pas tjetrit lexojnë vargjet sipas përkatësisë. Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë në fletore dy vargjet e fundit të vjershës.	Nxënësit lexojnë vargjet njëri pas tjetrit. Nxënësit shkruajnë dy vargjet e fundit të vjershës.
Detyrë	Të mësohet vjersha përmendsh. Të shkruhen në fletore tri vargje të tjera.	Nxënësit mësojnë vjershën përmendsh. Nxënësit shkruajnë në fletore tri vargje të tjera nga vjersha.

## MËSIMI MODEL 2

### Tema: Për një shkronjë që ti s’e vë

#### Objektivat:

1. Të lexojë me intonacionin e duhur vjershën.
2. Të shpjegojë kuptimin e fjalëve në vjershë.
3. Të krahasojë personazhin me veten e tij.

#### Teknika dhe strategji:

- Stuhi mendimi
- Lojë në role
- DLTA/Diagramë Veni
- Ushtrime gjuhësore

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të shkruarit, recitimi.

**Fjalë kyç:** Vjershë, varg, strofë, shkronjë, gabim.

**Ndërthurja:** Të lexuarit, të folurit, të shkruarit, arti i recitimit.

**Burime dhe mjete:** Vjersha të ndryshme për gjuhën dhe Abetaren.

### Zhvillimi i mësimi:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hapi Motivimi	<b>Lojë me etiketa</b>	
	Mësuesi shpërndan për të gjithë nxënësit etiketa, në të cilat janë shkruar fjalë që u mungon një apo dy shkronja dhe kërkon që nxënësit të gjejnë, të shkruajnë dhe më pas të lexojnë shkronjën që mungon.	Nxënësit marrin etiketat dhe plotësojnë shkronjën që mungon në fjalët e shkruara.
Hyrja	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi dhe nxënësit lexojnë alfabetin e gjuhës shqipe të paraqitur në dërrasën e zezë. Mësuesi ka hequr disa shkronja nga alfabeti dhe kërkon që nxënës të caktuar të gjejnë se cilat shkronja mungojnë.	Nxënësit lexojnë së bashku alfabetin. Nxënësit gjejnë dhe thonë se cilat shkronja mungojnë.



Kuptimi/zbërthimi i pjesës	DLTA/Diagrami i Venit/Lojë në role/Punë në grupe dyshe	
Hapi i tretë	<p>Mësuesi prezanton titullin e vjershës dhe kërkon që nxënësit të thonë se çfarë kuptojnë me titullin “Për një shkronjë”.</p> <p>Mësuesi pret me qetësi përgjigjet e nxënësve dhe më pas u thotë se, duke lexuar vjershën, do të zbulojnë të panjohurën.</p> <p>Mësuesi nis të lexojë me ndalesa vjershën, ndërkohë që ka kërkuar që edhe nxënësit të lexojnë në heshtje, duke e shoqëruar atë.</p> <p>Mësuesi, pasi e ka lexuar vjershën, kërkon që nxënësit të lexojnë në role vjershën, të ndarë në grupe dy e nga dy.</p> <p>Pasi nxënësit e kanë lexuar në role vjershën, mësuesi kërkon që ata të bëjnë një krahasim mes vetes dhe Besnikut dhe të dallojnë se cilat janë ato gabime që i kanë të përbashkëta, kur shkruajnë, dhe cilat janë ato që i ndryshojnë.</p>	<p>Nxënësit thonë se diçka mund të ketë humbur, diçka nuk shkon mirë etj.</p> <p>Nxënësit mendojnë dhe presin se çfarë të papriture do të zbulojnë.</p> <p>Nxënësit lexojnë në heshtje.</p> <p>Nxënësit, të ndarë në grupe dyshe, lexojnë në role vjershën. Njëri bën rolin e babit, tjetri rolin e Besnikut.</p> <p>Nxënësit, përmes të folurit, bëjnë një diagram Veni, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet me Besnikun, kur ata shkruajnë.</p>
Përforcimi	Punë me shkrim dhe ushtrime gjuhësore	
Hapi i katërt	Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në fletore emrat e sendeve që përmenden në vjershë (Plotësohet pjesa që mungon: shkri--, fle---, fja--, de--, shtë--)	Nxënësit bëjnë ushtrimin e kërkuar, i kërkojnë fjalët në libër, dhe më pas i shkruajnë në fletore.
Detyrë	Mësim përmendsh, shkrim i lirë	
	Mësuesi jep porosi që nxënësit të mësojnë përmendsh 8 vargje. Të shkruajnë katër vargje (një strofë).	Nxënësit mësojnë vargjet përmendsh. Shkruajnë një strofë të vjershës në shtëpi.

## MËSIMI MODEL 3

### Tema: Miqtë e pyllit

#### Objektivat:

1. Të lexojë me intonacionin e duhur përrallën.
2. Të kuptojë dhe të ritregojë përmbajtjen e përrallës.
3. Të gjejë cilësi të pjesëmarrësve në përrallë.

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të kuptuarit, të shkruarit.

**Fjalë kyç:** Përrallë, personazhe,

**Ndërthurja:** Të lexuarit, të folurit, të shkruarit.

**Burime dhe mjete:** Vjersha të ndryshme për gjuhën dhe Abetaren.

#### Teknika dhe strategji:

- Stuhi mendimi
- Imgjinatë e drejtuar
- Punë në grupe
- DLTA

### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hapi i parë Motivimi	<b>Bashkëbisedim, vizatim</b>	
	Mësuesi jep porosi të vizatojnë kafshën e pyllit që pëlqejnë më tepër dhe, më pas, të flasin për të: Cila është ajo kafshë? Si është? Ku e ka parë? Pse e pëlqen?	Çdo nxënës vizaton kafshën që pëlqen dhe, më pas, secili flet për të.
Hyrja	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë se çfarë kuptojnë me fjalën “miq” (“mik”). Në rast se nxënësit nuk arrijnë të nxjerrin kuptimin e saktë të fjalës së dhënë, mësuesi e plotëson. Më pas, mësuesi pyet se çfarë mendojnë kur dëgjojnë fjalët “Miq të e pyllit”.	Nxënësit shprehen lirshëm për kuptimin e fjalës “miq” (“mik”).  Nxënësit shprehen përsëri në lidhje me miqësinë e pyllit. Sigurisht, ata mund t’i afrohen idesë së përrallës.
Kuptimi /zberthimi i pjesës	<b>Imaginatë e drejtuar DLTA</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi kërkon që nxënësit, me kokën ulur, ta dëgjojnë atë.  Mësuesi lexon paragrafin e parë të pjesës. Kërkon që nxënësit të ngrenë kokën. Mësuesi i pyet se çfarë janë duke menduar në atë çast.  Mësuesi kërkon që ata të thonë se si ishin kafshët e pyllit që ata takuan.  Mësuesi pyet nxënësit se çfarë mendojnë ata se do të ndodhë më pas në përrallën që ka nisur ta lexojë.  Mësuesi lexon pjesën tjetër të përrallës dhe pyet nxënësit se cili është shqetësimi që ka lindur mes kafshëve të pyllit?  Mësuesi pyet nxënësit se si mendojnë ata se do të përfundojë përralla?  Mësuesi lexon pjesën e tretë dhe, më pas, pyet nxënësit nëse dolën parashikimet e tyre. Ai kërkon që nxënësit të lexojnë përrallën dhe, në grupe dyshe, siç janë ulur në bankat e tyre, t’i bëjnë pyetje njëri-tjetrit në lidhje me kuptimin e përmbajtjes.	Nxënësit mund të thonë: “Na u duk vetja sikur ishin në pyll dhe u takuam me kafshët e pyllit”.  Nxënësit shprehin mendimet e tyre mbështetur në imagjinatë.  Nxënësit përshkruajnë mbështetur në imagjinatë.  Nxënësit shprehen se kafshët e duan njëra-tjetrën dhe nuk duan që të braktisen nga miqtë e tyre.  Nxënësit japin parashikimet e tyre.  Nxënësit shprehen për parashikimet e tyre dhe pse ata kishin menduar ato mbyllje.  Nxënësit lexojnë përrallën dhe, më pas, ata i bëjnë pyetje njëri-tjetrit në lidhje me kuptimin e përmbajtjes së përrallës.

Përforcimi	Lojë në role/Plotësim tabele	
Hapi i katërt	Mësuesi kërkon që nxënësit, të formojnë grupe katërshe, të ndajnë rolet dhe ta interpretojnë përrallën.	Nxënësit luajnë në role përrallën.
Detyrë	Lexim me kuptim i përrallës dhe plotësim tabele	
	Nxënësit duhet të plotësojnë edhe tabelën në të cilën dalin në pah cilësitë e kafshëve të pyllit. (Tabela është bërë gati nga mësuesi dhe mund t'ju jepet e gatshme nxënësve.)	Në shtëpi, nxënësit duhet ta lexojnë disa herë përrallën dhe të thonë përmbajtjen e saj. Nxënësit plotësojnë tabelën.

## MËSIMI MODEL 4

### Tema: Alfabeti i gjyshe Rozës

#### Objektivat:

1. Të lexojë me intonacionin e duhur.
2. Të kuptojë dhe ritregojë përmbajtjen e përrallës.
3. Të gjejë cilësi të pjesëmarrësve në përrallë.

#### Teknika dhe strategji:

- Loja e alfabetit
- Pyetje-përgjigje
- Gushkuqi rrethor
- Shkrim dhe vizatim

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të kuptuarit, të shkruarit, të vizatuarit.

**Fjalë kyç:** Tregim, personazhe.

**Ndërthurja:** Të lexuarit, të folurit, të shkruarit, vizatimi.

**Burime dhe mjete:** Materiale për vizatim, bojëra, fletore vizatimi.

### Zhvillimi i mësimi:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hapi i parë Motivimi	<b>Loja e alfabetit</b>	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të çohen në këmbë dhe, pa folur, të rreshtohen sipas radhitjes së shkronjave të alfabetit. Nxënësi që flet, përjashtohet nga loja.	Nxënësit ngrihen në këmbë dhe rreshtohen sipas radhitjes së shkronjës së parë të emrit të tyre, në përshtatje me alfabetin e gjuhës shqipe.
Hyrja	<b>Pyetje-përgjigje</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi u thotë nxënësve se ka në mend një gjë që lidhet me një nxënës që ka shoqëruar gjyshen te mjeku i syve. Nxit nxënësit t'i bëjnë disa pyetje rreth kësaj situ-ate. Mësuesi vazhdon të tregojë më tej se Besniku mër-zitet kur mjeku viziton gjyshen. Mësuesi kërkon përsëri pyetje nga nxënësit.  Mësuesi pyet: "Si mund të ketë përfunduar kjo ngjarje?"	Nxënësit bëjnë pyetje ndryshme, si: "Pse e shoqëron Besniku?" "Çfarë ka gjysh-ja?", "Gjyshes i janë prishur syzet" etj.  Nxënësit do të bëjnë pyetje të tjera.  Nxënësit thonë mbyllje të mundshme dhe të dëshirueshme prej tyre.

Kuptimi / zbërthimi i pjesës	<b>Gushkuqi rrethor</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi u thotë nxënësve të hapin librin dhe, përmes teknikës “Gushkuqi rrethor”, të lexojnë pjesën “Miqtë e pyllit”.	Nxënësit lexojnë tregimin një e nga një. Të gjithë nxënësit do të lexojnë, d.m.th., tregimi lexohet disa herë.
Përforcimi	Lojë në role/Plotësim tabele	
	Shkruaj emrat e shokëve të klasës, vizato një palë syze.	Secili nga nxënësit shkruan emrat e shokëve të klasës.
<b>Hapi i katërt</b>	<b>Shkrim i lirë /Vizatim</b>	
Detyrë		

## MËSIMI MODEL 5

### Tema: Edukata

#### Objektivat:

1. Të lexojë me intonacionin e duhur vjershën.
2. Të shpjegojë kuptimin e fjalëve dhe grupeve të fjalëve në vargje dhe strofa.
3. Të interpretojë vjershën përmendsh.

#### Teknika dhe strategji:

- Recitim
- DLTA
- Shkrim i lirë

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të shkruarit, recitimi.

**Fjalë kyç:** Vjershë, varg, strofë.

**Ndërthurja:** Të lexuarit, të folurit, të shkruarit.

**Burime dhe mjete:** Vjersha të ndryshme për gjuhën dhe Abetaren.

#### Zhvillimi i mësimi:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?
Para leximit Motivimi	Mësuesi nxjerr disa foto me kafshë shtëpiake dhe kërkon që nxënësit t’i emërtojnë ato, por edhe të përshkruajnë sjellje (veprime) të tyre.  Më pas kërkon që nxënës që kanë kafshë shtëpiake të përshkruajnë kafshët e tyre, sjelljet që ata pëlqejnë dhe ato që nuk i pëlqejnë te kafshët që kanë në shtëpi.
Hapi i parë	Mësuesi kërkon që nxënësit t’i bëjnë pyetje njëri-tjetrit për kafshët shtëpiake që ata kanë (ose njohin).
Hyrja	<b>Stuhi mendimi</b>

Hapi i dytë	Mësuesi nxerr një foto maceje dhe një foto qeni dhe u drejton nxënësve pyetjet: Nëse do t'i keni në shtëpi këto dy kafshë, mendoni që do të shkojnë mirë apo keq me njëra-tjetrën? Pse mendoni kështu?
Gjatë leximit Kuptimi /zbërthimi i pjesës	Rrjet diskutimi, punë në grupe
Hapi i tretë	Mësuesi prezanton titullin e pjesës “Edukata” dhe kërkon që nxënësit të thonë nëse mund të lidhet ky titull me edukatën e kafshëve.  Organizon një rrjet diskutimi.  Mësuesi lexon vjershën.  Kërkon që edhe nxënësit, për pak minuta, ta lexojnë vjershën në heshtje.  Pastaj kërkon që nxënësit ta lexojnë përmes teknikës “Gushkuqi rrethor”.  Mësuesi kërkon që nxënësit, në grupe dyshe, të lexojnë përsëri dhe të nënvizojnë rrokjen e fundit në çdo varg, duke dalluar se çfarë i afron këto rrokje.
Pas leximit, përforcimi	Rrjet diskutimi
Hapi i katërt	Mësuesi kërkon që nxënësit të diskutojnë rreth shprehjes “Ama kjo është edukatë!”  Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë në vjershë dhe të shkruajnë 3 fjalë trirrokëshe.
Detyrë	Porosi:  Të lexojnë dhe të mësojnë vjershën përmendsh.  Të shkruajnë në fletore njëren nga strofat e vjershës.

## MËSIMI MODEL 6

### Tema: Hunda e Pinokut

#### Objektivat:

1. Të lexojë tregime që kanë dialog në tekst.
2. Të tregojë përmbajtjen e fabulës.
3. Të reflektojë rreth mesazhit të pjesës.

#### Teknika dhe strategji:

- Vizatim shkrim i lirë
- DRTA
- Lojë në role

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, dialogu, të shkruarit.

**Fjalë kyç:** Dialog, tregim, personazh.

**Ndërthurja:** Vizatimi, të folurit, të lexuarit.

**Burime dhe mjete:** Libra me tregime për Pinokun, CD me film për Pinokun.

### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Para leximit Motivimi	<b>Vizatim dhe shkrim i lirë</b>	
Hapi	<p>Mësuesi citon një fjali: “Një ditë pinoku ...” dhe u drejtohet nxënësve me pyetjen: “Çfarë ju vjen në mend, kur dëgjoni këtë fjali?”</p> <p>Mësuesi u thotë nxënësve që të vizatojnë një hundë si të Pinokut dhe brenda saj të shkruajnë një gënjeshtër që kanë bërë si Pinoku.</p>	<p>Nxënësit kujtojnë Pinokun.</p> <p>Nxënësit kujtojnë hundën e Pinokut dhe gënjeshttrat e tij.</p> <p>Nxënësit vizatojnë një hundë të gjatë si ajo e Pinokut dhe brenda saj shkruajnë me një fjali një gënjeshtër që ata u kanë thënë prindërve apo një shoku/shoqeje.</p> <p>Historinë e tyre mund ta tregojnë edhe me gojë, nëse duan.</p>
Hyrja	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	<p>Mësuesi vizaton në dërrasë të zezë disa hundë dhe brenda atyre shkruan disa nga gënjeshttrat e fëmijëve.</p> <p>Krijohet një situatë gazmore.</p>	Nxënësit qeshin dhe i tregojnë njëri-tjetrit histori të tjera të ngjashme.
Gjatë leximit Kuptimi /zberthimi i pjesës	DLTA	
Hapi i tretë	<p>Mësuesi prezanton titullin e tregimit “Hunda e Pinokut”.</p> <p><u>Ndalesa e parë</u></p> <p>Mësuesi lexon pjesën e parë të tregimit, ku Zana e pyet Pinokun se ku i ka çuar monedhat e arit. Në vazhdim, mësuesi pyet: “Çfarë ka ndodhur me Pinokun? Ku mendoni ju se i ka çuar monedhat? Përse i janë dashur?”</p> <p><u>Ndalesa e dytë</u></p> <p>Mësuesi lexon pjesën tjetër të tregimit, që ka të bëjë me gënjeshtren e Pinokut, dhe i pyet nxënësit: “A janë të vërteta fjalët që po thotë Pinoku?”</p> <p><u>Ndalesa e tretë</u></p> <p>Lexohet pjesa e tretë dhe e fundit nga mësuesi. Pasi lexon fragmentin, mësuesi pyet nxënësit: “Si ju duken përgjigjet e Pinokut? Keni nisur t’i besoni dhe pse?”</p>	<p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit, ashtu si i kuptojnë. Mësuesi plotëson, në rast se nxënësit kanë nevojë.</p> <p>Nxënësit përgjigjen duke sjellë edhe argumente pse pranojnë ose jo argumentet e Pinokut.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit, ashtu si i kuptojnë.</p> <p>Nxënësit, në grupe dyshe, lexojnë tregimin.</p>

	<p>Po ju çfarë do të bënit me të?</p> <p>Mësuesi bën pyetje të tjera, nëse nxënësit kanë nevojë.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit, në grupe dyshe, ta lexojnë me role tregimin.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të nënvizojnë fjalitë që flasin për gënjeshtrat e Pinokut.</p>	<p>Nxënësit nënvizojnë fjalitë që flasin për gënjeshtrat e Pinokut.</p>
Pas leximit Përforcimi	Dramatizim, rrjet diskutimi, thuhet-shkruhet	
Hapi i katërt	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit ta dramatizojnë fabulën.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të diskutojnë rreth shprehjes: “Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra”.</p> <p>Pasi nxënësit janë qetësuar pak, nga gjithë kjo veprimtari mësimore, mësuesi kalon te rubrika “Reflektim gjuhësor”, që ka të bëjë me çështje të përdorimit të gjuhës standarde.</p> <p>Për fëmijët do të emërtohet <b>“Thuhet-shkruhet”</b>.</p> <p>Në tabelën e fundit të faqes janë dhënë disa fjalë të përdorura në tekst, të cilat shqiptohen në mënyra të ndryshme nga folës të ndryshëm. Mësuesi diskuton për këtë, duke thënë se, kur flasim, i shqiptojnë ndryshe disa fjalë, por, kur i shkruajmë, ato duhet të shkruhen njësoj.</p> <p>Kërkon që nxënësit të shkruajnë si duhet fjalët në listën e paraqitur në fund të faqes.</p>	<p>Me dëshirë dalin dy-tri grupe nxënësish. Nxënësit interpretojnë, por edhe japin vlerësime për interpretimin e njëri-tjetrit.</p> <p>Nxënësit diskutojnë për shprehjen përmes teknikës “Rrjeti i diskutimit”, që udhëhiqet nga mësuesi.</p> <p>Nxënësit shkruajnë formën e saktë të fjalëve në listë.</p> <p>Nxënësit mund të gjejnë edhe fjalë të tjera që shqiptohen në mënyra të ndryshme, por shkruhen vetëm në një të njërit prej formave që shqiptohen.</p>
Detyrë	<p>Mësuesi jep detyrë të mësojnë dhe të ritregojnë përmbajtjen e fabulës.</p> <p>Të vizatojnë Pinokun.</p>	<p>Nxënësit lexojnë fabulën dhe e ritregojnë përmbajtjen e saj.</p> <p>Nxënësit vizatojnë Pinokun.</p>

## MËSIMI MODEL 7

### Tema: Mendime të ngjyrosura

#### Objektivat:

1. Të lexojë tregime që kanë dialog në tekst.
2. Të tregojë përmbajtjen e fabulës.
3. Të reflektojë rreth mesazhit të pjesës.

#### Teknika dhe strategji:

- Vizatim shkrim i lirë
- DITA
- Lojë në role

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, dialogu, të shkruarit.

**Fjalë kyç:** Titull, dialog, tregim, personazh, shenja pikësimi.

**Ndërthurja:** Vizatimi, të folurit, të lexuarit.

**Burime dhe mjete:** Mjete vizatimi dhe ngjyra.

### Zhvillimi i mësimi:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Para leximit Motivimi	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi	<p>Mësuesi kërkon nga nxënësit të nxjerrin mbi bankë lapsat me ngjyra dhe i nxit të mendojnë se për çfarë mund ta përdorin çdonjërin prej tyre.</p> <p>Përse e përdorim lapsin me ngjyrë të zezë? Të kuqe? Të verdhë? Blu?...</p> <p>Mësuesi kërkon sa më shumë përgjigje për këtë pyetje.</p> <p>Mësuesi bën pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ku i gjemë në natyrë këto ngjyra?</li> <li>Ku i gjemë në klasë këto ngjyra?</li> <li>Ku i gjemë në shtëpi?</li> <li>Ku i gjemë në filma?</li> <li>Ku i gjemë kur luajmë? Etj.</li> </ul>	<p>Nxënësit japin përgjigje të larmishme.</p> <p>Nxënësit gjejnë dhe japin përgjigje për çdo situatë?</p>
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	<p>Mësuesja pyet: “Me cilën ngjyrë shkruajmë? Po me ngjyrat e tjera nuk mund të shkruajmë? Po? Jo? Ku?”</p>	<p>Nxënësit përgjigjen: Me ngjyrën blu edhe të zezë.</p> <p>Nxënësit përgjigjen se kur mund t'i përdorin ngjyrat e tjera për të shkruar.</p>
Gjatë leximit: Kuptimi /zberthimi i pjesës	<b>DLTA, Punë në grupe dyshe</b>	



<p>Hapi i tretë</p>	<p>Mësuesi prezanton titullin e tregimit “Mendime të ngjyrosura” dhe u drejton nxënësve pyetjen: A mund të jenë mendimet e ngjyrosura?</p> <p>Mësuesi nis dhe lexon tregimin me ndalesa, si dhe duke drejtuar pyetje.</p> <p><b>Ndalesa e parë</b> Mësuesi lexon 6 rreshtat e parë të tregimit dhe pyet: Cilët marrin pjesë në tregim? Çfarë po bëjnë ata? Cila është pyetja që i bën motra vëllait?</p> <p><b>Ndalesa e dytë</b> Lexohen gjashtë rreshtat e dytë të tregimit nga mësuesi. Më pas, mësuesi bën pyetje: Si i përgjigjet vëllai motrës? Për çfarë e pyet ajo përsëri? Mësuesi bën edhe pyetje të tjera, nëse e sheh të nevojshme.</p> <p><b>Ndalesa e tretë</b> Mësuesi pyet: Si vazhdon më tej tregimi? Çfarë bëri motra? Çfarë bëri Tiku? Pse u çudit Tiku? A kishte të drejtë Marta ta bënte atë veprim? Pse e bëri? Etj.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit, të ndarë në grupe dyshe, ta lexojnë pjesën në role.</p> <p><b>Reflektim gjuhësor</b> Mësuesi kërkon që nxënësit të nënvizojnë fjalitë që kanë në fund shenjën e pikësimit: pikëpyetje (?) dhe pikëçuditje (!).</p>	<p>Nxënësit përgjigjen në mënyra të ndryshme, ashtu si e mendojnë.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit ashtu si ata i kuptojnë.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi. Mund të bëjnë edhe ata pyetje.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit, ashtu si ata i kuptojnë.</p> <p>Nxënësit, në grupe dyshe, lexojnë tregimin.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.</p> <p>Nxënësit, në grupe dyshe, lexojnë pjesën.</p> <p>Nxënësit gjejnë dhe nënvizojnë fjalitë që pyesin dhe fjalitë që tregojnë habi dhe çudi.</p>
<p>Pas leximit, përforcimi</p>	<p>Diskutim/Shkrim i lirë/Thuhet-Shkruhet</p>	

Hapi i katërt	Diskutohet rreth çështjes: “Ku gaboi Marta, ku gaboi Tiku?” Thuhet disa cilësi të personazheve. Tiku: Nxënës i zgjuar, punëtor. Punohet ushtrimi: “Unë shkruaj”, vetëm dy rreshta. Punohet tabela “Thuhet-Shkruhet”.	Nxënësit diskutojnë rreth gabimeve të fëmijëve të tregimit. Nxënësit i karakterizojnë personazhet e tregimit me nga tri cilësi: Tiku: _____, _____, _____  Shkruajnë drejt fjalët <i>detyra, kthye, ngjyra</i> .
Detyrë	Vazhdimi i ushtrimit “Unë shkruaj”. (Përse përdoren lapsat me ngjyra të ndryshme?)	Shkruajnë fjali për përdorimin e lapsave me ngjyra.

## MËSIMI MODEL 8

### TEMA: PARA TELEVIZORIT

#### Objektivat

1. Të lexojë tregime me temë jeta e përditshme.
2. Të gjejë hyrjen, zhvillimin, mbylljen në tregim.
3. Të reflektojë rreth mesazhit të pjesës.

#### Teknika dhe strategji:

- Dora e fshehtë
- Punë në grupe

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të shkruarit, të folurit.

**Fjalë kyç:** Titull, pjesë, tregim, personazh, hyrje, mbyllje.

**Ndërthurja:** Të folurit, të lexuarit, media.

**Burime dhe mjete:** CD me filma për fëmijë, TV, tregime.

#### Zhvillimi i mësimi:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	
Para leximit Motivimi	<b>Shikojmë dhe flasim për filmat për fëmijë</b>	
Hapi i parë	Mësuesi shfaq përmes televizorit, ose duke i çuar nxënësit në ndonjë kinema apo teatër, filma apo dramatizime për fëmijë. Mësuesi i lë të shprehen lirshëm me njëri-tjetrin.	
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Më pas, mësuesi diskuton me nxënësit se çfarë u pëlqen të shohin në TV.	

Gjatë leximit: Kuptimi/zbërthimi i pjesës	<b>Dora e fshehtë/Punë në grupe katërshe</b>	
Hapi i tretë	<p>Mësuesi ka fotokopjuar tregimin “Para televizorit” dhe e ka ndarë në pjesë, duke e prerë me gërshërë. Për çdo grup ka përgatitur një zarf me tregimin e ndarë në pjesë-pjesë. Ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep një zarf. Sqaron nxënësit: “Nëpër fletë është i shkruar një tregim. Nëse i bashkoni si duhet fletët, ju mund ta formoni përsëri tregimin”.</p> <p>Thekson se njëra nga fletët është pjesë e parë hyrëse. Tjetra tregon zhvillimin e ngjarjeve dhe e fundit tregon se si mbyllet tregimi.</p> <p>Më pas, pasi kanë mbaruar punën në grupe, mësuesi kërkon që nxënësit të vendosin në faqen e librit numrat sipas radhës.</p> <p>Mësuesi kërkon që nga çdo grup të dalë një nxënës që të lexojë tregimin.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të nënvizojnë tri fjalët e para që tregojnë hyrjen në tregim, dhe tri fjalët e para që tregojnë se tregimi po mbyllet.</p> <p>Mësuesi bën pyetje në lidhje me përmbajtjen e pjesës: Kush merr pjesë në tregim? Çfarë bëjnë ata? Çfarë u pëlqen të shohin në TV? Pse nuk bien dakord me njëri-tjetrin?</p>	<p>Nxënësit, të ndarë në grupe, punojnë për të rindërtuar tregimin e ndarë në pjesë-pjesë.</p> <p>Nxënësit punojnë me librin, duke vendosur numrat për rindërtimin e tregimit.</p> <p>Nga një nxënës për çdo grup lexon tregimin.</p> <p>Nxënësit nënvizojnë sipas porosisë së mësuesit.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve sipas kuptimit që kanë për pjesën që e lexuan në disa mënyra.</p>
Pas leximit, përforcimi	Rrjet diskutimi/Plotësim skede	
Hapi i katërt	Diskutojnë rreth çështjes “Cili emision më pëlqen dhe si e përdor unë TV-në?”	Nxënësit diskutojnë rreth çështjes se si e përdorin TV-në dhe për emisionet që u pëlqejnë më tepër.
Detyrë		

## MËSIMI MODEL 9

### TEMA: NË ZYRËN E BABAIT

#### Objektivat

- Të lexojë tregime me temë nga jeta e përditshme.
- Të përshkruajë prindërit e tij.
- Të reflektojë rreth pjesës, duke folur për profesionet e prindërve.

#### Teknika dhe strategji:

- Stuhi mendimi
- Di - dua të di - mësova
- Diskutim në grupe

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të shkruarit, të folurit, përshkrimi.

**Fjalë kyç:** Tastierë, shkresë, ekonomist, titull, pjesë, tregim, personazh.

**Ndërthurja:** Të folurit, të lexuarit, teknologji.

**Burime dhe mjete:** CD me filma për fëmijë, TV, tregime.

#### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Para leximit Motivimi	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i parë	Mësuesi paraqet para nxënësve disa foto njerëzish që ushtrojnë profesione të ndryshme. Kërkon nga nxënësit të gjejnë emrat e profesioneve sipas fotove. Mësuesi kërkon që nxënësit të tregojnë se çfarë bëjnë njëherë që ushtrojnë profesionet e mësipërme. (Shofer, pilot, mësues, shitës, kompjuterist, ekonomist etj.)	Nxënësit emërtojnë profesionet e ndryshme.  Nxënësit përshkrujnë, me aq sa dinë dhe munden, profesionet në fjalë.
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë profesioent që ushtrojnë prindërit e tyre, duke i përshkruar.	Nxënësit përshkruajnë profesionet e prindërve të tyre: profesionin, vendin e punës, punën që bën, kënaqësinë ose vështirësinë.
Gjatë leximit Kuptimi / zberthimi i pjesës	<b>Di - dua të di - mësova / Gushkuqi rrethor</b>	

Hapi i tretë	<p>Mësuesi prezanton titullin e pjesës “Në zyrën e babait” dhe u thotë nxënësve se do të lexojnë një pjesë që lidhet me punën e prindërve.  “Personazhi, i cili viziton punën e babit, është një moshatar me ju.  Çfarë ndodh me tejt?”  Mësuesi e zërthen përmes leximit të udhëhequr nga teknika “Di - dua të di - mësova”.  Mësuesi pyet:  Çfarë dini deri tani për pjesën që do të lexojmë?  Çfarë doni të dini më tej?</p> <p>Mësuesi pret pyetje të larmishme nga nxënësit.</p> <p>Më pas u thotë nxënësve “Ecim më tej” dhe kërkon që pjesa të lexohet përmes teknikës “Gushkuqi rrethor”.  Pasi nxënësit kanë lexuar pjesën, mësuesi u drejtohet:  A morët përgjigje për pyetjet që bëtë?  Për cilat pyetje morët përgjigje dhe për cilat jo?  Mësuesi kërkon që nxënësit ta lexojnë përsëri pjesën dhe të nënvizojnë fjalët që lidhen me profesionin e babit të Dorinës.  Kërkon që të shpjegohen fjalët e vështira: tastierë, ekonomist, shkresa etj.  Mësuesi pyet përsëri: Çfarë mësuam sot?</p>	<p>Nxënësit, të ndarë në grupe, punojnë për të rindërtuar tregimin e ndarë në pjesë-pjesë.</p> <p>Nxënësit përgjigjen se një fëmijë ka vizituar punën e babit të tij.</p> <p>Nxënësit përgjigjen në mënyra të ndryshme, duke thënë se çfarë bën Dorina, ku shkon, si është puna e babit...</p> <p>Çdo nxënës lexon nga një fjali.</p> <p>Nxënësit përgjigjen se për cilat pyetje morën përgjigje dhe për cilat jo.</p> <p>Nxënësit, me ndihmën e mësuesit, shpjegojnë fjalët e vështira.</p> <p>Nxënësit shprehen lirshëm për gjërat që ata mësuam: Profesionet e prindërve.</p>
Pas leximit Përforsimi	Rrjet diskutimi “Të njohim prindërit tanë”/ Shkrim i lirë	
Hapi i katërt	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë profesionet e prindërve, duke u udhëhequr nga pyetjet e tekstit në lidhje me këtë diskutim.  Çfarë pune bën babi/mami?  Të pëlqen puna që bën mami/babi?  Cila është ajo gjë që të pëlqen më shumë në profesionin e mami/babit  Si ndihesh për punën që bën mami/babi? I/e lumtur? I/e kënaqur?</p>	<p>Nxënësit përshkruajnë profesionet që bëjnë prindërit e tyre.  Shprehen se si ndihen etj.</p>
Detyrë	Të shkruajnë emra profesionesh dhe nga një fjali për secilin profesion.	Nxënësit shkruajnë emra profesionesh dhe nga një fjali për secilin profesion.

## MËSIMI MODEL 10

### TEMA: LEGJENDA E LULEDIELLIT

#### Objektivat:

1. Të lexojë me kuptim përralla/legjenda, duke thënë përmbajtjen e tyre.
2. Të gjejë hyrjen, zhvillimin, mbylljen në fabulën që lexon.
3. Të reflektojë rreth mesazhit të pjesës.

#### Teknika dhe strategji:

- Dora e fshehtë
- Punë në grupe

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të folurit, fjalëformim, të shkruarit.

**Fjalë kyç:** Titull, pjesë, legjendë, personazh, hyrje, mbyllje.

**Ndërthurja:** Të folurit, të lexuarit, arti, gjuha.

**Burime dhe mjete:** CD me filma për fëmijë, TV, tregime.

#### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Para leximit: Motivimi	<b>Vizatim /reflektim gjuhësor</b>	
Hapi i parë	Mësuesi paraqet para klasës disa foto lulesh dhe kërkon që nxënësit të vizatojnë lulen që pëlqejnë dhe, nën të, të shkruajnë emrin e lules.	Çdo nxënës vizaton lulen që pëlqen dhe shkruan, nën të, emrin e lules që vizatoi.
<b>Hyrja</b>	<b>Ture galerie/Reflektim gjuhësor/Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të vendosin vizatimet e tyre në mur ose në dërrasë të zezë dhe të shohin punët e njëri-tjetrit dhe emrat e luleve të shkruara nën to: luledele, luledielli, luleshtrydhe, lulekuqe etj. Mësuesi kërkon që nxënësit të reflektojnë rreth mënyrës se si i kanë shkruar emrat: disa ndaras dhe disa bashkuar. U thotë nxënësve se këto janë fjalë shumë të gjata, por që shkruhen bashkë.	Nxënësit vendosin vizatimet e tyre në mur ose në dërrasën e zezë dhe, të gjithë së bashku, shikojnë dhe lexojnë punimet e njëri-tjetrit.  Nxënësit reflektojnë rreth mënyrës se si i kanë shkruar emrat e luleve.
Gjatë leximit Kuptimi /zberthimi i pjesës	<b>Punë në grupe/Gushkuqi rrethor</b>	

Hapi i tretë	<p>Mësuesi kërkon që nxënësit, në grupe dyshe, të lexojnë pjesën “Legjenda e lulediellit”.</p> <p>Më pas, njëri nga grupi të lexojë pjesën.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit në grupe të nënvizojnë:</p> <p>Nx. A - fjalët hyrëse të legjendës.</p> <p>Nx. B - fjalët mbyllëse.</p> <p>Më pas, mësuesi/ja kërkon që të nënvizojnë fjalët e vështira. Nga çdo grup, fjalët shkruhen në dërrasë ose në fletë të vogla që ngjiten në dërrasë.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë përmbajtjen e legjendës.</p>	<p>Nxënësit, në grupe dyshe, lexojnë fabulën.</p> <p>Nxënësit në grupe dyshe nënvizojnë fjalët e vështira dhe i shkruajnë në dërrasë të zezë.</p> <p>Nxënësit në grup nënvizojnë fjalët hyrëse dhe mbyllëse në legjendë.</p> <p>Disa nga nxënësit tregojnë përmbajtjen e legjendës.</p>
Pas leximit Përforcimi	<b>Rrjet diskutimi/Punë me shkrim/ Reflektim gjuhësor</b>	
Hapi i katërt	<p>Diskutojnë rreth çështjes “A bëri mirë dielli që ia dha emrin lulediellit”?</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të nënvizojnë në legjendë fjalët që tregojnë veprim.</p>	<p>Nxënësit diskutojnë rreth çështjes.</p> <p>Nxënësit nënvizojnë fjalët që shprehin veprim.</p>
Detyrë	Mësuesi: Shkruani emra të përbërë lulesh.	Shkruajnë emra të përbërë lulesh.

## MËSIMI MODEL 11

### TEMA: NJË GJUHË PËR TË GJITHË

#### Objektivat:

1. Të lexojë pjesë që lidhen me artin dhe muzikën dhe të flasë për to.
2. Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje që lidhen me muzikën.
3. Të luajë në role një orkestër, duke imituar orkestrantë.

#### Teknika dhe strategji:

- Dëgjim muzikor
- Lexim me ndalesa, DLTA

**Shprehi që zhvillohen:** Të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, edukim muzikor.

**Fjalë kyç:** Një gjuhë për të gjithë, muzikant, dirigjent, koncert, balet, piano, violinë, flaut, bateri.

**Ndërthurja:** Dëgjimi, të folurit, të lexuarit, arti, muzika.

**Burime dhe mjete:** Magnetofon, CD me pamje nga koncertet e Vjenës, foto.

### Zhvillimi i mësimi:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Para leximit Motivimi	<b>Dëgjim dhe reflektim muzikor</b>	
Hapi i parë	Mësuesi ka vendosur në magnetofon ose shfaq me CD përmes videoprojektorit, nëse ka, pamje, foto të ndryshme nga koncertet e Vjenës. Mësuesi kërkon që nxënësit ta pyesin për diçka që ata mendojnë në lidhje me muzikën që panë/dëgjuan. Mësuesi kërkon që nëse ka një nxënës në klasë që di të këndojë, le ta dëgjojmë.	Nxënësit dëgjojnë dhe shijojnë muzikë.  Nxënësit pyesin për atë që ata panë, shijuan, dëgjuan. P.sh.: Ku është? Kush e organizon? Pse e dëgjuam? Etj. Një ose më shumë nxënës këndojnë një këngë, por mund të këndojnë edhe në grup.
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi u drejton nxënësve disa pyetje: Çfarë është muzika? Kush e prodhon? Kush e përdor? Çfarë ju pëlqen më shumë?	Nxënësit përgjigjen ashtu si mendojnë për pyetjet e mësuesit. Mund të shprehin edhe pëlqimet dhe mospëlqimet e tyre në lidhje me muzikën.
Gjatë leximit Kuptimi /zbërthimi i pjesës	<b>Punë në grupe katërshe/Gushkuqi rrethor</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi prezanton titullin e pjesës “Një gjuhë për të gjithë” dhe kërkon që nxënësit të thonë se çfarë kuptojnë me titullin e kësaj pjese.  Mësuesi kërkon që nxënësit, të ndarë në grupe me nga katër veta, të lexojnë pjesën “Një gjuhë për të gjithë”. Më pas, njëri nga grupi ta ritregojë.  Mësuesi pyet se si e lexoi pjesën secili nga nxënësit në çdo grup, cilat ishin gjërat pozitive dhe gabimet e bëra nga çdo nxënës.  Mësuesi kërkon që nxënësit në grupe të nënvizojnë në tekst fjalët e vështira, të cilave nuk ua dinë kuptimin. Nga çdo grup, fjalët shkruhen në dërrasë ose në fletë të vogla që ngjiten në dërrasë: <i>Muzikant, dirigjent, koncert, balet, piano, violinë, flaut, bateri.</i>	Nxënësit përgjigjen, ashtu siç mendojnë në lidhje me këtë shprehje.  Nxënësit, në grupe katërshe, përmes teknikës “Gushkuqi rrethor” lexojnë pjesën. Pasi e kanë lexuar në grup, e lexojnë edhe me zë për ta dëgjuar edhe të tjerët. Nxënësit lexojnë saktë dhe pa gabime, me zë, pasi marrin një vlerësim edhe nga mësuesi, edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënësit, në grupe katërshe, nënvizojnë fjalët e vështira dhe dalin i shkruajnë në dërrasë.  Disa nga nxënësit tregojnë përmbajtjen e pjesës.



Pas leximit Përforcimi	<b>Rrjet diskutimi/Lojë në role</b>	
Hapi i katërt	<p>Diskutojnë rreth çështjes “Pse muzika është një gjuhë për të gjithë?”</p> <p>Mësuesi kërkon që çdo grup nxënësish të krijojë dhe të luajë në role një orkestër të vogël.</p> <p>Nga orkestranët më të mirë të çdo grupi zgjidhen disa dhe krijojnë orkestrën e klasës dhe interpretojnë një melodi.</p>	<p>Nxënësit diskutojnë rreth situatës.</p> <p>Në grupe, nxënësit krijojnë orkestrat e vogla. Më pas, nga çdo grup vlerësohen orkestrantët më të mirë dhe ata luajnë me imagjinatë një vijë melodike të një kënge që e njohin. Me mjete rrethore krijojnë zhurmat e orkestrës (kapakë që përplasen, fizarmonika-lodër etj. Nxënësit e tjerë bëjnë korin dhe këndojnë së bashku.</p>
Detyrë	Shkruajnë emrat e veglave muzikore.	Me emrat e veglave muzikore që kanë shkruar, në shtëpi shkruajnë edhe fjali.

## MËSIMI MODEL 12

### TEMA: BIÇIKLETA

#### Objektivat:

1. Të lexojë pjesë që lidhen me jetën e tij.
2. Të përdorë fjalor nga fusha e shkencave.
3. Të gjejë pjesën hyrëse, zhvilluese dhe mbyllëse të tregimit.

#### Teknika dhe strategji:

- Imagjinatë e drejtuar
- DRTA
- Shkrim i lirë

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të folurit, diskutimi.

**Fjalë kyç:** Tregim, pjesë hyrëse, pjesa mbyllëse.

**Ndërthurja:** Art, teknologji, lexim-shkrim.

#### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Para leximit Motivimi	<b>Gara me biçikleta Imagjinatë e drejtuar</b>	
Hapi i parë	<p>Mësuesi nis të tregojë pjesën me titull “Gara me biçikleta”.</p> <p>Kërkon që nxënësit të ulin kokën dhe të dëgjojnë tregimin.</p> <p>Mësuesi flet:</p> <p>Një ditë, nxënësit e një klase sportive ishin në gara me biçikleta. Të gjithë ishin shumë të gëzuar. Kishin marrë biçikletat dhe po prisnin të niste gara. Gara filloi. Të gjithë fëmijët bërtisnin...</p> <p>Papritur, mësuesi e ndërpret tregimin dhe kërkon që nxënësit të vazhdojnë tregimin dhe të gjejnë një mbyllje për të.</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë me kokën ulur tregimin e mësuesit dhe, sapo ai urdhëron të ngrenë kokën, ata nisin të mendojnë se si do të vazhdojë më pas tregimi.</p> <p>Disa nxënës vazhdojnë tregimin, duke i bërë edhe një mbyllje, ashtu siç dëshirojnë.</p>

Hyrja	Stuhi mendimi	
Hapi i dytë	Mësuesi pyet nxënësit nëse ata mendojnë për të pasur një biçikletë, si mund ta sigurojnë atë.	Nxënësit shprehin lirshëm për dëshirën dhe mundësitë e tyre për të pasur një biçikletë.
Gjatë leximit Kuptimi / zbërthimi i pjesës	<b>DRTA/Punë në grupe</b>	
Hapi i tretë	<p>Mësuesi prezanton titullin e tregimit: “Biçikleta”. Pyet nxënësit se për çfarë mund të bëjë fjalë ky tregim.</p> <p>Mësuesi kërkon që një nga nxënësit të lexojë pjesën e parë të tregimit (gjashtë rreshtat e parë).</p> <p><i>Ndalesa e parë</i> Mësuesi pyet: Cilat janë në këtë pjesë ato fjalë që tregojnë se cili është problemi? Për çfarë është i shqetësuar personazhi i tregimit tonë? Pse nuk e zë gjumi? Çfarë e mundon? Çfarë mendoni për zarfin? Pse mendoni kështu?</p> <p><i>Ndalesa e dytë</i> Mësuesi kërkon që nxënësit të lexojnë pjesën e dytë: Nga <i>U ngrita ... deri Nuk m'u durua...</i> Mësuesi pyet: Çfarë ka ndodhur? E kishit menduar se do të ndodhte kështu? Cili është parashikimi juaj i mëparshëm që ka dalë deri tani? Çfarë mendoni se do të ndodhë më pas? Cilat janë ato fjalë që e tregojnë këtë gjë?</p> <p><i>Ndalesa e tretë</i> Nga <i>Vrapova... deri në ...në fund të shkallëve.</i> Mësuesi pyet përsëri: Çfarë ka ndodhur? E kishit menduar se do të ndodhte kështu? Cili është parashikimi juaj i mëparshëm që ka dalë deri tani? Si do të mbyllet tregimi?</p> <p><i>Ndalesa e katërt</i> Çfarë mund të jetë poshtë shkallëve? (Sigurisht, nxënësit e kanë lexuar fshehurazi tregimin dhe e dinë mbylljen.) Mësuesi pyet: Ju pëlqeu tregimi? Pse? Mësuesi kërkon që nxënësit, në punë me grupe dyshe, të mendojnë një mbyllje tjetër për tregimin dhe ta thonë.</p>	<p>Nxënësit shprehin mendime, duke u mbështetur në imagjinatë.</p> <p>Njëri nga nxënësit lexon pjesën e tregimit që kërkoi mësuesi.</p> <p>Nxënësit përgjigjen për pyetjet që bëhen nga mësuesi, duke shprehur edhe parashikimet e mundshme.</p> <p>Një nxënës lexon pjesën.</p> <p>Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të mësuesit.</p> <p>Me të njëjtin ritëm, nxënësit përgjigjen përsëri.</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit.</p> <p>Një përfaqësues i grupit të nxënësve thotë mbylljen e menduar për tregimin në fjalë.</p>
Pas leximit Përforcimi	<b>Bashkëbisedim/Shkrim i lirë</b>	

Hapi i katërt	Mësuesi kërkon që nxënësit të organizojnë një bashkëbisedim rreth çështjes “Dhuratat më të pëlqyera për djem dhe vajza”.  Mësuesi pyet nëse nxënësve u pëlqejnë surprizat.	Nxënësit ndahen në grupe të mëdha, djemtë nga njëra anë dhe vajzat nga ana tjetër, dhe diskutojnë për dhuratat.  Nxënësit tregojnë histori në lidhje me dhuratat e papritura që kanë marrë.
Detyrë	Mësuesi jep detyrë që nxënësit të ngjyrosin një biçikletë dhe të emërtojnë pjesët përbërëse të saj.	Nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin një biçikletë dhe, më pas, emërtojnë pjesët e biçikletës: rrota, timoni, sedilja, zinxhiri...

## MËSIMI MODEL 13

### TEMA: ZEMËRIMI I LULEVE (LIBRI I PUNËS:

#### Objektivat:

1. Të lexojë duke përdorur intonacionin e duhur në pjesët me dialog.
2. Të gjejë pjesën hyrëse, zhvilluese dhe mbyllëse të tregimit.
3. Të lexojë duke krahasuar cilësitë e objekteve të ngjashme.

#### Teknika dhe strategji:

- Kllaster
- Di - dua të di - mësova
- Diagrami i Venit

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të folurit, diskutimi, imagjinata.

**Fjalë kyç:** Përrallë, përmbajtje, personazh.

**Ndërthurja:** Lexim-shkrim/shkencë/teknologji.

**Burime dhe mjete:** Fjalor, lule natyrale, lule artificiale.

#### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Motivimi Para leximit</b>	Loja enigmë	
Hapi i parë	Mësuesi ka vendosur në dërrasë disa foto lulesh, por mbrapsh, dhe kërkon nga nxënësit që të gjejnë emrat e tyre. Zbulon pamjet pjesë-pjesë. E nis nga poshtë-lart dhe pastaj nga lart-poshtë. Ai/ajo që e gjen i pari, fiton lojën “Bingo”. Mësuesi kërkon që, pasi nxënësit të kenë gjetur emrat e luleve, të shkruajnë emrat e tyre dhe një fjali për njërin nga lulet.	Nxënësit ndjekin me vëmendje kur mësuesi zbulon pamjet e fotove dhe nxitojnë për të fituar lojën “Bingo”.  Nxënësit shkruajnë emrat e luleve dhe një fjali rreth njëres prej tyre.
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>	
Hapi i dytë	Mësuesi pyet se për çfarë mund të mërzhiten lulet.	Nxënësit kërkojnë dhe thonë arsye se pse mund të mërzhiten lulet.

Gjatë leximit Kuptimi /zbërthimi i pjesës	<b>Lexim në role/Punë në grupe dyshe</b>	
Hapi i tretë	Mësuesi prezanton titullin e pjesës dhe u tregon nxënësve mesazhin e fabulës. Për më tepër, kërkon që nxënësit ta lexojnë me role pjesën në grupe dyshe. Mësuesi pyet se cili është problemi që kanë lulet me njëra-tjetrën.	Nxënësit, të ndarë në grupe dyshe, lexojnë në role pjesën. Nxënësit gjejnë dhe thonë arsye se pse janë të mërzitura lulet natyrale dhe se a kanë të drejtë të mërziten.
Pas leximit Përforsimi	<b>Diagrami i Venit</b>	
Hapi i katërt	Mësuesi kërkon që nxënësit të krahasojnë lulet natyrale me lulet artificiale përmes diagramit të Venit.	Nxënësit krahasojnë lulet natyrale me lulet artificiale dhe, përmes mbiemrave, nxjerrin në pah cilësitë e tyre: të veçantat dhe të përbashkëtat.
Detyrë	Mësuesi kërkon që nxënësit për detyrë shtëpie të shkruajnë tri fjali me emrat e tri luleve.	

## MËSIMI MODEL 14

### TEMA: DIELLI DHE REJA (LIBRI I PUNËS:

#### Objektivat:

1. Të lexojë pjesë që lidhen me problematika të ndryshme.
2. Të shprehë ndjenja dhe dëshira që lidhen me raste festash.
3. Të gjejë pjesën hyrëse, zhvilluese dhe mbyllëse të tregimit.

#### Teknika dhe strategji:

- Kllaster
- Gushkuqi rrethor
- Diskutim/Shkrim i lirë

**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të folurit, diskutimi.


**Fjalë kyç:** Përrallë, përmbajtje, personazh.

**Ndërthurja:** Lexim-shkrim/shkencë/fantazi.

**Burime dhe mjete:** Fjalor, CD, foto, të dhëna nga stacioni metereologjik.

#### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Ndërthurja	Çfarë do të bëjnë nxënësit?	Koha
Para leximit Motivimi	<b>Lojë në role, parashikimi i motit, punë në grupe</b>			

Hapi i parë	Mësuesi ka incizuar një fragment nga rubrika e parashikimit të motit dhe kërkon që edhe nxënësit të luajnë në role, në grupe dyshe, të njëjtin rol, të bëhen spikerë për të paraqitur motin: Njëri grup në ditë vere, tjetri në ditë vjeshte, dimri dhe pranvere.		Fëmijët, të veshur si prezantuesit e motit, me një shkop në dorë dhe para një harte, japin të dhënat mbi motin sipas detyrës që kanë grupet.	
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>			
Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të bëjnë një kllaster në grupe dyshe, por me dy detyra: Njëri grup për retë dhe tjetri për diellin, duke vendosur në kllaster cilësitë e tyre. 		Nxënësit, sipas detyrës përkatëse, plotësojnë kllasterat dhe i prezantojnë ata.	
Gjatë leximit Kuptimi / zberthimi i pjesës	<b>Gushkuqi rrethor</b>			
Hapi i tretë	Mësuesi i vendos nxënësit në një rreth ose tavolinë të rrumbullakët, nëse ka mundësi, ose i sistemon bankat në mënyrë të tillë që të ngjajnë si tavolinë e përbashkët dhe kërkon që nxënësit të hapin librin te tema: “Dielli dhe Reja”. U jep nxënëve detyrë njëri pas tjetrit të lexojnë përrallën “Dielli dhe Reja”. Mësuesi kërkon që disa nxënës të thonë përmbajtjen e përrallës.		Nxënësit me radhë lexojnë përrallën derisa mësuesi të thotë “Ndal”.  Nxënësit thonë përmbajtjen e përrallës.	
Pas leximit Përforcimi	<b>Bashkëbisedim/Shkrim i lirë</b>			
Hapi i katërt	Mësuesi nxit nxënësit të diskutojnë rreth çështjes: “A mund t’i mbarohen rrezet diellit?” Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë fjalët që i thotë Reja Diellit.		Nxënësit gjejnë arsye pse mund t’i mbarohen ose pse nuk mund t’i mbarohen rrezet Diellit. Nxënësit gjejnë në tekst fjalët që i thotë Reja Diellit.	
Detyrë	Mësuesi jep detyrë të shkruajnë fjalët që i thotë Dielli Resë.		Nxënësit shkruajnë fjalët që i thotë Dielli Resë.	

## MËSIMI MODEL 15

### TEMA: PIKTURA E EDLIRËS

#### Objektivat:

1. Të lexojë pjesë që lidhen me talentin e fëmijëve.
2. Të shprehë ndjenja dhe dëshira.
3. Të përshkruajë personazhe dhe t'i vizatojë ato.

#### Teknika dhe strategji:

- Turi i galerisë
- Stuhi mendimi
- Gushëkuqi rrethor


**Shprehi që zhvillohen:** Të lexuarit, të folurit, diskutimi.

**Fjalë kyç:** Përrallë, përmbajtje, personazh.

**Ndërthurja:** Lexim-shkrim/Art.

**Burime dhe mjete:** Ekspozitë me foto e piktura kafshësh.

#### Zhvillimi i mësimit:

Hapa	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Ndërthurja	Çfarë do të bëjnë nxënësit?	Koha
Para leximit Motivimi	<b>Turi i galerisë</b>			
Hapi i parë	Mësuesi kërkon që nxënësit të vizatojnë një kafshë shtëpiake dhe, më pas, ta varin vizatimin në mur ose në tabelë. Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë emrat e kafshëve që ata kanë vizatuar.		Secili nga nxënësit vizaton kafshën që ai pëlqen.  Nxënësit shkruajnë emrat e kafshëve, figurat e të cilave shohin në tabelë.	
<b>Hyrja</b>	<b>Stuhi mendimi</b>			
Hapi i dytë	Mësuesi kërkon që nxënësit të bëjnë një kllaster për kalin. 		Nxënësit bëjnë kllasterin, duke shkruar sa më shumë mbiemra për ta karakterizuar dhe për ta përshkruar kalin.	
Gjatë leximit Kuptimi/ zbërthimi i pjesës	<b>Gushkuqi rrethor</b>			

Hapi i tretë	Mësuesi prezanton titullin e pjesës “Piktura e Edlirës” dhe kërkon që nxënësit të thonë se përse mund të flasë kjo pjesë. Mësuesi, përmes teknikës “Gushkuqi rrethor” i vë nxënësit të lexojnë pjesën. Mësuesi bën disa pyetje për të parë se sa e kanë kuptuar përmbajtjen e tregimit. Mësuesi pyet nxënësit nëse u pëlqen vizatimi dhe çfarë mund të bëjnë ata në shkollë për t’u bërë vizatues (“piktorë”) të mirë.		Nxënësit përgjigjen duke iu afruar subjektit të fabulës.  Nxënësit lexojnë tregimin  Nxënësit shprehin dëshira.	
Pas leximit Përforcimi	<b>Vizatim /Shkrim i lirë/Konkurs</b>			
Hapi i katërt	Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë emrat e mjeteve që përdorin për vizatim dhe nga një fjali për secilin mjet. Mësuesi kërkon që nxënësit të ngjyrosin kalin. Punimet varen në mur dhe shpallet vizatimi më i mirë.		Nxënësit pëshkruajnë dhe vizatojnë.  Nxënësit shpallin fituesin.	
Detyrë	Mësuesi jep detyrë të shkruajnë dy këshilla për nxënësit që vizatojnë.		Nxënësit, me ndihmën e të rriturve, shkruajnë dy këshilla.	

## MËSIMI MODEL PËR LIBRIN E PUNËS TË NJOHIM GJUHËN

### Mësim model 1

**Tema: Bashkësi fjalësh**

**Objektiva:**

1. Të nënvizojë fjalë në tekste të ndryshme.
2. Të gjejë grupe fjalësh që emërtojnë njerëz, kafshë, sende.
3. Të grupojë emra njerëzish dhe emra vendesh.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit.

**Fjalë kyç:** Fjalë, emra njerëzish, emra kafshësh, emra sendesh.

**Burim:** Libri i punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Punë e pavarur / Demonstrim / Grupim / Klasifikim / Diagrami i Venit

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?			
Hyrje	Vëzhgim/Demonstrim				
	Mësuesi kërkon që nxënësit të vështrojnë rreth e rrotull dhe të emërtojnë objektet dhe sendet që shohin në klasë.  Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë 5 fjalë që emërtojnë objekte të ndryshme.	Nxënësit emërtojnë objekte të ndryshme.  Nxënësit shkruajnë 5 fjalë që emërtojnë objekte që ata kanë parë rreth e rrotull.			
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Demonstrim / Punë në grupe / Punë e pavarur në Abetaren e Punës</b>				
	Mësuesi ndan klasën në grupe treshe dhe kërkon që një nxënës në çdo grup të gjejë 5 emra njerëzish, tjetri 5 emra kafshësh dhe tjetri 5 emra sendesh. Mësuesi bën një tabelë të madhe në klasë.  <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td>Emra njerëzish</td> <td>Emra kafshësh</td> <td>Emra sendesh</td> </tr> </table> Mësuesi tregon se emrat ndahen edhe si emra njerëzish dhe sendesh.	Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh	Nxënësit gjejnë emra sipas kërkesës së mësuesit. Nga çdo grup shkruhet një tabelë ku vendosen emra sipas kategorive.  Nxënësit lexojnë emrat sipas kategorive. Mësuesi i shkruan në tabelë.
Emra njerëzish	Emra kafshësh	Emra sendesh			
Përforsim	Punë e pavarur në Abetaren e Punës.				
	Mësuesi kërkon që të punohet ushtrimi 1.2.	Nxënësit shkruajnë me shkrim dore emrat e sendeve.			
Detyrë	Mësuesi kërkon që te vjersha “Abetare, Abetare”, nxënësit të gjejnë 4 fjalë-emra dhe të shkruajnë nga një fjali me secilën fjalë.				

## Mësim model 2

### Tema: Emra kafshësh

#### Objektiva:

1. Të nënvizojë në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra kafshësh.
2. Të formojë grupe fjalësh që emërtojnë emra kafshësh.
3. Të shkruajë emra të veçantë kafshësh.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit.

**Fjalë kyç:** Emra kafshësh.

**Burim:** Libri i punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim / Diagram / Demonstrim.



## Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / demonstrim	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të kujtojnë emra kafshësh dhe tregime që kanë lexuar, në të cilat kanë qenë disa emra kafshësh.	Nxënësit kujtojnë emra kafshësh.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Demonstrim / Punë në grupe / Punë e pavarur në Abetaren e Punës	
	<p>1. Mësuesi ndan klasën në grupe dyshe dhe kërkon që çdo grup të shkruajë 5 emra kafshësh.</p> <p>2. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë në fletën e punës, duke plotësuar ushtrimin 1 sipas modelit.</p> <p>3. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 2 (katër radhët e para) sipas modelit.</p>	<p>Nxënësit, në grupe dyshe, shkruajnë emra kafshësh.</p> <p>Nxënësit plotësojnë sipas modelit.</p> <p>Nxënësit punojnë ushtrimin 2 (katër radhët e para) sipas modelit.</p>
Përforsim	Punë e pavarur në Abetaren e Punës.	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë emra kafshësh dhe të shkruajnë fjali me to.	Nxënësit shkruajnë me shkrim dore emrat e kafshëve.
Detyrë	Mësuesi kërkon që te vjersha “Miqtë e pyllit”, nxënësit të gjejnë fjalë që emërtojnë sende.	Nxënësit shkruajnë me shkrim dore emrat e sendeve.

### Mësim model 3

**Tema:** Emra njerëzish dhe sendesh

**Objektiva:**

1. Të nënvizojë në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra njerëzish.
2. Të shkruajë emra njerëzish (femra dhe meshkuj).

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / të menduarit / kujtesa.

**Fjalë kyç:** Emra njerëzish, emra femrash, emra meshkujsh.

**Burime:** Libri i punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Punë e pavarur / Punë në grupe / Demonstrim / Grupim / Klasifikim / Diagram.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim/demonstrim	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të kujtojnë emra njerëzish nga tregimet që kanë lexuar në Abetare. Mësuesi kërkon që 5 nxënës të ngrihen dhe të shkruajnë secili nga një emër njeriu në tabelë.	Nxënësit kujtojnë emra njerëzish dhe emra sendesh.  Nxënësit shkruajnë emra njerëzish në tabelë.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Demonstrim / Punë në grupe / Punë e pavarur në Abetaren e Punës	
	1. Mësuesi ndan klasën në grupe dyshe dhe kërkon që çdo grup të shkruajë nga 5 emra njerëzish. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë në grupe dyshe për t'i ndarë emrat në emra femërorë dhe emra mashkullorë. 3. Mësuesi kërkon të plotësojnë ushtrimin 1 sipas modelit. 4. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 2, ku ata të gjejnë emra sendesh që mbarojnë me <i>a</i> dhe me <i>i</i> .	Nxënësit, në grupe dyshe, shkruajnë nga 5 emra njerëzish.  Nxënësit në grupe ndajnë fjalët në emra femërorë dhe emra mashkullorë.  Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 2, duke i klasifikuar emrat që shohin në ushtrimin 2, brenda bashkësive përkatëse në kërpudha: emra që mbarojnë me <i>a</i> dhe emra që mbarojnë me <i>i</i> .
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë në një tregim të tekstit të Abetares 3 emra sendesh dhe me secilin prej tyre të shkruajnë nga një fjali.	Nxënësit shkruajnë emra njerëzish që gjejnë në tregime nga teksti.
Detyrë	Kërkon të shkruajnë fjali me 3 emra sendesh.	

### Mësim model 4

**Tema:** Emra njerëzish

**Objektiva:**

1. Të nënvizojë në tekste të ndryshme fjalë që tregojnë emra njerëzish.
2. Të shkruajë emra njerëzish që mbarojnë me *a* dhe me *i*, sipas modelit.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit, të menduarit, kujtesa, imagjinata.

**Fjalë kyç:** emra sendesh që mbarojnë me *a* dhe me *i*.

**Burim:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / demonstrim	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të kujtojnë emra njerëzish femërorë dhe mashkullorë.	Nxënësit kujtojnë emra njerëzish. Nxënësit shkruajnë emra njerëzish.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Demonstrim / Punë në grupe / Punë e pavarur në Abetaren e Punës	
	1. Mësuesi ndan klasën në grupe dyshe dhe kërkon që çdo grup të shkruajë nga 5 emra njerëzish. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë në grupe dyshe për t'i ndarë emrat në emra femërorë dhe emra mashkullorë. 3. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë ushtrimin 1, sipas modelit.	Nxënësit, në grupe dyshe, shkruajnë nga 5 emra njerëzish. Nxënësit në grupe ndajnë fjalët në emra njerëzish që mbarojnë me <i>i</i> dhe me <i>a</i> . Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 1.
Përforcim	Punë e pavarur	
	1. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë 4 rreshtat e parë të ushtrimit 2. 2. Mësuesi u jep si detyrë të plotësojnë fjalitë me emrat e dhënë.	Nxënësit shkruajnë emrat njerëzish në tregime nga teksti. Nxënësit shkruajnë fjali me emrat e dhënë.
Detyrë	1. Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë 4 rreshtat e dytë të ushtrimit 2. Me secilin prej tyre të shkruajnë nga një fjali.	

## Mësim model 5

**Tema:** Emra njerëzish

**Objektiva:**

1. Të grupojë emrat sipas modelit *kalë - kali, lopë - lopa*.
2. Të grupojë emrat sipas modelit *burrë - burri, vajzë - vajza*.
3. Të grupojë dhe të shkruajnë emrat sipas modelit *televizori - televizori, derë - dera*.

**Shprehësi që zhvillohen:** Të shkruarit / klasifikimi.

**Fjalë kyç:** emra sendesh, kafshësh, njerëzish.

**Burim:** Libri i punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Demonstrim / Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim / Diagram.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / demonstrim	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të thonë disa emra sipas modelit që ai do të thotë: <i>kalë-kali, lopë-lopa</i> <i>djalë-djali, vajzë-vajza</i> <i>televizor-televizori, derë-dera.</i>	Nxënësit përmendin fjalë të tjera sipas modelit që prezantoi mësuesi.
Zhvillim dhe ndër- tim njohurish	Demonstrim/ Punë në grupe / Punë e pavarur në Abetaren e Punës	
	1. Mësuesi ndan klasën në grupe dyshe dhe kërkon që çdo grup të shkruajë nga 5 emra a njerëzish. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë në grupe dyshe për t'i ndarë emrat në emrat sipas modelit. 3. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë ushtrimin 1, sipas modelit. 4. Mësuesi ndërron detyrat e grupeve dhe, hap pas hapi, u jep detyrë për të plotësuar të gjitha tabelat, duke lënë në çdo tabelë nga dy linja pa plotësuar.	Nxënësit, në grupe dyshe, shkruajnë emra sipas modelit të dhënë. Çdo grup, një grup fjalësh 1, 2, 3, 4, 5, 6.  Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur ushtrimin 1. Nxënësit lexojnë fjalët e grupeve përkatëse.  Nxënësit plotësojnë fjalë në grupet e ndryshme të tabelave, duke lënë dy linja pa plotësuar.
Përforsim	Punë e pavarur në fletore	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë në një tekst 4 fjalë dhe t'i shkruajnë sipas njërit model në Abetaren e Punës.	Nxënësit shkruajnë emra njerëzish të pranishëm në tregime nga teksti.  Nxënësit shkruajnë fjali me emrat e dhënë.
Detyrë	Të plotësojnë linjat e paplotësuara në tabela.	

### Mësim model 6

**Tema:** Emra njerëzish

**Objektiva:**

1. Të shkruajë dhe të lidhë fjalë sipas një fushe të përbashkët semantike.
2. Të shkruajë fjali me emra profesionesh.
3. Të shkruajë emrat e të vegjëlve të kafshëve dhe të sendeve të mëdha.

**Shprehji që zhvillohen:** Të shkruarit / klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Emra të përafërt, emrat e të vegjëlve të kafshëve, emrat e sendeve të mëdha.

**Burim:** Libri i punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim.

## Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim/demonstrim	
	Mësuesi ka vendosur në dërrasë disa foto objektesh që kanë një përafërsi kuptimore: <i>zjarr-tym, lugë-pjatë, shkollë-nxënës, shkumës-dërrasë</i> etj. Kërkon që edhe nxënësit të gjejnë raste të ngjashme me shembujt e dhënë.	Nxënësit japin shembuj si modeli i paraqitur nga mësuesi.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur	
	1. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë ushtrimin 1, sipas modelit në faqen 65. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë emrat e njerëzve që kanë profesione të ndryshme, nisur nga veprimtaria që ata bëjnë: <i>Ai që nget makinën, ai që gatuan, ai që qep, ai që pret xhama</i> etj. Kërkon që nxënësit të japin raste të tjera. 3. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 2, sipas modelit të dhënë.	Nxënësit plotësojnë ushtrimin 1.  Nxënësit kërkojnë dhe japin shembuj të tjerë.  Nxënësit japin përgjigje me shkrim për ushtrimin 2.
Përforsim	Punë e pavarur	
	Mësuesi udhëzon që të punohet ushtrimi 3, sipas modelit.	Nxënësit japin përgjigje me shkrim për ushtrimin 3.

### Mësim model 7

**Tema: Emra njerëzish**

**Objektiva:**

1. Të shkruajë fjali dhe pyetje nisur nga figurat përkatëse.
2. Të shkruajë fjalë dhe të ngjyrosin objekte.
3. Të plotësojë format e fjalëve sipas modeleve të dhëna.

**Shprehje që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi / Grupimi / Kujtesa.

**Fjalë kyç:** Pyetje, fjali, fjalë, një fjalë-shumë fjalë, shumë-njëjës.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Punë në grupe / Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim/demonstrim	
	Mësuesi nxjerr në dërrasë të zezë dy figura dhe kërkon që nxënësit të bëjnë nga një pyetje për çdo figurë. Mësuesi kërkon që nxënësit të japin nga një përgjigje rreth pyetjeve të bëra.	Nxënësit bëjnë pyetje rreth figurave të demonstruara nga mësuesi. Nxënësit japin përgjigje rreth pyetjeve të ndryshme.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur/Demonstrim modeli/ Punë në grupe	
	1. Mësuesi kërkon që nxënësit të bëjnë një pyetje dhe një përgjigje rreth një fotoje që ai i ka dhënë çdo grupi. 2. Mësuesi jep detyrë që nxënësit të punojnë në mënyrë individuale dy nga figurat e ushtrimit 1.  3. Mësuesi kërkon që nxënësit t'i lexojnë fjalitë që kanë shkruar. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 2, sipas modelit të dhënë.	Nxënësit në grupe dyshe pyesin dhe përgjigjen rreth fotos përkatëse.  Nxënësit bëjnë dy pyetje dhe japin dy përgjigje për 2 fotot e librit. Nxënësit lexojnë fjalitë e shkuara.  Nxënësit japin përgjigje me shkrim për ushtrimin 2 dhe ngjyrosin.
<b>Përforcim</b>	<b>Punë e pavarur</b>	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 3, sipas modelit të dhënë.	Nxënësit japin përgjigje me shkrim për ushtrimin 3.
Detyrë	Ushtrimi 1, dy figurat e paplotësuara.	

### Mësim model 8

**Tema: Fjalë që tregojnë cilësi**

**Objektiva:**

1. Të lidhë emrat e kafshëve të ndryshme me cilësitë e tyre.
2. Të plotësojë pjesë të fjalëve që tregojnë cilësi dhe që mungojnë në grupin e fjalëve.
3. Të shkruajë fjali me grupet e fjalëve (fjalë +cilësi).

**Shprehji që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Libri i punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim.

## Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / demonstrim	
	Mësuesi demonstroi përpara nxënësve figura kafshësh dhe një listë me mbiemra të ndryshëm, tek e cila nxënësit do të gjejnë një cilësi për çdo kafshë.	Nxënësit cilësojnë figura kafshësh me mbiemra të ndryshëm.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
	1. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 1, përmes së cilit do të lidhin kafshën me cilësinë. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të lidhin fjalët me objektet përkatëse të ushtrimit 2.	1. Nxënësit plotësojnë ushtrimin 1, duke lidhur kafshën e figurës me cilësinë përkatëse. 2. Nxënësit lidhin me shigjetë fjalët me objektet përkatëse.
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë pjesën që mungon në fjalët e cilësisë. Mësuesi udhëzon nxënësit që ata të gjejnë një listë me mbiemra, që kanë në fund <i>ë</i> , dhe u thotë nxënësve t'i shkruajnë duke i shoqëruar sipas modelit: <i>Djalë i gjatë</i> <i>Fushë e gjerë</i> <i>Mal i lartë ...</i>	Nxënësit punojnë ushtrimin 2 dhe grupin e fjalëve shtesë të dhënë nga mësuesi.
Detyrë	Katër fjali me grupet e fjalëve të dhëna nga mësuesi.	

## Mësim model 9

### Tema: Përshkruajmë shokun

#### Objektiva:

1. Të përshkruajë shokun mbështetur në modelin e dhënë.
2. Të formojë fjali, duke lidhur grupe fjalësh, fjalë, cilësi.
3. Të shkruajë fjalitë e krijuara nga ushtrimi i mësipërm.

**Shprehje që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	<p>1. Mësuesi nxjerr përpara klasës një nga nxënësit dhe pyet: Si i ka flokët.....? Si i ka sytë.....? Si i ka buzët.....? Si e ka veshjen.....? Etj.</p> <p>2. Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë shokun/shoqen e bankës siç vepruan pak minuta më parë.</p>	<p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të mësuesit duke përshkruar shokun/shoqen e tyre.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë shokun/shoqen e bankës, duke përdorur sa më shumë fjalë-cilësi.</p>
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
	<p>1. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë me ushtrimin 1. Ai/ajo jep disa udhëzime se si do ta plotësojnë nxënësit.</p> <p>2. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë ushtrimin 2, duke shkruar edhe grupet e fjalëve që krijohen.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë përshkrimin, mbështetur në modelin e dhënë.</p> <p>2. Nxënësit plotësojnë ushtrimin 2, duke lidhur me shigjetë grupet e fjalëve me figurën përkatëse dhe, më pas, duke shkruar grupet e fjalëve.</p>
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi udhëzon që nxënësit të shkruajnë një rën linjë të ushtrimit 3.	Nxënësit shkruajnë linjën djathtas të ushtrimit 3.
Detyrë	Linja majtas e ushtrimit 3.	
Vlerësim	Mësuesi vlerëson faqen e punës së nxënësve për çdo ushtrim gjatë punës, por edhe më pas.	Detyra e shtëpisë vlerësohet edhe në orët pasardhëse.

## Mësim model 10

### Tema: Përshkruajmë objekte dhe kafshë

#### Objektiva:

1. Të përshkruajë objekte dhe kafshë, mbështetur në një listë pyetjesh ndihmëse.
2. Të shkruajë fjalë-cilësi me kuptim të kundërt.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

**Zhvillimi i mësimit:**



Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	<ol style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi nxjerr para klasës një zog dhe një lule dhe pyet:</li> <li>Si e ka pushin.....?</li> <li>Si i ka sytë.....? Etj.</li> <li>Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë lulen, ashtu si bën pak minuta më parë për zogun.</li> </ol>	<p>Nxënësit i përgjigjen pyetjes së mësuesit, duke përshkruar zogun.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë lulen, duke përdorur sa më shumë fjalë-cilësi.</p>
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
	<ol style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 1. Jep disa udhëzime se si do ta plotësojnë nxënësit atë.</li> <li>Mësuesi kërkon që nxënësit të gjejnë dhe të thonë fjalë-cilësi me kuptim të kundërt dhe, më pas, kërkon që nxënësit të plotësojnë ushtrimin 2.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit shkruajnë përshkrimin, mbështetur në modelin e dhënë.</li> <li>Nxënësit plotësojnë ushtrimin 2, duke gjetur për çdo fjalë të dhënë fjalën tjetër me kuptim të kundërt.</li> </ol>
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë një balonë, duke u udhëhequr nga pyetje të caktuara.	Nxënësit përshkruajnë balonën sipas modelit të ushtrimit 3.
Detyrë	Ushtrimi 4	
Vlerësim	Mësuesi vlerëson punën e nxënësve për çdo ushtrim gjatë punës, si edhe më pas.	Detyra e shtëpisë vlerësohet edhe në orët pasardhëse.

## Mësim model 11

### Tema: Fjalë që tregojnë cilësi

#### Objektiva:

- Të përshkruajë me fjalë që tregojnë cilësi sendesh, njerëzish.
- Të shkruajë cilësi dhe të lidhin me shigjetë fjalën me cilësinë e saj.
- Të shkruajë fjali me grupet e fjalëve (fjalë +cilësi).

**Shprehje që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Grupim / Klasifikim.

## Zhvillimi i mësimit

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / demonstrim	
	Mësuesi paraqet para nxënësve shumë objekte, ose kërkon që nxënësit të mendojnë një objekt dhe, me nga tri fjalë për secilin objekt, të tregojnë disa karakteristika.	Nxënësit mendojnë për një objekt dhe gjejnë tri fjalë që të tregojnë se si është objekti që ata kanë zgjedhur. Më pas e prezantojnë para klasës.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
	1. Mësuesi kërkon që nxënësit të punojnë ushtrimin 1. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të lidhin fjalët me objektet përkatëse të ushtrimit 2.	1. Nxënësit plotësojnë ushtrimin 1, duke u dhënë përgjigje pyetjeve të bëra. 2. Nxënësit lidhin me shigjetë fjalët me objektet përkatëse.
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë katër fjali me grupet e fjalëve të krahut të djathtë.	Nxënësit shkruajnë katër fjali me grupet e fjalëve të krahut të djathtë.
Detyrë	Katër fjali me grupet e fjalëve të krahut të majtë të shtrimit 2.	

### Mësim model 12

Tema: Fjalët që tregojnë veprime

**Objektiva:**

1. Të gjejë fjalë që tregojnë se çfarë bëjnë kafshët.
2. Të shkruajë fjali me fjalë që tregojnë veprime të kafshëve.
3. Të lidhë objektin me veprimin që kryen.
4. Të shkruajë fjali, duke përdorur fjalë që tregojnë veprime të ndryshme.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	1. Mësuesi kërkon që nxënësit të tregojnë se çfarë bëjnë kur zgjohen në mëngjes, kur dalin nga shkolla, kur mbarojnë mësimet, kur kanë pushim etj. 2. Mësuesi pyet edhe se çfarë veprimesh bëjnë kafshët.	1. Nxënësit përgjigjen duke përdorur fjalë që tregojnë veprime: lahem, krihem, vishem, loz, shikoj... 2. Nxënësit përgjigjen se kafshët ecin, punojnë, lehin, pëllasin, ulërijnë...

Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
	<p>1. Mësuesi udhëzon nxënësit për të plotësuar ushtrimin 1, së pari, të lidhin me shigjetë veprimin me kafshën përkatëse.</p> <p>2. Mësuesi kërkon të shkruhen fjalitë e ushtrimit 1.</p> <p>3. Mësuesi kërkon që nxënësit të kryejnë ushtrimin sipas modelit.</p>	<p>1. Nxënësit lidhin veprimin me kafshën përkatëse.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë fjali sipas modelit të ushtrimit 1.</p> <p>3. Nxënësit shkruajnë ushtrimin 2 sipas modelit.</p>
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi udhëzon të punohet ushtrimi 4.	Nxënësit shkruajnë fjalët që tregojnë veprim, sipas kërkesës së ushtrimit 4.
Detyrë	Ushtrimi 5	
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe i vlerëson.	

### Mësim model 13

#### Tema: Fjalët që tregojnë veprime

#### Objektiva:

1. Të formojë fjali me grupe fjalësh.
2. Të shkruajë fjali sipas modelit, duke përdorur foljen *kam* në forma të ndryshme.
3. Të përshkruajë veprime që bëjnë fëmijët.
4. Të shkruajë fjali, ku të përdoren drejt fjalë që tregojnë veprime.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimin

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim/Demonstrim/Punë në grupe dyshe	
	<p>Mësuesi ka shkruar në dërrasë fjalët: KAM, KE, KA, KEMI, KENI, KANË.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të formojnë fjali me çdonjërin prej tyre.</p>	Nxënësit formojnë fjali me fjalën <i>kam</i> në të gjitha format (me gojë).
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	

	<p>1. Mësuesi udhëzon nxënësit për të bërë ushtrimin 1, së pari të lidhin me shigjetë linjat, fjalët dhe fjalën që tregon veprim dhe, më pas, të shkruajnë fjalinë e linjës djathtas.</p> <p>2. Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë fjali duke përshkruar figurat dhe veprimet që bëjnë fëmijët.</p>	<p>1. Nxënësit shkruajnë fjali duke lidhur me shigjetë fjalët e grupuara në bashkësi.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë fjali duke përshkruar veprimet që bëjnë fëmijët.</p>
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi udhëzon të punohet ushtrimi 4.	Nxënësit shkruajnë fjali duke përshkruar veprimet që bëjnë fëmijët (me fjalët që tregojnë veprim) sipas kërkesës së ushtrimit 3.
Detyrë	Ushtrimi 1	
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe vlerëson.	

## Mësim model 14

### Tema: Fjalët që tregojnë veprime

#### Objektiva:

1. Të njohë dhe të përdorë fjalëzat (unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato).
2. Të shkruajë përemrat e mësipërm të shoqëruar me foljet *kam, jam, mësoj*.
3. Të shkruajë fjali me fjalë që tregojnë veprime të ndryshme.

**Shprehji që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimimit

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	<p>Mësuesi shkruan në dërrasë fjalëzat: <i>unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato</i>.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit të shoqërojnë këto fjalëza me fjalët <i>kam</i> dhe <i>jam</i> që tregojnë veprim/gjendje, sipas modelit.</p> <p>Si fillim, mësuesi e bën vetë këtë veprim, ndërsa më pas kërkon ta bëjnë edhe nxënësit.</p>	<p>Nxënësit formojnë fjali me fjalët <i>kam</i> dhe <i>jam</i> në të gjitha format (me gojë).</p> <p>Nxënësit, në grupe dyshe, bëjnë ushtrimin sipas udhëzimeve të mësuesit.</p>

Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
	<p>1. Mësuesi udhëzon që nxënësit të shkruajnë dhe të plotësojnë ushtrimin 1.</p> <p>2. Mësuesi kërkon që nxënësit, me 5 fjalë që tregojnë veprim nga ushtrimi 2, të shkruajnë fjali.</p> <p>3. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë fjalitë e ushtrimit 3.</p>	<p>1. Nxënësit plotësojnë ushtrimin 1.</p> <p>2. Nxënësit shkruajnë fjali me 5 fjalë që kanë zgjedhur nga ushtrimi 2.</p> <p>3. Plotësojnë fjalitë e ushtrimit 3.</p>
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi udhëzon nxënësit për plotësimin e ushtrimit 4.	Nxënësit plotësojnë ushtrimin 4.
Detyrë	Mësuesi jep udhëzime për të shkruar 4 fjali me fjalë që tregojnë veprim nga ushtrimi 2.	
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe vlerëson.	

## Mësim model 15

### Tema: Fjalët që tregojnë veprime

#### Objektiva:

1. Të përdorë fjalë që tregojnë veprim në kohë të ndryshme.
2. Të shkruajë në formën e duhur fjalët-veprim në tabelë.
3. Të plotësojë fjalitë, duke gjetur fjalët-veprimet në formën e duhur.

**Shprehji që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

#### Zhvillimi i mësimi:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	<p>Udhëzohen nxënësit të punojnë ushtrimin 1.</p> <p>Mësuesi plotëson në dërrasë ose në <i>flipchart</i> tabelën e ushtrimit 1, sipas kërkesës.</p> <p>Mësuesi kërkon që nxënësit ta përsërisin disa herë duke e lexuar.</p>	<p>Nxënësit shkruajnë fjalët që tregojnë veprim në tabelë.</p> <p>Nxënësit ndjekin mësuesin sipas modelit.</p> <p>Lexojnë tabelën me zë.</p>
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
	Mësuesi udhëzon nxënësit të plotësojnë me shkrim tri linjat e ushtrimit 2.	Nxënësit shkruajnë fjalitë e ushtrimit 2, tri linjat e para.
Përforcim	Punë e pavarur	

		Nxënësit plotësojnë linjën e katërt.
Detyrë	Ushtrimin 2, linja 5.	
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe i vlerëson.	

## Mësim model 16

**Tema: Fjalët që tregojnë veprime**

**Objektiva:**

1. Të përshkruajë një situatë pikniku, duke plotësuar fjalët që mungojnë.
2. Të shkruajë fjali me grupe fjalësh orientuese.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim/ Punë në grupe dyshe	
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe	
Përforcim	Punë e pavarur	
Detyrë		
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe i vlerëson. Mësuesi mban shënime në lista vëzhgimi.	

## Mësim model 17

**Tema: Përshkruajmë ditëlindjen**

**Objektiva:**

1. Të përshkruajë një situatë ditëlindjeje, duke plotësuar fjalët që mungojnë.
2. Të shkruajë fjali me grupe fjalësh orientuese.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, cilësi, grup fjalësh.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	Mësuesi pyet nxënësit se si e festojnë ditëlindjen.	Nxënësit përshkruajnë mbresa dhe kujtime nga ditëlindjet e tyre.
<b>Zhvillim dhe ndërtim njohurish</b>	<b>Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe</b>	
	1. Mësuesi i orienton nxënësit të vëzhgojnë pamjet . 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë në formën e duhur fjalët.	1. Nxënësit përshkruajnë. 2. Nxënësit, të orientuar nga fjalët ndihmëse, plotësojnë përshkrimin e ushtrimit 1.
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi orienton që nxënësit të provojnë të plotësojnë fjalitë e ushtrimit 2.	Nxënësit plotësojnë me shkrim fjalitë e ushtrimit 3.
Detyrë	Të rishkruajnë ushtrimin 2	
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe i vlerëson nxënësit. Mësuesi mban shënime në lista vëzhgimi.	

## Mësim model 18

### Tema: Përshkruajmë ditë pushimi

#### Objektiva:

1. Të përshkruajë një situatë pikniku, duke plotësuar fjalët që mungojnë.
2. Të shkruajë fjali me grupe fjalësh orientuese.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, fjali, tregim, përshkrim, pyetje.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	Mësuesi kërkon nga nxënësit të thonë se ku i kalojnë ditët e pushimeve, fundjavat, ku shkojnë, me kë, me se, çfarë bëjnë, ç' mbresa e kujtime kanë etj.	Nxënësit përshkruajnë mbresa dhe kujtime nga ditët e pushimeve.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur / Demonstrim modeli / Punë në grupe.	

	1. Mësuesi i orienton nxënësit të vëzhgojnë pamjet. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të plotësojnë në formën e duhur fjalët.	1. Nxënësit, të orientuar nga fjalët ndihmëse, plotësojnë përshkrimin e ushtrimit 1.
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi i orienton nxënësit të plotësojnë fjalitë e ushtrimit 2.	3. Nxënësit plotësojnë me shkrim fjalitë e ushtrimit 3.
Detyrë	Të rishkruajnë ushtrimin 2.	
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe i vlerëson. Mësuesi mban shënime në lista vëzhgimi.	

## Mësim model 19

**Tema: Përshkruajmë një ditë me shi**

**Objektiva:**

1. Të përshkruajë një situatë dite me shi.
2. Të shkruajë duke iu përgjigjur pyetjeve.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, fjali, tregim, përshkrim.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimi:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë mbresa dhe ndodhi nga një ditë me shi.	Nxënësit përshkruajnë një ditë me shi: Si është shiu kur të prek, kur të godet mbi kur-riz, kur të lag këpucët, kur bie me furi etj.
Zhvillim dhe ndërtim njo-hurish		
	1. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përshkruajnë foton e faqes 77, duke dhënë sa më shumë hollësi. 2. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit t'u përgjigjen me shkrim nën figurë pyetjeve për pamjen.	Nxënësit përshkruajnë figurën me sa më shumë hollësi. Nxënësit përgjigjen me shkrim për pyetjet që janë në ushtrimin 77.
Përforcim	Punë e pavarur	



	Mësuesi/ja bën disa pyetje për pyetjet e ushtrimit 2: KU? dhe SI?, të cilat bëhen njësoj për të gjitha fotot e këtij ushtrimi.	Nxënësit përgjigjen për pyetjet që bëhen dhe, më pas, shkruajnë përgjigjet e tyre.
Detyrë	Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që ata të marrin një foto çfarëdo, të shkruajnë tri pyetje dhe të japin tri përgjigje.	Nxënësit marrin ose shohin një foto çfarëdo nga libri, apo nga diku tjetër, bëjnë për të tri pyetje dhe japin tri përgjigje.
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe vlerëson. Mësuesi mban shënime në lista vëzhgimi.	

## Mësim model 20

### Tema: Kush? Çfarë? Ku? Si? Me kë? (faqe 78)

#### Objektiva:

1. Të shkruajë pyetje të ndryshme dhe t'i përgjigjet atyre.
2. Të plotësojë fjalë që mungojnë në fjali.
3. Të shkruajë fjali pohore dhe fjali mohore sipas modelit.

**Shprehi që zhvillohen** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, fjali, tregim, përshkrim.

**Burime:** Libri i punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

#### Zhvillimi i mësimet:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
<b>Hyrje</b>	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	Mësuesi ka nxjerrë disa foto të kthyer nga faqja e pasme dhe kërkon që nxënësit të drejtojnë pyetje të ndryshme. Pamjen e fotos e hap pak nga pak, me qëllim që nxënësve t'u shtohet interesimi dhe të pyesin vazhdimisht.	Nxënësit bëjnë pyetje derisa mësuesi të thotë "Mjaft".
Zhvillim dhe ndërtim njohurish	Punë e pavarur	
	Mësuesi u jep detyrë nxënësve të punojnë ushtrimin 1, duke bërë pyetje për çdo figurë.	Nxënësit shkruajnë nga tri pyetje për çdo figurë.
Përforsim	Punë e pavarur	
	Mësuesi i udhëzon nxënësit të pyesin herë me fjali pohore dhe herë me fjali mohore. Më pas, mësuesi kërkon që në ushtrimin 2, pasi të punohet me gojë, nxënësit të shkruajnë në fletore njëzën linjë në klasë, ndërsa tjetrën në shtëpi.	Nxënësit plotësojnë linjën majtas.

Detyrë		Nxënësit shkruajnë tri fjali pohore dhe tri fjali mohore.
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe i vlerëson. Mësuesi mban shënime në lista vëzhgimi.	

## Mësim model 21

**Tema: Përshkruajmë stinët**

**Objektiva:**

1. Të përshkruajë stinët.
2. Të shkruajë duke iu përgjigjur pyetjeve.

**Shprehi që zhvillohen:** Të shkruarit / Klasifikimi.

**Fjalë kyç:** Fjalë, fjali, tregim, përshkrim.

**Burime:** Abetarja e Punës, libra jashtë klase.

**Strategji dhe teknika:** Vëzhgim / Demonstrim / Punë e pavarur / Punë në grupe / Grupim / Klasifikim.

### Zhvillimi i mësimit:

Fazat/hapat	Çfarë do të bëjë mësuesi?	Çfarë do të bëjnë nxënësit?
Hyrje	Vëzhgim / Demonstrim / Punë në grupe dyshe	
	Mësuesi kërkon që nxënësit të ndahen në grupe dhe të përshkruajnë stinët.	Nxënësit, të ndarë në grupe, bashkëbisedojnë për stinët dhe karakteristikat e tyre. Një pjesëtar i grupit përshkruan stinën përkatëse.
Zhvillim dhe ndërtim njohurish		
	1. Mësuesi orienton nxënësit të përshkruajnë fotografinë (njërën prej pamjeve të stinëve), duke dhënë sa më shumë hollësi. 2. Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë njërën prej stinëve.	Nxënësit përshkruajnë figurën me sa më shumë hollësi.  Nxënësit përgjigjen me shkrim për pyetjet e ushtrimit.
Përforcim	Punë e pavarur	
	Mësuesi udhëzon nxënësit të përshkruajnë pamjen e ushtrimit 2.	Me ndihmën e pyetjeve, nxënësit përshkruajnë një pamje pylli.
Detyrë		Ushtrimin 2, nxënësit e punojnë duke e plotësuar edhe në shtëpi.
Vlerësim	Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe i vlerëson. Mësuesi mban shënime në lista vëzhgimi.	

## PJESA III: VLERËSIMI

### VLERËSIMI

1.4	Mund të flasë për një libër			
1.5	Mund të bëjë parashikime se çfarë mund të ndodhë më pas			
1.6	Kujton pjesë nga teksti			
1.7	Bën pyetje sqaruese			
1.8	Përgjigjet për pyetje që lidhen me çështje të caktuara të pjesëve që lexon			
2	<b>Nxënësi ka aftësi ritreguese kur:</b>			
2.1	E tregon tregimin nga fillimi në fund			
2.2	Tregon pikat kryesore sipas radhës			
2.3	Tregon hollësi			
3	<b>Nxënësi flet me kuptim për:</b>			
3.1	Karakteret e tregimeve dhe ngjarjeve			
3.2	Vendngjarjen			
3.3	Problemet			
3.4	Ngjarjet	R	S	V
3.5	Zgjidhjen			
4	<b>Nxënësi lexon:</b>			
4.1	Tekste të shkurtra/të gjata			
4.2	Kupton diferencat midis fjalëve dhe fjalisë			
4.3	Dallon paragrafin			
4.4	Qartë dhe saktë			
4.5	Respekton intonacionin			
4.6	Shkurton rrokje apo tinguj në fjalë			
4.7	Ka shpejtësi mesatare nga 50-70 fjalë në minutë			
4.8	Lexon pa gabime			

### LISTË KONTROLLI DHE VLERËSIMI PËR TË SHKRUARIT DHE AFTËSI TË TJERA ZHVILLUESE

Simbolet: R = Rrallë, S = Shpesh, V = Vazhdimisht

	Shprehia	R	S	V
1	<b>Në shkrimet e tij, nxënësi:</b>			
1.1	Shkruan shkronjat e alfabetit, të shtypit dhe të dorës, saktë dhe bukur			
1.2	Shkruan qartë fjalët			
1.3	Shkruan grupe bashkëtingëlloresh nistore			
1.4	Shkruan grupe bashkëtingëlloresh mesore			
1.5	Shkruan grupe bashkëtingëlloresh fundore			
1.6	Shkruan grupe zanoresh			
1.7	Shkruan saktë fjali të shkurtra			
1.8	Shkruan me të kopjuar dhe me të diktuar			
1.9	Shkruan duke lexuar mendimin e tij			
1.10	Shkruan duke iu përgjigjur pyetjeve që i bëhen			
1.11	Shkruan duke plotësuar shkronja ose fjalë që mungojnë			
2	<b>Nxënësi përpiqet të përdorë drejt kur shkruan:</b>			
2.1	Shkronjën e madhe			
2.2	Pikën			
2.3	Pikëpyetjen			
2.4	Ndan drejt fjalët në rrokje dhe në fund të rreshtit			
3	<b>Nxënësit shkruajnë:</b>			
3.1	Emra njerëzish, sendesh, kafshësh			
3.2	Duke i kthyer emrat (me intuitë dhe sipas modelit) nga njëjës në shumës			
3.3	Fjalë që tregojnë cilësi			
3.4	Fjalë që tregojnë vetë (unë, ti, ai, ajo)	R	S	V
3.5	Fjalë që tregojnë veprime (folje)			
4	<b>Nxënësit shkruajnë:</b>			
4.1	Me imagjinatë			

4.2	Plotësojnë hyrje ose mbyllje tregimesh			
4.3	Përgjigjet e pyetjeve që u bëhen			
4.4	Tregime, duke plotësuar në formën e duhur fjalët që mungojnë.			

## VLERËSIMI ME FJALË DHE SHPREHJE

Siç dihet, vlerësimi në klasën e parë bëhet me fjalë dhe shprehje dhe jo me notë. Në këtë lloj vlerësimi dallojmë:

a - Vlerësim me shprehje motivuese, i cili shoqëron veprimtarinë e përditshme të mësuesve dhe nxënësve dhe komunikimin e vazhdueshëm

ndërmjet tyre.

Vlerësimi me fjalë dhe shprehje është pjesa më e pëlqyeshme, më argëtuese dhe motivuese për fëmijët. Për këtë qëllim, mësuesi duhet të përdorë sa më shumë shprehje dhe shenja nxitëse, të tilla si:

Me gojë:	Me shkrim ose simbole:
Të lumtë! Të lumtë dorë e vogël! Më i shkathëti! Më i shpejti!	Arush, Flutur, Raketë, Aeroplan, Yll me xixa

E shumë shprehje dhe simbole të tjera, të cilat mund të jenë gjetje të mësuesve në bashkëpunim edhe me nxënësit dhe prindërit.

## VLERËSIMI NË REGJISTËR

Për të pasur një vlerësim të saktë e të qartë lidhur me aftësinë lexuese dhe shkruese të nxënësve, gjatë dhe në përfundim të Abetares, rekomandojmë që:

### Në Paraabetare:

*Të bëhet vetëm një vlerësim.* Ky vlerësim do të mbështetet në arritjen e standardeve të vendosura në hyrje të kapitullit për Paraabetaren.

### Në Abetare:

Nxënësit do të marrin vlerësim në fund të çdo grupi shkronjash, duke përfshirë këtu edhe orët e rimarrjes, gjithsej 6 vlerësime.

Secili vlerësim do t'i përgjigjet arritjeve të nxënësve në përfundim të çdo 6 shkronjave, siç janë të organizuara në Abetare dhe në Abetaren e Punës.

Orët e përsëritjes si në Abetare dhe në Abetaren e Punës do të shërbejnë si teste për matjen e arritjeve të nxënësve.

Shprehjet që do të përdoren për vlerësimin e tyre, do të merren në listat e vlerësimin të parashtruara më sipër në këtë tekst, realizimit të objektivave për orë mësimi, kërkesave specifike të programit, si dhe nga

përvoja e vetë mësuesit. Pra, gjatë punës me Abetaren do të vendosen 6 vlerësime, në të cilat do të përshkruhen aftësitë lexuese dhe shkruese të nxënësve sipas listave të kontrollit e vlerësimin.

### Në Pasabetare

Nxënësit do të marrin 2 vlerësime të dokumentuara, të cilat lidhen me aftësitë shkruese, lexuese, dëgjuese dhe shprehëse të nxënësve që do të mbështeten në arritjet e nxënësve dhe progresin e tyre të vazhdueshëm.

Në përfundim të semestrit të parë dhe në fund të vitit shkollor, nxënësve mund t'u bëhet një test përmbledhës me ushtrime të natyrave të ndryshme. Vlerësimi i marrë mund të shënohet në regjistër.

## Test 1

1. Diktim
2. Qarko shkronjat e mësuara:

**N ë n a i d h a A l b ë s n j ë l i b ë r . N ë f a q e n e p a r ë , a i k a t ë v i z a t u a r A b e t a r e n . A t ë e m b a n n ë d o r ë d j a l i i v o g ë l S h p e n d .**

3. Lidh me shigjetë. Shkruaj fjalët.  
p u b e k r l u n ë l e  
b i k u l a h u m i m a

4. Ndani në rrokje dhe shkronja.  
Lirimi luan me topa bore.

5. Plotëso:

Ela lumin	lepuri
Ha karrotë	bukur
Iliri luan	kalon

6. Formo fjali.
- a. (Eri, libër, ri, të bleu)
  - b. A ke lule në klasë?

## Test 2

1. Diktim
2. Qarko shkronjat e nënvizuara.  
Mimi i vogël po luante. Të gjithë dolën te dera. Maçoku kishte mbetur nën gur. Rendëm drejt tij dhe e shpëtuan.
3. Shkruaj fjalët.
4. Ndani në rrokje dhe shkruaj:  
Mirela bëri kala me rërë.
5. Plotëso.

% e P.P.S*	0-24	25-38	39-51	52-64	65-77	78-90	91-100
Intervali i pikëve	0-24	25-38	39-51	52-64	65-77	78-90	91-100
Vlerësimi	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë		Shumë mirë		

### Puna e diferencuar

Gjatë punës me Abetaren do të diferencohen edhe nxënësit me vështirësi të dukshme në lexim-shkrim. Dëmi më i madh që mund t'i bëhet klasës ku ju punoni, është braktisja e nxënësve me probleme të dukshme në lexim-shkrim. Për këtë qëllim, në rekomandojmë që mësuesit të shmangin problemet që kanë dhe të punojnë me ta në mënyrë të difer-

Bëri balonë Ana

Miri orë. Lule,

Pema ka bleu

Formo fjali:

b. (Mali, lule, ka, erë, me)

c. (A ke lule në klasë?)

Për vlerësimin e secilit ushtrim, të mbahet parasysh tabela e mëposhtme:

Ushtrimi 1 ka 29 pikë. 24 pikë për shkrimin saktë të fjalëve (12x2); 3 pikë për shkronjat e mëdha (3x1) dhe 2 pikë për shenjat e pikësimit, vendosjen e pikës (2x1).

Ushtrimi 2 ka 6 pikë. Nxënësi i merr ato, kur qarkon saktë të gjitha shkronjat e mësuara.

Ushtrimi 3 ka 12 pikë. 6 pikë për lidhjen e saktë të rrokjeve dhe 6 pikë për shkrimin e saktë të fjalëve.

Ushtrimi 4 ka 3 pikë për gjetjen dhe shkrimin e saktë të fjalëve.

Ushtrimi 5 ka 30 pikë. 10 pikë për ndarjen e fjalëve në rrokje; 20 pikë për ndarjen në shkronja të fjalëve.

Ushtrimi 6 ka 20 pikë. 7 pikë për pikën a, të shpërndara në këtë mënyrë: 1 pikë kuptimi i figurës, 4 pikë për shkrimin saktë të fjalisë dhe 2 pikë për vendosjen e shkronjës së madhe dhe të pikës në fund të

fjalisë; 7 pikë për pikën b: 5 pikë për shkrimin saktë të fjalisë dhe 2 pikë për vendosjen e shkronjës së madhe dhe të pikës në fund të fjalisë; 6 pikë për pikën c: 4 pikë për krijimin e fjalisë dhe 2 pikë për vendosjen e shkronjës së madhe dhe të pikës në fund të saj.

Për vlerësimin e punës së nxënësit të mbahet parasysh tabela e mëposhtme:

encuar, pa qendruar indiferent duke u marrë vetëm me nxënësit që ecin vetë. Puna e mësuesit të klasës së parë duhet të përqendrohet në vështirësitë e nxënësve me probleme në lexim-shkrim. Është mirë që për këtë kontigent, të ndërtohet një program plus, duke e rifilluar punën me ta, në atë moment ku ata kanë ngecur.

Për këtë qëllim ka rëndësi që mësuesi të

ndërtojë grupin e nxënësve me vështirësi në lexim-shkrim dhe për çdo ditë për ta të ketë kërkesa të veçanta, duke kërkuar prej tyre të kryejnë detyra specifike me ndihmën e tij, por edhe me ndihmën e

nxënësve më të përparuar. Për të lehtësuar punën me ta, këshillohen mësuesit që hapi i parë të jetë çlirimi i tyre prej stresit të të qenët i pasuksesshëm.

### PUNA ME STANDARDIN E GJUHËS SHQIPE

Gjatë veprimtarisë mësimore për mësimin e lexim-shkrimit, mësuesit do të ndeshen edhe me probleme të standardit në raport me dialektin. Për ecurinë më të mirë të këtij procesi, ne ju ofrojmë mësuesve një lëndë gjuhësore, e cila mund të punohet me nxënësit në ato raste kur mësuesit e shohin të nevojshme, përmes një rubrike, të cilën e kemi emërtuar **“Thuhet-shkruhet.”**

Qëllimi i kësaj rubrike është që nxënësit të njihen me format e përdorimit të fjalëve nga njëri dialekt në tjetrin dhe me formën standarde të tyre.

Mësuesi duhet të kërkojë respektimin formës

standarde gjatë të shkruarit të nxënësve.

Ne e rekomandojmë këtë rubrikë për punën që duhet të bëjnë mësuesit si në veri, ashtu dhe në jug të vendit për të njohur fëmijët me forma të gjuhës së folur dhe me normën standarde të saj. Me këtë hap, ne duam të pasurojmë gjuhën dhe ta bëjmë të përdorshme, duke e çuar gjithnjë dhe më tepër drejt njësimi të saj.

I ofrojmë mësuesit këtë rubrikë dhe këtë material gjuhësor, me qëllim për t’i dhënë dorë punës me fjalën shqipe dhe me disa forma të larmishme të artikullimit të saj në mjedise të ndryshme shqipfolëse.

### USHTRIME DIALEKT-STANDARD

#### Thuhet

-/ë

#### shkruhet

1. kal, ball, mjalt, lum, gjalm, brum, dhjam, lum, djal, gjum, grur, uj

kalë, ballë, mjaltë, lumë gjalmë, brumë, dhjamë,

lumë, djalë, gjumë, grurë, ujë.

2. pun, buk, birr, lug, gjell, goj, boj, shum etj.

punë, bukë, birrë, lugë, gjellë, gojë, bojë, shumë etj.

#### Thuhet

i/j

#### shkruhet

bie/bje, shpie/shpje, ndiej/ndjej, miell/mjell, e diel/e djelë, diell/djell.

bie, shpie, ndiej, miell, e diel, diell,

lulia/lulja, dritaria/dritarja, boçia/boçja,

lulja, dritarja, boçja.

#### Thuhet

s ose t

#### shkruhet

mas/mat, nxis/nxit, gëlltis/gëlltit, përshtëndes/përshtëndet, pëshpëris/pëshpërit etj

mas/mat, nxis/nxit, gëlltis/gëlltit, përshtëndes/përshtëndet, pëshpëris/pëshpërit etj.

#### Thuhet

j/nj

#### shkruhet

ullij/ullinj, barij/barinj, ftoj/ftonj

ullinj, barinj, ftonj

lumej/lumenj, përrej/përrenj,

lumenj, përrenj

shej/shenjë, të këqij/të këqinj etj.

shenjë, të këqij etj.

<b>Thuhet</b>	<b>ç/q</b>	<b>shkruhet</b>
çen/qen, ceros/qeros, çukapik/qukapik, çime/qime, çejf/qejf, çershor/qershor, çeth/qeth çep/qepë, çytet/qytet, çaj/qaj, çumsht/qumësht, çaf/qafë etj.		qen, qeros, qukapik, qime qejf, qershor, qeth, qepë, qytet, qaj qumësht, qafë etj.
<b>Thuhet</b>	<b>q/ç</b>	<b>shkruhet</b>
qorape/çorape, qajnik/çajnik, qelës/çelës qiklist/çiklist, qekiq/çekiç, qati/çati etj.		çorape, çajnik, çelës çiklist, çekiç, çati etj.
<b>Thuhet</b>	<b>ë/e</b>	<b>shkruhet</b>
zëmër/zemër, fëmër/femër, emër/emër thëmbër/thembër, dhëmbje/dhembje etj. vend/vend, mëndje/mendje, qën/qen, emër/emër brënda/brenda, qëndër/qender, dëndur/dendur		zemër, femër, emër, thembër, dhembje etj. vend, mendje, qen, emër brenda, qendër, dendur
<b>Thuhet</b>	<b>m/mb</b>	<b>shkruhet</b>
mjell/mbjell, mledh/mbledh, myll/mbyll, muloj/mbuloj, maj/mbaj mi/mbi, mrapa/mbrapa, mret/mbret etj.		mbjell, mbledh, mbyll, mbuloj, mbaj mbi, mbrapa, mbret etj.
<b>Thuhet</b>	<b>n/nd</b>	<b>shkruhet</b>
nez/ndez, nreq/ndreq, knoj/këndoj, niej/ndiej, nikoj/ndikoj, ner/nder, neshje/ndeshje, noshta/ndoshta etj.		ndez, këndoj ndiej, ndikoj, nder, ndeshje, ndoshta etj.
<b>Thuhet</b>	<b>n/ng</b>	<b>shkruhet</b>
nas/ngas, nrij/ngrij, nroh/ngroh, nre/ngre, nado/ngado, i nathët/ i ngathët etj.		ngas, ngrij, ngroh, ngre, ngado, i ngathët etj.
<b>Thuhet</b>	<b>nj/ngj</b>	<b>shkruhet</b>
njyey/ngjyey, njal/ngjalë, njaj/ngjaj, njyros/ngjyros, njesh/ngjesh etj.		ngjyey, ngjalë, ngjaj, ngjyros, ngjesh etj.
<b>Thuhet</b>	<b>xh/gj</b>	<b>shkruhet</b>
xhak/gjak, xharpër/gjarpër, xhej/gjej, xhashtë/gjashtë, xhiz/gjizë, xheth/gjethe, xhoks/gjoks, i xhatë/ i gjatë, i xhall/ i gjallë, xhirafë/gjirafë, xhurm/gjurmë		gjak, gjarpër, gjej, gjashtë, gjizë, gjethe gjoks, i gjatë, i gjallë, gjirafë, gjurmë etj.
<b>Thuhet</b>	<b>gj /xh</b>	<b>shkruhet</b>
gjezve/xhezve, gjaket/xhaketë, gjup/xhup, gjam/xham etj.		xhezve, xhaketë, xhup, xham etj.

**Thuhet****r /rr**

ri/rri, roj/rroj, burë/burrë, reth, rreth, rap/rrap,  
rjetë/rrjetë, fur/furrë, rotë/rrotë, i rall/i rrallë etj.  
rush/rrush, resht/rresht, rezik/rrezik, rufe/rrufe

**shkruhet**

rri, rroj, burrë, rreth, rrap,  
rrjetë, furrë, rrotë, i rrallë etj.  
rrush, rresht, rrezik, rrufe etj.

**Thuhet****i /y**

ill/yll, birek/byrek, tim/tym, si/sy, qip/qyp,  
pies/pyes, hij/hyj, fiell/fyell, qitet/qytet,  
mbit/mbyt, liej/lyej, fiej fyej,  
ilber/ylber, it/yt, inë/ynë, di/dy,  
ai/ay, frykë/frikë, gjylpanë/gjilpërë  
hyp/hip, lypset/lipset etj.

**shkruhet**

yll, byrek, tym, sy, qyp,  
pyes, hyj, fyell, qytet,  
mbyt ose mbys, lyej, fyej,  
ylber, yt, ynë, dy,  
ai, frikë, gjilpërë,  
hip, lipset etj.

**Thuhet****dh /ll**

dhambë/llambë, dhucë/llucë, dhaç/llaç,  
dhukanik/llukanik, veshdhapush/veshllapush,  
dhokum/llokum, dhudhë/llullë, dhupës/llupës etj.

**shkruhet**

llambë, llucë, llaç  
llukanik, veshllapush  
llokum, llullë, llupës etj.

**Thuhet****o/a**

kom/kam, jom/jam, Tirona/Tirana  
Elbasoni/Elbasani, mor/marr, fol/flas etj.

**shkruhet**

kam, jam, Tirana, Elbasani  
marr, flas etj

**Thuhet****a/ë**

baj/bëj, rana/rëra, gjana/gjëra,  
hana/hëna, kamba/këmba,  
më pak/më pak, nana/nëna  
nanta/nënta, zani/zëri etj

**shkruhet**

bëj, rëra, gjëra  
hëna, këmba,  
më pak, nëna  
nënta, zëri etj

**Thuhet****o/ë**

boj/bëj, gjo/gjë, koma/këmba  
zoni/zëri, rona/rëra, nona/nëna etj.

**shkruhet**

bëj, gjë, këmba, zëri  
rëra, nëna etj.



## PJESA IV:

### ■ Mjetet dhe materialet didaktike

#### Mjete mësimore që mund të përdoren gjatë punës me Paraabetaren





Për punën me Abetaren “Shkronjë pas shkronje” rekomandohen mjete alternative, të cilat mund të sigurohen sipas kushteve të shkollës, klasave dhe rajonit përkatës.

Për ta lehtësuar dhe për të mos e standardizuar punën për gjetjen dhe përdorimin e mjeteve mësimore, ne rekomandojmë për mësuesit mjete si më poshtë, të cilat janë:

Tabela plastike. (Prodhim kinez, që ka një fushë, në të cilën nxënësit mund të shkruajnë dhe vizatojnë duke i ndrequr dhe ribërë shkrimet e tyre sa herë të duan dhe si duan. Kjo tabelë është e tillë që mund të përdoret për shumë detyra mësimore, shkrimi, vizatimi, numërimi etj., shumëfunktionale.)

- Libra për fëmijë me përralla, tregime, vjersha, gjëegjëza.
- Krijimi i minibibliotekës së klasës (krijohen kutitë me libra për çdonjërin nxënës).
- Mjete të ndryshme vizatimi, lapsa me ngjyra, shkumësa me ngjyra.
- Shkronja plastike të mëdha ose të vogla.
- Tabela e alfabetit, në një vend të dukshëm në klasë.
- Alfabeti për çdo nxënës në formë fizarmonike, në çdo faqe, një shkronjë, një figurë dhe një fjalë apo fjali.
- Pazëlla të ndryshme, ngjitja e të cilave krijon fjalë, fjali dhe figura.



Shkronja lëvizore, mësuesi mund të përdorë në rastet kur ka nxënës me shumë vështirësi. Në rastin e Abetares “Shkronjë pas shkronje”, tabela plastike zëvendëson punën me shkronjat lëvizore. Ajo është shumë e rëndësishme si gjatë punës me Paraabetaren, ashtu edhe gjatë punës me Abetaren.

#### Mjetet kolektive të punës në klasën e parë

Klasa e parë duhet të ketë pamjen e një klase që tregon se atje punohet dhe mësohet, lexohet dhe shkruhet. Në klasë duhet të bihen në sy raftet, tavolina dhe kënde, si:

- Këndi i librave
- Këndi i mjeteve të shkrimit
- Këndi i dramës
- Alfabeti i gjuhës shqipe me shkronja të mëdha, të dallueshme, të lexueshme dhe me ngjyra.
- Alfabeti me shkronjat e dorës, të vogla dhe të mëdha.
- Tabela plastike
- Tabela magnetike
- Lojëra dhe kuti me pazëlla me figura që lidhen me përralla dhe shkronja për t'i riformuar.
- Mjete për vizatim dhe zbatim, mjete punëdore.

### Librat që rekomandohen të përdoren gjatë punës me Abetaren

- Libra të vegjël
- Libra me shumë figura
- Libra me pak fjalë, por me shkronja të mëdha.
- Rekomandohet që librat të zgjidhen nga vetë mësuesi ose prindërit.
- Duhet të pasurohen çdo ditë.
- Çdo nxënës duhet të kontribuojë në pasurimin e bibliotekës.
- Çdo nxënës duhet që gjatë vitit të blejë rreth 3-4 tekste.

### Detyrat e shtëpisë

1. Përmes detyrave të shtëpisë synohet:

- Të plotësojnë veprimtari të lexuari dhe të shkruari për të përforcuar ato që kanë punuar gjatë ditës në klasë.
- Të aftësohen dhe të fitojnë shprehje më të mira lexim-shkrimi.
- Të mbajnë gjallë procesin e leximit dhe të shkrimit.

2. Gjatë realizimit të detyrave të shtëpisë, nxënësit:

- nuk duhet të mbingarkohen me detyra të shumta dhe pa kuptim;
- nuk duhet të stresohen dhe krenohen në rastet kur nuk i kryejnë në kohë dhe me cilësinë e duhur;
- nxënësve u duhet dhënë detyra e nevojshme, koha e duhur dhe vendi i duhur;
- Kur në shtëpi nuk mund ta kryejë një detyrë të caktuar, ai mund ta kryejë ditën tjetër në klasë, nën mbikëqyrjen e mësuesit.

### 3. Në klasën e parë, nxënësi që mëson me Abetare, duhet të mësojë në shtëpi jo më shumë se 1 orë (aktivitete të lexuari, por edhe detyra shtëpie me shkrim)

3. *Nxënësi do të bëjë detyrë shtëpie ato ushtrime dhe atë volum pune aq sa ka nevojë.* Nuk është e

nevojshme që të gjithë nxënësit të punojnë njësoj dhe në mënyrë të barabartë për leximin dhe shkrimin në shtëpi.

4. *Nxënësit mund të stërviten në shtëpi ose në klasë me detyra shtesë për aq sa ata munden dhe kanë nevojë, pa u mbingarkuar.*

5. *Mësuesit dhe prindërit duhet të orientojnë nxënësit të bëjnë ato veprimtari leximi dhe shkrimi për të cilat ata kanë nevojë.*

6. *Rekomandohet që si mësuesi, ashtu edhe prindi të mos i kalojnë fëmijët në detyra të reja për leximin dhe shkrimin, pa u siguruar se i kanë përvetësuar ato të mëparshmet.*

7. *Mësuesi këshillohet që në klasën ku ai punon, të punojë me grupe nxënësish për detyra dhe nevoja të njëjta të fëmijëve, duke i ndihmuar dhe specifikuar ato.*

8. Nga Abetarja e Punës, nxënësit i jepen si

detyrë shtëpie ushtrime të caktuara, për të cilat mësuesi mendon se ai mund t'i kryejë në shtëpi ose të ribëjë ushtrime, të cilat nuk i ka kryer mirë në klasë.

9. Ushtrime të caktuara nga Abetarja e Punës, që mund të mos jenë përfunduar në orët e caktuara, mund të rimerren dhe përfundohen në orët e përsëritjeve, por edhe si detyra shtëpie në kohë të caktuara.

10. Për ushtrimin e fëmijëve për punë të paruar, përveç librit të punës, mund të përdoren edhe fletore të tjera të çfarëdollojshme me vija. Në përdorimin e tyre nuk ka kufizime. Mësuesi mund të zgjedhë dhe

rekomandojë fletore shkrimi të ndryshme.

11. Në detyrat e shtëpisë është e rëndësishme që të fillojmë t'i ushtrojmë fëmijët të shkruajnë saktë dhe të përkthejnë me shkrim mendimin e tyre, përmes ushtrimeve që u rekomandohen, si dhe përmes Abetares së Punës, situatave të ndryshme të të folurit, për të cilat duhet të përgjigjen me shkrim, kur pyeten apo u kërkohet të japim përgjigje.

## PJESA V: Fjalori

<b>A</b>	bagëti	bri	dal	ekran	fluskë
adresë	bajame	brumë	dafinë	ekskursion	fokë
aeroplan	bakllava	byrek	dalëngadalë	Elbasan	forcë
aeropot	balash	bukë	dallgë	elektrik	formë
i/e afërt	balet	i/e bukur	dardhë	emër	i/e fortë
aftësi	balonë	i/e butë	darkë	emigrant	fortesë
agresiv	baltë	buzë	dasmë	end	foshnjë
agrumë	balluke	burrë	daulle	enjte (e)	fotografi
ai/ajo/ata/ato	ballë	bukëpjekës	degë	erë	fqinj
ajër	ballkon		dele	errësirë	francez
akrep	banane	<b>C</b>	derdh	i/e errët	frenim
ende	banesë	i/e cekët	derë	etje	frikësoj
akull	bankë	cep	derr	(ie) etur	front
i/e akullt	banoj	cifla	det		frutë
akullore	banjë	cigare	detyrë	<b>Ë</b>	fruth
akuarium	i/e bardhë	cik	dëftesë	i/e ëmbël	fryj
album	bark	cilido	djeg	ëmbëlsirë	frymë
alfabet	bastun	qipë	diktim	ëndërr	fshat
alpe	bashkë	cirk	dikur	ënjtem	fshatar/e
ambulancë	bashkim	ciu-ciu	dikujt	është	fsheh
amerikan	bebi	cjap	dimër		fshesë
amtar/e	befasi	copa-copa	disa	<b>F</b>	fshij
andej	berber	copëtoj	djalë	fabrikë	ftesë
anë	besë	cullufe	djathtas	faj	ftoj
anë/sor	bërtas		dollar	fiks	ftohje
anëtar	bëj	<b>Ç</b>	domate	filxhan	fuçi
anije	bërryl	çadër	dorë	fill	fund
antenë	bërthamë	çaj	dredh	filloj	fuqi
apartament	bibliotekë	çajnik	drejtim	firmos	i/e fuqishëm
armë	biçikletë	çakmak	dritare	fis	furçë
atlet	biletë	çalaman	dritë	fishek	furi
ar	bilbil	çantë		fishekzjarr	furtunë
ari	birrë	çarçaf	<b>Dh</b>	fitoj	furrë
arbëresh	birila	çarje	dhallë	fitil	furrëtar
ardhje	bimë	çatia	dhe	fizarmonikë	fustan
arkë	binjak	çdo	dhé	fjalë	fushë
arë	bisedë	çel	dhelpër	fjali	futem
arrë	bisht	çelës	dhëmb	fjalor	futboll
asaj	bjeshkë	çekiç	dhëndër	fletore	fyej
asgjë	blej	çfarë	dhi	flak	fyell
asnjëri	blu	çezmë	dhjamë	flakë	fyt
asnjëherë	bluzë	çibuk	dhjetë	flamur	fytyrë
aspak	bllok	çift	dhjetor	flas	
atdhe	bodrum	çifte	dhuroj	fle	<b>G</b>
atij	borë	çifteli	dhuratë	fletë	gabim
autor	bosh	çikrik	dhomë	flokë	gafë
	breg	çoban		flokëtore	gajas
<b>B</b>	bregdet	çorape	<b>E</b>	flori	garë
baba	brenda		ecje	flutur	gardh
babagysh	breshka	<b>D</b>	edhe	fluturim	gati

gatim	gjel	helm	invalid	kapedan	kitarë
gatit	gjelbër	hendek	iriq	kapelë	kjo
gaz	gjellë	heq	italian	kap	klasë
gazetë	gjemb	herët		kapërcej	klimë
gazmor	gjej	hero	<b>J</b>	kapiten	klithmë
gëlqere	i/e gjerë	i/e hershëm/me	ja	i/e kapshëm/me	kockë
gëlltit	Gjermani	hesht	jaka	kapëse	kohë
gënjej	gjethe	hënë (e)	jam	kapuç	kokë
gënjeshtar/e	gjë	hiç	jap	kaq	kokërr
gërmoj	gjëegjëzë	hiçgjë	janar	karafil	kollë
gërshet	gjilpërë	higjienë	japonez	karamele	kollluk
gërhimë	gjinkallë	hije	jastëk	karkalec	komb
gërvisht	gjithë	i/e hijshëm/me	jashtë	karotë	kombinat
gështenjë	i/e gjithë	hile	javë	karvan	komçë
gëzim	gjobë	hileqar	jelek	karrige	komik/e
gëzoi	gjoks	himn	jehonë	karro	komodinë
gëzhojë	gjuaj	hinkë	jetë	kasap	komunë
gic	gjuetar	hip	jetim	kasatë	komunikim
gisht	gjueti	hi	jetoj	kasolle	konkurs
glob	gjuhë	i/e hirtë	jetimore	kat	kope
godas	gjurmë	histori	jorgan	katër	kopje
godinë	gjym	hithër	juaj	kaush	kopsht
goditje	gjymtyrë	hoje	jug	Kavajë	kopshtar
gojë	gjyq	i/e hollë		kazan	kor
gomar	gjysmë	hollësi	<b>K</b>	kazmë	korb
gonxhe	gjyshe	holloj	kabinë	kërce	Korçë
gosti		hop	kaçavidë	kek	kornizë
Gostivar	<b>H</b>	horizont	kaçkavall	i/e keq/e	korr
gotë	ha	hotel	kafaz	këlysh	korrije
gozhdë	habi	hua	kafe	këllëf	kos
Gramsh	hajdut	i/e huaj	kafshatë	këmbë	Kosovë
Greqi	hak	huazim	kafshë	kënd	Kosovar/e
grep	halë	humb	kakao	këndo	koshere
grimcë	hall	humbje	kakarit	këngë	kostum
grij	hallë	hundë	kala	këpucë	kovë
gris	hallvë	hurme	kalendar	këput	krah
gropë	hap	hyj	kalë	kërcas	kraharor
grua	hap, -i	hyrje	kalorës	kërcej	kreh
grurë	hapem		i/e kaltër	kërcet	krejt
grumbull	i/e hapur	<b>I</b>	i/e kalueshëm	kërkesë	krem
grumbulloj	harabel	ibrik	kallam	kërkoj	krenar
grup	hardhi	idiot	kallëz	kërmill	krevat
grusht	hare	ik	kalli	kërpudhë	krimb
grykë	hark	ilaç	kallo	kësaj	i/e kripur
gur	harkëtar	ilir	kam	kësulë	krutan/e
gushë	harmonikë	ilustrim	kamera	këshillë	krushk/ë
gusht	hartë	im/e	kamion	këshilloj	krye
guxim	harxhoj	i/e imët	kamomil	kështjellë	kryeqytet
	harraq	imitim	kamp	kështu	kryetar
<b>GJ</b>	harresë	imitoj	kampion	këta	kryq
gjah	harroj	i/e imët	kanal	kikirik	kthej
gjak	hasëm	inat	kandil	kilogram	kub
gjalm	hatër	inatos	kangur	kinema	kudo
gjalpë	hedh	indian	kanistër	kinez	kufomë
i/e gjallë	hekur	infeksion	kap	kinkaleri	kujdes
gjashtë	hekuros	insekt	kapak	kishë	kujtim

kujtoj	lavdërim	lumtë (të)	mat	minare	ndërpres
kulaç	leckë	lundrim	matematikë	ministër	ndërtoj
kulm	leh	luspë	mbaj	minutë	ndiej
kullë	lehje	Lushnjë	mbarim	mirë	ndihmë
kullotë	i/e lehtë	lutje	mbaroj	miqësi	ndihmëse
kundër	leje	lyej	mbath	mirëdita	ndikim
kupë	lejlek	lypës	mbes	mirëpo	ndizem
kuptoj	lek	lagje	mbesë	misër	ndiej
i/e kuq/e	lemzë		mbeturinë	mistrec	ndjek
kur	lë	<b>LL</b>	mbërthej	mish	ndjell
kurdoherë	leopard	llaç	mbështet	mizë	ndjenjë
kureshtar	lepur	llafazan	mbështjell	mjaft	ndjeshmëri
kuroj	lesh	llamarinë	mbjell	mjaltë	ndodh
kurorë	letër	llambë	mbjellje	mjegullë	ndokush
kursej	leverdi	llapush	mbledh	mjek	ndonjë
kurrë	lëkund	llastik	mbllaçit	i/e mjerë	ndonjëherë
kurriz	lëkurë	llasticë	mbrapsht	mjerim	ndot
kthim	lëmë	llogari	mbret	mjet	ndreq
kusar	lëmsh	llokum	mbrëmje	mobilje	ndriçim
kusur	lëng	llucë	mbrohem	model	ndrin
kurrkush	lëpij	llum	mbroj	modern/e	ndrit
kushedi	lëshoj		mbuloj	mohim	i/e ndritur
kushëri	lëviz	<b>M</b>	mburr	mollë	ndryshe
kusht	lëvozhgë	mace	mburrje	mos	ndryshk
kushton	libër	maçok	mbush	mposht	ndyj
kush	lice	i/e madh	mbyll	motër	ne
kuti	lidh	magazinë	mbyllur	mot	nerv
kuvertë	lidhje	magnet	mbytem	motor	nesër
kuzhinier	i/e lig/ë	magji	me	mullar	natë
ky	ligj	mahnit	megjithatë	mund	nevojë
kyç	limë	Maj	megjithëse	mundoj	në
	limon	i/e majm/ë, e	mekanik	mungesë	nën
<b>L</b>	lindje	majmun	melodi	mungoj	nëntë
lab	liqen	majtë (e-)	memec	mur	nëpër
Laç	i/e lirë	makinë	i/e mençur	murator	nëse
lag	lireta	makinist	mençuri	muskul	ngacmoj
lagje	liria	mal	mendim	mustaqe	ngadalë
lahutë	lis	malësi	menjëherë	mushkë	ngadalësoj
laj	listë	malor	meqenëse	mushkëri	ngado
lajm	litar	mall	marr	mushkonjë	ngarkoj
lajmërim	lodër	mallkim	merak	muzikë	ngas
lajmëtar	lodhem	mama	mermer		ngel
lak	lojtar	mami	mes	<b>N</b>	ngop
lakim	lojtar	man	metale	na	ngre
lakmitar	lopatë	mandolinë	metër	naftë	ngricë
lakmues	lopë	manastir	mërkurë (e-)	natë	i/e ngrirë
lakuriq	lot	manushaqe	mëmë	natyrë	ngrohës/e
lakror	luaj	Maqedoni	mëngjes	ndaj	i/e ngrohtë
lakër	luadh	marangoz	mërgim	ndarje	i/e ngrysur
lamtumirë	luan	martesë	mërzit	nder	ngul
laps	lugë	martë (e-)	mësim	nderoj	ngulit
laraskë	lule	marr	mësues	ndesh	i/e ngulur
larg	lulëzohj	maskë	mëz	ndez	i/e ngushtë
larje	lulishte	mashë	midis	ndër	ngjaj
i/e lartë	lum	mashkullor	miell	ndërhyj	ngjalë
lartësi	lumturi	mushkë	mik	ndërmjet	ngjall

ngjarje	<b>P</b>	parashutë	i/e përbërë	pjell	puth
ngjitëse	pa	parashkollor	përbuz	pjesë	pyll
ngjyiej	i/e paaftë	parmak	përcjell	pjeshkë	pyetje
ngjyrë	pabesi	park	përdor	plaçkë	
nis/nisem	padron	parmendë	përditë	plagë	<b>Q</b>
nismë	padjallëzi	pas	përfitim	plakë	qafë
nishan	i/e paedukatë	pasagjer	përgjigje	plas	qaj
nivel	pafaj	pasaportë	përgjithmonë	plep	qarkoj
nofull	pafajësi	pasnesër	përgjysmë	plis	i/e qartë
normal	i/e pafat	pasoje	përhap	plot	qejf
notar	pafundësi	pasqyrë	përgashta	pluhur	qeleshe
notë	pagë	pastaj	përleshje	pllakë	qelq
nuk	pagëzot	pastë	i/e përlotur	po	qiell
numër	paguaj	i/e pastër	përmbaj	poç	qen
numëroj	pagjumësi	pastërri	përmbi	poet	qendër
nuse	pahir	pastroj	përmbledh	poezi	qengj
nxe	pajë	pastrim	përmbys	polic	qep
nxij	pajis	i/e pasur	përmirësoj	popull	qepallë
nxënës/e	pajtim	pasuroj	përngjit	popullsi	qepë
nxit	pak	Pashkë	përngjas	port	qeras
nxjerr	paketë	i/e pashpirt	përparim	portë	qeros
nyjë	pakësoj	patate	përparoj	portofol	qerpik
	pako	patina	përpjij	portokall	qersh
<b>Nj</b>	i/e pakrehur	patok	përpiqem	postë	qerre
Një	pakujdesi	Patos	përppjekje	i/e poshtër	qesh
njeh	palaço	patriot	përjetë	poshtë	i/e qetë
njësoj	palcë	i/e pathyer	përplas	pra	qeth
njëherë	palë	pauzë	përppjetë	prag	që
i/e njëjtë	palmë	pavarësi	përqqafim	praktik/ë	qëlloj
njëllonj	palos	i/e pavlerë	përsëritje	pranë	qëndis
njëmbëdhjetë	pallat	pazar	përsipër	pranoj	qëndrim
njëqind	pallto	i/e pazier	përsos	prapa	qëndroj
njëri/njëra	pallua	pe	përtac	prapë	qëroj
njësh	pambuk	pecetë	përtej	prehër	qiell
njëzet	pamje	pelë	përtokë	prej	qilim
njoftim	i/e pamundur	pellg	përveç	prek	qime
njoh	panair	pemë	përvëlloj	premtë (e-)	qind
njollë	i/e pandarë	pendë	përzë	premtim	qingj
i/e njomë	panoramë	pengesë	përziej	prerje	qiri
njomëz	panxhar	perde	përrallë	pres	qortoj
	i/e paparë	perëndi	pëshpërit	president	qortim
<b>O</b>	i/e papastër	perëndoj	pësoj	presh	qoshe
objekt	papjekuri	person	pështyj	prish	quaj/quhem
obobo	papritmas	perime	pi	Prishtinë	qull
oborr	i/e papritur	pesë	piano	pritë	qumësht
opera	i/e papunë	pesëmbëdhjetë	pianist	prindër	qymyr
opingë	i/e paqartë	pesëqind	pickoj	prodhim	qypi
oqean	paqe	peshë	pikë	provë	qyqe
ora	i/e paqetë	peshk	pikturë	puçërr	qysh
orari	i/e paqenë	petë	pilot	pulë	qytet
oreks	para	petulla	piqem	pudër	
origjinal	parà	pëlças	pirun	pullë	<b>R</b>
oxhak	paradite	pëlhurë	pis	punë	radio
orkestër	parajsë	pëllëmbë	pishinë	pus	radhë
	paraqes	pëllumb	pjatë	pushkë	raft
	parashikim	përballë	pjek	pushim	raketë

raki	rrobaqepës/e	skuq	shënim	shpoj	term
rast	rrobë	i/e skuqur	shërbej	shportë	terr
re	rrotull	sobë	shëroj	shpreh	tetë
reçel	rroftë	sokak	shfaq	shpresë	teto
rehat	rrogos	Sokol	shfryj	shpullë	teze
regjistër	rroj	sorrë	shi	shqep	tënde
reklamë	rrojtoje	i/e sot/ëm, me	shihem	Shqipëri	tërbim
rend	rrok	spango	shij	shqiponjë	i/e tërë
respekt	rrokje	spinaq	shikoj	shqit	tërheq
revistë	rrotë	spital	shiringë	shquaj	tërmet
restorant	rruazë	sport	shirit	shtatë	tifoz
i/e rëndë	rrudhë	sqarim	shishe	shtrat	tigan
rënkim	rrugë	sqep	shkabë	shteg	tigër
rënkuj	i/e rrumbullaktë	sqetull	shkallë	shtazë	i/e tij
rërë	rrush	stallë	shkas	shtet	i/e tillë
i ri/e re		stadium	shkel	shtesë	timon
rigë		stërgjysh	shkelës	shtëpi	tip
rigon	<b>S</b>	stërvitje	shkelm	shtie	Tiranë
ring	sa	stilograf	shkëlqim	shtrembëroj	tiranas/e
rini	i/e saj	stinë	shkëmb	shtrëngoj	titull
riparim	sajoj	stof	shkëmbej	shtrij	tjegull
robot	sakrificë	stol	shkëmbim	shtrydh	tjetër
rojë	i/e saktë	stop	shkëput	shtyllë	tmerr
rol	saktësi	stomak	Shkodër	shtyp	tokë
rosë	salcë	strehë	Shkodran/e	shuaj	top
rosak	sallë	studio	shkoj	shumë	tortë
ruaj	sallon	sulmoj	shkop	shul	i/e trashë
rus/ e	samar	sulem	shkrim	shurdh	tre
	sandale	supë	shkrep	shurdhoj	treg
	sapo	sy	i/e shkretë	shkronjë	tregim
<b>RR</b>	sapun	synoj	shkrij		tregti
i/e rrallë	sardele	syth	shkul	<b>T</b>	trekëndësh
rrap	sasi	syze	shkumë	tabak	tresh
rreth	satelit	supermarket	shkund	tabaka	triko
rrecka	secili	studim	shkurtim	tabelë	trime
rregull	sjell		shndrit	taka	trondit
i/e rremë	sillem	<b>SH</b>	shoh	takim	tru
rrepë	sekondë	shah	shok	tall	truall
rresht	sekret	shaj	shoqe	tamam	trup
rreze	semafor	shaka	shoqëroj	tanë	tub
rrezik	send	shalë	shoshë	tani	tuaj
rrëfej	serë	shalqi	shpatë	i/e tanishëm	tryezë
rrëke	serioz	shami	shpejtësi	tapë	tul
rrëmbej	seri	sharrë	shpellë	tas	tullac
rrëmujë	sëmurë	shat	shpend	tashmë	tullë
rrënoj	sëpatë	shef	shpejt	tavan	tund
rrënjë	sfungjer	shegë	i/e shpejtë	tavë	tunel
rrëshqas	sfurk	shekull	shpesh	te	turist
rrëzë	siguresë	shembull	i/e shpeshtë	tek	turp
rrëzuj	sikur	shërbet	shpëlaj	tekst	Turqi
rri	simpati	shes	shpërblej	tel	tym
rrip	sillem	shesh	shpërblim	telefon	tyl
rripa-rripa	sjellje	sheshoj	shpëtim	telegram	tytë
rrit/em	skaj	shëmti	shpëtoj	temperaturë	
rrjep	skllav	shëmtoj	shpinë	teneqe	<b>TH</b>
rrjetë	skulptor	shëndet	shpirt	tepër	

thaj/thahem	vajguri	vizitor	yt
thanë	vajzë	vizore	
tharëse	i/e vakët	vjedh	<b>Z</b>
i/e thatë	vaksinoj	vjel	zagar
theks	valë	vjell	zagori
thelb	valle	vjershë	zakon
i/e thellë	vapë	vjeshtë	zambak
them	var	i/e vjetër	zanat
thembër	i/e varur	vjollcë	zar
themel	varr	vlerë	zarf
ther	vath	vloj	zbardh
therje	vëth	vlonjat/e	zbarkim
thes	vazo	i/e vogël	zbatoj
thesar	vdekje	vonë	zbatues
thikë	veç	i/e vonë	zbath
thërras	i/e veçantë	votë	zbavit
thith	vegël	vrap	zbeh
i/e thjeshtë	vello	vrapim	zbërthej
thumb	velenxë	i/e vrarë	zbraz
thupër	vend	vras	zbritje
thur	vendbanim	vrer	zbut
thërrime	vendos	vrinë	zdrukth
thyej	veprim	vrull	zebër
	verbëri	vuaj	zemër
<b>U</b>	i/e verdhë	vulë	zero
ububu	verë	vullnet	i/e zezë
udhë	ves		zë
udhëtim	vesh	<b>X</b>	zënkë
udhëtar	veshje	xanxar	zgjat
ujë	veshkë	xanë	zgjedhje
ujit	vete	xixë	zgjuaresi
ujk	vetëm	xixëllim	zile
ul/ulem	vetjak	xurxull	zili
ulërimë	vezë	xixëllimë	zinxhir
ulje	vë	xixëllon	zjarr
ulli	vëlla	xixëllonjë	zog
unazë	vërej		zonjë
ungj	vërejtje	<b>XH</b>	zorrë
urdhër	i/e vërtetë	xhaketë	zotëri
urë	vërtit	xhami	zotëroj
urgjent	vrinë	xhaxha	zvarrit
i/e urtë	vështrim	xhelat	zymbyl
urra	vëth	xhep	zyrë
urrej	vëzhgoj	xhezve	zyrtar
ushqej	vidë	xhiro	
ushqim	vidhos	xhufkë	<b>ZH</b>
ushtar	vigan	xhungël	zhabë
ushtrim	vij	xhup	zhavorr
uthull	vilë	xhuxh	zhurmë
uzinë	viktimë	xhuxhmaxhuxh	zhdëp
	vinç	<b>Y</b>	zhdredhje
<b>V</b>	violinë	yha	zhduk
vadit	vit	yll	zhubros
vaditje	vizatim	ylber	zhul
vagon	vizë	yllkë	zhvendos
vaj	vizitë	yndyrë	zhvesh